GUILLAUME MUSSO

SEPSE TË DUA

- ROMAN -

~~3rj0n1xx~~

Nuk ka asgjë më të mirë se sa një roman
për të kuptuar
se realiteti është i gabuar,
se ai nuk është i mjaftueshëm
për të përmbushur dëshirat,
orekset, ëndrrat njerëzore.

MARIO VARGAS LLOSA

1

Nata
ku filloi e gjithë kjo histori

Ne duhet të mësohemi:
në kryqëzimet më të rëndësishme
të rrugëve të jetës sonë,
nuk ka asnjë tabelë treguese.
- ERNEST HEMINGWAY

Dhjetor 2006

Është nata e Krishtlindjeve, mu në zemër të Manhatanit...

Bora po bie pa pushim që nga mëngjesi. I mpirë prej të ftohtit, "qyteti që nuk fle kurrë", duket sikur po lëviz me ngadalë, pavarësisht nga një vërshim ndriçimesh.

Për një natë të tillë feste, qarkullimi është çuditërisht i rrjedhshëm, ku shtresa me baltë e borës në rrugë si dhe shtjellat e trasha vështirësojnë akoma edhe më çdo lloj manovrimi të makinave.

Në kryqëzimin e Medison Avenju, Rruga nr. 36, limuzinat

vargojnë njëra pas tjetrës me një ritëm konstant. Ato shkarkojnë klientët e tyre para sheshit të një ndërtese të stilit të Rilindjes, aty ku ndodhet edhe selia e *Morgan Library*, një nga fondacionet kulturore më prestigjioze të Nju Jorkut, që sot feston njëqind vjetorin.

Në shkallët e saj të mëdha vihet re një pështjellim smokingësh dhe fustanesh të kushtueshëm, veshje gëzofi dhe bizhuterish. Turma përqëndrohet në drejtim të një pavijoni prej xhami dhe prej çeliku i cili përgjaton ndërtesën për ta vendosur atë në harmoni me shekullin e XXI. Në katin e sipërm, një korridor i gjatë të çon drejt një salle të madhe, ku prapa vitrinave, janë ekspozuar disa nga thesaret e këtij institucioni: një Bibël e Gutenbergut, dorëshkrime të zbukuruar të Mesjetës, vizatime të Rembrandit, të Leonardo da Vinçit dhe të Van Gogut, letra të Volterit dhe të Ainshtajnit, madje edhe një copë napë prej letre mbi të cilën Bob Dilan shkroi fjalët e *Blowin'in the Wind.*

Të vonuarit nxitojnë të zënë vendet e tyre. Biblioteka pothuaj është zbrazur plotësisht për të organizuar koncertin e violinistes Nikolë Hetëuej e cila do të interpretojë sonata nga Moxarti dhe Brahmsi.

Artistja hyn në skenë e shoqëruar nga duartrokitjet e të pranishmëve. Ajo është një grua e re, rreth të tridhjetave, me një pamje elegante dhe serioze. Flokët e mbledhura topuz në stilin e Greis Kellit, i japin asaj pamjen e një heroine hiçkokiane. E suksesshme dhe e brohoritur në skenat ndërkombëtare, ajo ka luajtur me orkestrat më të mëdha dhe, disku i saj i parë ka dalë kur ishte 16 vjeçe dhe pati një sukses të madh. Pesë vjet më parë, një dramë i shkatërroi jetën. Shtypi dhe televizioni u morën shumë me këtë çështje, dhe, që nga ajo kohë, njohja e

saj e ka kaluar prej kohësh numrin e të pasionuarve të muzikës.

Nikola përshëndet publikun me elegancë. Bukuria e saj klasike përputhet për mrekulli me ndërtesën elegante sikur violinistja do të zinte natyrshëm vendin e saj në mes të skulpturave dhe gravurave antike dhe dorëshkrimeve të Rilindjes. Me një kontakt të pastër e të plotë harku i violinistes gjen menjëherë dialogun me telat dhe kjo do të vazhdojë deri sa Nikola të mbarojë koncertin. Ndërsa jashtë vazhdon të bjerë borë, këtu brenda çdo gjë është e ngrohtë e luksoze.

* * *

Jo më shumë se pesë metra prej këtu, jo shumë larg nga stacioni i metrosë Grand Central, dikush shtyn ngadalë një kapak të ujërave të zeza, nga ku shfaqet një kokë me një mjekër, me shikim të përhumbur dhe me një fytyrë të vrarë e të dërrmuar nga goditjet...

Pasi ka nxjerrë më parë që aty një qen, një Labrador me qime të zeza, të cilin e mbante në krahë, një burrë mezi çapitet në trotuarin e mbushur me borë. Ai kalon rrugën duke u lëkundur e duke i shpëtuar shtypjes nga makinat në mes të një kori borish.

I dobët e i drobitur, ky endacak ka veshur një pallto të pisët dhe të shpifur. Kur ndeshet përballë me kalimtarë, këta nxitojnë hapin dhe largohen me të shpejtë prej tij.

Kjo është normale. Ai e di që ata tremben prej tij, sepse mban era zhul, shurrë dhe djersë.

Është vetëm 35 vjeç por duket sikur është 50. Në të kaluarën, ai kishte një punë, një grua, një fëmijë dhe një shtëpi. Por kjo ishte shumë kohë më parë. Tani, është thjesht një hije

që bredh, një fantazmë e mbështjellë me lecka që belbëzon fjalë të pakuptimshme.

I merren këmbët e mezi mban ekuilibrin.

Çfarë dite është sot? Sa është ora? Në ç'muaj jemi? Ai nuk e di. Çdo gjë është rrëmujëshëm në kokën e tij. Në sytë e tij, duket sikur dritat e qytetit po treten. Flokët e ngrirë të dëborës të shtyrë nga era ia mbështjellin fytyrën dhe i shkaktojnë një dhimbje sikur të merrte goditje me thika. Këmbët janë të mardhura, stomaku plot dhimbje dhe kockat e gjymtyrëve gati për t'u shkërmoqur.

U bënë dy vjet që ai ka braktisur shoqërinë njerëzore për t'u varrosur në të përbrendshmet e qytetit. Si mijëra endacakë të tjerë, ka gjetur strehë në zorrët e metrosë, të ujërave të zeza dhe të hekurudhës. Të mos shqetësohen qytetarët dhe turistët: Politika e tolerancës zero e shpallur me pompozitet nga bashkia i ka dhënë frytet e saj, duke pastruar me kujdes Manhatanin në sipërfaqe. Por poshtë qiellgërvishtësve plot vezullim, në nëntokë vibron një jetë paralele: një Nju Jork plot rrënoja njerëzore që ujisin një rrjet të gjerë tunelesh, strofullash dhe zgavrash. Janë me mijëra "njerëz-minj", të hedhur në gropat e qytetit që i druhen represionit policor.

Burri kontrollon në xhep dhe nxjerr prej aty një shishe me alkool të keq. Gëlltit një gllënjkë. Si mund të bëjë ndryshe? Si mund ta harrojë jetën e tij të mëparshme?

* * *

Nikola ekzekuton edhe lëvizjen e fundit të harkut. Hapësira ndërmjet dy kohëve, një heshtje e përmbajtur, qëndron pezull në mes të të pranishmëve. Kjo heshtje e

famshme që pason Moxartin, që mendohet të jetë edhe ajo Moxart, dëbohet më pas nga duartrokitjet e fuqishme.

Violinistja përkul kokën lehtë, pranon një tufë me lule pastaj lëviz nëpër sallë për të marrë urimet e pafundme. Megjithëse të ftuarit ishin entuziastë, Nikola e di shumë mirë që paraqitja e saj sot nuk qe kushedi se çfarë. Ajo i ekzekutoi këto sonata me një teknikë të përkryer, me një pastërti të pashoqe dhe me shumë saktësi. Por, nuk luajti me shpirt.

E përhumbur siç është, shtrëngon duart në mënyrë mekanike, njom pak buzët në një gotë shampanjë, dhe, që tani, kërkon të largohet që aty.

- Do që të kthehemi shpirt?

Ajo kthehet ngadalë në drejtim të këtij zëri të sigurt. Eriku, miku i saj, ndodhet përballë, me një gotë Martini në dorë. Ky avokat biznesi jeton me të që prej disa muajsh. Duke qenë gjithmonë i kujdesshëm, ka ditur të jetë pranë saj në çastet kur ajo ka pasur nevojë.

- Po, kthehemi, po më merren mendtë. Më ço në shtëpi. - Duke i paraprirë përgjigjes së saj, ai nxiton për në drejtim të garderobës dhe i zgjat pallton të cilën ajo e vesh menjëherë.

Pasi Nikola përshëndetet me të pranishmit, ata shpejtojnë të zbresin shkallët prej mermeri, ndërsa mbrapa tyre festa vazhdon.

- Të kërkoj një taksi, - propozon Eriku, kur gjenden në hollin përpara hyrjes. - Unë po shkoj të marr makinën time në zyrë dhe takohemi në shtëpi.

- Po vij me ty, nuk është larg, nuk duhen më shumë se pesë minuta.

- As që bëhet fjalë. E shikon ç'kohë e llahtarshme është?

- Kam nevojë të ec pak dhe të thith pak ajër të pastër.

- Por kjo është rrugë e rrezikshme!

- Që kur qenka bërë e tmerrshme të bësh treqind metra në këmbë? Pastaj pse të kam ty?

- Si të duash.

Ata drejtohen nga Avenjuja e Pestë duke nxituar nga i ftohti therës. Bora vazhdon të mbulojë qytetin me flokë të rëndë e të qetë.

Tani, vetura e tyre është vetëm njëqind metra larg, mbrapa Briant Park. Kur bën kohë e bukur, ky vend ofron një kënd të këndshëm gjelbërimi, ideal për një ndalesë në shoqërinë e diellit, një piknik ose një lojë shah pranë shatërvanit. Ndërsa sonte, ky vend është i trishtë, i zhytur në errësirë, i shkretë...

- Paratë!

Nikola lëshon një britmë të shkurtër.

Një thikë feks përpara syve të saj, një thikë që vringëllin si një vetëtimë.

- Paratë, të thashë! - kërcënon njeriu me thikë në dorë që u shfaq papritur

Ai duket si një njeri pa moshë, trupmadh dhe i fuqishëm. Koka e rruar i shquhet sipër xhupit të errët që i varet deri te gjunjët. Fytyra e tij e shpuar nga dy sy të veckël, të cilët shprehin një vegim prej të çmenduri, është e çarë në të gjithë gjatësinë e saj nga një shenjë e qartë.

- Më shpejt!

- Ok! Ok! - dorëzohet Eriku. Nxjerr e i jep portofolin. E pa ja kërkuar njeri Eriku i jep edhe orën e tij të dorës "Breitling" si dhe telefonin celular.

Agresori i merr ato dhe pastaj i afrohet edhe më Nikolës dhe kërkon t'i rrëmbejë çantën dhe violinën.

Muzikantja mundohet të fshehë ankthin, por nuk është

në gjendje të përballojë shikimin e këtij njeriu dhe e vetmja gjë që i mbetet për të bërë është të mbyllë sytë. Ndërsa një dorë i shkul varësen e perlave që ka në qafë, ajo fillon të thotë përmendësh alfabetin mbrapsht. Shumë shpejt. Ashtu siç bënte kur ishte fëmijë, për të zotëruar frikën.

- Z Y X W V U...

Këtë gjeti ajo si zgjidhje për të përqëndruar vëmendjen e saj te diçka, duke menduar që ky moment të ishte thjesht vetëm një kujtim i keq.

- T S R Q O P...

Tani ai do të iki. Mori ato që deshi: paratë, celularin, bizhuteritë...

- N M L K J I H...

Tani do të iki. Nuk ka pse të na vrasë.

- G F E D C B A...

Por, kur ajo hap sytë, agresori është përsëri aty dhe largon krahun për të marrë fuqi që t'i japë asaj një goditje me thikë.

Eriku e sheh gjithë këtë skenë, por rri shtangur nga frika dhe nuk bën asnjë gjest për ta mbrojtur Nikolën.

Po përse kjo nuk shpreh asnjë lloj habie që Eriku nuk po e ndihmon?

Sido që të jetë, nuk ka më kohë të lëvizë. Duke qenë spektatore e pafuqishme, shikon e hipnotizuar thikën që do t'i çajë qafën.

Kaq do të ishte jeta e saj? Me një fillim premtues, një mjedis vezullues i cili pasohet nga një zbritje në ferr dhe pastaj me një fund të llahtarshëm që vjen papritur? Ajo ka ndjesinë mizore e fatale se është një heroinë e një historie të pambaruar...

Është e çuditshme. Shpesh thuhet se në pragun e vdekjes,

njeriu shikon si me kamera të përshpejtuar çastet më të rëndësishëm të jetës së tij. Ndërsa Nikola, sheh vetëm një skenë: një plazh i pafund, sa të të hajë syri, me përjashtim të dy personave që lëvizin gëzueshëm duart në drejtim të saj. Ajo ua shquan shumë mirë fytyrat. E para është ajo e burrit të vetëm që ka dashur dhe të cilin nuk mundi ta mbante. Fytyra e dytë është ajo e së bijës të cilën nuk diti ta mbronte.

* * *

Unë kam vdekur.

Jo, akoma jo. Pse?

Dikush shfaqet nga asgjëja.

Një endacak.

Fillimisht Nikola mendon se bëhet fjalë për një sulm të dytë, para se të kuptojë që ky dikush po mundohet ta shpëtojë. Në fakt, është ky person që kërkon ta shpëtojë, i cili në çastin e fundit, pëson në shpatull një goditje me thikë. Pavarësisht nga kjo plagë e marrë, ai ngrihet menjëherë dhe sulet me furi drejt agresorit, arrin ta çarmatosë si dhe t'i marrë prenë e sapo rrëmbyer. Një ndeshje me grushte fillon të shfaqet para syve të saj, një ndeshje e ashpër dhe e pafund. Ndonëse është më i dobët, endacaku arrin të vendosë një lloj epërsie. I ndihmuar edhe nga qeni, një Labrador me ngjyrë të errët, ai e detyron agresorin t'ia mbathë.

Por fitorja e tij nuk është pa pasoja. I tejlodhur, shembet mbi borë, me fytyrën mbi trotuarin e akullt.

Nikola nxiton drejt tij duke lënë edhe një këpucë me shkëlqim në dëborë.

Ajo ndodhet pranë tij, në gjunjë, në dëborë, pranë kokës

së këtij burri që i shpëtoi jetën. Ajo shquan njollat e gjakut të përhapura në borë. Përse ky endacak rrezikoi jetën e tij për t'i shpëtuar të sajën?

- T'i japim njëzet dollarë për ta shpërblyer, - thotë fare pa takt Eriku, duke marrë përtokë kuletën e tij si dhe celularin.

Tashmë që rreziku kaloi, avokati e rigjen oratorinë e tij.

Nikola i hedh Erikut një vështrim neveritës.

- Nuk e sheh që është i plagosur?

- Epo të lajmëroj policinë.

- Në vend që të marrësh policinë bën mirë të kërkosh ambulancën mjekësore!

Nikola arrin me vështirësi ta kthejë të panjohurin me shpinë në trotuar. Me dorë i kontrollon shpatullën që vazhdon të kullojë akoma gjak, pastaj i shikon fytyrën, e cila duket sikur është gëlltitur nga një mjekër e stërmadhe.

Fillimisht nuk e dallon mirë, deri sa e ngulit shikimin te sytë e tij, dy sy të gjallë që e vështrojnë ngultas.

Paskësaj diçka shkërmoqet brenda saj. Një valë e nxehtë i përshkon gjithë qenien. Ajo nuk di të dallojë nëse është dhimbje apo lehtësim. Një dhimbje apo një shpresë po lind për Nikolën sonte.

Ajo e afron fytyrën e saj pranë së tijës si për ta mbrojtur nga vorbulla e dëborës.

- Çfarë po bën? - thotë gjithë shqetësim Eriku.

- Mbylle telefonin dhe shko merr makinën, - i jep urdhër ajo duke u ngritur në këmbë.

- Pse?

- Unë e njoh... këtë burrë.

- Ç'do me thënë kjo?

- Më ndihmo ta çojmë në shtëpinë time, - i thotë ajo, pa iu përgjigjur pyetjes së tij.

Eriku tund kokën në shenjë mosmiratimi dhe pastaj, pas një psherëtime, shton:

- Dreq o punë, po kush është ky burrë?

E përhumbur Nikola mërmërit:

- Ky është Marku, burri im.

2

E humbura

Ne jemi të mbrojtur më keq kundër
dhimbjes kur dashurojmë.

- FREUD

Nga ana tjetër e lumit duket Bruklini, ndodhet një shtëpi e vogël, me mobilim çlodhës, në një stil viktorian, e zbukuruar me frëngji dhe me ulluqet që i rrinë hijshëm...

Një zjarr bubulak kërcet në oxhak.

Akoma pa vetëdije, Mark Hetëuej ndodhet i shtrirë mbi kanape, me këmbët e mbështjella me një batanije të trashë. Doktoresha Suzan Kingston po i qep plagën e hapur në shpatull.

- Plaga është në sipërfaqe, - i shpjegon ajo Nikolës. - Ajo që më shqetëson më shumë është gjendja e tij shëndetësore në përgjithësi: ka një bronkit të ashpërsuar, ka plot hematoma në trupin e mavijosur.

Pak para mbrëmjes, në kohën që po shijonte me familjen

ëmbëlsirën e Krishtlindjeve Suzanën e mori në telefon fqinja, Nikolë Hetëuej, e cila iu lut të vinte të mjekonte burrin e saj të plagosur.

Pavarësisht se u çudit nga një telefonatë e tillë, Suzana nuk ngurroi për asnjë çast të vinte të vizitonte të sëmurin. Burri i saj dhe ajo vetë i njihnin shumë mirë Markun me Nikolën. Para tragjedisë së ndodhur pesë vjet më parë, të dy çiftet ishin miqësuar dhe shpesh dilnin bashkë duke zbuluar një e nga një restorantet italiane të Park Slope, duke rrëmuar tek antikuarët e Bruklin Heitit dhe duke vrapuar fundjavave në lëndinat e pafundme të Prospekt Parkut.

Sot kjo dukej një kohë shumë e largët, pothuajse ireale.

Me sy të ngulur te Marku, Suzana e kish të vështirë të mos vinte re se çfarë abuzimi kish bërë ai me jetën.

- E dije që jetonte rrugëve?

Nikola mohon me kokë, në pamundësi për të thënë diçka.

Një mëngjes, para dy vjetësh, i shoqi i tha se do të largohej, se ai nuk mund të jetonte më "kështu" dhe se nuk kishte më fuqi për ta përballuar jetën në këtë mënyrë. Ajo bëri *gjithçka* mundi për ta ndalur, por nganjëherë *gjithçka* nuk mjafton. Që nga ajo kohë nuk kishte më asnjë lajm prej tij.

- I kam dhënë një dozë qetësuesish si dhe antibiotikë, - qartëson Suzana duke mbledhur pajisjet e saj mjekësore.

- Do të vi prapë nesër në mëngjes, - shton Suzana ndërsa Nikola e shoqëron te dera. - Por... - Ajo e ndërpreu fjalinë, si e zënë njëkohësisht në turp dhe e llahtarisur nga ajo që donte të thoshte. - ...mos e lër të largohet në këtë gjendje, përndryshe... ai do të vdesë. - Sapo mbyll derën pas saj dëgjohet një...

* * *

- Atëherë?

- Çfarë atëherë?

- Çfarë do të bëjmë me të? - pyeti Eriku. - Me burrin tënd?

Me një gotë uiski në dorë avokati vente e vinte nëpër kuzhinë.

Nikola e vështroi me lodhje dhe përçmim njëkohësisht. Çfarë bënte ajo me Erikun që prej gati një viti? Si e kish lënë që ai të hynte në jetën e saj? Përse ishte lidhur me të?

- Ik, të lutem, - i mërmëriti Nikola.

Eriku tundi kokën.

- As që bëhet fjalë që unë të të lë në gjendje të tillë.

- Kur unë e kisha thikën te gryka nuk e pate të vështirë të më braktisje!

Eriku ngriu në vend, i poshtëruar... Iu deshën disa sekonda për të dhënë një justifikim:

- Po unë nuk pata kohë të..., - filloi të belbëzojë pa mundur ta përfundojë fjalinë.

- Ik, - i tha fare thjeshtë dhe qetësisht Nikola.

- Në qoftë se ti e dëshiron vërtet një gjë të tillë... Po të marr nesër në telefon, - shtoi para se të zhdukej.

E lehtësuar që e hoqi qafe Erikun, Nikola u kthye në sallon. I fiku të gjitha dritat dhe pa bërë zhurmë, afroi një kolltuk pranë kanapesë për të qenë sa më afër Markut.

Ambienti ndriçohej tashmë vetëm nga ngjyra e portokallinjtë e prushit të oxhakut dhe brenda mbretëronte një heshtje e qetë.

E dërrmuar dhe e çorientuar, Nikola vendosi dorën e saj mbi atë të të shoqit dhe mbylli sytë. Sa të lumtur kishin qenë

në këtë shtëpi! Ata ishin çmendur nga gëzimi kur e kishin gjetur. Ishte një nga këta *brownstones,* të ndërtuar në fund të shekullit XIX, me një fasadë gurësh ngjyrë kafe dhe me një lulishte të bukur. E kishin blerë para dhjetë vjetësh, pak para lindjes se fëmijës së tyre, të cilin donin ta rrisnin sa më larg jetës së zhurmshme të Manhatanit.

Në të ndarat e bibliotekës, disa foto në korniza të kujtonin ditët e lumtura. Së pari një burrë dhe një grua të kapur dorë për dore, me shikim plot ngrohtësi dhe me lëvizje të çlirëta. Pushime romantike në Havai dhe udhëtim plot aventura me motor në Kanionin e Madh. Më poshtë një foto ekografie dhe disa muaj më vonë, fotoja e një bebeje me fytyrë të rrumbullakët që feston Krishtlindjet për herë të parë. Në fotot e tjera bebja është rritur dhe është bërë një vajzë e vogël së cilës sapo i kanë rënë dhëmbët e përparmë. Ajo pozon me krenari para gjirafave të kopshtit zoologjik të Bronksit, duke rregulluar kapuçin e saj, pastaj, në Montana me borë dhe tregon në drejtim të aparatit fotografik dy peshqit e saj klounë, Ernesto dhe Kapuçino.

Parfumi i ditëve të lumtura është zhdukur një herë e përgjithmonë...

Marku kollitet në gjumë. Nikolës i kalojnë mornica nëpër trup. Njeriu që tani po flinte në atë kanape nuk kishte asgjë të përbashkët me atë me të cilin ajo qe martuar. Vetëm diplomat dhe titujt që zbukuronin murin si trofe të bënin të mendoje se dikur Marku kishte qenë një psikolog me famë. Si specialist i reziliencës, FAA-ja dhe FBI-ja i drejtoheshin atij kur bëhej fjalë për katastrofa ajrore dhe për marrje pengjesh. Pas Njëmbëdhjetë Shtatorit, ai u aktivizua në skuadrën psikologjike, e krijuar për t'u ardhur në ndihmë familjeve të

viktimave si dhe punonjësve të *World Trade Center* që mbijetuan nga katastrofa. Asnjë nuk del i paprekur nga një dramë e tillë. Një pjesë e jona mbetet përgjithmonë e marrë peng nga britmat, flakët dhe gjaku. Ju ndoshta nuk keni vdekur por ju e ndjeni veten të njollosur, ju bren një ndjenjë fajësie, ju ha një ankth i shurdhër dhe jeni të fiksuar nga një pyetje ngacmuese e cila nuk do të marrë asnjëherë përgjigje: përse ju keni mbijetuar, pse pikërisht ju, e jo të tjerët? Ju e pse jo fëmija juaj, gruaja juaj, prindërit tuaj...

Paralelisht me punën si psikolog, Marku e kish përhapur eksperiencën e tij në shumë revista popullore me tirazh të madh. Nëpërmjet artikujve të tij, ai ishte apasionuar të bënte të njohura terapitë e reja: - ndërrimi i roleve, përmbysja e tyre, hipnoza... - me të cilat punonte si pararendës së bashku me ortakun e tij dhe shokun e fëmijërisë, Konor Mekkoi. Pak nga pak, Marku ishte bërë një nga psikologët më në modë të cilin e shihje shpesh në një panel televizioni, dhe kjo famë e menjëhershme, i kish çuar në qendër të vëmendjes mediatike që të dy. Në numrin e saj mbi çiftet më në zë të Nju Jorkut, prestigjiozja *Vanity Fair* i kish kushtuar Markut dhe Nikolës katër faqe me fotografi. Një kurorëzim i vërtetë.

Por kjo përrallë me shtojzovalle e me zana të bukura e shkruar në një letër të artë, ishte shkërmoqur fare papritmas. Një pasdite marsi, Lajla, vajza e tyre e vogël pesëvjeçare, ishte zhdukur pranë një qendre tregtare të *Orange Country*, në jug të Los Anxhelosit. Për herë të fundit që e kishin parë, ajo po shikonte përpara vitrinave të një *Disney Store*. Guvernantja e saj, një vajzë e re australiane, e kish lënë vetëm për disa minuta, sa të provonte një xhins i cili shitej me ulje në lokalin e veshjeve Diesel, aty pranë...

Sa kohë kish kaluar nga koha kur guvernantja vuri re që Lajla ishte zhdukur? *"Jo më shumë se pesë minuta"*, kështu iu kish thënë guvernantja hetuesve. Është njëlloj sikur të thuash një përjetësi. Çdo gjë mund të ndodhë në pesë minuta.

Orët e para që pasojnë humbjen e një fëmije janë të rëndësishme e të bëjnë të besosh se fëmija është gjallë e do ta kesh përsëri në krah. Pas dyzet e tetë orëve shpresat fillojnë të veniten, e ankthi sa vjen e shtohet. Shanset për ta gjetur gjallë fillojnë të shuhen sekond pas sekonde.

Atë 23 mars binte shi me shtamba. Edhe pse zhdukja kish ndodhur në mes të ditës dhe në një vend plot me njerëz, hetuesit e kishin shumë të vështirë të grumbullonin të dhëna të besueshme. Kontrollimi i shiritave video të vëzhgimit nuk dha asgjë të re, as edhe marrja në pyetje e guvernantes, e cila ishte fajtore për mungesë ruajtje të fëmijës, por jo e rrëmbimit të fëmijës.

Paskëtaj, ditët kishin fluturuar...

Për disa javë rresht, më shumë se njëqind policë, të shoqëruar nga qen të specializuar dhe me helikopterë, e krehën të gjithë rajonin. Me gjithë përpjekjet edhe të FBI-së, asnjë pistë konkrete nuk kish dhënë mundësi që të lokalizohej fëmija.

... pastaj kaluan muaj...

Mungesa e të dhënave e çoroditi policinë. Askush nuk kish kërkuar ndonjë shpërblim për rrëmbimin, asnjë pistë e besueshme nuk ekzistonte. Asgjë.

...pastaj kaluan edhe vitet...

Që prej pesë vjetësh, fotografia e Lajlës ishte e varur në stacionet e trenit, në aeroporte, në zyrat e postës, bashkë me fotot e fëmijëve të tjerë të humbur. Por Lajla nuk gjendej. Ishte zhdukur.

* * *

Për Markun jeta ishte ndalur më 23 mars 2002. Zhdukja e vajzës e kishte zhytur në dëshpërim të thellë. I shkatërruar nga një tërmet i brendshëm, sa nga dhimbja e po aq edhe nga ndjenja e fajësisë, ai u shkëput fare nga profesioni, nga gruaja, nga miku i tij.

Muajt e parë, punësoi detektivët privatë më të mirë që të vazhdonin kërkimet deri në hollësitë më të vogla.

Por edhe kjo nuk dha rezultat.

Filloi të investigonte vetë, por përsëri pa dobi.

Këto kërkime nga ana e tij të cilat përfunduan me dështim, zgjatën tre muaj. Pas kësaj, Marku u zhduk edhe vetë, duke mos dhënë më shenjë jete dhe asnjë lajm as gruas e as Konorit.

Nikola nuk kish pasur të njëjtin fat si i shoqi.

Fillimisht, dëshpërimi i saj ishte i mbërthyer nga një fajësi e veçantë: ishte vetë Nikola që kishte këmbëngulur që Lajla ta shoqëronte për në Los Anxhelos, ku ajo do të jepte disa recitale; ishte po Nikola që zgjodhi edhe guvernanten e cila u bë shkak për dramën që ndodhi. Për të përballuar më të keqen, ajo kish zgjedhur si barrikadë marrjen përsipër të një aktiviteti të dendur, duke dhënë njërin pas tjetrit shumë koncerte dhe duke bërë inçizime të shumta, madje, duke shkuar deri aty saqë kishte pranuar të fliste për dramën e saj familjare nëpër gazeta ose në televizione, duke u shndërruar kështu në një viktimë e një lloj manie shikuesish të dëmshëm.

Por kishte ditë që dhimbja bëhej e padurueshme. Kur nuk kish më forcë të luftonte kundër ideve të saj patologjike, Nikola merrte me qira një dhomë në ndonjë hotel, dhe mbështillej poshtë batanijeve sikur të ishte në gjendje gjumi letargjik.

Secili mbijeton sipas mënyrës së tij...

* * *

Papritmas një kërcu kërcëlliti në oxhak. Marku bëri një lëvizje shpërthyese dhe hapi sytë. U ngrit me forcë, dhe, për disa sekonda, po pyeste veten ku ishte dhe se çfarë i kishte ndodhur.

Po kur pa fytyrën e Nikolës, mendimet filluan t'i kthjellohen.

- Je plagosur gjë ti? - iu drejtua së shoqes.

- Jo, dhe kjo për meritën tënde.

Për një çast u duk se ai u zhyt përsëri në përhumbje para se të ngrihej më me energji.

- Rri shtrirë, të lutem, duhet të çlodhesh!

Sikur të mos e kish dëgjuar fare të shoqen, ai bëri disa hapa në drejtim të hapësirës së xhamtë. Nga xhamat, rruga shkëlqente e bardhë dhe e qetë.

- Ku janë rrobat e mia?

- I hodha poshtë, Mark. Ishin bërë shumë pis.

- Po qeni im ku është?

- E mora deri këtu bashkë me ty, por... pastaj ai ia mbathi.

- Po iki, - tha Marku duke ecur jo fort i sigurt në drejtim të derës.

Ajo i doli përpara për ta penguar.

- Më dëgjo, është natë, ti je i plagosur, i dërrmuar... ka më shumë se dy vjet që nuk e kemi parë njëri-tjetrin. Duhet të flasim.

Ajo zgjati krahun drejt tij por ai e shtyu me ngadalë. Ajo iu afrua por ai u largua duke rrëzuar kalimthi etazherët. Një kornizë ra përtokë dhe kërcëllitja e një xhami të thyer u dëgjua në dhomë.

Marku e mori dhe e vendosi në vendin e vet. Syri i tij ndeshi sytë e së bijës në fotografi. Me sytë jeshilë e të qeshur, me buzëqeshje, ajo transmetonte lumturinë dhe gëzimin e jetës.

Në këtë çast diçka u thye tek ai dhe u lëshua në gulçima, me kurrizin mbështetur në mur. Në atë çast Nikola u fut në gjoksin i tij duke u shtrënguar fort. Qëndruan gjatë në këtë pozicion, të dërrmuar në krahët e njëri-tjetrit, e duke ndarë së bashku të njëjtën dhimbje. Lëkura e butë e njërit kundrejt lëkurës së ashpërsuar të tjetrit. Aroma plot finesë e parfumit të Guerlainit përzihej me erën e rëndë të atyre që jetojnë nëpër rrugë.

* * *

Nikola filloi ta tërhiqte Markun me butësi në drejtim të banjës. Marku ecte i bindur pas saj. Ai qëndroi pa lëvizur deri sa Nikola përgatiti ujin. I dehur nga era e fortë e shampos, Marku qëndroi më shumë se një gjysmë ore nën forcën e ujit që dilte nga dushi, një ujë i ngrohtë e rigjenerues. I lagur siç ishte, u mbështoll me një peshqir të madh para se te vinte në sallon, duke lënë flluska uji në parketin e lustruar. Hapi atë që kish qenë dollapi i tij dhe vuri re se rrobat e veta ishin të gjitha aty. Nuk i kushtoi asnjë vëmendje kostumeve të vjetra: Armani, Boss, Zegna..., të cilët ishin trofetë e një jete që tashmë nuk ishte e tija. Në këtë rast ai u mjaftua me veshjen e një palë mbathjesh, një xhins të plotë, një këmishe me mëngë të gjata dhe një pulovër të trashë.

Zbriti shkallët për të shkuar në kuzhinë ku ndodhej Nikola. Ambienti këtu ishte i këndshëm, një kombinim i drurit, xhamit dhe metalit, jepte efektin e një harmonie të plotë. Një

banak i madh me linja fine qarkon gjithë murin, ndërsa një tavolinë mesi e pajisur mirë të fton të bësh diçka në sobë apo te furra elektrike. Vite më parë ky ambient shkëlqente nga një atmosferë e gëzueshme gjatë mëngjeseve që familja hante së bashku, shijimi i kekut si dhe darkat kokë më kokë të të dashuruarve. Tani ka realisht shumë kohë që askush nuk ka gatuar më këtu.

- Të kam përgatitur një omëletë dhe disa feta bukë të thekur, - i thotë Nikola duke i hedhur kafen në një filxhan të madh që nxjerr akoma avull.

Marku ulet para omëletës dhe ngrihet pothuajse menjëherë. Duart fillojnë t'i dridhen. Para se të fusë diçka në gojë për të ngrënë, i duhet të pijë patjetër alkool. Alkool! Përballë shastisjes së Nikolës, ai hap me nxitim shishen e parë të verës që i zuri dora dhe e thau gjysmën me dy gllënjka. I qetësuar paksa për çastin, e përlau ushqimin duke mos thënë asnjë fjalë, derisa më në fund Nikola guxoi t'i thotë:

- Ku ishe Mark?

- Në dush, - përgjigjet ai pa e shikuar.

- Jo, po të pyes ku ke qenë këto dy vjet?

- Aty poshtë.

- Poshtë?

- Po, në tunelet e metrosë, në kanalet e ujërave të zeza, në kthinat e kanalizimeve, bashkë me të pastrehët e tjerë.

Me lot në sy, Nikola tund kokën si për të thënë që nuk po kupton asgjë.

- Pse?

- Ti e di mirë pse, - reagon Marku duke ngritur zërin.

Nikola i afrohet dhe kërkon t'i kapë dorën.

- Po ti ke një grua Mark, ke një profesion, ke miq...

- Më lër të qetë!

- Më shpjego një gjë të paktën, - lëshoi një klithmë ajo si për ta mbajtur: - Çfarë fiton duke bërë një jetë lypësi?

Ai i hodhi një shikim të rëndë.

- Jetoj në këtë mënyrë sepse nuk mund të jetoj ndryshe. Ti mund të jetosh, unë nuk mundem.

- Nuk ke pse të më bësh me faj edhe mua Mark.

- Nuk kam asgjë kundër teje. Ti bëje jetën tënde si të duash. Unë për vete kam një dhimbje që nuk e duroj dot.

- Ti je psikolog, Mark. Ti ke ndihmuar shumë njerëz të tjerë që të kalojnë dhimbje nga më të ndryshmet.

- Këtë dhimbje nuk e përballoj dot. Nuk ka minutë që unë të mos mendoj për të, që të mos pyes veten se çfarë mund t'i ketë bërë grabitësi dhe të mos e pyes veten se ku mund të jetë ajo në këtë çast. Asgjë nuk më intereson më nga kjo jetë. Vetëm ajo!

- Ajo ka vdekur, Mark, - klithi Nikola.

Marku nuk mund të duronte më shumë se kaq: U ngrit dhe e mbërtheu të shoqen nga gryka sikur donte ta mbyste.

- Si ta nxë goja një fjalë të tillë?

- U bënë pesë vjet Mark! - klithi ajo duke u larguar prej tij. - Pesë vjet pa as më të voglin sinjal, pesë vjet pa kërkuar asnjë shpërblim!

- Ekziston gjithmonë një mundësi...

- Jo Mark, kjo histori ka marrë fund. Nuk ka më shpresë të arsyeshme. Ajo nuk mund të shfaqet papritmas një ditë të bukur. Kjo s'ndodh kurrë, e kupton, kurrë!

- Qepe!

- Nëse do të gjejmë diçka, do të jetë vetëm varri i saj dhe asgjë më tepër.

- Jo!

- Po! Dhe mos mendo se ti je i vetmi që vuan. Çfarë duhet të them unë, që përveç vajzës kam humbur edhe burrin?

Pa u përgjigjur Marku del nga kuzhina me nxitim. Nikola i shkon pas, tashmë e bindur që ta vërë me shpatulla për muri të shoqin:

- S'e ke menduar që ne mund të kishim prapë fëmijë? A i ke bërë pyetjen vetes se me kohë jeta mund të rifillonte në këtë shtëpi?

- Para se të kem fëmijë të tjerë dua të gjej vajzën time.

- Më lër ta marr në telefon Konorin. Edhe ai s'ka lënë vend pa të kërkuar që prej dy vjetësh. Ai mund të të ndihmojë t'ia dalësh mbanë.

- Nuk dua t'ia dal mbanë. Vajza ime vuan e unë dua të vuaj bashkë me të.

- Nëse ti ngul këmbë të jetosh në rrugë, ti do të vdesësh! Këtë do? Atëherë? Jepi! Futi një plumb kokës tënde dhe zgjidhe problemin!

- Nuk dua të vdes tani, sepse dua të jem aty ditën që ne do ta gjejmë vajzën tonë.

Nikola kishte nevojë për ndihmë. Mori celularin dhe formoi numrin e Konorit.

- Ngrije, Konor, ngrije!

Diku nëpër natë, disa zile telefoni oshtinë në boshllëk. Nikola e kuptoi se Konori nuk do të përgjigjej dhe se ajo e kish humbur betejën me të shoqin. E vetme, ajo nuk mund ta ndalte dot atë.

Në sallon, Marku u shtri përsëri në kanape dhe fjeti edhe disa orë.

Ai u ngrit me zbardhjen e ditës, mori një çantë sportive

në dollap, rrasi brenda një batanije, një xhakoventë, disa pako biskota dhe shumë shishe me alkool.

Nikola e ndoqi gjithë këtë skenë dhe i shtoi bagazhit edhe një celular me karikues.

- Në qoftë se ke ndërmend ta marrësh në telefon Konorin, ose po të kem nevojë për të të marrë unë...

Kur Marku doli jashtë, bora kishte pushuar dhe ngjyrat e para të ditës po ngjyrosnin qytetin me reflekse të ndryshme.

Sapo Marku vuri këmbën jashtë shtëpisë, labradori i zi u shfaq si me magji duke dalë nga një kazan plehrash e duke lëshuar ca kuisje kënaqësie. Marku i ledhatoi kokën si për ta falënderuar. Ai u fryu duarve si për t'i ngrohur, e hodhi çantën në shpinë dhe u nis në drejtim të urës së Bruklinit.

Te pragu i derës, Nikola shikonte burrin e jetës së saj që po largohej këtë mëngjes. Plot dhimbje ulëriti:

- Unë kam nevojë për ty!

Si një boksier të cilit i ka rënë gongu, ai u kthye kur ishte nja dhjetë metra larg për të hapur duart e si për t'i thënë që i vinte keq e që nuk kishte se çfarë të bënte për të. Më pas, te cepi i rrugës, ai u zhduk.

3

Dikush që më ngjan

Jeta është një gjerdan i mbushur
plot me frikë.
- BJORK

Vajza që luante me zjarrin
Titulli i një romani i
STIEG LARSSON

Kabineti i dr. Konor Mekkoit ndodhej në njërën prej dy kullave prej xhami të prestigjiozes *Time Warner Center*, në skajin perëndimor të Parkut Qendror.

Konori ndihej krenar sepse kabineti i tij ishte shumë komod dhe pacientët ndiheshin mirë dhe kishin mundësi të merrnin mjekimet e përkujdesjet më të mira. Kështu duke folur vesh më vesh e gojë pas goje, klientët i qenë shtuar së tepërmi, edhe pse metodat e tij të veçanta nuk para u pëlqenin kolegëve të tij konservatorë.

Në këtë natë Krishtlindjesh, Konori ishte ende në zyrë, i zhytur në dosjen mjekësore të një pacienti. Mënjanoi një hapje

të gojës që e ftonte për gjumë dhe i hodhi një sy kalimthi orës.

Ora ishte një e gjysmë e mëngjesit.

Sido që të ishte, askush nuk e priste atë. Konori jetonte vetëm për punën e tij dhe nuk kish as të dashur e as familje. Kabinetin e parë e kishte krijuar së bashku me Mark Hetëuejin, mikun e tij të fëmijërisë, me të cilin ndante të njëjtin pasion për psikologjinë. Që të dy ishin rritur në një nga lagjet e vështira të Çikagos. Që të dy kishin njohur vuajtjet nga afër para se t'i kushtonin karrierën e tyre dhe energjitë për të vënë në funksionim metoda të reja terapie. Suksesi i tyre kishte qenë i mrekullueshëm dhe i jashtëzakonshëm deri në çastin e dramës së Markut. Konori e kishte mbështetur me sa kishte mundur, duke rifilluar nga e para anketën për gjetjen e vajzës së Markut edhe atëherë kur policia i uli krahët në shenjë pafuqie. Por me sa duket, ndihma e tij nuk paska qenë e mjaftueshme. Kështu, pas këtyre ndodhive, edhe Marku u zhduk i helmuar nga dhimbja. Ikja e ortakut e kish zhytur Konorin në një dëshpërim të plotë. Kish humbur jo vetëm mikun e tij më të mirë, por njohu me këtë rast edhe disfatën më të madhe në fushën profesionale.

Si për të larguar tutje kujtimet e këqija, Konori u ngrit nga kolltuku dhe mbushi një gotë me uiski të vjetër.

- *Gëzuar Krishtlindjet,* - tha me zë, duke ngritur gotën në drejtim të pasqyrimit të portretit të tij në pasqyrë.

Ambienti ku ndodhej Konori, rreth e qark, e gjithandej me panele xhami, notonte në një ngjyrë areale dhe të krijonte një pamje marramendëse, kur shihje në drejtim të parkut. Këtu çdo gjë ishte e thjeshtë dhe e zhveshur. Mbi një etazher metalik, dy skulptura të tipit Xhakometi dukej sikur i drejtoheshin hapësirës, ndërsa në mur, një pikturë njëngjyrëshe e Robert

Rimanit i linte mendueshëm të gjithë ata që shikoje brenda kornizës së saj. Madje edhe vetë Konori ishte i magjepsur nga pafundësia e variacionit të ngjyrave që binin mbi pikturë.

Të zbulosh të padukshmen, të shohësh më tej se sa pamja e jashtme...

Ky ishte edhe thelbi i punës së tij.

Me gotën në dorë, mjeku e kaloi shikimin te disa fotografi në ekranin e laptopit. Ishin imazhe cerebrale që paraqisnin një zonë të trurit të një prej pacientëve të tij. Sa herë që shikonte të tilla imazhe, Konori shtangej dhe befasohej edhe vetë.

Të vuash, të dashurosh, të jesh i lumtur, fatkeq: çdo gjë ndodh aty brenda, në trurin tonë, në mes të miliarda e miliarda neuronesh. Kënaqësia, memoria, frika, agresiviteti, mendimi, gjumi, vareshin pjesërisht, nga sekretimi që i bën organizmi substancave të ndryshme kimike, ku neurotransmetuesit kanë për detyrë të çojnë mesazhe nga një neuron te tjetri. I apasionuar nga shpikjet më të fundit të neuroshkencave, Konori ishte një nga pionierët e analizës së shkaqeve biologjike të dëshpërimit. Studimi në të cilin ai kish marrë pjesë tregonte për shembull se një formë më e shkurtër e një geni transportues të predispononte ose drejt depresionit ose drejt vetëvrasjes. Pra, individët nuk lindin të barabartë për t'u përballur me ndodhitë e jetës.

Në fakt Konori nuk mund të mjaftohej vetëm me shqyrtimin e këtij determinizmi gjenetik. I bindur se psikika dhe biologjia janë të lidhura ngushtë, ky mjek i ri kish bërë kujdes që të formohej gjithmonë në të dyja fushat: psikologji dhe neurologji. Natyrisht, trashëgimia jonë gjenetike është e pranishme te ne gjatë gjithë jetës, por ndërkohë, truri ynë

mund të riprogramohet nëpërmjet marrëdhënieve afektive dhe dashurore.

Pra kjo ishte si të thuash motoja e tij e punës: asnjëherë nuk mund të thuash se tani gjithçka përfundoi.

Konori gëlltiti me një të ngritur dozën e uiskit, veshi pallton dhe doli nga zyra.

Në këtë ndërtesë kishte gjithashtu një hotel me pesë yje, disa restorante dhe një klub xhazi. Britmat e festës dëgjoheshin në të gjitha katet, gjë që nxirrte akoma më në pah vetminë e psikologut.

Në ashensor hapi çantën e punës për të parë se mos kish harruar ndonjë dosje në zyrë, pasi kish ndërmend të studionte edhe nesër në apartamentin e tij. Për dy ditë do të organizonte një seancë psikologjie kolektive dhe, për të qenë sa më i suksesshëm, kjo lloj terapie kërkonte një përgatitje shumë serioze.

Mbërriti në parkingun nëntokësor ku hyrja sigurohej me një detektim të retinës së syrit. Pasi bëri veprimin e duhur Konori u drejtua nga vetura e tij, një Aston Martin kupe sport, ngjyrë argjendi që shkëlqente nga njëmijë e një ngjyra. Me një shtypje të butonit të çelësit makina u hap dhe u gjend brenda në të, në shoqërinë e këndshme të erës së lëkurës së ndenjëseve. Çantën e vendosi te ndenjësja në krah të tij dhe doli nga garazhi në drejtim të *Columbus Circle*. Vazhdonte të binte borë me flokë të rëndë, gjë që e bënte rrugën edhe më të rrëshqitshme. Konori iu drejtua tani *Avenue of Americas* në drejtim të *TriBeCa*- së.

Në autoradio, muzika elektronike e *RadioHead* të çonte në një të ardhme të pasigurt, çnjerëzore, në të cilën njeriu i kish humbur të gjitha betejat. Kjo ishte një muzikë në përshtatje

me gjendjen e tij shpirtërore të çastit që karakterizohej nga një gjendje e keqe shumë e thellë që e kishte kapluar prej kohësh.

Në kryqëzim të Broduejit, ai tentoi t'i jepte gaz me të shpejtë makinës dhe për pak doli nga rruga. Gjithnjë e më shpesh sikur i pëlqente të flirtonte me rrezikun dhe me vdekjen. Një mënyrë kjo si një tjetër për ta kuptuar që je gjallë.

Ndaloi në semaforin e kuq në fillim të *Greenwich Village*. I përkulur mbi timon, mbylli sytë.

Duhet ta mbledh veten!

Deri tani vonë, ai mendonte, se në sajë të punës së tij, kish arritur të kapërcente përfundimisht frikërat e tij të vjetra. Madje kish botuar edhe një libër, *"Të mbijetosh"*, për të treguar historinë e tij dhe për të dhënë një mesazh shprese. Por tërheqja e Markut kish hedhur çdo gjë në erë. Konori kish rënë në një dëshpërim të rrezikshëm, në një vetmi shkatërruese, një fajësi që e ndiqte kudo.

Po fërkonte sytë kur zilja e celularit e solli në vete. Nxori celularin nga xhepi i xhaketës dhe pa në ekran:

Nikolë Hetëuej

Nikola? Ata pothuajse nuk flasin me njëri-tjetrin qëkur ajo ka filluar të dalë me atë avokatin, Erikun. Një trap i vërtetë. Zemra e Konorit kish filluar të rrahë më shpejt, duke shpresuar, po pa i besuar shumë, se mos vallë ajo kishte ndonjë lajm nga Marku. I eksituar si ishte, ai po i përgjigjej kur...

- Dreq o punë!

Dera e përparme e pasagjerit nga ana tjetër e *Aston Martin*-it hapet rrufeshëm dhe një dorë e shpejtë rrëmben çantën e

lëkurës. Pa u menduar fare, Konori del me të shpejtë nga makina dhe vrapon në drejtim të hajdutit ose më saktë... të hajdutes.

Edhe pse bora ishte e dendur, ai arrinte të shquante flokët e gjatë të një vajze të re që shtrëngonte çantën para gjoksit, duke rendur me vrap.

Konori po vraponte gjithnjë e më shpejt duke rrezikuar të rrëshqiste dhe të rrëzohej në trotuarin plot me borë. Tani vetëm dy metra e ndanin nga ajo, kur rrëmbyesja kalon befas mes përmes rrugës duke rrezikuar të shtypej nga makinat.

Kurvicë!

Pa marrë parasysh rrezikun e madh, të njëjtën gjë bëri edhe Konori që iu vu pas. Çfarëdo që të ndodhte ai nuk donte të humbiste dosjet që gjendeshin në çantë. Aty gjendeshin jeta intime, sekretet më të fshehta të pacientëve të tij.

Tani ai ishte lëshuar, duke e shkurtuar distancën me hajduten. Kur e kuptoi që vajzës po i zihej fryma, iu lëshua me gjithë forcën e trupit që ta kapte. Ajo u gjend përtokë me fytyrën në borë, e bllokuar, me duart të përthyera, të kapura fort nga mbrapa.

- Lëshoje atë që më more! - i dha urdhër Konori, duke i tërhequr nga dora çantën.

Pasi mori gjënë e tij, mjeku u ngrit ngadalë, duke ia shtrënguar edhe më krahun kundërshtares, për ta detyruar që ajo t'i bindej.

- Më lësho, - klithi ajo duke u munduar të çlirohej.

Duke mos ia vënë veshin kërkesës së saj, Konori e tërhoqi zvarrë për disa metra deri sa të arrinte të shquante në dritën e llambave të rrugës. Vetëm në këtë çast ai e pa në fytyrë.

Ishte një vajzë rreth të pesëmbëdhjetave, me një trup të

dobët, të drejtë e të gjatë. Tiparet e saj të zbehta bënin kontrast me flokët e gjatë e të zinj, të ndotur me bukle të dala boje që anonin nga e pangjyrëta. Një pallto vinili e vjetër i varej sipër një fundi të shkurtër nga ky dukeshin një palë geta vija-vija.

- Lëshomëni! - përsëriti ajo.

I pandjeshëm ndaj kërkesave të saj, Konori i shtrëngoi edhe më fort dorën. Çfarë bënte një vajzë kaq e re, e vetme, në mes të natës, mbrëmjen e Krishtlindjeve?

- Si e ke emrin?

- Ik pirdhu, - e fyeu ajo.

- Epo, po qe se do kështu po të çoj në polici.

- I poshtër!

Ajo u mundua të lirohej nga Konori duke përdorur të gjitha forcat e energjitë dhe, lëvizi aq shumë, sa i ra portofoli nga xhepi i palltos. Konori u tregua më i shkathët dhe e kapi më shpejt se ajo. Kishte një kartë identiteti, ku ai lexoi të dhënat për hajduten:

Evi Harper
Lindur më 3 shtator 1991

- Ç'djallin bën në rrugë në orën dy të mëngjesit? Më thuaj pak Evi?

- Ma jep portofolin tim! Ju s'keni të drejtë!

- Nuk e di se kush nga ne të dy ka të drejtë për të folur për drejtësi, - vuri në dukje Konori.

Pastaj e lëshoi. E lirë, Evi u largua disa metra, por pa ia mbathur. Ajo po e përballonte duke e sfiduar drejtpërdrejt.

Edhe Konori ia nguli sytë. Evi dridhej nga të ftohtit. Qepallat rreth e rrotull i kishte të zeza sterrë, por pavarësisht

nga një makijazh si prej vampiri, mund të shquaje dy sy ngjyrë të çelur të një fëmije të tromaksur, ku shquhej një vendosmëri e çuditshme.

- Eja të të çoj tek prindërit e tu.

- Nuk kam prindër, - përgjigjet ajo duke u larguar e ecur prapa.

- Po ku jeton atëherë? Në një qendër? Në ndonjë familje?

- Ik pirdhu!

- Ma the njëherë këtë, - psherëtiu mjeku. - Vetëm këtë të kanë mësuar në shkollë?

Konori ndjente për të njëkohësisht edhe nervozizëm edhe keqardhje. Ajo i kujtonte dikë, të cilin ai nuk e gjente dot se kush ishte. E ndjente që vajza ishte e tmerruar. E kuptoi që ajo vuante dhe kjo vuajtje dukej sheshit.

- Ke nevojë për pará?

Asnjë përgjigje nga ana e vajzës. Ata sy që shprehnin një frikë të madhe dhe po ata sy që mundoheshin ta fshihnin këtë frikë ishin përballë tij.

- Të duhen gjë pará për të blerë drogë? E gjeta? Duhet të marrësh dozën tani? Të mungon kjo gjë?

E revoltuar Evi i kundërpërgjigjet:

- Unë nuk jam amerikane!

- Po në shkollë a shkon?

- E ç'të duhet ty?

Konori i afrohet Evit dhe mundohet të sillet në një mënyrë më të afrueshme.

- Më dëgjo, unë jam mjek, mund të të gjej një strehë për të kaluar natën.

- Domethënë, dashke të më shpëtosh? Kështu?

- Dua të të ndihmoj.

- Nuk kam nevojë për ndihmën tënde.

- Çfarë do atëherë?

- Pará. Asgjë tjetër.

- Përse i do paratë?

- Dreq o punë. Mos je gjë polic?

Konori hapi zinxhirin e kuletës së Evit për të parë se çfarë kishte aty. Asgjë, asnjë kartëmonedhë. Asnjë monedhë metalike. Vendosi në vend kartën e identitetit dhe ia ktheu portofolin. Vajza e rrëmbeu me një gjest të trembur.

- A je dakord sikur të të paguaj një darkë me ushqim të ngrohtë? - i propozoi Konori.

- E në këmbim çfarë kërkon prej meje?

- Asgjë Evi, - i premton ai duke tundur kokën.

Tani ajo filloi ta shihte me dyshim. Jeta e kish mësuar të mos u besonte burrave, por diçka e bënte që të ishte më e sigurt me njeriun që kish përballë.

- E përse dashke të më ndihmosh?

- Sepse ti më kujton dikë.

Pas njëfarë ngurrimi, ajo shton:

- Po iki, nuk e dua darkën tënde.

Por Konori nguli këmbë:

- Dëgjo, ka një *Dinner* diku më lart, në rrugën e katërmbëdhjetë. Alberto quhet restoranti. A e di për ku po të them?

Evi bëri po me kokë kundër dëshirës së saj.

- Po shkoj të marr makinën, - thotë Konori, - pastaj do të jem atje të ha diçka edhe unë. Alberto në Nju Jork, është mbreti i hamburgerit. As që krahasohet me Mek Donalds, ke për ta parë...

- S'kam për të parë asgjë.

- Si do që të jetë, unë aty po shkoj. Kështu, në qoftë se për dhjetë minuta ty të mbushet mendja që të hash një hamburger me mish të freskët dhe të butë, me qepë, me kornishone dhe me patate furre, ti e di se ku do të jem.

Pa u ngutur, ai vazhdoi rrugën duke ecur në mes të trotuarit. Pasi kish bërë nja njëzet metra u kthye nga ajo.

Dritat i jepnin një ngjyrë argjendi flokëve të dëborës që vazhdonin të binin, duke i dhënë rrugës një pamje të qetë. Si e ngrirë prej të ftohtit, Evi nuk kish lëvizur as edhe një centimetër. Konori vuri re edhe një herë brishtësinë e trupit si dhe zbehtësinë prej kufome të saj. Atij iu duk sikur brenda vajzës diçka kish vdekur.

- Nuk do vij jo, - tha përsëri vajza si për ta sfiduar.

- Atë e di ti, - iu përgjigj Konori.

* * *

Një çerek ore më vonë, e ulur në banakun e një *coffe-shop*-i, Evi po shqyente ushqimin me urinë e një njeriu që s'ka ngrënë që prej dy ditësh.

Ishte një *darkë* jashtë kohe që mbante erën e mirë të Nju Xhersit me ato tavolinat me lëkurë të përdorur dhe me pjesët metalike të dalë boje. Varur në mur, mbrapa arkës, ishte vendosur një koleksion fotografish me dedikim. Ato të bënin të kuptoje se Xhek Nikolson, Bruse Springstin apo Skarlet Johanson kishin qenë këto kohët e fundit në këtë restorant. Në fund të sallës, një altoparlant, që dukej sikur po ankohej po jepte një këngë të vjetër të Erik Kleptonit, për vetëm gjysmë duzine njerëzish që ndodheshin aty.

Jashtë, në trotuar, Konori po pinte një cigare, dhe

vështronte me kujdes vajzën duke parë nga xhami sikur do të arrinte nëpërmjet pamjes së jashtme të depërtonte në sekretet e brendshme të saj.

Evi e kish vendosur pallton ashtu të mbledhur mbi karrige dhe kish zbërthyer jelekun nga ku dukej një bluzë e zezë, ku ishte stampuar mbishkrimi *Kabbalist do it better*. Në qafë, në një zinxhir argjendi varej një kryq i përmbysur dhe një yll me pesë cepa. Ajo po e përpinte hamburgerin me një nxitim të tillë aq sa ishte bërë me salcë të kuqe kudo në fytyrë. Teksa fshihej me një pecetë letre, Konori vuri re se ajo e kish të fashuar dorën rreth kyçit. Ai vuri re gjithashtu edhe gjurmë të vetëshpimit me age në pjesën e brendshme të parakrahut. Të thoshe që kjo vajzë nuk ishte mirë, kjo ishte më se e qartë. Konori e ndjente se tek ajo vepronin forca të kundërta: ajo tregonte një shpirt plot vendosmëri, por në të njëjtën kohë edhe në buzë të greminës.

Aftësia që Konori kishte për të parë në thellësi të shpirtit të njerëzve, e kishte të trashëguar, bashkë me Markun, që nga rinia e tyre.

Mark...

Me të kujtuar mikun e tij shikimi iu turbullua. Që kur ishin fëmijë, ishin betuar se do të ndihmonin gjithmonë njëri-tjetrin. Me kalimin e viteve, kishin arritur t'i bënin ballë dallgëve të vështira të jetës. Por zhdukja e Lajlës, i kish hedhur në erë pikat e tyre të referimit si dhe premtimet e shenjta që i kishin bërë njëri-tjetrit.

Konori thithi edhe një herë cigaren dhe e hodhi mbi dëborë. Në këtë mbrëmje Krishtlindjesh, i dukej sikur mbante mbi supe të gjithë peshën e botës. Ç'djallin bënte ai në këtë vend në orën tre të mëngjesit duke u plevitosur përjashta në

vend që të ishte në shtëpinë e tij? Nuk mund të vazhdonte më kështu me këtë lojë stërmundimi. Nuk mund të shpëtonte gjithë botën mbarë. Ishte shumë e rëndë për të të merrte përsipër rolin e Nënë Terezës. Ndofta kishte ardhur koha që të bënte pak pushim, të shkëputej, të harronte për njëfarë kohe pacientët e tij, të ikte nga Manhatani për të shkuar diku tjetër e të fillonte një jetë të re.

Të rilindte.

Për disa sekonda, kjo mundësi i sillej nëpër mendje si një element euforik deri sa ndjeu shikimin e Evit të përqëndruar tek ai nga ana tjetër e xhamit. Ai ngriti kokën dhe, për herë të parë, shikimet e tyre u kryqëzuan. Në këtë çast Konori e kuptoi se kujt i shëmbëllente kjo vajzë.

Ajo i ngjante atij vetë.

Pa e njohur këtë vajzë ai e ndjente se ata ndanin së bashku të njëjtën dhimbje. Dhimbjen e saj ajo e tregonte dhe e mbante përpara si një flamur ndërsa ai e fshihte atë nën petkun e mjekut. Por, në fund të fundit, ata të dy i përkisnin të njëjtës familje.

Konori vendosi të futet në ngrohtësinë e *coffe shop*-it. Kitara e Kleptonit ia kish lënë vendin asaj të Bob Dilanit. *Shelter from the Storm: Të mbrohesh nga stuhia.* Kjo ishte një nga këngët e preferuara të Konorit, shkruar nga Dilan në vitin 1975, pasi ai ish ndarë nga e shoqja Sara. Një provë e re kjo e efekteve pozitive të dhimbjes në favor të krijimit artistik...

- Si t'u duk hamburgeri? - pyeti ai, duke u ulur në mbështetësen përballë saj.

- Jo keq, - pranoi Evi, duke gëlltitur edhe një gllënjkë qumësht.

Konori u afrua për nga vajza, sikur donte ta ndihmonte.

Duhej të dinte më shumë për të. U mundua që të ishte sa më bindës me zërin e tij:

- Qëparë më the se kishe nevojë për pará...

- Lëre fare atë bisedë tani, - ia preu ajo.

- Jo, më thuaj, këto pará, përse të duhen? Dua thjesht të kuptoj.

- S'ka asgjë për të kuptuar këtu!

- Më fal, atëherë...

Konori lëshoi një psherëtimë. Ç'djallin kishte që merrej me njerëzit edhe kur ata nuk ia kërkonin një gjë të tillë?

I zënë ngushtë, Konori u ngrit dhe vajti drejt banakut ku porositi një birrë *Corona* duke kontrolluar me sy Evin. E shqetësuar, ajo po kruante me dhëmbë thonjtë e saj me vernik të zi, me shikimin nga dritarja.

Kur Konori po paguante birrën, ai kontrolloi sasinë e parave në kuletë: tre kartëmonedha njëqind dollarëshe. Për ta ndjerë veten të sigurt, ai kish nevojë gjithmonë të kishte një shumë parash me vete. Ky është një refleks i zakonshëm i atij që dikur kishte qenë i varfër.

Ndërkohë një ide i erdhi ndërmend. U largua nga banaku dhe u kthye përsëri te Evi e cila po mblidhte sendet e veta për të ikur.

- Do të bëjmë një lojë, - tha ai, duke vendosur mbi tavolinë një kartëmonedhë njëqind dollarëshe.

- E si quhet kjo lojë? Korrupsion i një të miture?

- Më dukej se ti kishe nevojë për pará...

Ajo shikoi kartëmonedhën me një ndjenjë ku kishte èdhe përbuzje edhe kuriozitet. Dora e Konorit e mbulonte një pjesë të kartëmonedhës dhe Evi vuri re se Konorit i mungonte një kockë e gishtit të unazës.

- Në qoftë se do, këto pará janë të tuat, - tha me vendosmëri Konori duke e shtyrë njëqind dollarëshin në drejtim të saj. - Në qoftë se më përgjigjesh, paratë janë të tuat...

Ajo i hodhi një vështrim hetues. Dukej që ishte e pavendosur për të hyrë në këtë lojë, ingranazhin e së cilës nuk po ia kuptonte fare logjikën. Por më në fund thotë:

- Pa bëje pyetjen...

- Përse ke nevojë për pará? - e pyeti Konori duke e shikuar drejt e në sy.

Evi afron dorën pranë kartëmonedhës.

- Që të blej një revole, - thotë ajo fare e qetë.

Pastaj merr kartëmonedhën, e fut në xhep, duke e sfiduar Konorin me shikimin e saj.

Këto ishin paratë që kish fituar me lehtësinë më të madhe për herë të parë në jetën e saj.

Konori mbeti i shtangur në vend. Ishte i befasuar nga përgjigjja. Imazhi i një arme zjarri i përshkoi për një çast mendjen, imazh i shoqëruar edhe me një të shtënë dhe me një ulërimë. Ky ishte një kujtim i zhytur thellë në kujtesën e tij i cili shfaqej pa ndonjë paralajmërim.

I vënë në siklet, nxori nga xhepi njëqind dollarëshin e dytë dhe e vendosi përsëri mbi tavolinë.

- Përse ke nevojë për një revole?

Këtë herë Evi ngurroi më shumë. Ideja e parë ishte që të gënjente, por e kuptoi që Konori do ta kuptonte gënjeshtrën. Në njëfarë mënyre, e vërteta ishte një gjë e rrallë dhe e çmuar dhe 100 dollarëshi që ai i ofronte ishte çmimi i kësaj të vërtete.

- Sepse dua të vras një njeri.

Kjo fjali gjëmoi si një vendim gjyqi. I mpirë tërësisht, Konori lëvizi kokën, i tmerruar nga përgjigjja e vajzës.

Megjithatë nxori edhe 100 dollarëshin e tretë, e vendosi përsëri mbi tavolinë dhe bëri pyetjen e fundit:

- Përse do ta vrasësh këtë njeri?

Kësaj radhe Evi nuk ngurroi për asnjë çast. Tashmë kish shkuar shumë përpara për t'u tërhequr. Mori njëqind dollarëshin e tretë në të njëjtën mënyrë që mblidhen paratë në poker.

- Që të hakmerrem.

Në kokën e Konorit oshëtinë tre fjalë nga e kaluara e tij: *Hakmarrje e pamëshirshme*, - të cilat e shkundën nga vendi.

- Ç'do me thënë kjo, të hakmerresh? Për kë? Përse?

Por tashmë Evi kish veshur pallton dhe e kish lidhur shallin.

- Më vjen keq, - i thotë duke u ngritur, - bëtë dy pyetje suplementare dhe ti nuk ke më pará për të më paguar.

Viktimë e asaj që ai vetë ndërtoi, Konori e vështroi, i pafuqishëm, kur ajo kapërceu derën e restorantit.

- Prit! - bërtiti ai që ta ndalonte.

E arriti në rrugë. Dëbora vazhdonte të binte me të njëjtin ritëm, duke vulosur qytetin me forcën e saj të shurdhët e shtypëse.

- Ku do të shkosh kështu? Bën ftohtë, është e rrezikshme. Do të të gjej një vend për të fjetur sonte.

Ajo i ktheu kurrizin, pa marrë mundimin që t'i përgjigjej.

Duke parë se po e humbte davanë, Konori i futi në xhep një kartëvizitë.

- Nëse do të ndryshosh mendje...

Por ai e dinte që kjo gjë nuk do të ndodhte.

Ndërkohë që ajo po kalonte rrugën në krahun tjetër, Evi

u ndal në mes të saj te vijat e bardha, duke u kthyer nga Konori për të bërë edhe ajo pyetjen e saj të vetme:

- Cili është ai person... ai që i ngjaj?

Para *coffe shop*-it Konori ndezi një cigare tjetër. Shtëllungat e tymit të cigares, të qartësuara edhe më nga të ftohtit, ngriheshin mbi kokën e tij.

- Ai jam unë.

Ajo po e shikonte me habi por edhe e përhumbur nga përgjigjja. Shikimet e tyre u kryqëzuan edhe një herë tjetër dhe Evi ndoqi rrugën e saj. Konori e pa tek largohej nëpër natë, duke thithur me nervozizëm cigaren.

Pas pak e humbi nga sytë, por ai qëndroi aty edhe disa minuta duke parë gjurmët e këpucëve të saj në dëborë.

Sigurisht ai nuk mund të shpëtonte të gjithë njerëzit.

Por cila është shpresa për jetë e një vajze pesëmbëdhjetë vjeçare e cila:

Është e humbur,
pa të ardhura,
në mes të një nate dimri
në Manhatan?

4

Rruga e natës

Kur ti sheh veten në pasqyrë
dhe ke dëshirë ta thyesh atë,
nuk duhet thyer pasqyra,
por duhet të ndryshosh veten tënde.

- ANONIME

Konori parkoi makinën në *Broome Street* dhe përshkoi në këmbë dy blloqet e pallateve që e ndanin nga banesa e tij. Si edhe pjesa tjetër e qytetit SoHo-ja ishte mbuluar nga një dëborë njëformëshe e cila fshihte reklamat dhe tabelat e galerive të artit, të restoranteve si dhe të shitoreve me veshje të modës.

Tani ai ndodhej para një ndërtese *cast-iron* me armaturë çeliku. Fasada e ndërtesës, e rinovuar kohët e fundit, ishte e zbukuruar me qindra llamba, ndërsa në trotuar një plak prej dëbore i pa përfunduar priste që dikush t'i vinte një kapele, një karotë apo një llullë.

- Merr këtë ta kesh të paktën, - i thotë mjeku duke i lidhur shallin e tij rreth qafës.

Në holl, Konori mori postën dhe shtypi butonin e ashensorit. Ky e çoi në katin e fundit të ndërtesës ku gjendej apartamenti i tij, një papafingo e bollshme me një zbukurim spartan. Këtu nuk vinte as erë keku i pjekur, as erë gjel deti i pjekur në furrë. Nuk kishte as pemë të Vitit të ri, dhe as dhomë fëmijësh. Ambienti ishte pa ngrohtësi, pa jetë. E kish blerë këtë apartament para pesë vjetësh, si një simbol i arritjeve të tij sociale, por asnjëherë nuk ish marrë me zbukurimin apo me mobilimin e tij. Sa më shumë punë, aq më shumë komplikime... dhe për më tepër Konori nuk kishte asnjeri për të jetuar së bashku në këtë apartament.

Ndërkohë që ia kish kushtuar jetën e tij studimit të shpirtit të të tjerëve, për veten e vet, ai ishte dikush që ishte i fshehtë e i mistershëm. I donte gratë, por deri tani, të gjitha aventurat e tij të dashurisë, kishin mbetur pa perspektivë për të ardhmen. Edhe kur çdo gjë shkonte mirë, dhe arrinte një çast ku partnerja e qortonte se ai ishte i pangopur. Si kish mundur ai të pohonte se nuk arrinte të gjente të njëjtën shkallë intimiteti në dashuri siç e kishte këtë gjë me pacientët e tij?

Konorit iu hap goja për gjumë, futi kokën në frigorifer dhe pa aty një shishe *Chardonnay*. Mbushi një gotë dhe pastaj u drejtua nga salloni. Meqë apartamenti ishte i ftohtë, ai e rrëkëlleu menjëherë gotën dhe nuk i rezistoi tundimit për të mbushur edhe një tjetër.

Sonte, ai po ndjente pulsin e tij të vjetër vetëshkatërrues që po nxirrte krye. Gjithë jetën ish munduar ta luftonte, por ai e dinte mirë që kjo betejë kërkonte gjithmonë një vigjilencë në çdo çast.

Liroi kravatën, bëri disa hapa nga faqja e xhamtë, pastaj u shtri në kanape. Në mendje i vinte gjithnjë rrotull imazhi i

kësaj vajze të çuditshme, e Evit, e cila kish dashur t'i vidhte çantën. Solli përsëri ndërmend dëshpërimin që kish lexuar në shikimin e saj, dhe, përsëri, i erdhi keq që nuk mundi të bënte dot gjë për të. Fjalët e saj shqetësuese i oshëtinin ende në kokë, aq sa mund t'i shkaktonin një migrenë: "Dua të vras një njeri", "Për t'u hakmarrë".

- Mos e bëj atë idiotësi, - mërmëriti Konori, sikur Evi mund ta dëgjonte. - Çfarë do që të të ketë bëri ky njeri, mos e vrit.

Në këto e sipër ra telefoni. Ai ngrysi vetullat. Me siguri do të jetë Nikola. Me gjithë këto që i ndodhën, ai kish harruar ta merrte në telefon.

Ngriti receptorin.

Ishte zëri i një gruaje të re, tërësisht i deformuar nga paniku e frika, që po i thoshte se kish vrarë dikë.

5

Dritë

Askush nuk mund të shohë agimin
pa kaluar më parë nga rruga e natës.
- KHALIL GIBRAN

Tre muaj më vonë...

Dimrit po i vjen fundi, është fillimi i pranverës. Një agim me ngjyrë rozë të zbehtë po çel në *East Side*, duke lënë të kuptohet se dita do të jetë me diell.

Jo shumë larg brigjeve të *East River*-it ngrihet kisha e Shën Mërisë, një famulli e vogël hispanike që ndodhet si e ngecur në mes të një magazine dhe të një ndërtese pa shpirt. Këtu ndodhet edhe një qendër strehimi e përkohshme për endacakët. Edhe pse pajisjet janë të thjeshta, me pllaka të thyera, ndarje që mezi mbahen, instalime hidraulike difektoze..., ky ambient është i vlerësuar shumë nga ata që jetojnë nëpër rrugë. Ndryshe nga qendrat zyrtare, ata e dinë

që këtu nuk do t'ju bëjnë pyetje dhe se këtu do të gjejnë ushqim dhe rroba të pastra për të veshur.

Në fjetoren e katit të parë nën tokë, nja dhjetë endacakë e mbyllin natën duke fjetur në krevate portativë, ndërsa në sallën e përbashkët të katit përdhes, ata që ngrihen të parët kënaqen duke ngrënë një mëngjes të pakët e të varfër. Ky është oborri i mrekullive të shekullit XXI. E ulur mbi një tavolinë, një grua ende e re, me dhëmbë të rëna po gjerb një filxhan me kafe. Pranë saj, një rus trupmadh me një krah të prerë po skërmit i shkujdesur një biskotë që të mund të zgjasë sa më shumë procesin e ngrënies. Fare pranë dritares, një zezak i vjetër e thatuq, i pa interesuar për ushqimin, mblidhet kruspull në thesin e tij të gjumit duke vazhduar lutjen e përhershme.

Papritmas dera hapet dhe aty hyn një burrë me pallto të zezë dhe me mjekër të bollshme. Edhe pse nuk ka fjetur këtu, është i ambientuar me këtë vend. Ka disa kohë që ai e ka bërë të udhës të vijë këtu për të karikuar celularin e tij.

I ulur këmbëkryq, indiferent, Mark Hetëuej shkon në një cep të sallës dhe zgjatet tek një prizë elektrike për të vendosur aty karikuesin e celularit.

Ai nuk e ka parë të shoqen që për Krishtlindje. Tashmë ai nuk i ngjan askujt. Me flokë të hapërdarë, me shikim të fikur dhe me fytyrën plot yndyrë, ai është larguar prej kohësh nga bota e të gjallëve për të evoluar në një mjegull të përhershme, etapa e fundit para rënies.

Ju keni një mesazh të ri.

Zëri metalik në aparat nuk i kujton asgjë atij deri sa ajo thotë:

- *Mark? Jam unë...*

Këtë zë Marku natyrisht e njeh. Është zëri i gruas së tij.

Edhe pse me mendje jo të kthjellët, ai dallon gulçima në zërin e saj.

- *Më merr shpejt në telefon. Është urgjente.*

Pas një pauze të vogël:

- *Duhet të të them diçka...*

Në këtë çast Marku është i bindur se Nikola do t'i thotë se është gjendur kufoma e Lajlës. Papritmas ai ka një vegim të llahtarshëm: një kuçedër, një kafshë, një vajzë e vogël e cila ulërin nëpër natë, por...

- *Ishe ti që...*

Marku as arrin të marrë frymë. Të rrahurat e zemrës i oshtijnë te tëmthat.

- *...ishe ti që kishe të drejtë...* vijon të dëgjohet zëri i Nikolës.

Përsëri heshtje. Tani Marku nuk beson më asgjë, nuk kupton asgjë. Pastaj përsëri:

- *E gjetën...*

Marku mbyll sytë, gjen forcën për të pëshpëritur një lutje pa e ditur se kujt i drejtohej.

- *Ajo është gjallë, Mark.*

Një afsh përvëlues ia përshkon të gjithë trupin dhe e dërrmon plotësisht.

Tani Marku po qan.

- *Lajla është gjallë.*

6

Është gjallë

Të dashurosh, do të thotë të përkujdesesh
për vetminë e tjetrit, pa u munduar që ta plotësosh
madje as të mundohesh ta dish.

- CHRISTIAN BOBIN

Marku as që e ridëgjoi më mesazhin. Lajla ishte gjallë! Para një minute ai ishte në nenin e fundit të vdekjes, ndërsa tani e ndjente veten të rigjeneruar, të elektrizuar nga lajmi që mori vesh.

U largua nga qendra, vrapoi sa iu zu fryma përgjatë *Stanton Street*-it për të mbërritur në *Little Italy*. Disa herë u mundua të merrte një taksi, por asnjë nuk denjoi të ndalonte. E megjithatë ai nuk kishte as edhe një dollar në xhep. S'ka gjë. Do të hipte në metro pa biletë, deri në Bruklin.

Me të hipur në metro u ul në një stol për t'u mbushur me frymë. Ai s'arrinte të merrte frymë, i erreshin sytë, por nuk duhej të dorëzohej në këtë çast. Jo tani. Duhej të qetësohej,

dhe të normalizohej dalëngadalë. Edhe pse koka po i çahej dhe se zemra po i rrihte me shpejtësi.

Mblidh veten. Ti duhet të bëhesh ai që ke qenë më parë. Duhet ta bësh këtë për Lajlën. Ajo është gjallë. Ti e ke ditur gjithmonë këtë. Ti nuk e di sepse, por fakti është që ti e ke ditur gjithmonë.

Marku mbylli sytë dhe po mundohej të vinte pak rregull në kokën e tij.

Prandaj ti i rezistove dëshirës për t'i dhënë fund jetës tënde. Që të ishe i pranishëm ditën që ajo do të gjendej. Tani do të të duhet ta ndihmosh. Ti duhet të bëhesh i fortë për atë.

Marku qëndroi për një kohë të gjatë në këtë pozicion dhe i hapte sytë vetëm për të parë se në cilin stacion ishte kur treni ndalonte.

Në gjithë këtë rrëmujë që ekzistonte në trurin e tij, diçka papritmas u bë e qartë. Më tepër ishte intuita e tij se sa një përfundim logjik.

Data! Verifiko datën!

Në një nga ndenjëset para tij ndodhej një kopje e "Nju Jork Postit" e këtij mëngjesi. Ai rrëmbeu gazetën duke i hedhur një shikim të vrullshëm për të parë datën e ditës së sotme: E shtunë 24 mars 2007. Mesazhi telefonik i Nikolës ishte i djeshmi në mbrëmje. Domethënë Lajlën e kanë gjetur dje.

Më 23 mars 2007!

Kjo datë në vetvetę nuk donte të thoshte asgjë, por për Markun, ajo ishte një datë e shënuar me hekur të skuqur në zemrën dhe në mendjen e tij.

Lajla ishte zhdukur më 23 mars 2002.

Pesë vjet më parë.

Ditë më ditë.

* * *

Marku mbërriti në rrugën e vogël e të qetë të Bruklinit, ku ndodhej kjo shtëpi që më parë kishte qenë "shtëpia e tij", por që nuk ishte më. Në trotuar vuri re një makinë policie e cila ishte parkuar në një vend të ndaluar.

Me dy hapa të shpejtë ngjiti shkallët e hyrjes, i ra derës pa e parë të arsyeshme t'i binte ziles.

Fytyra e Nikolës sakaq u shfaq te pragu i derës. Thjesht një shikim që donte të thoshte shumë: dhimbja e mungesës, forca e lidhjeve të sinqerta... Pastaj një përqafim i ndërprerë nga shfaqja e një agjenti te FBI-së që prapa kurrizit të gruas së tij.

- Mirëdita doktor Hetëuej, - ndërhyri polici duke treguar distinktivin. - Frank Marshall, zyra e FBI-së të Kalifornisë, besoj se më mbani mend.

Marku u kthye nga ai. Me sa duket Nikola duhet ta kishte informuar, sepse polici nuk shfaqi asnjë shenjë habie që përpara tij kishte një njeri me pamje lypësi. Polici kishte një trup të madh e të fortë si Ed Harrisi: i plotë, me prerje flokësh të rregullta, me pamje disi të këndshme. Ishte ai që kishte mbikëqyrur dosjen lidhur me rrëmbimin e Lajlës.

- Ku është ajo? - arriti të thoshte Marku. - Ku është Lajla?

Nikola hapi gojën për të folur, por Marshalli u përgjigj në vend të saj:

- Duhet të jemi të kujdesshëm, doktor Hetëuej, - paralajmëroi ai duke u drejtuar nga një laptop i vendosur mbi tavolinën e sallonit. - Për momentin, ne nuk jemi njëqind për qind të sigurt se bëhet fjalë për vajzën tuaj. Një analizë e ADN-së është duke u kryer dhe pastaj do të jemi më të qartë.

Marshalli shtypi një buton të kompjuterit dhe fytyra e një vajze të vogël u shfaq në ekran.

- Kjo foto është marrë mbrëmë në darkë, disa orë para se ta gjenim.

Marku u përkul para ekranit.

- Lajla është! - tha pa dyshimin më të vogël. - Është vajza jonë!

- Atë shpresoj edhe unë, - iu përgjigj Marshalli.

- Dua ta shoh!

- Nuk ndodhet në Nju Jork, doktor.

Marku i afrohet Marshallit.

- Ku është?

- Në Los Anxhelos, në një qendër trajtimi mjekësor, Saint Francis Memorial Hospital.

- Si... Si është?

- Është akoma shumë shpejt për të dalë në përfundime. Mjekët po bëjnë të gjitha analizat e duhura. Është shumë shpejt për...

- A e kanë rrahur, përdhunuar?...

- Sinqerisht ne nuk dimë asgjë për momentin.

Marku shpërthen:

- Ç'domethënë kjo? Ne nuk dimë asgjë!

I ishte afruar aq shumë policit gati për ta prekur dhe i hakërrehej me një ton kërcënues.

- Qetësohuni, - ia ktheu qetësisht Marshalli duke u zmbrapsur paksa. - Do t'i themi gjërat me rregull e me radhë ashtu siç bëra edhe me gruan tuaj.

Nikola u bëri shenjë dhe i drejtoi për nga kuzhina dhe u përgatiti kafenë. Të dy burrat u ulën në krah të njëri-tjetrit

dhe Marshalli nxori një bllok nga xhepi si për të qenë i sigurt që nuk po harronte asgjë.

- Një vajzë, rreth dhjetë vjeçe është gjetur dje pasdite, rreth orës 17.00, duke u endur në një nga rrugicat e galerisë tregtare *Sun Shine Plaza*, në *Orange County*, në Los Anxhelos.

Marku zuri kokën me të dyja duart. Marshalli vazhdoi:

- Mosha e saj, ngjashmëria, data e saj e lindjes, blana poshtë mjekrës, të gjitha këto na bëjnë të mendojmë se bëhet fjalë për vajzën tuaj.

- Kjo qendra tregtare, - belbëzoi Marku, - është ajo ku...

- Po, ku humbi vajza juaj saktësisht para pesë vjetëve, ditë më ditë, - e plotësoi Marshalli.

Një shprehje dyshimi përshkoi fytyrën e Markut.

- E njëjta orë, i njëjti vend, me një interval kohor prej 5 vjetësh...

- Pra, nuk është me saktësi ajo që ne mund ta quajmë rastësi, jam dakord me ju.

- Po Lajla çfarë ju tha?

- Ky është edhe problemi, doktor Hetëuej, vajza juaj nuk na tha asgjë.

Marku ngrysi vetullat.

- Ajo nuk ka shqiptuar asnjë fjalë, - shpjegoi Franku, - as para nesh e as para personelit mjekësor që po merret me mjekimin e saj nga mbrëmë në darkë.

Një heshtje e plotë.

Marku filloi të arsyetojë si mjek. Në mjaft raste gjatë karrierës së tij, ai kish mjekuar fëmijë që vuanin nga një heshtje psikotike.

- Mjaft dëgjova! - u shpreh Marku duke brofur në këmbë. - Po nisem për në Los Anxhelos, po shkoj të marr Lajlën.

- Ju kemi rezervuar vende për sot ose për nesër, - ndërhyn Franku duke u ngritur gjithashtu... - Më merrni në telefon kur të jeni gati. Një nga makinat tona do t'ju shoqërojë për në aeroport.

- Gati jemi, - nxitoi të thotë Marku. - Nuk ka pse të presim.

Një qetësi e sforcuar u vendos në shtëpi, por ndërhyn Nikola:

- Jo!

Marku kthehet nga e shoqja duke shfaqur hapur habinë.

Për t'ju përgjigjur Nikola me gisht i tregon në drejtim të xhamllëkut të sallonit. Marku shikon andej dhe vë re portretin e tij që reflektohej si në pasqyrë. Portreti që shfaqej aty ishte ai i një të huaji, të dobësuar, të pistë, me flokë të gjata të palara, me mjekër të stërgjatë, me surrat të vrarë, me sy të skuqur e të lodhur tej mase. Ai të ngjallte frikë kur e shikoje.

- S'besoj se ke dëshirë që vajza të të shohë në këtë gjendje apo jo?

Marku që ndihet keq, ul kokën, në shenjë miratimi.

* * *

- Sa mirë që të gjithë klientët e mi nuk veprojnë si ju! - i thotë nëpër dhëmbë Xho Kallahani, një nga berberët tradicionalë të Bruklinit. - Të presësh dy vjet për t'u qethur, nuk është e arsyeshme doktor Hetëuej! Dhe këtu nuk po fus edhe punën e mjekrës!

Iu desh më shumë se një orë berberit të gjorë për t'ia dalë mbanë. Dhe siç e kanë zakon berberët, ai mori një pasqyrë me të cilën i tregoi punën e paqme që kish bërë.

- Shpresoj që herën tjetër të mos vonohem kaq shumë, - premtoi Marku.

Me dhjetë centimetra flokë më pak dhe i rruar taze, ai e kish të vështirë të njihte veten e vet.

Pas berberit, Marku kaloi nga shitorja e veshjeve e Park Slopit ku shkonte shpesh kur ishte ende mjek i ri shumë i suksesshëm e premtues dhe me një të ardhme të sigurt. Një palë pantallona copë e mirë, një xhaketë që i rrinte mirë pas trupit, *Polo*-n e fundit të modës, e zbukuruar me një krokodil ngjyrë argjendi... sigurisht që nuk ishin rrobat që e bënin njeriun. Disa orë më parë, ai nuk ishte veçse një rrangullinë që endej në një gjol gjithë plehra, dhe ja, me fare pak përkujdesje dhe me disa truke të tjera, ai përsëri arrinte të krijonte një iluzion.

Në shtëpi u kthye në këmbë. Makina e policëve para shtëpisë ishte larguar.

Punë e paqme.

U bë gati t'i binte ziles por u kujtua që Nikola i kishte dhënë çelësat. Hapi derën dhe u fut në korridor. Dritaret ishin të hapura. Salloni shkëlqente nën dritën pranverore dhe vinte erë molle dhe portokalli. Një këngë e Keit Xharretit ndihej aty brenda dhe të jepte përshtypjen se po e spërkaste ambientin me një mori notash kristaline. *The Koln Concert*: apoteoza e Xharretit, koncerti më i bukur i improvizuar i të gjitha kohërave, disku i xhazit që u pëlqente edhe atyre që nuk e kishin qejf xhazin. Marku u mallëngjye. Ky disk kishte për të një vlerë sentimentale: Nikola ia kish dhuruar në fillim kur ata ishin dashuruar.

- Nikolë, - thirri Marku.

Asnjë përgjigje. Mbase është në katin e sipërm.

I ngjiti shkallët katër e nga katër.

- Nikolë?

Marku hap derën e banjës.

Asnjeri.

Pastaj ndalet para derës së dhomës së tyre. Aty ishte ngulur me një gjilpërë me kokë një kartolinë ku dukeshin dy trupa njerëzish të bashkuar që ishin të lëshuar në një çarçaf që valëvitej. Marku dalloi menjëherë *Valsin,* këtë skulpturë të Kamilë Klaudelit, të cilin ata të dy e kishin admiruar në muzeun e Rodinit, gjatë udhëtimit të tyre të parë në Paris.

Muzika e Xharretit, pasioni i Kamilë Klaudelit. Dy "delikatesa" të lëna nga Nikola të cilat të shoqëronin në një të kaluar të largët.

Po ku ishte gruaja e tij?

Pa ditur se çfarë të bëjë, ai shkëputi nga vendi kartolinën dhe zbuloi se nga mbrapa ishin shkruar me ngut disa fjalë:

Mark, shpirti im!

Mos u shqetëso për mua. Unë jam mirë, por nuk mund të vij në Los Anxhelos tani.

Në fakt, me zemër këtë do doja të bëja, të vija me ty, të isha përsëri me ty dhe me vajzën tonë.

Por kjo është e pamundur.

Këtë udhëtim ti duhet ta bësh i vetëm.

Më fal që nuk mund të të them më shumë se kaq.

Më vonë, ti do ta kuptosh.

Çfarëdo që të ndodhë më pas, dije që unë të kam dashur gjithmonë dhe se do të të dua gjithmonë.

Nikola

7

Made in heaven

Kur unë kisha frikë, ai erdhi,
dhe, kur ai erdhi, kisha më pak frikë.

- EMILY DICKINSON

Dymbëdhjetë orë më vonë
Los Anxhelos
Saint Francis Memorial Hospital

Dukej se ashensori po ngjitej pa fund. Brenda në të, Mark Hetëuej dhe Frank Marshalli vështronin njëri-tjetrin sikur të ishin dy qen prej porcelani. Para se ashensori të mbërrinte në katin e duhur, agjenti i FBI-së vendosi të bënte pyetjen që mezi po e mbante përbrenda:

- A nuk ju duket e çuditshme që gruaja nuk erdhi me ju?

Marku nuk u përgjigj, gjë që i shkaktoi Frankut përshtypjen e pakëndshme se ai po fliste kot.

- Megjithatë, - vazhdoi Franku, vajza që ajo e quante të vdekur, shfaqet dhe...

- Çfarë do të thuash me këtë? - e ndërpreu Marku i irrituar.

Pas një mëdyshje të vogël, Franku vijoi:

- Nëse ju keni diçka për të na thënë për gruan tuaj që ne nuk e dimë, duhet të na e thoni. Këtë desha të të them.

Por Marku vijoi të mos ia vërë veshin, madje duke i kthyer edhe kurrizin. Ai duhet t'i harronte ato fjalë që i kish shkruar Nikola, të cilat nuk dinte se si t'i interpretonte. Tani për tani, i duhej të mendonte vetëm për të bijën, të cilën do ta takonte edhe për pak minuta. Asgjë tjetër nuk kish rëndësi për të në këto çaste.

- Edhe diçka, - shtoi Franku, - për nevoja të hetimit, FBI-ja nuk do ta bëjë publike daljen në skenë të vajzës suaj. Ne nuk i kemi dhënë shtypit asnjë informacion dhe dëshirojmë që gazetarët të mos merren me këtë punë tani për tani.

- Pse?

- Ne kemi arsyet tona, - u përgjigj qetë polici.

Por Marku kundërsulmoi përsëri:

- Që natyrisht ju nuk do të m'i thoni! Gjithmonë me maninë tuaj të mbajtjes së sekreteve! Por dijeni, se me mua këtu merr fund gjithçka. Ju s'keni pse të më imponoheni më për asgjë!

I habitur pak nga qëndrimi i Markut, Franku shtyp butonin e urgjencës së ashensorit duke e bllokuar atë në mes të dy kateve. I duhet të sqarojë situatën:

- Ta marrësh vesh një herë e mirë Hetëuej: unë do ju lejoj që ju të merrni Lajlën në Nju Jork, me kusht që ju të respektoni disa nga rregullat tona.

- Ik pirdhu. Vëre në punë ashensorin.

- Unë kërkoj që vajza juaj të ndiqet çdo ditë nga një psikolog i FBI-së. Dhe kur Lajla të fillojë të flasë, atë do ta marrim në pyetje ne.

Me këto që dëgjoi, Marku nuk u përmbajt. Në më pak se një sekondë, ai e mbërtheu agjentin federal nga jaka e xhaketës dhe e përplasi pas pasqyrës së ashensorit me një fuqi të paparashikueshme, aq sa ashensori u lëkund.

- Psikologu i sime bije tani jam unë, e more vesh? Vajzën time nuk do ta vizitojë askush tjetër. Unë jam specialist në këtë fushë, ndoshta më i miri.

Franku as nuk tentoi të luftonte por vetëm tha:

- Ndofta *ke qenë* dikur më i miri, ndërsa tani nuk je veçse një njeri i dhunshëm dhe impulsiv, i cili është dergjur për dy vjet rrugëve. Dhe ky nuk është një element sigurie për një fëmijë në gjendje shoku, ndaj besoj se edhe ju do të jeni dakord me mua.

Marku i shtrëngoi edhe një herë grushtet duke ushtruar përsëri presion mbi Frankun.

- Ju u treguat të paaftë për të gjetur Lajlën! Nëse ajo është sot këtu, ju nuk keni fare të bëni me këtë çështje. Prandaj qërohuni. Tani e kam vetë situatën nën kontroll. Çështja u mbyll.

Marku e lëshoi policin dhe shtypi butonin që ashensori të rivihej në punë.

Duke rregulluar jakën e xhaketës Franku i thotë:

- Çështja do të mbyllet atëherë kur ne të kapin rrëmbyesin e vajzës suaj.

* * *

Dyert e ashensorit u hapën dhe përpara shtrihej një korridor i gjatë me mure xhami, të cilët lageshin nga shiu e

era. Nata tashmë ka rënë dhe dritat e qytetit shtrihen pa kufi, pafundësisht mbi qytetin e engjëjve.

Marku mundohet të ndjekë udhëzimet që i kanë dhënë. Dhoma e Lajlës ndodhet në fund të korridorit. Marku dallon derën, kur është edhe dyzetë hapa larg saj.

Dhoma 466.

Dyzet metra.

Spitali zien nga zhurma e mjekëve dhe infermiereve, por Marku nuk dëgjon asgjë. I mbyllur në një flluskë qetësie, ai po ecën si në një xhirim të ngadalësuar, si në një plonzhon me ndërprerje të frymëmarrjes. Ai është i nxituar dhe plot paramendime: Për t'u siguruar, ai përsërit me vete se është përgatitur për të gjitha hipotezat e mundshme: ndoshta vajza edhe mund të mos e njohë ose të tregohet agresive, ndoshta nuk do të jetë në gjendje t'i flasë, ndoshta....

Tridhjetë metra.

Koha zgjatet në pafundësi. Përse ka kaq shumë frikë? E megjithatë, është ai që është në të drejtën e tij. Që prej pesë vjetësh, ai ka qenë i vetëm e kundër të gjithëve. Mobilizoi të gjitha energjitë për të mos pranuar idenë e vdekjes së Lajlës. Më shumë luftohet me mendje se sa me grushte. Ky ishte një mësim që Konori dhe ai kishin marrë që në fëmijërinë e tyre të vështirë në një lagje të qelbur të Çikagos. Ishte ky mendim që i kish orientuar në përzgjedhjen e profesionit të tyre. Dhe kur dhimbja bëhet shumë e fortë dhe kur nuk mund të japësh më goditje, njeriu përmblidhet në vetvete dhe e lë stuhinë të kalojë. Ka gjithmonë një çast ku armiku lodhet duke dhënë goditje. Ka gjithmonë një çast ku nxjerr krye më në fund premtimi i një rrugëdaljeje.

Njëzet metra

Sa më shumë afrohet, aq më shumë qartësohet në mendjen e tij përmbledhja e gjithë atyre vuajtjeve e tmerreve që ka pësuar këto kohët e fundit. Pesë vjet, janë shumë, pesë vjet i zhytur në një greminë dhimbjeje, duke ditur se vajza e tij vuan dhe se ai nuk ishte në gjendje të bënte asgjë për të. Është e dhimbshme që në fund të fundit të mos kesh zgjidhje tjetër, veçse të vuash edhe ti bashkë me të, në një orvatje të fundit për një bashkim ndjenjash.

Dhjetë metra.

Edhe pak metra dhe makthi do të marrë fund. Por tani për tani e ka të vështirë ta besojë një gjë të tillë.

Ndërsa akoma nuk ka arritur te dera, ajo hapet ngadalë.

Në fillim shquan vetëm një aureolë flokësh të lëshuar mbi pizhamet ngjyrë rozë. Pastaj dallon një vajzë të vogël, e shoqëruar nga një ndihmësmjeke, e cila ngre kokën në drejtim të tij.

Ajo është! Qenka rritur. Sigurisht. E megjithatë i duket e vogël dhe kaq e brishtë...

Një granatë së cilës i kanë hequr siguresën shpërthen në zemrën e tij, por jo për ta trembur. Ai e frenon dëshirën për të vrapuar drejt saj dhe mjaftohet vetëm me një lëvizje të dorës. Markut i dridhen të gjithë gjymtyrët.

Mos ik, Lajla, mos ik!

Vajza e vogël nuk ka lëvizur nga vendi. Marku guxon të shkëmbejë shikimin e tij me të sajin.

Njëmijë e tetëqind e njëzet e tetë ditë që kurse ajo ka humbur.

Ishte përgatitur të shihte një fëmijë të drobitur e të ç'orientuar, por në sytë e saj nuk lexon as tmerr e as dhimbje. Përkundrazi, ajo duket e qetë. Madje ja tek i jep edhe një

buzëqeshje të lehtë, lëshon dorën e ndihmësmjekes dhe vrapon në drejtim të tij. Marku ulet për të qenë në të njëjtin nivel lartësie me të dhe më në fund e merr në krahët e tij.

- Mirë je shpirt, - thotë ai duke e ngritur lart.

E shtrëngon pas vetes dhe një mirënjohje e një kënaqësi e pafund e pushton të gjithin. Është një ndjesi që për sa i përket intensitetit që ndjen, ia kalon edhe çastit kur ajo lindi.

- Çdo gjë mori fund tani, - i pëshpërit ai në vesh. - Mori fund. - Dhe për të qartësuar këtë kthim në normalitet, kontrollon në çantën e tij dhe nxjerr prej aty lepurushin prej pelushi të cilin e kish sjellë që nga Nju Jorku.

- Të solla lepurushin tënd të bardhë. Të kujtohet? Ti nuk flije asnjëherë pa Zotëri Lepurushin.

Vajza e vogël e merr lepurushin dhe e shtrëngon fort pranë zemrës së saj.

- Mori fund bebushi im, - përsërit Marku si për të bindur akoma më shumë veten e tij. - Mori fund. Do të kthehemi në shtëpi.

8

Aeroporti

Të ëndërrosh një ëndërr të pamundur
Të mbash brenda vetes dhimbjen e largimeve
Të përvëlohesh nga ethe të mundshme
Të shkosh atje ku askush nuk shkon.

- JACQUES BREL

Sot
25 mars 2007 - ora 8 e mëngjesit
Aeroporti Los Anxhelos LAX

MARKU

Taksia ndaloi para terminalit 2, por Marku nuk zbriti menjëherë. Gjatë rrugës deri në aeroport, Lajlën e kish zënë gjumi në supin e tij dhe nuk donte ta zgjonte menjëherë. Pasi u larguan nga spitali, ata fjetën atë mbrëmje në një hotel në *down town*. Lajla akoma nuk kishte thënë asnjë fjalë të vetme,

por ajo dukej e qetë, e lumtur që po e takonte atë.

- Do flasësh përsëri, - i premtoi vajzës së vogël që po flinte gjumë.

Për këtë ishte i sigurt. Për këtë mjaftonte që ajo të ishte e rrethuar nga njerëzit dhe e mbrojtur. Dhe Marku do të të bënte gjithçka që ajo të rifitonte besimin.

Që nga xhamat e errët të makinës, Marku shikonte me njëfarë ankthi gjallërinë që gëlonte rreth e rrotull aeroportit. Ai e urrente Los Anxhelosin, ndotjen, pamjen e tij sipërfaqësore, si dhe dhunën e këtij qyteti. Ky qytet gjigant i kishte krijuar përshtypjen se gëlltiste gjithçka që shfaqej para tij: natyrën dhe njerëzit.

Brenda kabinës së makinës ndihej i mbrojtur edhe për disa sekonda, i përkundur në mendimet e tij nga pastërtia e intonacioneve të një pjese për violinë që po transmetonte radio e makinës.

Unë e njoh... unë e njoh këtë muzikë.

- Qenka shumë e bukur kjo pjesë. E kujt është?

- "La Shakone" e Bahut, - u përgjigj shoferi duke i treguar kapakun e kompakt diskut.

Marku shikoi me vëmendje kutinë e ilustruar ku ishte edhe një fotografi: një violiniste, e veshur lehtë, me fytyrën të mbështetur në një pasqyrë, e cila reflektonte imazhin e një qenieje me dy koka, njëkohësisht seksi edhe shqetësuese. Në etiketën e verdhë ishte shkruar emri i instrumentistes dhe programi i recitalit:

Nicole Hathaway plays Bach
Partitas for solo violin

Marku nuk pati kohë të mallëngjehej. Lajla sapo hapi sytë. Ajo e pa të atin duke buzëqeshur dhe mposhti një të hapur të gojës.

- Vishe xhakoventën, - i tha butësisht Marku. - Tani do të hipim në avion.

Vajza e vogël u bind dhe ata dolën nga taksia për t'u futur në terminal.

Në hollin e nisjeve, tensioni ishte maksimal. Para një jave, zbulimi i një tjetër komploti terrorist në Mbretërinë e Bashkuar kishte ngjallur panik në të dy anët e Atlantikut dhe ishte pasuar nga një numër alarmesh të rreme. Niveli i gatishmërisë anti-terroriste kish kaluar nga "kritik" në "i rëndë", dhe, çdo ditë, shumë fluturime ishin anuluar. Marku verifikoi që fluturimi i tyre nuk ishte anuluar dhe u drejtua për nga vendi i kontrollit. Ai e dinte që forcimi i kontrollit të pasagjerëve dhe i kontrollit të bagazheve e zgjasnin kohën e pritjes dhe donte të shpëtonte sa më shpejt nga ky formalitet.

Në mes të turmës së njerëzve, ai mbante fort përdore vajzën e tij Lajlën, si të kish frikë se mos e humbiste përsëri.

- Doktor Hetëuej! Doktor Hetëuej!

Marku ktheu kokën, i çuditur që dikush po e thërriste.

Disa metra prapa tij, gjendej një njeri që ai s'e kish parë ndonjëherë dhe që po vraponte në drejtim të tij.

- Majkëll Filips, punoj për *Herald*, - u prezantua ai.

Marku ngrysi vetullat.

- Do të doja që vajza juaj të më thoshte diçka, - tha gazetari duke nxjerrë magnetofonin nga xhepi.

- Ne nuk kemi asgjë për t'ju thënë, - vendosi Marku duke e shtrënguar edhe më dorën e së bijës dhe nxitoi hapin.

Por edhe gazetari i ndoqi pas duke u munduar të tregohej sa më bindës:

- Ju ofrojmë një kontratë prej 75.000 dollarësh për një intervistë dhe për një seancë fotografish.

- Ik shporruni tutje! - iu hakërrye Marku.

Duke u kthyer në drejtim të tij, vuri re se gazetari e kish hapur celularin dhe po mundohej të merrte vjedhurazi një foto.

Duke u munduar edhe të mbrojë Lajlën, e kapi Filipsin nga gryka duke e shtrënguar fort deri sa gazetari të bindej të lëshonte celularin nga dora.

Celulari ra përtokë dhe Marku e shtypi fort me këmbë dhe e shkërmoqi me thembrën e këpucës.

- Do të ma paguash këtë! - e kërcënoi gazetari duke fërkuar qafën.

Marku e fiksoi për disa çaste, i befasuar paksa nga impulsiviteti dhe shpejtësia me të cilën e kishte kryer këtë veprim.

Dhe ndërsa Marku kthehet për t'u drejtuar në zonën e regjistrimit, dëgjoi Filipsin që po e kërcënonte:

- Jeni një copë muti Hetëuej, dhe nuk e dini! Unë e kam bërë anketimin tim: kam të dhëna që mund t'ju shërbenin edhe juve. Ju nuk e dini të vërtetën! As atë të gruas suaj e as atë të vajzës!

* * *

EVI

Autobusi që vinte nga *Union Station* i la pasagjerët te terminali 2. Në mes tyre ishte edhe një vajzë 15 vjeçare me pamje gotike. Evi ishte e fundit që zbriti nga autobusi. Akoma

e përgjumur, ajo u fut në hollin e nisjeve, me sy të rënduar, të drejtuar nga ekranet për të verifikuar orën e fluturimit të saj. Natën e kaluar kish fjetur në një stol dhe tani i dhembnin të gjitha. Zorrët e barkut i kërcisnin. Kyçet i thernin dhe kockat i kishte të brishta, sikur do t'i thyheshin nga çasti në çast. Ajo pa gjithë zili një kafe *Starbucks* ku kishte kafe dhe çokollata, por ajo nuk kishte as edhe një dollar në xhep. E uritur rrëmbeu fshehurazi një gotë me pak lëng portokalli që dikush e kish lënë dhe një copë kek në koshin e plehrave të *coffee-shopit*.

Për pak orë ajo do të ishte në Nju Jork. Pasi kish hezituar për të shkuar në Los Anxhelos, tashmë ajo ishte e gatshme të gjente njeriun që po ndiqte. Ajo e dinte adresën e tij: një ndërtesë në Manhatan. Kur ta gjente, ajo do ta vriste.

Ajo do ta vriste.

Ajo do ta vriste.

Dhe ndoshta pastaj dhimbja do t'i pakësohej.

* * *

ELISONI

Një fuoristradë me pamje agresive, në formë kupe në të dy anët, u parkua me vështirësi në katin e tretë të parkingut nëntokësor të terminalit nr. 2.

Brenda në makinë dëgjohej përzierja marramendëse e një muzike rep dhe një R&B që ishte ngritur në kupë të qiellit. Makinën e ngiste një vajzë 26 vjeçare, Elison Herrisoni: me flokë ngjyrë platini të prera shkurt, xhinse të hollë firmato, me një rrip në formë laku, me një xhaketë lëkure me bel.

Elisoni fiku makinën dhe e lëshoi veten mbi timon. I gjithë

trupi iu përshkua nga mornica. Duhej që të dukej e qetë nëse dëshironte të hipte në avion. Dhe për ta bërë këtë nuk kishte tridhjetë e gjashtë zgjidhje. Ajo kontrolloi në çantën e saj të markës "Hermes" për të nxjerrë prej aty një kuti pudre prej fildishi. E ndezur siç ishte, ajo thithi dy-tri herë kokainën pastaj fërkoi mishrat e dhëmbëve me pak pudër të bardhë. Ishte e vetmja zgjidhje që të mos shembej përdhe. Pa dozën e kokainës ajo dukej e mjerë, e pazonja të bënte as edhe veprimin më të thjeshtë. Që prej shumë vitesh e kishte humbur kontrollin nga konsumimi i drogës.

Në fakt, në më pak se një minutë, Elisoni sikur e rigjeti veten disi dhe e ndjeu përsëri trupin të fortë dhe veten të zonjën për të përballuar gjithçka. Shumë shpejt, kjo qetësi transformohej në arrogancë dhe në një hiperndjeshmëri. Por ndërkohë asaj i duhet thjesht të rigjente forca deri sa bytha t'i zinte vend në avion dhe të kthehej në Nju Jork.

Ajo i hoqi lentet e kontaktit të miopisë për t'i zëvendësuar me lente me ngjyra: një sy rozë dhe tjetrin blu. Në pasqyrën e makinës rregulloi balluken duke e fiksuar me një kapse në formë fluture. Pasi u zbukurua, doli nga fuoristrada duke iu marrë këmbët, e duke qëndruar në majë të ca takave të larta dhe duke tërhequr një çantë udhëtimi me rrota.

Kur blici i paparacit u shkrep, Elisoni pa reflektimin e saj të fashitej te xhami i përparmë i një berline të ndalur aty. Xhami ia ktheu mbrapsht këtë imazh mizor por të drejtë.

Ishte ky imazhi i një llastice të kokainizuar e cila vlente një miliard dollarë.

* * *

Ja pra, aty janë të tre, disa metra larg njëri-tjetrit, në këtë teatër që quhet holli i aeroportit.

Marku,

Evi,

Elisoni.

Ata nuk e njohin njëri-tjetrin, nuk kanë folur asnjëherë së bashku, por ata kanë tashmë diçka të përbashkët.

Që të tre janë në një çast kthese në jetën e tyre.

Në çastin e fundit.

Fare pranë fundit.

Që të tre kanë një të kaluar të dhimbshme.

Të gjithë kanë pasur një jetë të trazuar nga mungesa ose nga vdekja.

Të gjithë e ndjejnë veten edhe viktima edhe fajtorë njëkohësisht.

Edhe për pak minuta, ata do të hipin në të njëjtin avion.

Dhe jeta e tyre do të ndryshojë.

* * *

- Lajla, unë po kaloj para teje dhe pastaj ti më ndiq, dakord?

Marku hoqi xhaketën, rripin, orën të cilat i vendosi në tapetin lëvizës para se të kalonte në portikun e sigurisë.

Asnjë shqetësim për të.

- Hajde, Lalja, vazhdo ti tani! - i thotë ndërkohë që po merrte sendet e veta.

E qetë, vajza e vogël iu bashkëngjit të atit, por duke kaluar sinjali i alarmit u ndez në sistemin e sigurisë.

- Boshatisni xhepat dhe hiqni këpucët!

A do mërzitej surrati yt sikur të ishe më shumë i sjellshëm, mendoi Marku duke e pushkatuar me shikimin e tij agjentin e sigurisë.

Duhet thënë se në aeroport që në mëngjes ekzistonte një atmosferë e elektrizuar. Tensioni i lartë ishte përforcuar nga prania e shumtë e ushtarakëve që ushtronin kontroll pa ndërprerje.

Mjeku u ul pranë vajzës së tij që ta ndihmonte të hiqte këpucët. I kontrolloi xhepat, por ato ishin bosh.

- Mos u shqetëso shpirt, çdo gjë do të shkojë mirë.

Me çorape, Lajla kaloi përsëri portikun e sigurisë dhe përsëri sinjali i sigurisë u dëgjua. E çuditshme: ajo kishte veshur vetëm një palë pantallona xhins, një bluzë dhe xhakoventën.

Marku u vrenjt.

- Makina juaj qenka e çakërdisur!

Pa marrë mundimin t'i përgjigjet, punonjësja e sigurisë iu afrua vajzës.

- Kthehuni nga ana tjetër zonjushe, dhe ngrini krahët lart.

Lajla u bind ndërkohë që tjetra po i kalonte detektorin në të gjithë trupin.

Aparati filloi të tërbohej prapë kur ai arriti në nivelin e kokës së fëmijës.

- Ç'domethënë kjo? - u nervozua Marku.

Punonjësi i sigurisë nuk dinte se çfarë të thoshte. E përsëriti veprimin e tij, dhe detektori u dëgjua përsëri, derisa u thirr një koleg tjetër që të sillte një detektor të ri. Por as ky detektor i ri nuk e zgjidhi problemin: logjika të bënte të mendoje se

Lajla mund të kishte një trup metalik të vendosur poshtë lëkurës!

I befasuar punonjësi i sigurisë u drejtua nga një kamera sigurie për të folur me një bashkëbisedues të padukshëm:

- Zonjë, kemi një problem...

* * *

Marku dhe e bija tashmë ndodheshin në një zyrë të zbrazët që të jepte përshtypjen e një dhome hetuesie. Para tyre, një femër latino-amerikane me pantallona stofi, me pamje të rëndë së cilës i dukej vetja si Kondoleza Rajs, po shikonte me imtësi pasaportat e tyre.

- Më shpjegoni diçka, zoti Hetëuej: a ka pasur vajza juaj këto kohët e fundit ndonjë ndërhyrje kirurgjikale?

- Nuk... Nuk e di, - detyrohet të thotë Marku.

- Mos vallë i kanë injektuar diçka në qafë? Një çimkë ose një implant të çfarëdollojshëm?

- Nuk e di.

Shefja e sigurisë i hodhi Markut një shikim përçmues.

- Ç'domethënë kjo, ju nuk e dini! A është vajza juaj, apo jo?

- Kjo është një histori shumë e gjatë, - u përgjigj Marku me një zë të dërrmuar.

Kondoleza i drejtohet Lajlës:

- A ke dhimbje nga mbrapa kokës?

Vajza e vogël i bëri ballë shikimit të saj pa i lëvizur asnjë qerpik, duke ruajtur në të njëjtën kohë qetësinë e plotë.

- Hë pra, të paska ikur goja?

Duke mos u përmbajtur dot më Marku brofi nga karrigia.

- Eja ikim! - vendosi ai duke kapur të bijën për dore. - Punë e madhe për avionin. Do të marrim një makinë me qira.

- Ju nuk do të lëvizni prej këtu, - tha prerazi bashkëbiseduesja e tij duke treguar një ushtarak i cili qëndronte te dera e hyrjes.

- Pa të shohim njëherë! - shpërtheu Marku. - Pa më jepni pak pasaportat! Nuk kam asgjë për t'ju thënë.

Diskutimi po merrte nuanca konfliktuale. Në atë kohë ra zilja e telefonit.

- Po? - tha Kondoleza duke shtypur edhe altoparlantin që të dëgjohej në sallë.

- Zonjë, është FBI-ja, - e informoi sekretarja e saj, - agjenti Frank Marshall.

- I thoni të më marrë pak më vonë.

- Ai thotë se është urgjente.

- Mirë, ma kalo pra, - shtoi ajo, duke e mbyllur altoparlantin.

Marku ishte ulur përsëri, i befasuar nga kjo ndërhyrje e Frankut dhe po pyeste veten se ku donte të dilte ai.

Biseda qe e shkurtër, e saktë me dy "po" dhe me një "si urdhëron zotëri" para se Kondoleza të mbyllte receptorin.

E vënë në siklet, ajo ngriti sytë nga Marku dhe, duke i dhënë fund bisedës shtoi:

- Çdo gjë është në rregull, doktor Hetëuej, - tha ajo duke ia kthyer pasaportën. - Ju lutemi të na falni për shqetësimin. Ju uroj udhëtim të këndshëm juve dhe vajzës suaj.

* * *

I nervozuar nga ky kontroll poshtërues, Marku e ndau

mendjen se babë e bijë kishin të drejtë tani të hanin një mëngjes të mirë. Në banakun e Bon Café, kishte një mori dyqanesh *Coffe-shops*, të krijuara nga një francez. Marku porositi dy tabaka të mbushura mirë dhe ul me Lajlën në një tavolinë të vogël, pranë një peme jeshile. Ai vuri re me kënaqësi se vajza ishte mirë me oreks dhe se kafshonte me të gjithë dhëmbët në kruasanin e saj "ala parisien", duke e shoqëruar me lëng portokalli. Ndërsa vetë u mjaftua me një kafe, duke i hedhur një sy të shkujdesur një ekzemplari të gazetës *USA Today*, që u ofrohej falas të gjithë klientëve.

* * *

Terminali ndriçohej nga një dritë e këndshme e bardhë. Kur Marku me Lajlën u larguan nga kafja, një vajzë e re u kaloi pranë dhe, pa u vënë re, u ul në tavolinën e tyre për të rrëkëllyer lëngun e portokallit të mbetur në gotë dhe të kosit që as nuk ishte prekur fare me dorë.

Evi përfitoi për t'u hedhur edhe një sy titujve të gazetës. Një shkrim i ilustruar me një foto të madhe zinte gjysmën e faqes së parë.

Vetëvrasja e miliarderit Riçard Harrison

Themeluesi i grupit *Green Cross*, një nga liderët botërorë të shpërndarjes së madhe, vdiq dje në Nju Jork, në moshën 72 vjeçare. Miliarderi u gjend në

anijen e tij, i shtrirë në një masë gjaku, pasi kish qëlluar veten me një plumb, të një pushke gjuetie, në kokë.

Sipas informacioneve tona, Riçard Harrisoni duhet t'u ketë lënë një letër të afërmve, për t'ju shpjeguar arsyet e veprimit të tij. Zoti Harrison, i cili para dy vjetësh kishte bërë publik faktin se ishte prekur nga sëmundja e alzheimerit, nuk mund të pranonte që të ligështohej edhe më nga kjo sëmundje.

Shërbimet funebër do të kryhen nesër pasdite në Manhatan.

Në vitin 1966, në një qytet të vogël të Nebraskas, Riçard Harrisoni vendosi gurin e parë të perandorisë së tij duke hapur fillimisht një ushqimore me çmime të lira. Suksesi ishte i madh dhe i menjëhershëm, dhe shumë shpejt, ai mundi të hapë edhe pika të tjera shitjeje, fillimisht në këtë krahinë, e më pas, në të gjithë vendin. Numri i *Green Cross* nuk ka reshtur së shtuari në Shtetet e Bashkuara, aq sa sot arrin në më shumë se 600 sipërfaqe të mëdha.

Njeri i rezervuar, i njohur për jetën e tij të moderuar, Riçard Harrisoni jetonte në të njëjtën shtëpi që prej tridhjetë vjetësh. Paraja me sa duket nuk paska ndryshuar ndonjë gjë të madhe në jetën e zakonshme të këtij bosi të madh që kishte kënaqësi të bëhej i njohur duke e konsideruar veten si "Zot i gjithë të tjerëve", duke mos treguar për asnjë çast shenja dalluese të pasurisë së tij.

Njeri i qetë dhe i përmbajtur, krejt ndryshe nga e bija, Elison, bëmat e së cilës trajtohen shumë shpesh nga shtypi i popullit.

Evi e ndërpreu leximin e gazetës, e shpërqëndruar nga zhurma që bëhej pranë dyerve automatike. E befasuar nga një turmë fotografësh, e verbuar nga blicet, Elison Harrisoni sapo hyri në terminal. E dobët si manekin mode, me fytyrën gjysmë të fshehur nga një palë gjyzlykë të stërmëdha, ajo e kish të vështirë të përmbante turmën që e rrethonte dhe e mbyste në pyetje:

Flash - Flash - Flash *Elison! Kaloni këtej Elison!* ***Flash - Flash:*** *Si po e përballoni Elison?* ***Flash*** *Çfarë marrëdhëniesh kishit ju me babanë tuaj? Thuhet se ju nuk flisnit me njëri-tjetrin. Po nga droga, a keni hequr dorë? Elison!* ***Flash - Flash:*** *Si ju duket vetja si trashëgimtare e një miliard dollarëve? Elison! A keni njeri në jetën tuaj aktualisht?* ***Flash - Flash:*** *A do të riktheheni në spital? Po me drogën çfarë do të bëni Elison? Nuk u përgjigjët, vërtet i keni dhënë fund asaj?* ***Flash***

Pyetjet vazhdonin, e Elisonit i dukej se çdo herë merrte një shpullë.

Në fillim, kur mediat filluan të interesohen për të, Elisonit i pëlqente dhe i ishte përkëdhelur sedra. Madje për njëfarë kohe asaj i dukej se e kontrollonte situatën duke kujtuar se i kishte instrumentalizuar mediat në favor të saj. Pastaj njohja e saj u kthye në famë dhe kështu loja midis tyre kish përfunduar. Tani nuk kishte ditë që një fotograf të mos i bënte një foto dhe se ndonjë shkrues me një mikrofon në dorë orvatej t'i shkëpuste ndonjë fjalë.

Flash - Flash:

Elisoni vuri njërën dorë para fytyrës së saj për t'u mbrojtur.

Ndërkohë kujtimet e së kaluarës vijnë ndërmend me shpejtësinë e një bumerangu.

Flash...

...Back

9

Elisoni
Flash backu i parë

Tetë vjet më parë

Trashëgimtarja e perandorisë Green Cross provokon një skandal në Times Square

(AP - 18 tetor 1999)

Ndërsa dilte nga një restorant, që ishte shumë në modë në atë kohë, ku kish festuar 19 vjetorin e ditëlindjes së saj, Elison Harrisoni, me sjelljen e saj provokoi një grumbullim njerëzish atë mbrëmje në Times Square. Me sa duket, pasi kishte pirë mirë e mirë, e dehur plotësisht, zonjusha Harrison improvizoi një skenë striptizmi në mes të rrugës, nën të qeshurat, të tallurat dhe të sharat e një "publiku" të shumtë në numër që ndodhej aty pranë.

Qëkurse ka ndërprerë studimet e saj për "t'iu përkushtuar tërësisht" "mbrëmjeve popullore" si dhe sekuencave të shopingut, vajza e miliarderit Riçard Harrison mbush rregullisht kronikën me ekstravagancat dhe qëndrimin e saj prej fëmije të llastuar.

* * *

Kapriçot e Elisonit

(AFP - 23 dhjetor 1999)

Në Paris, miliarderja ka befasuar personelin e Hotelit Georges V.

Pasi kishte boshatisur me blerjet e saj shitoret e veshjeve të Champs-Elysées, ajo ka rezervuar, përveç suitës së saj luksoze, edhe një dhomë tjetër vetëm për të vendosur pakot. "Kishte të paktën 30 kuti këpucësh, të gjitha të markave më të njohura ", deklaroi pastruesja e dhomës.

* * *

Stivi dhe Elisoni: Lidhje serioze

(Online - 14 janar 2000)

Kanali *e-Music* e kish dhënë si lajm javën e shkuar,

por tashmë është zyrtar: bateristi i grupit të rrokut 6th Gear dhe trashëgimtarja e perandorisë Green Cross po përjetojnë një romancë dashurie që prej dy javësh.

Stiv Gleni, tridhjetë e një vjeç, është i njohur për sjelljet e tij prej djali të keq dhe si dhe për shijen e tij të theksuar për alkoolin. Stivi dhe Elisoni: një koktej shpërthyes i cili do t'u hapte shumë punë paparacëve.

* * *

Skandal në Kurshevel

(AFP- 12 shkurt 2000)

Trashëgimtarja e perandorisë Green Cross nuk u shfaq këtë fundjavë në stacionin e famshëm dimëror të Alpeve, ku kishte rezervuar dy pista vetëm për përdorim vetiak nga ana e saj.

"Askush nuk e ka parë. Merret me mend se trashëgimtarja do të jetë llahtarisur nga zhurma mediatike lidhur me kushtet e pritjes që i ishin rezervuar. Me sa duket këtu nuk i kanë qejf ata që i tejkalojnë të drejtat e tyre", deklaroi një burim nga bashkia, i cili nuk donte të identifikohej.

* * *

Miliarderja hajdute
(AP - 03 maj 2000)

Me sa duket, Elison Harrisoni qenka e të gjithave! Biondja bombastike u arrestua dje pasdite për vjedhje të disa mijëra dollarëve veshje në një dyqan veshjesh të njohur të Beverli Hills.
Babai i saj bëri të ditur se do t'i drejtohej Xhefri Uekslerit, një nga avokatët më në zë, për të siguruar mbrojtjen e së bijës.

* * *

Elisoni e relaksuar
(AP - 08 qershor 2000)

* * *

Elisoni dhe Stivi: kaq e patën
(Online - 18 dhjetor 2000)

* * *

Elison Harrisoni e akuzuar për veprën penale të ikjes
(The Telegraph - 03 janar 2001)

Të jesh miliarder nuk të jep të drejtën të jesh mbi ligjet.

Sipas faqes së internetit OMZ.com, Elison Harrisoni u largua nga vendngjarja pas një aksidenti, që për fat të mirë nuk pati viktima.

Kjo shkelje do të kish mbetur me kaq nëse një kalimtar nuk do të kish filmuar skenën me telefonin e tij celular. E detyruar të pohojë faktet, Elisoni iu drejtua avokatit të familjes së saj Xhefri Uekslerit për të gjetur një marrëveshje me mirëkuptim me pronarin e makinës.

* * *

Elison Harrisoni ka një të dashur të ri

(Online - 12 shkurt 2001)

Mondania që u nda nga rrokstari Stiv Glen gjeti menjëherë ngushëllim në krahët e heroit të serisë televizive Pacific Pallissad, aktorin Austin Tailer me të cilin u takua gjatë xhirimit të një reklame.

* * *

Elison Harrisoni shpenzon shuma marramendëse për Roksin

(AP - 06 mars 2001)

Trashëgimtarja shumëfishon çmenduritë me blerjet për veshjen e qenit të saj. Asgjë nuk i mungon atij: rrip qafe me diamante, "një garderobë" e dizenjuar nga stilistët më në zë, seanca te një psikolog për qentë. Asgjë nuk është me tepri dhe ekzagjerim për Roksin e bukur, qenin e saj kinez, të cilin e merr kudo që shkon me vete. "Ndryshe nga burrat, e di që Roksi të paktën nuk do të më braktisë asnjëherë", tha miliarderja për të justifikuar shpenzimet për qenin e saj.

* * *

Një video e nxehtë e Elisonit në Net!

(Online - 20 korrik 2001)

Pasi i kishin vjedhur celularin në një klub nate në Majami, trashëgimtarja kishte frikë se mos ia shfrytëzonin për keq të dhënat që ajo kishte në të. Përveç adresave të miqve të rrethit të ngushtë, celulari kishte edhe shumë foto e video nga jeta e saj private. Njëra prej këtyre videove, një videoklip prej diçka më shumë se dy minutash, tregonte Elisonin dhe të dashurin e saj në një skenë të fuqishme shtrati me këmbët përpjetë, që tashmë sapo kish filluar të jepej në internet.

- Jam e shokuar se si mund të ekspozohet intimiteti im në këtë mënyrë, - deklaroi Elisoni. - Do doja t'ju

kërkoja falje për këtë miqve të mi dhe familjes sime. Pasi e kaloi këtë dallgë, miliarderja, sikur të mos kish ndodhur gjë fare shprehet: - Është e natyrshme të bësh dashuri, unë nuk pranoj të konsiderohem fajtore për asgjë.

* * *

Elison Harrisoni promovon linjën e saj të të brendshmeve

(AP - 6 gusht 2001)

Krijimet e saj do të shiten vetëm në dyqanet *Green Cross*.

* * *

Elison Harrisoni përsëri beqare?

(Online - 28 gusht 2001)

* * *

Elisoni, ithtare e *la Kabbale*

(Reuters - 9 shtator 2001)

Si shumica e sërës së saj në Hollivud, biondja e

çuditshme u deklarua si një ithtare e *la Kabbale*, feja e fundit në modë te yjet. "E mbaj gjithmonë me vete byzylykun tim me fije të kuqe. Ai më ndihmon që të largoj fatin e keq dhe më lejon që të jem në kontakt me fuqinë time spirituale".

* * *

Një parfum me emrin Elison

(AP - 29 shtator 2001)

Tani e ka radhën trashëgimtarja Harrison për të nxjerrë një parfum të ri me emrin e saj. Zonjusha Elison bashkëpunoi me një markë prestigjioze (pronë e të atit) për të krijuar parfumin e ri, i cili do të jetë i gatshëm në treg për Krishtlindje.

* * *

Elison Harrisoni prapë me dikë?

(Online - 28 tetor 2001)

* * *

Elison Harrisoni do dëshironte të bëhej aktore kinemaje

(Imdb.com - 20 nëntor 2001)

* * *

Nga një sportist te tjetri...

(Online - 5 dhjetor 2001)

Elison Harrisoni me sa duket është shumë e interesuar për sportet. Pas futbollistit Dave Dela Luna, kësaj here në rrjetën e biondes miliardere ka rënë kampioni olimpik i notit Xhon Aldren.

* * *

Parfumi i Elisonit është një dështim

(AP - 8 janar 2002)

* * *

Elison Harrisoni arrestohet për ngasje të makinës në gjendje të dehur

(Reuters- 12 janar 2002)

Nga burime të policisë mësohet se ylli Elison Harrison është arrestuar në mbrëmjen e të shtunës duke u gdhirë e diel në Los Anxhelos, për drejtimin e makinës në gjendje të dehur.

Arrestimi u krye në orën 2 e 15 minuta të mëngjesit në Beverli Hill pasi policët rrugor vunë re se makina e saj ecte duke gjarpëruar në mënyrë të rrezikshme në rrugë.

Policët nuk e patën të vështirë të gjejnë një shishe tekila në makinë.

Testi i alkoolemisë vërtetoi se Elison Harrisoni, 22 vjeçe kishte një nivel shumë të lartë të alkoolit në gjak nga norma e lejuar.

Tashmë i takon prokurorisë të përcaktojë se kur ajo duhet të përgjigjet për shkeljen e bërë para drejtësisë.

* * *

Elisoni dënohet!

(Reuters - 24 shkurt 2002)

Elison Harrisoni u dënua sot me një gjobë 10000 dollarë dhe heqje të patentës për gjashtë muaj pas një kontrolli pozitiv për drejtimin e makinës në gjendje të dehur më 12 janar të këtij viti.

Trashëgimtarja duhet gjithashtu t'i nënshtrohet një programi lidhur me rreziqet e alkoolit kur je duke drejtuar makinën.

10

Në avion

I vënë në provë, njeriu
ka vetëm tre mundësi zgjedhjeje:
1)Të luftojë;
2)Të mos bëjë asgjë;
3)Të iki.
- HENRI LABORIT

Sot
25 mars 2007 - ora 10 e mëngjesit
Aeroporti i Los Anxhelosit LAX

"Zonja dhe zotërinj, kapiteni Mekkarti dhe ekuipazhi i tij janë të lumtur t'ju kenë në bordin e këtij avioni *Airbus A380* me destinacion Londër - Nju Jork. Ne ju lutemi të uleni në vendet tuaja dhe të prisni sinjalin e nisjes. *Shangri - La Airlines* ju uron një fluturim shumë të këndshëm".

Në çastin e hipjes në avion, Marku u befasua nga stërmadhësia e tij. *Airbus*-i shtrihej përgjatë një ure dyfishe të

plotë ku mund të zinin vend më shumë se 500 pasagjerë. Për të shmangur bllokimet, hyrja në avion bëhej nëpërmjet dy pasarelave të cilat të çonin në kate të ndryshëm. Duke e shtrënguar fort Lajlën nga dora, Markut iu deshën dy minuta për të gjetur vendet e tyre. Pas disa vonesash në lëvrimin e këtij tipi avioni, kompania e Singaporit, *Shangri La-Airlines* ishte e para që e vuri në shfrytëzim këtë gjigant evropian dhe nuk i kishte kursyer paratë për të krijuar një ambient luksoz në ambientet e brendshme të tij. Me dritaret e mëdha dhe me ndenjëset e zhvendosura nga njëra-tjetra, klasa ekonomike ishte plot shkëlqim, luks dhe e rehatshme.

Marku dhe e bija i kishin vendet mbrapa platformës së poshtme. Kur u ulën nëpër vendet e tyre, një vajzë e re rreth të pesëmbëdhjetave, me flokë të palara dhe të ngjitura, po flinte tashmë në ndenjësen ngjitur me dritaren në rreshtin e tyre. Mbi gjunjë kishte një çantë shpine të vjetër me një etiketë:

Evi Harper

Lajla u ul në vendin e vet, midis të atit dhe Evit. Ajo kish veshur bluzën me ngjyra *Liza në botën e çudirave* që Marku sapo ia kish blerë në një shitore të *duty free. Follow the white rabbit...* të këshillonte një slogan me imazhin e një lepuri të çmendur, i mbështjellë me një pallto dhe që mbante para krahëve një orë të madhe xhepi.

- Mirë je? - pyeti Marku pa pritur doemos përgjigjen e së bijës.

Lajla e vështroi me ëmbëlsi. Ai ndjeu zemrën që t'i sëmbonte, por arriti ta mbajë emocionin larg. Nisi të kërkonte në një çantë me stemën e një librarie dhe nxori prej aty një

bllok vizatimi dhe një pako me bojra uji si dhe dy libra: një album për fëmijë të vegjël fare, si dhe vëllimin e parë të Harri Poterit.

- Mora dy sepse... nuk e di nëse ti di të lexosh, - u detyrua të thotë Marku duke i vendosur gjërat mbi tavolinën ngjitur me ndenjësen. - Para pesë vjetësh unë të lexoja histori para se të të zinte gjumi, a të kujtohet?

Ai piu një gllënjkë ujë mineral nga shishja që kish përpara dhe vazhdoi monologun e tij me një tonalitet rrëfimi.

- E di ti shpirt, as që e kam idenë se çfarë mund të të ketë ndodhur. Nuk e di se kush është marrë me ty gjatë gjithë kësaj kohe. E marr me mend se ke vuajtur dhe se ke pasur shumë frikë. Tmerrësisht frikë. E di gjithashtu që ti e ke ndjerë veten të vetmuar, të pashpresë, dhe se sigurisht ke menduar se mami dhe unë të kishim braktisur. Por kjo nuk është e vërtetë. As edhe për një sekondë të vetme nuk kemi reshtur së menduari për ty dhe se do të jepnim gjithçka për të të gjetur.

E vëmendshme, me gojë të hapur, Lajla shikonte të atin me përqëndrim të plotë.

- Zogu im, nuk e di nëse e mban mend se çfarë pune bëj unë... Kur ti më pyete se çfarë pune bëja, unë t'u përgjigja që isha doktor, por një lloj doktori i veçantë që shëroja plagët e shpirtit. Është e vështirë ta shpjegosh: njerëzit vijnë tek unë kur ata vuajnë nga brenda. Ata vuajnë sepse kanë kaluar situata që ju kanë lënë plagë në zemër. Këto janë plagët më të vështira për t'u shëruar...

Mjeku po mundohej të gjente fjalët para se të vazhdonte.

- Këta persona shpesh e ndjejnë veten fajtorë për diçka edhe kur nuk kanë asnjë faj. Zanati im është që njeriu mund të rilindë edhe pas një dhimbje të madhe. Asnjë plagë nuk

është e pashërueshme. Mund të them se për këtë jam thellësisht i bindur: dhimbjen mund ta kthesh në forcë. Asgjë magjike nuk ka këtu. Por çdo gjë do kohën e vet. Ndodh shpesh që edhe të mos shërohesh plotësisht. Dhimbja nuk zhduket asnjëherë përgjithmonë. Ajo zë vend në thellësi të qenies sonë, por ajo na lejon t'i rikthehemi jetës dhe të vazhdojmë rrugën tonë. E di që nuk është e lehtë për të kuptuar këtë që po të them, por ti je një vogëlushe e zgjuar.

Para se të përfundojë ligjëratën e tij Marku bëri edhe një pauzë tjetër:

- Fakti që po të tregoj këto gjëra, është se dua të them që unë do të bëj gjithçka për të të mbrojtur dhe të të rri pranë, por duhet që edhe ti të pranosh që unë të të ndihmoj, shpirt. Kur ti të jesh gati, duhet që edhe ti të më flasësh, të më tregosh atë që ke përjetuar. Dua të di gjithçka. Jo sepse jam mjek, por sepse jam babai yt. Më kupton?

Në vend të përgjigjesh Lajla i dhuroi një buzëqeshje të lehtë.

Pastaj ajo vërejti me kujdes të dy librat para se të vendoste të merrte Harri Poterin.

Marku e ndoqi me vëmendje gjithë këtë skenë për disa minuta; ajo vërtet dinte të lexonte.

Ajo di të lexojë, mendoi ai. *Dikush i ka mësuar asaj të lexojë...*

Po kush vallë?

Ndërkohë që Lajla kthente faqet e romanit, Marku bënte çfarë të mundte që të fshihte ankthin. Megjithatë në kokë i përplaseshin me mijëra pyetje që mbeteshin akoma pa përgjigje: Kush e kishte rrëmbyer vajzën e tij? Përse e kish lënë të lirë pas pesë vjetësh? Përse ajo vazhdonte të qëndronte në këtë heshtje që të tmerronte? Si shpjegohej ngjarja në

portikun e sigurisë në aeroport? Vërtet t'i kishin vënë vallë një trup të huaj nën lëkurë vajzës së tij? Sigurisht që po, po i çfarë lloji ishte ai? Një mikrofon i inkorporuar ndoshta?... Për ta lokalizuar në çdo kohë? Për ta ndjekur kudo? Po përse?

Po Nikola? Përse ishte zhdukur edhe ajo tani, sikur të kish diçka për të ngarkuar veten me faj? Pa folur pastaj për atë gazetarin e pacipë që ishte në dijeni për rishfaqjen e Lajlës ndërkohë që FBI-ja nuk e kish bërë publike një gjë të tillë? Përse ai e kish paralajmëruar: "Ju nuk e dini të vërtetën! As atë të gruas e as atë të vajzës suaj!"

Ju nuk e dini të vërtetën...

* * *

Në të njëjtën kohë në pjesën e përparme të platformës së sipërme, u vu re një gjallërim i papritur i stjuardesave dhe i personelit të avionit. Të gjithë e kishin ngulitur shikimin e tyre te Elison Harrisoni që ishte shfaqur në sallonin e klasit të parë ku ishin rreth 60 kolltukë të bollshëm, me dizajn e me komandë elektronike.

Një stjuardesë elegante dhe e sjellshme e shoqëroi Elisonin deri në vendin e saj.

- Mirëserdhët në *Shagri - La Airlines*, zonjushë. I gjithë personeli është në dispozicionin tuaj dhe ju uron një udhëtim shumë të këndshëm.

Me syzat e diellit të ngjeshura pas hundës, Elisoni u lëshua në kolltukun e saj. Tashmë nuk e ndjente veten rehat në ambientet publike. Nuk e ndjente më veten të sigurt asgjëkund. Gjithmonë kishte me dhjetëra sy të ngulur në drejtim të saj dhe ndonjë paparac amator që e priste me celularin në dorë

me shpresë se mos kapte ndonjë foto që ta rishiste në ndonjë *sit gossip*.

Elisoni nuk e ndjente veten të sigurt askund. Që prej disa vjetësh, ekzistenca e saj ishte shndërruar në një vazhdimësi pa fund bredhjesh dhe eksesesh që e shkatërronin çdo ditë e më tepër, dhe një miliard dollarët që ajo kish trashëguar nuk ia ndryshonin dot jetën.

Në jetë, gjërat që kanë më shumë vlerë janë ato që nuk kanë çmim.

Elisonit i ishte dashur shumë kohë për të kuptuar një gjë të tillë.

Shumë më tepër nga ç'duhej.

* * *

Avioni i stërmadh mbërriti në fillim të pistës dhe u ndal para se të merrte vrull.

- Nisja për një minutë, - lajmëroi komandanti i fluturimit.

Me pesëqind e gjashtëdhjetë tonët dhe me dy shkallët e sipërvendosura, avioni më shumë i ngjante një vapori fluturues sa sa një avioni linje.

Si mundet vallë që një gjë e tillë të arrijë të ngrihet në ajër? - tha me vete Evi duke parë që jashtë dritareve. Ajo udhëtonte për herë të dytë me avion dhe e urrente një gjë të tillë.

* * *

Piloti e mbushi me gaz avionin me katër motorë dhe gjigandi u lëshua në pistë.

Evi filloi të hante thonjtë me dhëmbë.

- *Hë pra do ngrihesh...* tha ajo me mendje.

Ajo pa rreth vetes me ankth, por askush me sa dukej nuk shqetësohej për kohën që i duhej avionit për t'u shkëputur nga toka.

Ishte vërtet për të ardhur keq që ajo të vdiste pikërisht tani, pak para se të kryente aktin e hakmarrjes.

* * *

Avioni po ecte, ecte, vazhdonte të ecte...

Që nga shkallët e sipërme pamja e pistës të kaplonte. Më shumë se dymbëdhjetë metra lart, pasagjerët dominonin pëlhurën e stërmadhe dhe dukej sikur po i vinin çatinë pistës.

Do ketë ndonjë problem, mendoi Elisoni, *ky shkërdhatë avion duhet të ishte ngritur tashmë.* E megjithatë ideja e një aksidenti të mundshëm nuk e shqetësonte aspak. Në fund të fundit edhe vdekja ishte ndoshta zgjidhja e problemeve: fundi i vuajtjes, i turpit dhe i ndjenjës së fajësisë. Fundi i frikës që i gërryente zorrët në vijimësi. Fundi i gjithçkaje...

Disa herë rresht ajo kishte dashur t'i jepte fund jetës, por gjithmonë kishte dalë diçka për t'iu kundërvënë nismave të saj: një dozë jo e saktë medikamentesh, vena që hapen në drejtim të kundërt, ndihma e shpejtë që është njoftuar para kohe më shpejt se ç'duhej...

Deri tani, ajo nuk kish mundur t'ia arrinte qëllimit.

Deri tani.

* * *

Marku shihte në ankth pistën që dridhej nën 20 rrotat e

këtij gjiganti. Nuk ishte ai në rregull apo avioni po vonohej pak si shumë për t'u ngritur?

Në xhepin e ndenjëses përballë tij, broshura teknike e avionit theksonte me krenari se fuqia e turboreaktorëve ishte e barasvlershme me atë të 6000 veturave.

Në qoftë se je kaq i fuqishëm, çfarë pret më për t'u shkëputur?

Shikimi i shqetësuar i Markut ndeshi atë të vajzës së re, të ulur pranë dritares, në një rresht me të tijin. Edhe ajo nuk ndihej e qetë. Vetëm Lajla, e ulur në mes të dyve dhe e zhytur në leximin e saj, ndihej e pa shqetësuar dhe as që donte t'ia dinte nga sa ndodhte përreth.

Shkëputu! Shkëputu!

* * *

Pothuajse në fund të pistës, gjiganti i ajrit u duk sikur hezitoi për një çast, para se të shkëpuste nga toka të 560 tonët, duke shkaktuar një "uf" çlirimi nga ana e pasagjerëve.

* * *

Në një heshtje varri, avioni në më pak se gjashtë minuta u ngjit në lartësinë e pesëmbëdhjetë mijë këmbëve.

I eksituar dhe nervoz, Markun mezi e mbante vendi. Duart i dridheshin, djersë të ftohta i rridhnin mbi ballë dhe i rrëshqisnin dalëngadalë në kurriz. Një migrenë e tmerrshme po i çante kokën, sikur truri i tij të kish kaluar në shtrydhje.

Marku e dinte shkakun e kësaj gjendjeje: varësia alkoolike. Nuk kishte marrë asnjë pikë alkool që prej 36 orësh dhe tani situata po rëndohej. Dje në mbrëmje, pastaj sot në mëngjes, ai

kishte pasur një dëshirë të papërmbajtshme për t'i përlarë të gjitha pijet e minibarit në dhomën e hotelit. Por duke qenë i lumturuar nga gjetja e së bijës, kish arritur ta përmbante veten, por endja nëpër rrugë për një kohë të gjatë e kish bërë alkoolist. Ishte i sigurt se mund t'ia dilte me forcat e tij nga ky ferr, por për këtë i duhej njëfarë kohe. Në karrierën e tij kish ndjekur pacientë alkoolikë gjatë periudhës së dezintoksikimit, dhe ai e dinte se çfarë e priste po të mos pinte: një çorientim, delir, kriza me konvulsione, halucinacione vizuale dhe auditive.

Pranë tij, Lajla ngriti sytë dhe e pa me dyshim. Për të lënë përshtypje të mirë, Marku i shkeli syrin që e shoqëroi me një buzëqeshje bindëse, por diçka brenda tij i thoshte që e bija nuk e hante një gjë të tillë dhe se ai nuk mund t'ia hidhte kaq kollaj asaj.

- Nuk ndiheni mirë zotëri?

Ishte vajza pranë dritares që e bëri këtë pyetje. Marku e vështroi me vëmendje: gjysmë-grua, gjysmë-fëmijë, me flokë të pistë e të dalë boje, një veshje gotike e sajuar dhe e zhubravitur, një stërmundim në shikim që reflektonin një eksperiencë tronditëse në jetën e saj, pavarësisht nga mosha e re.

- Mirë jam, - e siguroi ai. - Si quheni?

Vajza nguroi t'i përgjigjej. Ky mosbesim e kishte shoqëruar gjithmonë dhe kishte zënë rrënjë të thella në trurin e saj. Por diçka në sytë e Markut, e bëri vajzën që të kishte besim te ky njeri. Marku kishte një ngrohtësi në shikim që i kujtoi mjekun me të cilin ish takuar para tre muajsh, në vigjilje të Krishtlindjeve, të cilin ajo nuk e kish harruar ende. Ajo ish munduar të mos e sillte ndërmend dhe ta shprehte këtë gjë për aq pak kohë që ata ndenjën së bashku, por vajza e kish

ndjerë çuditërisht veten shumë pranë tij. Shpesh, në çastet e vetmisë dhe të dyshimit, ajo çuditej edhe vetë tek mendonte për të. Dhe në këto çaste frika bëhej më e vogël dhe një shpresë akoma e paqartë për një jetë më të mirë ia përshkonte të gjithë qenien.

- Quhem Evi, - u përgjigj ajo.

- Unë quhem Mark Hetëuej, dhe kjo është vajza ime Lajla.

- Përshëndetje Lajla, - tha Evi duke u përkulur në drejtim të vogëlushes.

- Ajo nuk... Ajo nuk flet, - shpjegoi Marku.

Evi e shikoi nga duart.

- Mungesa e alkoolit?

- Çfarë?

- Po mundoheni të mos pini më? Prandaj po dridheni...

- Jo, - u mundua të gënjente mjeku, duke u ndjerë i zënë në turp. - Përse po ma thua këtë?

- Sepse edhe nëna ime, kështu dridhej si ju.

- Dëgjo, është disi e koklavitur kjo punë, - filloi të thotë Marku.

Pas një ndalese të vogël ai iu drejtua Evit:

- Po mamaja si është tani?

- Ka vdekur.

- Ah,... më vjen keq.

Në avion, sinjali *fasten seat belt* sapo ishte fikur, gjë që tregonte se pasagjerët mund të lëviznin tani.

Evi propozoi:

- Nëse ju doni të freskoheni, të pini diçka, mund të kujdesem unë për vajzën tuaj.

- Faleminderit, do kalojë, - tha Marku duke u bërë dyshues.

- Mendoj se po nuk pitë diçka tani shpejt, ju nuk do të ndiheni mirë.

Marku e arsyetoi gjendjen në mënyrë racionale. Ishte e vërtetë që po ndihej gjithnjë e më keq. Brenda disa orëve ai e kish ndryshuar jetën e tij prej lypësi, e megjithatë e kishte shumë vështirë t'i përshtatej gjendjes së re. Mbi të gjitha kish nënvlerësuar ndërprerjen brutale të alkoolit dhe tani ndodhej në këtë avion e nuk dinte se si të vepronte.

I hodhi një vështrim së bijës. A mund ta linte vetëm për disa minuta me Evin të cilën nuk e njihte? Si do të reagonte e bija? Nga ana tjetër nëse ai do të duhej të ishte në gjendje ta ndihmonte, kish nevojë të rrëkëllente një a dy gota që të qetësohej.

- Zemra ime, dëgjo, babushi yt do të kthehet për pesë minuta. Kështu që ti rri këtu, qetë-qetë, me këtë zonjushën këtu, dakord?

Pastaj u kthye nga Evi.

- Ka një bar në pjesën e sipërme të avionit. Nëse ke edhe problemin më të vogël me Lajlën, eja menjëherë më kërko lart, dakord?

Evi miratoi me kokë.

Marku u ngrit dhe fillimisht u drejtua për nga tualetet. Me fytin të tharë, me fytyrën që i përvëlonte ndihej i dehidratuar e qullë në djersë.

U fut në kabinën e vogël, e gjitha e kromuar, me qeramikë dhe me pasqyra. Edhe tualetet kishin një dritare të madhe nga ku dukej qielli! Ato ishin të pastra akull, me përjashtim të një steme: një shabllon i bërë me model që zinte një pjesë të mirë të faqes së murit. Marku dalloi "tre majmunët e mençurisë" që ai kish pasur rastin të shihte në tempujt budistë gjatë një seminari në Japoni. Me duart e tij, i pari mbulonte sytë, i dyti veshët dhe i treti gojën. Një fjali përmblidhte

domethënien e gravurës: *Të mos shohësh, të mos dëgjosh dhe të mos thuash asgjë!* Sipas besimit, ai që ndiqte këtë këshillë nuk do t'i ndodhte asgjë e keqe.

Duke parë këtë shprehje të çuditshme, Marku hoqi orën, lau duart dhe freskoi fytyrën me ujë të freskët, duke evituar të shihej në pasqyrën që ndodhej sipër lavamanit.

Pastaj i thau duart te tharësja automatike dhe doli që aty. Me të dalë u kujtua: kish harruar orën. Kur donte të dilte nga tualeti, ai u shtang në vend.

Nuk është e mundur...

Në mur gdhendja e tre majmunëve ishte zhdukur dhe në vend të saj ishte një shkarravinë që kishte diçka të frikshme dhe patologjike. Në të përmblidheshin shumë simbole që ai kishte ndeshur gjatë studimeve të tij të psikologjisë: fillimisht *një sahat rëre, një kosë dhe disa eshtra*: me fjalë të tjera, koha që kalon dhe që e çojmë kot, vdekja e pashmangshme dhe e papritur, është pluhuri drejt të cilit ne do të shkojmë. Pastaj një pasarelë, e gjatë dhe e rrezikshme: *ura e gjykimit*, që simbolizon vështirësinë e kalimit në botën tjetër. Dhe së fundi, një shkallë, *shkalla e shpëtimit*, simboli universal i ngritjes së shpirtit pranë së cilës priste *një njeri me kokë ujku*: Anubisi, udhërrëfyesi i të vdekurve, i cili ka për detyrë të shoqërojë njeriun pas vdekjes së tij deri në skutat më të thella të botës së përtejme.

Sipër kësaj pamjeje, ishte vendosur kjo fjali:

NUK DUHET PASUR FRIKË NGA ASGJË
ÇDO GJË DUHET TË KUPTOHET

Marku mbeti i ngurosur në vend. Ai nuk mund të kish

parë ëndërr. I hipnotizuar nga pamja që kishte përballë, nuk arrinte të dilte nga tualeti. Ajo që po shihte e bënte të vuante, edhe pse nuk mund të bënte vlerësimin e saktë të kësaj situate.

Iu desh vullnet i fortë për të dalë që andej, por sapo e mbylli derën nga jashtë nuk i rezistoi tundimit për ta hapur përsëri derën për të parë. Këtë herë vuri re një pamje tjetër. Kësaj here një zog impozant kish hapur krahët e tij të stërmëdhenj në të gjithë faqen e murit; Feniksi, zogu përrallor që rilind gjithmonë nga hiri i tij.

Sipër këtij simboli ringjalljeje, ishte shkruar kjo frazë:

NJERIU MUND TË SHKATËRROHET
POR ASNJËHERË NUK MUND TË MPOSHTET

Kësaj here Marku u shqetësua me të vërtetë.

Kaq e pata, po luaj mendsh!

Halucinacionet të cilave ai iu trembej gjatë zvjerdhjes së tij alkoolike po konkretizoheshin me një ankth të paparë. I dridhej gjithë trupi. Ai nuk mund të komandonte gishtat që i dridheshin si dhe frekuencën kardiake që ishte gati të shpërthente.

Ai do të kish pasur nevojë të hidratohej përsëri, të merrte qetësues dhe vitamina. Por s'kishte asgjë nga këto me vete. Me vete kishte vetëm vullnetin e tij. Mbylli sytë dhe mobilizoi të gjitha forcat në një përleshje të brendshme për të rigjetur qetësinë.

Të gjitha këto që po sheh janë false. Çdo gjë që po sheh ndodh vetëm në kokën tënde. Nuk ka piktura as vizatime. Këto imazhe të vdekurish dhe ringjalljesh, janë makthet dhe frika jote: pasojat e dy viteve të kaluara nëpër rrugë. Nuk ke pse të shqetësohesh. Lajla

tani është me ty dhe shumë shpejt ti do të takosh edhe Nikolën. Ti do arrish të rindërtosh familjen tënde dhe çdo gjë do të bëhet si më parë.

Kur ai hapi sytë, të gjitha vegimet e tij ishin zhdukur dhe muri ishte i pastër.

- Hë more, akoma nuk ia vutë emrin? - u dëgjua nga jashtë zëri i dikujt që po i humbiste durimi nga pritja e gjatë.

Duke marrë zemër nga fitorja e vogël mbi veten, Marku doli nga kabina duke i premtuar vetes që nuk do të kthehej më në këtë vend gjatë gjithë udhëtimit.

* * *

Evi, e cila e mori me seriozitetin e duhur rolin e saj prej "motre të madhe", po kujdesej për Lajlën pa ia shqitur sytë për asnjë çast. Gjithmonë e heshtur, vajza e vogël kish marrë një laps uji dhe po shkarraviste në bllok forma abstrakte siç bëjnë të gjithë fëmijët e kësaj moshe. Evi e shikonte me dhembshuri, e mallëngjyer dhe e befasuar nga heshtja e saj.

Kishin kaluar dhjetë minuta nga largimi i Markut kur Lajla ngriti sytë nga vizatimi i saj.

Ajo hapi gojën, dhe pikërisht në këtë çast ndodhi mrekullia:

- Nga se ka vdekur mamaja jote? - pyeti Lajla vajzën adoleshente.

11

Evi
Flash backu i parë

Las Vegas, Nevada
Në fillim të një mbrëmjeje të muajit tetor
Dy vjet më parë

Nevada është një terren i papërcaktuar, i mbuluar nga barërat e këqija dhe nga mbetje të tjera, diku në periferinë e Las Vegasit, larg salltaneteve dhe neoneve të Stripit [1].

Në këtë terren ndodhen rreth 40 karavane, shumica e të cilëve të rrjepur e të dalë boje, me xhama të thyer, me ndarje të shembura dhe me çati të rrënuara. Ky është stacioni i fundit para atyre që ndodhen nëpër rrugë ku banon një popullsi e përzier: punëtorë me të ardhura modeste, mjeranë të rrënuar nga pokeri ose nga lojrat e tjera, të cilët mendonin se do të

---

[1] Arteri më i famshëm i qytetit, ku janë përqëndruar hotelet më luksozë dhe zona më turistike.

ishin aty vetëm për disa ditë, "thjesht sa për të rikapur veten", por që nuk kishin mundur të dilnin nga kjo skëterrë loje.

Në fund të kësaj djerrine, një karavan i mirëmbajtur pak më mirë, që kishte një mbyllje me llamarinë të harkuar i jepte rulotës pamjen e një shtëpize të sajuar.

Nën këtë hapësirë të mbyllur, sipër një tavoline prej laminati, qenë vendosur një grumbull librash impresionues, një radio e vjetër e hapur në një stacion me muzikë kantri si dhe një akuarium ku lëviz pa pushim një peshk rakitik.

E ulur pranë tavolinës, Evi, 13 vjeçe, kafshon për një çast stilolapsin para se të përfundojë paragrafin e fundit të leximit të cilën duhet t'ia japë të nesërmen mësuesit të saj.

Papritur një zë e thërret nga karavani ngjitur:

- *Date prisa, Evi, vamos a llegar tarde al trabajo*[1]!

- *Ya voy, Carmina, dame dos minutos*[2].

Adoleshentja bën një vajtje-ardhje të shpejtë nëpër karavan dhe duke larë dhëmbët, nxiton të rilexojë atë që ka shkruar, duke korrigjuar nëpër të ndonjë gabim që mund të ketë bërë.

- *Eja, tundu vendit!*

Migueli, menaxheri i ekipit të pastrimit të hotelit *Oasis*, ishte njeri i vështirë. Evit i ishte dashur t'i lutej që ta merrte në punë vetëm për disa net, pavarësisht nga mosha e saj. Një punë mjerane, e paguar në të zezë pesë dollarë ora.

Evi në kalim e sipër rrëmben kanoçen e hapur që ndodhet mbi tavolinë, shpëlan gojën me një përzierje të paparë

---

[1] Nxito Evi, se do të bëhemi vonë për në punë!

[2] Erdha, Karmina, më jep edhe dy minuta.

ndonjëherë, koka-kola dhe pastë dhëmbësh, dhe pështyn prapë në një kosh. Pastaj rregullon sendet shkollore në çantën e shpinës para se të futet edhe një herë në karavan për t'i thënë mirupafshim së ëmës.

- Mami, po iki tani, pafshim.

Tereza Harper dergjet në vendin e poshtëm të një krevati marinar.

Ajo është 35 vjeçe por duket edhe 20 vjet më e madhe për shkak të një hepatiti kronik që e gërryen prej vitesh, një cerozë e rëndë e kthyer së fundmi në kancer. Para disa muajsh bëri një operacion ku i hoqën tre të katërtat e mëlçisë së dëmtuar nga tumori dhe tani përballon gjithnjë e më keq efektet sekondare të trajtimit të saj mjekësor; temperaturë, të vjella, lodhje në maksimum e dhimbje trupi.

Tereza e ndal të bijën për dore.

- Kujdes shpirt.

Ka më se një vit që Tereza e ka lënë punën dhe të dy gratë jetojnë vetëm me ato pak para të fituara nga Evi si dhe të një ndihme sociale qesharake.

- Mos ki merak mami, - i përgjigjet e bija duke u ngritur.

Pasi mbyll me kujdes derën, Evi nxiton për te fqinja, Karmina, e cila punon bashkë me të si pastruese në hotelin *Oasis*.

* * *

Evi hipën në makinën e Karminës, një Pontiak i vjetër me ndenjëse të fundosura. Skarpamentoja e makinës nxirrte një tym të zi. Karmina, një meksikane e bollshme dhe e thjeshtë ishte nëna e tre fëmijëve dhe gruaja e një burrë koti që shumicën

e kohës rrinte pa punë. Meqë asaj nuk i pëlqente të fliste kot, s'e hap gojën gjatë gjithë rrugës, por kjo nuk e shqetëson Evin që me sytë mbyllur mendonte për hallet e saj. Është shumë e tensionuar nga lajmi që kishte marrë vesh para disa ditësh: pronari i tokës ku ndodhen karavanet e tyre, ka vendosur t'ia shesë atë dikujt, që do të ndërtojë aty një park lodrash. Nuk i ka thënë gjë akoma së ëmës për të mos e shqetësuar. E bren mendimi se çdo të bëhet me to kur t'i kenë përzënë që aty. Që prej tre vjetësh, përveç sëmundjes së Terezës, të dy gratë kanë zënë njëfarë qetësie pasi kanë kaluar një periudhë shumë të vështirë. Alkoolizëm, drogë, prostitucion... Tereza i ka kaluar vitet 1990 si të kish kaluar një korridor të errët, duke ndarë sipas rastit materialin e saj grackë-shiringa, pambuk, pipëza për të thithur me të mjerë të tjerë duke marrë kështu një hepatit agresiv e të pamëshirshëm.

Në ato kohëra Tereza ndiqej kudo nga shërbimet sociale që donin t'i merrnin vajzën e t'ia vendosnin në një shtëpi fëmijësh. Për të mos u ndarë nga e ëma, Evi kish zhvilluar me kohë aftësitë e saj për një jetë të pavarur dhe një pjekuri të rrallë për moshën që kishte. Me aq sa i kujtohet asaj, Evi ishte prej kohësh personi madhor në këtë familje. Kështu Tereza i dorëzonte së bijës një pjesë të rrogës kur ajo ishte në rregull, që të mos i shpenzonte të gjitha me dozat e heroinës. Evi bënte pazaret, paguante faturat, zgjidhte problemet me fqinjët dhe ishte përsëri po Evi që e kish shpëtuar të ëmën duke e nxjerrë nga ferri i drogës.

Evi në njëfarë mënyre ishte bërë pa u thënë nëna e nënës së saj...

* * *

- Mbërritëm, - ndihet Karmina duke shkundur Evin. - Merr plaçkat e tua.

Evi hap sytë dhe rrëmben çantën nga ndenjësja e pasme.

Makina lëviz në bulevardin Las Vegas. Tashmë është pothuajse natë. Në një vezullim neonesh, hotelet me fasadat plot shkëlqim rivalizojnë se kush është më madhështori. Silueta e stërmadhe e Oazisit shkëlqen nga njëmijë drita dhe e gëlltit Pontiakun që do të parkohet në parkimin e nëndheshëm për punonjësit e shërbimit.

Me tre mijë dhomat, katër pishinat dhe me galerinë tregtare, hoteli është faraonik. Këtu çdo gjë është jashtë përmasave normale: lulishtja e brendshme ku janë mbjellë mbi një mijë palma e përshkuar nga një lum i vogël, plazhi me rërë të imët, kopshti zoologjik ku gjenden luanë dhe tigra të bardhë, akullnaja e rindërtuar ku vuajnë pinguinët e majmur si dhe akuariumi prej njëqind mijë litrash ku mund të strehoheshin edhe delfinët.

Në dhomat prej mermeri nga dyshemeja në tavan, një dekori është konceptuar në bazë të parimeve *feng-shi* dhe ekranet e televizorëve plazma gjenden kudo, madje edhe në tualete.

Për të funksionuar në mënyrë korrekte, kjo makinë ka nevojë për mijëra pastruese, larës xhamash, personel mirëmbajtjeje për çdo gjë, të gjithë "të padukshëm"...

Evi bën pjesë tek këta të padukshëm. Çdo mbrëmje ajo bën nga një punë të ndryshme. Sonte, do të shoqërojë ekipin e Karminës, që është ngarkuar për të pastruar shkallët e shërbimit. Një punë e paguar shumë keq: tridhjetë kate, me kurrizin të përkulur dhe leckën në dorë për orë të tëra...

* * *

Ora dy e mëngjesit

Evi po bën një pushim të shkurtër prej dhjetë minutash në çatinë e hotelit. Që këtu, rreth njëqind metra lart, dominon Las Vegasi dhe lumi i dritave që rrjedh përgjatë Stripit.

Ajo ka lindur në këtë qytet që e urren, ashtu siç urren këtë faunë turistësh të cilët kanë ardhur për të bërë një martesë të mjerë ose për të shpenzuar dollarët e tyre nëpër kazinotë e tij. Asnjëherë nuk e ka kuptuar se çfarë mund t'i kënaqte njerëzit me këtë park gjigant lojërash ku gjithçka është kot, idiotësi dhe artificiale.

Në Las Vegas, nuk mund të bësh më shumë se tre metra e të mos të të dalë para syve një makinë parash. Ato janë kudo, në benzinata, në supermarkete, restorante, bare, lavanteri. Por është shumë e vështirë të gjesh një vend për të blerë një libër.

Evi, në fakt, më shumë se çdo gjë ka qejf librat, sidomos romanet dhe poezinë. Ishte njëra nga mësueset e saj që i ngjalli dëshirën për letërsinë, dhe që nga ajo kohë, leximi është bërë për të lulishtja e saj e fshehtë, pasaporta për të shkuar në vende të tjera, një mjet i papritur për të dalë nga mediokriteti në të cilën jeta e kish zhytur.

Në njërën nga shitoret e veshjeve të shumta ku jepen gjëra me garanci, ajo gjeti një stok romanesh me çmim të ulur me 2 dollarë copa: *"Njëqind vjet vetmi"*, *"Britma dhe tmerri"*, *"Krim e ndëshkim"*, *"Minj dhe njerëz"*, *"Rrëmbyesi i zemrave"*, *"Të përpjetat e Hurleventit"*, *"Kasapi i kotësive"*.

Garcia Marquez, Faulkner, Dostojevski, Steinbeck, Salinger, Brontë, Wolfe, me çmimin e një pakoje patatina...

* * *

Ora katër e mëngjesit

Fërko, fërko, fërko...

Evit i duket sikur rrobat e saj mbajnë erë uji të ndenjur. Kurrizi i është bërë petë dhe është e ngordhur për gjumë. Për ta mbajtur veten fillon të mendojë për të ardhmen e saj dhe të nënës. Tereza është regjistruar në listën e pritjes për të bërë një transplant veshke. Por dhurimi i organeve është një gjë e rrallë dhe Evi ka një frikë: se mos e ëma vdes përpara.

Duhet që ajo të rezistojë, thotë gjithë ankth Evi, duhet që ajo të rezistojë edhe disa muaj.

Por, në të njëjtën kohë, Evi e ndjen veten fajtore që i duhet të presë që të vdesë dikush tjetër, një dhurues organesh.

* * *

Ora gjashtë e mëngjesit

Evi merr pagën te kryepunëtori dhe largohet nga hoteli *Oasis*. Më tej, në bulevard ndodhet një *coffe-shop* në shërbim të klientëve të orëve të para të mëngjesit. Evit i pëlqen të ulet në fund të sallës, disi e veçuar, në një tavolinë me pamje nga rruga. Ka edhe një orë para se të marrë autobusin për të shkuar në shkollë. Ajo ka plot një orë, për veten e saj, një orë ku ajo ka kohë të lexojë dhe të shkruajë.

Porosit një kakao të ngrohtë dhe nxjerr nga çanta një libër që e ka shumë përzemër. E kish gjetur një natë pranë komodinës në një dhomë hoteli. Me siguri që do ta kish harruar

ndonjë klient. Ky nuk është as roman as përmbledhje me poezi, por një sprovë e shkruar nga një neuropsikiatër i Nju Jorkut.

Njëfarë Konor Mekkoi.

Libri i tij titullohet: *Të mbijetosh.*

Dukej sikur autori e kishte shkruar këtë libër enkas për Evin.

Në këtë libër autori flet pikërisht për atë që ajo ka përjetuar, për këtë nevojë për të marrë forca dhe të qëndrosh me trimëri përballë situatave më të këqija, të kesh gjithmonë këtë mburojë të pa penetrueshme që ajo vetë e ka ndërtuar me shumë mundim gjatë këtyre viteve dhe që i jep asaj mundësinë që të mos dorëzohet. Por në kapitujt që vijojnë, Evi vëren se aty ka edhe një paralajmërim, një gjë për të cilën ajo kish pasur një ide, por pa mundur ta shprehte qartë: nuk duhet të mbrohesh shumë, sepse përndryshe nuk ndjen më asgjë. Zemra jonë bëhet e akullt, nuk je veçse një i vdekur i gjallë dhe jeta humbet çdo shije.

Kjo është arsyeja që Evi ka mundur të ndërtojë një lloj lulishteje të brendshme, një kapsollë shprese dhe lirshmërie të cilën e mban fshehur, të mbjellë thellë në qenien e saj, gati për të çelur ditën që...

E ardhmja e saj? Herë pas here ajo ëndërron të bëhet shkrimtare ose psikiatre për të ndihmuar njerëzit që vuajnë. Por ajo e di shumë mirë që nuk mund të vazhdojë studimet. Universiteti nuk është për një vajzë amerikane e cila banon në një kasolle dhe që është e detyruar të punojë natën që të ketë mundësi të blejë diçka vetëm sa për të ngrënë.

Evi pi një gllënjkë kakao të ngrohtë dhe fillon të hedhë disa shënime në një bllok.

Shpesh ndihet e vetmuar.

Shumë e vetmuar. Do t'i pëlqente t'i ndante mendimet me dikë që do ta kuptonte.

Por, meqë nuk ka asnjeri, i drejtohet ditarit të saj, sepse vetëm atij ia beson të gjitha hamendjet dhe sekretet e saj.

Në fund të bllokut, ka përpiluar një listë, atë të dhjetë gjërave të fshehta që ajo do dëshironte t'i realizoheshin në jetë. E di që nuk ka shumë shanse që dëshirat e saj të realizohen të gjitha, por nganjëherë edhe duhet ëndërruar, sepse në të kundërt...

Nr.1: që mamaja ime të vërë një veshkë të re e të shërohet.
Nr.2: që të gjejmë një banesë të re jo shumë të shtrenjtë.
Nr.3: që mamaja të mos përdorë më alkool dhe drogë.
Nr.4: që as unë të mos varem nga droga apo alkooli.
Nr.5: që të ikim disa ditë me pushime larg Las Vegasit.
Nr.6: që të shkoj të bëj studimet në Nju Jork.
Nr.7: që ta di një ditë se cili është babai im i vërtetë.
Nr.8: që të jem e ndërgjegjshme që në jetë ka edhe gjëra të bukura.
Nr.9: që të gjej një ditë dikë që të më kuptojë.

Për numrin 10, ishte disi më e koklavitur puna. Ajo kish shënuar diçka, pastaj i kish ardhur turp dhe e kishte fshirë më pas. Por në qoftë se e mendojmë mirë këtë punë, kjo dëshirë do të formulohej kështu:

Nr. 10: që një ditë dikush të bjerë në dashuri me mua...

12

Marku & Elisoni

Çdo gjë është kopsitur që në fëmijëri.
Nuk jemi ne ata që i shqiptojmë fjalët.
Janë fjalët ato që na shqiptojnë ne.
- WITOLD GOMBROWICZ

Sot
Në avion
Ora 11 e 45 minuta

Avioni A380 vazhdonte fluturimin me shpejtësi të njëtrajtshme, duke çarë retë që qëndronin pezull në qiell sipër Roçejuzisit.

Marku u ngjit në shkallën monumentale që bashkonte të dy katet. Mbërriti në mes të skelës së sipërme ku ndodhej Floridita, *Lounge-bar*-i, që ishte krenaria e kompanisë ajrore. Aty dëgjohej muzikë e qetë, kishte një ndriçim të sofistikuar, kolltukë luks si dhe kanape prej lëkure: çdo gjë ishte krijuar për një ambient intim e komod. Në këtë hapësirë të arreduar

në mënyrë luksoze, ishte e lehtë të harroje se ndodheshe në një avion.

Marku u ul në një nga ato taburet e larta pranë banakut të barit. Nga ana tjetër e banakut qëndronte një burrë me mustaqe e me një pamje afrikane i tipit Xhekson Faiv dhe që dukej si një sozi i vërtetë i Isakut, barmenit te filmi *Anija po argëtohet*.

- Një dopio uiski pa akull, - tha mjeku.

Që tani filloi të ndihej më mirë. Thjesht ideja se do të pinte kish qenë e mjaftueshme që të qetësohej.

Kështu, kur barmeni Isak ia vuri përpara, Marku i lejoi vetes luksin të mos e pinte menjëherë gllënjkën e parë, duke u përmbajtur.

Hodhi një shikim rreth e rrotull. Pasagjerët sa venin e shtoheshin në bar. Një grua e re, me pamje provokuese, erdhi e zuri vend fare pranë tij. Duke pritur të bënte porosinë Elisoni tundte kokën nën ritmin e muzikës, një përzierje *elektro* dhe *bosa*.

- Çfarë dëshironi t'ju shërbej zonjushë? - pyeti barmeni.

- Një daikiri, ju lutem. Pa sheqer, por me pak lëng greinfruti.

Elisoni ndali sytë në drejtim të Markut dhe shikimet e tyre u kryqëzuan.

- Ky quhet një heminguej special, - përcaktoi Marku.

- Më falni?

- Koktejli që sapo porositët, quhet daikiri i hidhur. E ka shpikur Ernest Heminguej.

Meqë Elisoni nuk po reagonte, Markut iu duk se duhej të jepte më shumë shpjegime:

- Hemingueji, shkrimtari.

- Faleminderit, e di se kush është Heminguej!

- Më vjen keq, - kërkoi të falur Marku. - Nuk doja t'ju vija në siklet.

- Jo, por unë, desha të them se...

E ndodhur në një çast emocional që nuk e zotëronte dot veten, Elisoni u zvarrit në shpjegimet e saj dhe ktheu kokën.

I intriguar, Marku e shikoi me më shumë vëmendje: me flokë ngjyrë vetëvrasjeje bionde, me një formë trupi të hedhur, me një pamje *call-girl*...

Kur ajo u përkul për të marrë çantën e saj, Marku vuri re një pjesë të një tatuazhi në boshllëkun e veshkave dhe vuri re simbolin budist të rrotës së ligjit:



- Më falni, mirë jeni zonjushë? - vijoi më tej Marku.

- Mirë, mirë, - e siguroi Elisoni. - Ishte thjesht ajo referenca juaj me Heminguejin. Ishte autori i preferuar i babait tim.

Ajo e vështroi Markun drejt e në sy dhe çuditërisht u ndje mjaft mirë. Ky burrë rrezatonte një lloj magnetizmi të çuditshëm, i përbërë nga një ngrohtësi njerëzore, që e bëri Elisonin të ndihej akoma më mirë dhe ajo vazhdoi më tej bisedën:

- Babai më vdiq para disa ditësh, - shtoi ajo. - Vrau veten.

- Më vjen vërtet keq.

- Një goditje me çifte si...

- ...Si Hemingueji, - plotësoi Marku.

Elisoni miratoi me kokë në heshtje.

- Unë quhem Mark Hetëuej.

- Elison Harrison.

Pas një minute mëdyshjeje, Marku guxoi të bënte pyetjen që mezi po e mbante përbrenda:

- Përse gjysma e pasagjerëve në këtë avion ju shikojnë pa reshtur Elison?

Gruaja e re, e vënë në siklet u detyrua të pohojë:

- Këto vitet e fundit, më kanë parë shumë nëpër gazeta... Desha të them, gazetat..., është si të thuash...

- Ah?

- Vë bast se edhe ju më keni parë në foto, në gazetë. Përndryshe vërtet që ju do të jeni i fundit.

- Nuk kam hapur e as lexuar asnjë gazetë që prej pesë vjetësh, - u rrëfye mjeku.

- Vërtetë?

- Vërtetë.

Elisoni e pa Markun me kureshtje.

Edhe Marku bëri të njëjtën gjë dhe e kuptoi se gruaja që ish pranë tij kish nevojë të rrëfehej.

- Atëherë më thuaj Elison, çfarë kam humbur unë gjatë këtyre pesë vjetëve?

3rj0n1xx

13

Elisoni
Flash backu i dytë

Pesë vjet më parë

Elison Harrisoni arrestohet në Dubai për zotërim droge

(Ap - 11 shtator 2002)

Trashëgimtarja e famshme u arrestua sot në aeroportin e Dubait ku kishte shkuar për të kaluar disa ditë pushime. Zonjusha Harrison do të gjykohet javën e ardhshme. Ajo pranoi se kishte me vete kokainë, por për përdorim personal. Më tej shtoi se nuk e kish përdorur atë në territorin e Emirateve të Bashkuara Arabe.

Nuk është hera e parë që miliarderja e famshme, për bëmat e saj, të zërë faqen e parë të kronikave, dhe deri tani, sjelljet e saj të skajshme, ishin mbyllur nga ndërhyrjet e të atit përkundrejt pagesës së

dhjetëra mijëra dollarëve. Por rasti në fjalë, ndodhur jashtë territorit amerikan mund të mos zgjidhet aq lehtë. Le të kujtojmë se Dubai, qendër e rëndësishme e bizneseve dhe rajon turistik në zhvillim të plotë, ka legjislacionin më të rreptë në të gjithë botën lidhur me narkotikët.

* * *

Elison Harrisoni dënohet me tre vjet burg në Dubai për dy gram kokainë!

(AP - 18 shtator 2002)

Vajza e biznesmenit Riçard Harrison u dënua sot në mëngjes me tre vjet burg. Gjykata e deklaroi fajtore për futje dhe zotërim kokaine në territorin e Emirateve të Bashkuara Arabe.

* * *

Bloomberg TV

...biznesmeni i fuqishëm Riçard Harrison, themeluesi i supermarketeve *Green Cross* është nisur sot në mëngjes për në Dubai ku ai pritet të...

* * *

Lajmi i fundit:
Elison Harrisoni, falet dhe lirohet nga burgu në Dubai

(AP- 19 shtator 2002)

Përmbysje e situatës në çështjen Harrison: vetëm disa orë pasi ishte dënuar me tre vjet burg, Elison Harrisoni u fal sot në mëngjes nga guvernatori i Dubait.

Pa u shpallur mirë dalja nga burgu, biondja trashëgimtare u largua nga Emiratet e Bashkuara Arabe për t'u kthyer në Shtetet e Bashkuara, me avionin privat të të atit.

* * *

- Elison, a po më dëgjon?

Riçard Harrisoni, rri ulur në avion, përballë së bijës.

Është një njeri me shtat mesatar. Ka syze miopi, një pulovër me qafë deri në grykë, një palë pantallona kadife dhe këpucë të mëdha. Ka kohë që vishet thjesht, por në botën e biznesit ai njihet si një njeri i frikshëm dhe i rreptë, që të bën të druhesh prej tij.

- Shpirt, çfarë ka që nuk shkon?

Gruaja e re, që është mbledhur kruspull në ndenjësen e saj, me mjekrën mbështetur te gjunjët, me të dëgjuar këto fjalë, njëlloj sikur ta kish pickuar njeri hidhet përpjetë:

- Ti guxon të më pyesësh se çfarë nuk shkon, pas asaj që bëre?

- Atë që bëra, e bëra thjesht për ty, për të mirën tënde, - i përgjigjet i ati me një ton të lodhur. - Dhe ta dish, se po të ishte për mua s'do të lëvizja as gishtin.

- Do ta kisha zgjidhur vetë...

Heshtje.

- Nuk mund të kthehemi më mbrapa, - rifillon të flasë Riçardi, - por duhet t'i dalësh për zot vetes, sepse unë nuk do të jem gjithmonë pas teje për të të nxjerrë nga situata.

- As që dua t'ia di. Do të kem paratë e tua.

Edhe pse i fyer, nga ky qëndrim i së bijës, babai nuk dorëzohet:

- Duhet të heqësh dorë nga droga dhe të fillosh të merresh me diçka, - vazhdon t'i thotë qetësisht i ati. - Një projekt që do të kishte kuptim për ty. Mund të drejtoje fondacionin që nëna jote ka krijuar...

- Lëre mamanë atje ku është!

- Unë vetëm dua të të ndihmoj.

- Atëherë më lër rehat!

Riçardi e duron edhe këtë herë pa u thyer.

- Ky agresivitet ndaj vetes tënde dhe ndaj të tjerëve, kjo dëshirë për të fyer dhe për të qenë e keqe!? Unë e di që thellë-thellë ti nuk je e tillë, Elison. E di që je inteligjente dhe e ndjeshme. Vetëm se tani po kalon një çast të vështirë. Nëse unë të kam lënduar, të kërkoj të falur, por të lutem, mos e zhyt veten edhe më thellë në këtë batak, sepse ndryshe nuk do të dalësh më dot kurrë.

Asnjë përgjigje.

* * *

Vuajtja ime është hakmarrja kundër vetes time.
Albert Cohen.

* * *

Elisoni në dezintoksikim

(Online - 04 janar 2003)

Trashëgimtarja e perandorisë *Green Cross* ka shkuar vetë në klinikën Coolidge të Malibusë për të kuruar varësinë e saj ndaj drogës dhe alkoolit. "Zonjusha Harrison ka vendosur të marrë masa drastike për mirëqenien e saj dhe të familjes së saj", deklaroi Xhefri Ueksler, avokati i saj në një komunikim për shtyp.

* * *

Elisoni rifillon përsëri

(Online - 14 gusht 2003)

Elison Harrisoni nuk u lejua të udhëtojë sot me një avion të linjës United Airlines për shkak të gjendjes së saj të dehur.

Duke pritur fluturimin e saj për në Los Anxhelos në aeroportin e Majamit, zonja Harrison me sa duket ka pirë shumë koktejle në barin e aeroportit dhe ka

dalë prej andej duke iu marrë këmbët.
Personeli i kompanisë ajrore nuk pranoi që ajo të udhëtonte.
"Zonjusha Harrison nuk na ka fyer, - tha një punonjëse e kompanisë. - Ajo ishte thjesht e dehur, gjë të cilën e pranoi edhe vetë".

* * *

Riçard Harrisoni i jep tre të katërtat e pasurisë së tij organizatave bamirëse

(Reuters - 28 gusht 2003)

Miliarderi Riçard Harrison sapo bëri të ditur se ka ndërmend t'u japë një shumë prej 10 miliard dollarësh disa organizatave bamirëse dhe humanitare. Kjo shumë që përbën rreth tre të katërtat e pasurisë së tij do të ndahet nëpërmjet organizatave të ndryshme nga të cilat edhe Fondacioni Shania të cilën e ka krijuar ai vetë para më shumë se 20 vjetësh me gruan e tij të parë (vdekur më 1994) dhe që drejtohet tani nga gruaja e tij e dytë Stefani Harrison.

* * *

Shkurt 2004

Një dhomë gjumi me ngjyra pasteli në një klinikë të re

dezintoksikimi. Nga dritarja duken malet e veshur me dëborë të Montanës. Elisoni është duke bërë gati valixhen. Riçardi hap derën dhe e shikon trishtueshëm.

- Sapo fola me drejtorin. Ai nuk do të të shohë më në këtë klinikë. Ai pretendon se ti ke vënë në rrezik edhe pacientët e tjerë.

- Të gjitha këto janë idiotizma! I vetmi person që vë në rrezik është vetja ime.

Nga që nuk di ç'të bëjë, Riçardi orvatet ta ndihmojë të palosë ndonjë pulovër të saj por e bija ia rrëmben nga duart me brutalitet. Pa u zmbrapsur Riçardi merr çantën e tij prej lëkure nga ku nxjerr një broshurë të plastifikuar dhe një biletë avioni.

- Dëgjo, më kanë folur për një institucion të ri në Zvicër. Nuk është tamam klinikë, po më shumë një vend ku ti mund të çlodhesh...

- E di se ç'janë të gjitha këto institucione, baba.

- Eja në shtëpi atëherë.

Pa marrë mundimin t'i përgjigjet Elisoni, futet në banjë dhe vë në prizë tharësen e flokëve.

Riçardi ngul këmbë, duke ngritur zërin që të mbysë zhurmën e tharëses:

- Elison, më dëgjo...

Ai e heq tharësen nga priza për të komunikuar me të bijën.

- Është një mjek që do të kisha dëshirë të takoje në Nju Jork, doktor Konor Mekkoi, një nga më të mirët në fushën e psikologjisë. Ai kryen eksperimente me metoda krijuese, dhe mendoj se do të jetë e dobishme për ty.

- Babi, e di çfarë, ik më mirë, po kthehem vetëm me taksi.

- Të paktën lexo librin e këtij doktori, - i thotë i ati duke i zgjatur librin e neuropsikiatrit.

Meqë Elisoni nuk reagon fare, Riçardi e vendos librin në valixhen e së bijës: *Të mbijetosh*, nga Konor Mekkoi.

Ai i lë gjithashtu edhe një kartëvizitë me të dhënat e doktorit, e duke marrë çantën bën të largohet. Kthehet edhe një herë nga Elisoni:

- Doja të të thosha edhe diçka tjetër. Parapëlqej të ta them vetë para se ta marrësh vesh nga shtypi.

E shqetësuar, Elisoni del nga tualeti. Instinktivisht e ndjeu që do të ishte diçka e rëndësishme.

- Çfarë?

- Së shpejti unë do të vdes.

* * *

Riçard Harrisoni vuan nga sëmundja e Alzheimerit

(CNN.com - 15 mars 2004)

Biznesmeni, miliarderi Riçard Harrison, 71 vjeçar, vuan nga sëmundja e Alzhaimerit, tha dje, zëdhënësi i tij, avokati Xhefri Ueksler.

"Riçardi efektivisht vuan nga kjo sëmundje, - ka konfirmuar Xhefri Ueksler. - Shenjat e para të sëmundjes janë shfaqur para dy vjetësh, por pavarësisht nga kjo, Riçardi është shumë aktiv. Edhe pse me disa mungesa, ai është i ndërgjegjshëm për sëmundjen e tij. Kjo nuk e pengon atë që të ngrihet çdo mëngjes për të shkuar në punë".

Kujtojmë se kjo sëmundje neuro-degjenerative është tani për tani e pashërueshme. Për mungesë përparimesh në fushën e kërkimeve mjekësore nga kjo sëmundje parashikohet të preken rreth 15 milionë amerikanë për një periudhë prej dyzet vjetësh nga katër milion e gjysmë që është numri i tyre sot.

* * *

2005

Është një natë vjeshte në Las Vegas.

Me pamje të ngrysur, Rasëll Malone, menaxheri i hotel *Oasis*, kalon me të shpejtë hollin e stërmadh prej mermeri e xhami për t'u gjendur përballë ashensorëve. Futet në njërin prej tyre dhe ngrihet lart duke fluturuar mbi pjesën e atriumit qendror, ku në një gërshetim çmendurie të delirit të madhështisë dhe të luksit të tepruar, janë ndërtuar në përmasa reale monumentet më të famshme të Romës: Fontana di Trevi, harku i Titiusit, madje edhe një pjesë e Koloseut. Ashensori e çon Rasëllin në katin e tridhjetë dhe të fundit të hotelit, ai i suitave më luksoze. Ndalet për një çast përpara derës së apartamentit të Elison Harrisonit. Shumë klientë ishin ankuar në recepsion për zhurmën e jashtëzakonshme të trashëgimtares së re. Madje edhe në korridor dëgjohet muzika e vënë në maksimum. Rasëlli dallon zërin e këngëtarit Kurt Kobain: *The Man Who Sold the World*, e rimarrë nga David Bovie nga ana e Nirvanës gjatë koncertit mitik të *MTV Unplugged*.

Në fraksionin e një sekonde, Rasëllit i kujtohen vitet e tij

në universit, ku kishte qenë bashkë me Joanën, mikeshën e tij që i kishte dhuruar këtë disk. Ishte periudha kur ai ishte i lumtur dhe pa kokëçarje. Por ky kthim në të kaluarën nuk zgjati shumë. Madje, detyra dhe përgjegjësitë e tij e sjellin në vete më shpejt se ç'duhej.

- Zonjusha Harrison? - dëgjohet zëri i tij duke trokitur njëkohësisht edhe në derë. - Çdo gjë në rregull?

Pak më parë, ai u mundua disa herë të lidhej me telefon, por ajo nuk e ngriti telefonin. Meqë asnjë përgjigje nuk vinte nga brenda, ai detyrohet të përdorë çelësin kopil dhe futet në apartament.

- Zonjusha Harrison?

Pasi kontrollon të gjitha dhomat, e apartamentit të stërmadh, Rasëlli ndalet para derës së banjës. Dhoma është e mbushur me avull. Tërheq ngadalë perden e dushit dhe lëshon një zë.

Brenda në dush ndodhej trupi i Elison Harrisonit që dridhej si purtekë me duar e kavile të shtrënguara bashkë.

Mbi komodinën e saj, është një libër që ajo as ka marrë mundimin ta lexojë.

Të mbijetosh, shkruar nga Konor Mekkoi.

* * *

Qershor 2006

'Nautilusi' është një hotel luksoz, në gjirin e Karaibeve, i zhytur nën ujë në 15 metra thellësi. Ky është nga vendet më

të reja në modë, ku vjen një elitë e përzgjedhur: të sapo pasuruarit, ultra të pasurit, yje dhe pseudo yje të shou biznesit dhe të modës. "Ky hotel nën det", shquhet nga pjesa e tij transparente e cila të jep mundësi të admirosh fundin e detit, me kusht që të mos jesh klaustrofob.

Është mesi i natës në dhomën 33. Dy burra që janë rrumbulluar mirë dalin nga dhoma duke mërmëritur disa fjalë nëpër dhëmbë lidhur me gruan e re që po flinte në shtrat.

Elisoni zgjohet disa orë më vonë. Asaj i dhemb koka dhe nxiton të shkojë të vjellë në banjë. Mezi kthehet dhe lëshohet si një copë dengu mbi dyshek. Në dysheme gjendet një shishe tekila bosh, dy prezervativë dhe gjurmë kokaine...

Elisoni fillon të qajë.

Ajo nuk është në gjendje të kujtojë se çfarë ka ndodhur me të.

Shpesh i është dukur se kishte parë fundin e saj, duke qenë e bindur se nuk mund të binte më poshtë.

Por çdo herë ishte gabuar.

Sepse fundi është gjithmonë më i thellë se sa mund ta imagjinojmë.

* * *

Nëntor 2006

Një urë në autostradë, natën, në Los Anxhelos. Një pasarelë prej betoni që shërben si mbikalim të *freeways*, disa kilometra larg nga një kryqëzim autostrade.

Elisoni e ka ndaluar fuoristradën e saj në korsinë e

emergjencës. Ajo, ka kaluar njërën këmbë të pengesës dhe shikon në dëshpërim të plotë lumin e veturave që kalon me shpejtësi 20 metra më poshtë se ajo. Duart e saj janë mbërthyer te pjesa metalike e mbrojtjes së rrugës ndërsa takat e saj të larta dridhen poshtë.

Asnjëherë nuk ka qenë kaq afër fundit të saj. Ka kaq kohë që është e burgosura e jetës së saj, e veprimeve të saj, e të kaluarës së saj. Ka shumë kohë që ajo jeton në ankth në çdo çast dhe në neveri të plotë për vetveten.

Me sa duket ferri duket kur nuk ka më shpresa. Pra sonte është fundi i saj.

Game over

Kishte ardhur koha.

Sirenat e policisë uturijnë nëpër natë. Një veturë policie dhe dy motorë i ndalojnë pranë. Katër burra formojnë menjëherë një gjysmërrethi në një distancë prej pesë metrash larg saj. Meqë ata po i afrohen ajo fillon të bërtasë dhe të katërt ata mbeten si të ngrirë. Ata janë aty pranë e nuk mund të bëjnë asgjë. Po të dojë ajo hidhet. Ky është çasti i fundit i lirisë para greminës. Ajo ka akoma mundësi të zgjedhë.

- Zonjushë, mos e bëni këtë gjë!

Ishte polici më i ri që foli. Një i zi jo më shumë se 20 vjeç, me një pamje të brishtë ala Otis Reding, i njëjti zë melankolik, të njëjtat mustaqe prej adoleshenti.

- Nganjëherë mendojmë se kjo është zgjidhja e problemeve tona, por nuk është kështu...

Zëri i tij ka theks emocioni dhe është i vërtetë. Të krijohet përshtypja sikur ai është një specialist që e di se ç'thotë. Duhet thënë se para pesë vjetësh atij i kish vdekur motra binjake. Ajo ishte mbyllur nga brenda në veturën e familjes dhe në

gojë kish futur një tub kauçuku i cili ishte lidhur me tubin e skapamentos. Ishte i vëllai që e gjeti trupin e saj kur hapi derën e garazhit. Askush nuk kish parë asgjë.

- Nuk ka tjetër, zonjushë! - thotë ai duke iu afruar Elisonit.

- Nuk ka jetë tjetër.

Ai arrin ta kapë për krahu dhe e tërheq ngadalë.

* * *

Sot
Në avion
Ora trembëdhjetë

Elisoni sapo e mbaroi tregimin e saj. Ajo uli sytë e shtangur dhe e vënë në siklet që iu rrëfye një të panjohuri. Marku e kish dëgjuar me një vëmendje të rrallë. Kur i fliste, ajo ndihej e mbrojtur, sikur të ishte brenda një sfere.

Iu deshën vetëm pak minuta që Marku të rifitonte reflekset e tij si psikolog, duke mbajtur shënime me mend, duke u munduar të krahasojë eksperiencën e Elisonit me ato të pacientëve të tjerë që ai kish ndjekur.

Edhe vetë Marku ndihej më i qetë. Të hynte në marrëdhënie me njerëzit, të ndryshonte kursin: ja kjo gjë i kish pëlqyer gjithmonë atij. Të ndalë zbritjen në ferr të pacientëve të tij dhe t'i ndihmonte që ata t'i riktheheshin pak nga pak jetës.

Marku e shikoi mendueshëm gruan e re. Tani për tani mund t'i bënte vetëm një pyetje:

- Përse doni ta dënoni veten tuaj?

Elisoni ktheu sytë në drejtim tjetër dhe diçka u ngurtësua tek ajo, gjë që tregonte se Marku kish goditur në shenjë. Natyrisht që impulsi i saj vetëshkatërrues e kishte burimin diku. Ajo hapi gojën, dhe për një sekondë të vetme, mendoi se mund t'ia pohonte sekretin e saj dhe të lehtësohej nga kjo barrë e rëndë, që e mundonte prej shumë kohësh. Por fjalët iu mblodhën lëmsh në grykë dhe lotët i mbushën sytë.

Marku donte të rifillonte dialogun por në atë kohë avioni filloi të kollitej e të lëkundej si shumë. Isakut iu derdh kokteji që sapo kish përgatitur. Dikush aty pari bërtiti dhe sinjalet e alarmit u ndezën në avion.

Zonjë, Zotëri, aktualisht ne po kalojmë një zonë me turbulenca. Ju lutemi kthehuni në vendet tuaja dhe lidhni rripin.

Pati disa zëra që kundërshtuan nga klientët e barit, por secili zbatoi urdhrin e dhënë.

- Më duhet të kthehem te vajza, në pontilin e poshtëm, - tha Marku duke u ngritur nga tabureja ku ishte ulur.

- E kuptoj, - tha Elisoni.

Kështu ata u ndanë, pa thënë asgjë tjetër, por, në çastin e ndarjes secili lexoi në sytë e tjetrit premtimin për t'u takuar shumë shpejt.

14

Rrota e jetës

Rrota e jetës rrotullohej aq shpejt
saqë asnjë burrë nuk mund të qëndronte
në këmbë për një kohë të gjatë.
Dhe në fund të fundit, ajo kthehej
përsëri në pikën e fillimit

- STEPHEN KING

Sot
Në avion
Ora 13 e 15 minuta

Fluturimi 714 vallëzonte furishëm sipër një deti resh.

Në ankth të plotë, Marku u rikthye në vendin e tij pa humbur kohë. Si kish mundur ai ta linte vetëm vajzën e tij për më shumë se një gjysmë ore? Pra, në çast e pushtoi një panik i madh. Po sikur në vend të Lajlës të gjente vendin bosh? Iu desh të përdorte bërrylat dhe të shtynte disa njerëz për të mbërritur sa më parë në vendin e tij. Po sikur fëmija i tij të zhdukej përsëri e kësaj radhe do të ishte plotësisht për faj të

tij? Duke u ngjitur te shkalla, i dukej sikur vendi ku shkelte i rrëshqiste nën këmbë. Po sikur...

U ndal dhe qëndroi pa lëvizur disa metra larg vendit të tij. Lajla nuk kishte lëvizur nga vendi i saj. Me lapsin e ujit në dorë, me fytyrë të drejtuar nga Evi, ajo po i tregonte me krenari vizatimet e saj adoleshentes.

- Çdo gjë në rregull? - pyeti Marku duke u ulur.

- Shumë mirë, - u përgjigj Evi duke i shoqëruar fjalët edhe me lëvizjen e kokës.

Mjeku u afrua për të parë më nga afër vizatimet që Lajla kish bërë gjatë mungesës së tij.

- A mund t'i shoh? - kërkoi leje ai, duke përkëdhelur flokët e së bijës.


Gjithmonë e heshtur, Lajla largoi krahun e saj nga mbështetësja përballë që t'i jepte mundësi të atit të shikonte vizatimet.

Vajza e vogël kishte ngjyrosur shumë faqe të bllokut. Në praktikën e tij si psikolog, Marku i kish përdorur shumë vizatimet që t'i ndihmonte pacientët e tij të rinj për të komunikuar më mirë. Madje dikur ai kishte edhe një dhunti të vërtetë për t'i deshifruar e analizuar ato.

Duke parë me vëmendje vizatimet e vajzës, ndjeu një lehtësim të vërtetë: ishin vizatime me ngjyra të çelura e të gjalla, të mbushur me flutura, yje dhe lule. Edhe pse kish kohë që nuk e ushtronte zanatin, ishte i bindur që ngjyrosjet e Lajlës nuk ishin ato të një fëmije që kish pasur trauma të mëdha.

- Shumë bukur, shpirt, - i tha.

Sapo vendosi të linte fletët mbi mbështetëse, kur një gjë i tërhoqi vëmendjen. Një formë gjeometrike që ishte e pranishme në të gjitha fletët, të cilën fillimisht ai e kish kujtuar lule apo yll.



3rj0n1xx

Ky simbol përfaqësonte *rrotën e ligjit.* Ligji i fatit të njerëzve që asnjë forcë nuk mund t'ia ndryshonte drejtimin, ligji i rifillimit të përjetshëm të gjërave: lindja, vdekja, rilindja...

Këtë emblemë ai e kish parë në formë tatuazhi pak më parë në trupin, në boshllëkun e veshkave të Elisonit! Ishte i njëjti rreth i cili e kish mrekulluar gjithmonë Konorin, me tetë rrezet e tij të cilat dukej sikur i tregonin njeriut rrugën për t'u çliruar nga dhimbja.

- Zemra ime, përse e ke vizatuar këtë? - pyeti gjithë ankth Marku duke parë Lajlën drejt e në sy.

- *Nuk e di,* - tha vajza e vogël fare qetësisht.

Marku mbeti i ngurosur nga habia. Lajla i ishte përgjigjur! Ajo fliste! A kish dëgjuar vërtet apo mendja e tij nuk ishte në rregull?

- Mirë je shpirti im? - pyeti përsëri duke pasur frikë se kësaj radhe nuk do të merrte përgjigje.

- Kam pak gjumë, por mirë jam.

Marku u lehtësua dhe nuk dinte se si të vepronte më tej. Ngaqë donte t'i bënte një mijë pyetje së bijës, atij i duhej gjithashtu të ishte i vëmendshëm për të mos e shqetësuar.

- A është shumë i madh ky avion? - pyeti Lajla të atin duke i buzëqeshur.

- Po, ashtu është, - miratoi Marku duke ia kthyer buzëqeshjen. - Është avioni më i madh në botë.

- A është i shpejtë?

- Shumë i shpejtë.

- Epo, nuk duket! - vazhdoi Lajla duke u mbështetur nga ana e Evit për të vlerësuar shpejtësinë nga dritarja.

- Po ashtu duket, - pranoi Marku. - Duket sikur rrimë në vend sipër reve, e megjithatë avioni fluturon shumë shpejt, më shumë se një mijë kilometra në orë. Këtu kemi të bëjmë me një iluzion optik.

- Iluzion optik?

- Do të thotë që nganjëherë gabohemi nga pamja e jashtme, - shpjegoi Marku.

- Aha?

Ajo u duk se po sodiste për një çast për këtë që ju tha e pastaj ndërroi temën e bisedës:

- A mund të ha një akullore?

- Dakord. Do të na japin stjuardesat sa të kalojmë zonën e turbulencave.

- Unë e dua me çokollatë dhe me bajame, - tha Lajla me seriozitetin më të madh në botë.

- Më duket zgjedhje e mirë.

- Duhet të jenë *Haagen Dazs*, - saktësoi ajo.

- Vërtet?

- Jam e sigurt. I pashë në vitrinë kur hipëm në avion. Dhe duhet të më besosh që nuk është një iluzion optik.

Lajla i dhuroi të atit një buzëqeshje, shumë e kënaqur për atë që tha.

Marku filloi të rijetojë. Vajza e tij ishte njëlloj si ajo që ai kishte njohur vite më parë. Plot shkëlqim, me shëndet dhe e plotë në vetvete. Dhe menjëherë iu krijua ideja se gjërat mund të ktheheshin siç ishin më parë. Por më parë duhet të dinte

shkaqet e zhdukjes së papritur të Nikolës dhe sidomos të merrte vesh shkaqet e mungesës së Lajlës. Vajza e tij ishte bërë sakaq llafazane. Duhej që të përfitonte nga ky çast për ta pyetur por pa e ngutur.

- A do të më thuash se çfarë ka ndodhur me ty, zogu i babit? - pyeti Marku me zërin më të qetë të mundshëm duke iu afruar së bijës.

- Çfarë më ka ndodhur kur kam qenë e vogël?

Marku tha po me kokë.

- Tani nuk ke pse të shqetësohesh. Do takohesh me mamin, do vish në shtëpi, te dhoma jote, do shkosh në shkollë. Çdo gjë do të jetë në vendin e vet, por, më parë duhet të më thuash *ku* ke qenë gjatë gjithë kësaj kohe dhe sidomos... *me kë.*

Lajla hapi gojën për t'u përgjigjur menjëherë, pastaj ajo u tërhoq duke i lënë vetes kohë të mendohej. Kur, më në fund vendosi të flasë, ajo shtoi:

- Pse nuk pyet më mirë mamin?

Markut i ngriu gjaku nga sa dëgjoi nga e bija.

- A e di mami se çfarë të ka ndodhur ty?

Lajla bëri një shenjë pohuese me kokë.

- Jo, besoj se ti gabohesh.

- Kjo është e vërteta, - pohoi Lajla, e pakënaqur që fjala e saj po vihej në dyshim.

- Je e sigurt?

- Më se e sigurt, - tha ajo, pa iu dridhur zëri.

I ç'balancuar, Marku dëgjoi zërin e vet që tha:

- E ke takuar mamin gjatë këtyre pesë vjetëve?

- Sigurisht, jemi takuar shpesh.

- Ç'domethënë kjo? Jemi takuar shpesh?

Lajla e pa të atin me ëmbëlsi. Sytë e saj shkëlqenin. Pastaj,

me një fjalë të vetme i dha fund bisedës:

- Babi, tani dua të fle.

Akoma në gjendje shoku, Markut iu deshën edhe disa sekonda që të mblidhte veten përpara se të hiqte dorë:

- Dakord, shpirt, çlodhu.

Marku shtypi butonin që komandonte përkuljen e kolltukut. Lajla u shtriq, mbylli sytë dhe filloi të dremisë nën gërhimën e motorëve të avionit..

Marku u zhyt në një greminë dilemash. Si t'i vlerësonte fjalët që sapo kish dëgjuar? Pavarësisht nga pamja e saj e qetë, Lajla me siguri që do të ketë pësuar ndonjë traumë nga rrëmbimi i gjatë. Fjalët e saj mbase kishin njëfarë baze të vërtetë, por Marku nuk donte ta pranonte se Nikola qoftë nga larg apo nga afër, direkt apo indirekt të ishte e implikuar në rrëmbimin e fëmijës së tyre.

Lajla flinte me të dyja duart e mbyllura grusht. Marku e pa me dhembshuri, deri sa ai e rregulloi frymëmarrjen e tij në një ritëm me të sajën. Ai i përkëdheli shumë lehtë flokët, duke larguar një bukle që i rrinte mbrapa veshit. Lajla kish trashëguar tiparet e Nikolës dhe shikimin e Markut. Të paktën, kështu thoshin të gjithë: "Ajo ka buzëqeshjen e së ëmës dhe shikimin e të atit".

E megjithatë...

Megjithatë, Marku e dinte që kjo nuk ishte e vërtetë. Dhe kjo për arsyen e thjeshtë dhe të vetme se Lajla nuk ishte vajza e tij biologjike.

* * *

Kur Marku u njoh me Nikolën, para dhjetë vjetësh, ajo ishte në fillim të shtatzënisë së saj dhe sapo ishte shkëputur

nga një lidhje me shefin e orkestrës franceze, Daniel Grevin. Rreth të gjashtëdhjetave, brilant, i kulturuar, i njohur në mbarë botën, Grevini kishte shumë marrëdhënie jashtëmartesore me muzikantet të cilat luanin nën drejtimin e tij. Aventura e tij me Nikolën kishte zgjatur vetëm disa javë dhe ishte ajo që i kishte dhënë fund e para lidhjes së tyre.

Kur Nikola mori vesh se ishte shtatzënë, ndryshe nga ç'mund të mendohej, kish vendosur ta mbante këtë fëmijë pa i thënë gjë fare Grevinit. Takimi i saj me Markun i kish fshirë të gjitha këto andralla. Marku e kish dashur dhe rritur Lajlën si të ishte vajza e tij. Ishte Marku që ia kishte vënë dorën Nikolës në bark për të ndjerë lëvizjet e para, kishte qenë përsëri Marku që i mbante dorën Nikolës kur ajo lindi. Ai ishte gjithmonë aty për frymëmarrjen e parë të fëmijës, për hapat e parë të saj, për fjalët e para e kështu me radhë. Lumturia e të qenit baba e kish bërë Markun të harronte origjinën e vërtetë të Lajlës. Bashkë me Nikolën, ata kishin vendosur ta mbanin këtë sekret vetëm për vete.

Ishte sekreti i tyre. Ishte dashuria e tyre. Ishte fëmija i tyre.

Këtë gjë nuk ia kishin thënë askujt. As Konorit dhe as hetuesve që pyesin rrënjë e dhëmballë gjatë zhdukjes së Lajlës. Grevini vdiq nga një krizë kardiake në fund të viteve 1990, dhe me kohë, sekreti kish filluar të tretej, madje të zhdukej plotësisht.

Sepse është dashuria që end lidhjet familjare dhe jo gjaku.

* * *

E ulur pranë dritares, Evit nuk i ka shpëtuar asgjë nga biseda e Markut me të bijën. Pa e ditur as vetë, adoleshentja

nuk rrinte dot pa ia hedhur sytë herë pas here doktorit. Pa ditur ndonjë gjë të madhe për historinë e tij, ajo e ndjente dhimbjen e këtij burri si dhe lidhjen shumë të fortë që ai kishte me të bijën. Ajo e ndjente që ai e kishte humbur pusullën, që ishte i dërmuar nga ajo që i kish ndodhur, dhe e kuptonte që ai duhet të ketë qenë tjetër njeri para disa vitesh.

- Faleminderit që u morët me të, - i tha Marku duke drejtuar sytë nga Lajla.

- Ju lutem.

- Mendoj se duhet të të jap disa shpjegime, - i thotë Marku Evit.

Kurioze, Evi kthehet nga Marku, dhe me disa fjalë, ai i tregoi historinë e tij që nga rrëmbimi i Lajlës e deri te rishfaqja e mistershme e saj, pesë vjet më vonë.

- Do doja të dija: a të tha ndonjë gjë vajza ime gjatë kohës që unë nuk isha këtu?

- Foli pak...

- Më konkretisht?

- Në fakt ajo më bëri vetëm një pyetje të vetme.

- Çfarë?

- Ajo donte të dinte se çfarë i kish ndodhur mamasë sime.

I intriguar, Marku donte që ajo të vazhdonte:

- Po ti, çfarë i the?

15

Evi
Flash backu i dytë

Las Vegas, Nevada
Disa muaj më parë

Është pothuajse mesnatë.

Terreni i vjetër i kampingut ia ka lëshuar vendin një kantieri ndërtimi i zhytur tërësisht në errësirë. Vetëm nja dhjetë karavane ndodhen kuturu akoma në këtë vend.

Rulota e "familjes" Harper ndriçohet nga një qiri. Sonte Evi nuk është në punë. E shtrirë në kanape, ajo po shfleton një revistë të vjetër duke dëgjuar radion me zë të ulur. Nëna e saj fle diku afër saj. Pranë ka një komodinë nate e cila është plot me ilaçe. Evit i hapet goja dhe bëhet gati të shtrihet kur dëgjohet të bjerë zilja e një celulari i cili punon me një kartë të parapaguar, të cilin Evi e përdor me shumë kursim.

- Alo?

Është një telefonatë nga spitali. Doktori Kreg Devis,

koordinator i transplanteve hepatike, i jep një lajm të gëzueshëm: Ndoshta do të ketë një veshkë të gatshme për transplantin e nënës suaj! Duhet të vini menjëherë.

Me një të kërcyer, Evi ndodhet te koka e së ëmës.

- Mami! Zgjohu! Mami!

Tereza, mezi ngrihet në këmbë. Evi i shpjegon situatën me disa fjalë dhe e ndihmon të bëhet gati. Pesë minuta më vonë, të dyja gratë ndodhen para karavanit të fqinjës së tyre.

- Karmina, jemi ne! Kemi nevojë për makinën tënde. Ë urgjente!

Pas një pritje që u duk pambarim, dera më në fund u h por në vend të mikeshës së tyre u shfaq burri, Rodrigo, i shpërtheu me një lumë sharjesh.

- *Pero qué cono pasa? Esta gente siempre jodiéndome* [1]...

Evi nuk ligështohet dhe i bën ballë të sharave të spanjolli sepse edhe ajo di të shajë po aq, në mos më shumë se ai. Pa shkëmbimit të këtyre fjalëve të "kortezisë", Rodrigo, që do t jetë ai protagonisti, pranon më në fund t'i shoqërojë.

Ja tek nisen të katërt hipur në Pontiakun e vjetër *Firebird*, model i vitit 1969, me ndenjëse të rëna dhe me një skapamento e cila ishte jashtë normave të ndotjes së ambientit. Makina ecën me zigzage në rrugë. Të paktën nja dhjetë herë desh u përplas me trotuaret ose me pengesa të tjera. Dhjetë. Në fakt dhjetë është edhe numri i shisheve të birrës *Corona* që ka pirë Rodrigo para se të marrë timonin...

Për fat të gjithë arrijnë shëndoshë e mirë në parkingun e spitalit. Ka net të tilla kur fati është në anën tonë.

Me kusht që këtë fat të vazhdojmë ta kemi akoma.

---

[1] Çfarë dreqin po ndodh akoma? Kur do të mos na e çani më...?

* * *

Kur Evi dhe Tereza hyjnë në hollin e spitalit, doktori Kreg Devis i pret personalisht në recepsion.

- Duhet të nxitojmë! - thotë ai, - duke i shoqëruar të dyja për nga ashensori.

Agjencia e biomedicinës që administron donacionin e organeve e kontaktoi spitalin vonë në mbrëmje. Në fakt gjithçka ndodhi këtë pasdite, kur një çift pësoi një aksident me motor në rrugën e *Apple Valley*. Ata të dy kishin kaska në kokë dhe po ecnin ngadalë. Burri shpëtoi pothuajse pa asnjë gërvishtje. Gruaja nuk u ngrit më: traumatizim të kafkës. Ndihma e shpejtë e çoi në reanimacion në spitalin e San Bernardinos ku u bë ç'ishte e mundur për ta shpëtuar. Por ishte shumë vonë. Edhe pse diagnoza e vdekjes encefalike u përcaktua shumë shpejt, u desh mjaft kohë për të bindur familjen për të bërë dhuratë disa organe. Gjithmonë duam të besojmë te mrekullitë. Një mjek i spitalit u mundua t'i shpjegonte të shoqit se në rastin e vdekjes cerebrale, të gjitha funksionet neuronale janë të shkatërruara. Tjetri e dëgjonte ligjërimin e mjekut, por nuk ia vinte veshin fare. Ai vazhdonte të mbante dorën e së shoqes në të tijën. Ajo merrte frymë akoma, edhe pse kjo bëhej në mënyrë artificiale. Lëkura e saj ishte e ngrohtë dhe ndiheshin të rrahurat e zemrës. Megjithatë ajo s'kishte më jetë. Kishte vetëm një iluzion jete.

Bashkëshorti më në fund u bind, dhe pak para orës 21, e kuptoi që e vetmja mënyrë për të zgjatur jetën e gruas së tij ishte ndoshta të bëhej që ajo ta jetonte jetën e saj nëpërmjet një jete tjetër. Pa humbur kohë, ekipet mjekësore, hoqën zemrën, mushkëritë, pankreasin, zorrët para se t'i dërgonin

në drejtimet e duhura: Los Anxhelos, San Diego, Santa Barbara...

Ndërsa veshkën, e ruajtën në një kuti çeliku dhe e futën në një frigorifer për ta mbajtur në temperaturën e duhur. Frigoriferi u transportua me helikopter deri në Las Vegas. Tereza ishte e para në listën e pritjes. Këtë transplant ajo po e priste që prej 24 muajsh. Mungesa e donacioneve, por edhe grupi i saj i veçantë i gjakut e kishin zgjatur pa fund kohën e pritjes. Po të kish pritur edhe një muaj ose dy, sëmundja do ta kish marrë me vete.

- Një sallë operacioni sapo u lirua, - thotë doktori Devis. - Ne do të mund t'ju operojmë për një orë. Kemi kohë sa për të bërë një bilanc biologjik.

- Do dëshiroja që të më shoqërojë ime bijë, - thotë Tereza.

- Ajo mund të qëndrojë me ju deri sa t'ju fusim në sallë, - pranon mjeku duke e shoqëruar pacienten në një dhomë më vete.

Pastaj fillojnë të kryhen të gjitha veprimet: analiza gjaku e bërë nga një infermiere, biseda me anestezistin i cili e siguron: "Do ta ndjeni veten si të re", dushi përgatitor me betadinë dhe pastaj pritja.

Për disa minuta, Evit i duket vetja si nëpër re. Ankthi se mos e humbte të ëmën i cili i përdridhte zorrët ndër vite, pak nga pak po fashitet. Fizikisht ajo ndjen se diçka po ç'tendoset brenda saj. Ajo do të besojë se sonte çdo gjë do të shkojë mirë.

Evi gjithmonë ka besuar te ky transplant. Prej muajsh të tërë ajo lundron nëpër *websitet* ku lexon forumet e ndryshëm për të kuptuar natyrën e saktë të sëmundjes së nënës. Ajo e di që ky operacion është shansi i fundit për të ëmën. Natyrisht transplanti nuk do të bëjë "të zhduket" si me magji hepatiti.

Sigurisht, ekziston një rrezik që virusi të infektojë transplantin, por statistikat për të jetuar gjatë janë premtuese.

Këto javët e fundit, Evi ka shkuar shpesh në kishën e vogël të *Riverside*.

Fshehtas.

Pas shumë kohësh, është lutur për herë të parë.

E çfarë mund të bënte tjetër kur nuk kishte asnjë rrugëdalje?

Kur ishte e vogël, gjente ngushëllim duke menduar se kishte një engjëll mbrojtës që i qëndronte pranë. Pastaj, me futjen në adoleshencë, ajo nuk besonte më në asgjë. As tek engjëjt, as tek Zoti, as te karmaja.

Ka disa kohë që i bën një numër të madh pyetjesh vetes së saj.

Shpesh ka përshtypjen se një fatalitet i çuditshëm i është ngjitur pas, sikur e kaluara dhe e ardhmja e saj të ishin parashkruar që më parë në një libër të madh të fatit...

***

Kish kaluar një orë që nga ardhja e anestezistit.

Një orë e një çerek.

Përse po zgjatet kaq shumë?

Evi ndjen përsëri therje në bark. Pra qetësia paska qenë shumë e shkurtër. Kur, më në fund, në dhomë shfaqet doktor Kregu, i shoqëruar nga infermierja. Evi instinktivisht e kupton se lajmet nuk janë të mira.

- Morëm rezultatet e analizave tuaja, Tereza, - thotë ai me një pamje të sikletshme.

Evi e shikon me dhimbje doktorin i cili tund një fletë para syve të nënës së saj.

- Keni pirë alkool, nuk ka shumë kohë! - nervozohet Davis.

- Ju e dini që kjo e bën të pavlefshëm protokollin!

Fraza duket sikur qëndron pezull në ajër për disa sekonda. Areale!

E dërrmuar Evi kthehet nga e ëma.

- Nuk kam pirë asgjë doktor! - betohet Tereza e befasuar.

- Ne i kemi bërë testet në dy mostra të veçanta. Dhe në të dy rastet rezultati është pozitiv. Ju nuk e keni respektuar kontratën, Tereza. Të paktën gjashtë muaj para transplantit. Ju ishit angazhuar ta mbanit fjalën.

- Nuk kam pirë asgjë, - vazhdon të mbrohet Tereza.

Por mjeku nuk e dëgjon më.

- Njoftoni personin tjetër në listën e pritjes, - e urdhëron ai infermieren. - S'duhet të na shkojë dëm veshka.

- Nuk jam gënjeshtare, - mbrohet Tereza.

Tashmë ajo nuk shikon më mjekun por të bijën. Ajo do të bindë të bijën e saj. Ajo e di që betejën me mjekun e ka tashmë të humbur. Madje asnjëherë nuk ka pasur besim te ky transplant. E ndjen që do të vdesë së shpejti, por do që e bija ta besojë.

- Shpirt, të betohem që nuk kam futur asnjë pikë në gojë, - thotë Tereza duke u ngritur nga krevati.

E zhgënjyer Evi bën dy hapa mbrapa.

- Këtë fjali e kam dëgjuar me qindra herë që kur isha tre vjeçe, mama...

- Ke të drejtë, por këtë herë...

- Nuk të besoj më.

- Këtë radhë po të them të vërtetën. Të betohem...

- Përse shkatërrove gjithçka mami? - i thotë ajo me lot në sy.

- Zemër... - fillon të thotë përsëri Tereza duke zgjatur dorën.

Por Evi ja shtyn dorën me brutalitet e me egërsi.

- Të urrej! - ulërin Evi duke u larguar me vrap.

* * *

Sot
Në avion
Ora 13 e 45 minuta

- Të urrej! - përfundoi Evi. - Këto janë fjalët e fundit që i kam thënë nënës sime.

- Nuk e ke takuar më? - e pyet Marku.

- Jo, nuk e kam parë më kurrë.

Mjeku qëndroi pa folur për disa çaste, i prekur thellë nga rrëfimi i vajzës. Pas një qetësie të shkurtër, avioni hyri në një zonë të re turbulence. I tundur nga forca të padukshme, kolosi i ajrit dukej sikur kish marrë të ftohur e po i dridheshin nofullat.

- Po pastaj? - pyeti Marku.

- Pastaj ajo vdiq.

16

Evi
Flash backu i tretë

Las Vegas, Nevada

Varrezat e Mauntin Vju rrihen nga shiu dhe nga era.

Sapo futën në tokë arkivolin e Teresa Harperit. Prifti ka kohë që është larguar dhe vendi është pothuajse i zbrazur. Rreth e rrotull gropës, janë vetëm Evi dhe Karmina që po rrinë akoma aty.

Një vetëtimë shkëlqen në qiell. Një bubullimë e pason.

- Po të pres te vetura, - i propozon Karmina ndërsa shiu ia fillon më me rrebesh.

E mbetur vetëm, Evi ulet në gjunjë para varrit dhe fshin lotët që i bien rrëke nga dhimbja mbi faqet e dobësuara. Nuk e ka takuar të ëmën që nga zënka e tyre në spital, para dy muajsh. Pa transplantin, Tereza jetoi vetëm disa javë. Natyrisht kanceri, alkooli dhe droga e vranë. Por, pikërisht në këtë çast, nuk mund të mos e bëjë veten fajtore. Më në fund vajza vendos

të shkojë te Karmina. Është lagur e bërë qullë. Dridhet nga koka deri te majat e gishtave.

Evi ngrihet dhe sheh një grua me çadër në dorë, që po i afrohet. E panjohura e ka ndjekur nga larg ceremoninë pa mundur të jetë pjesë e saj. Pardesyja gri, kostumi i saj me pantallona dhe prerja e fundit e flokëve i japin njëfarë klasi edhe pse ka një pamje prej të sëmure. Ajo hap portobagazhin e një berline dhe nxjerr prej aty një peshqir dhe ia jep Evit:

- Fshihu, përndryshe do ftohesh, - e këshillon gruaja me një theks të lehtë italian.

Ndonëse e befasuar, Evi e pranon peshqirin e pastër si dhe mbrojtjen nga shiu nga flatrat e mëdha të çadrës. Duke fshirë fytyrën, ajo vëren bashkëbiseduesen e saj me vëmendje dhe e kupton se ajo ka shumë klas për të qenë një mikeshë e nënës së saj.

- Unë quhem Meredit DeLeon... - shpjegohet gruaja.

Pas një ngurrimi të vogël, ajo e përfundon fjalinë e saj:

- ....unë e kam vrarë nënën tënde.

* * *

- Para një viti më diagnostikuan një kancer të mëlçisë, - filloi të thotë Merediti.

Të dyja gratë janë ulur përballë njëra-tjetrës në *Heaven Café*, që gjendet buzë rrugës që të çon në varreza. Dy ibrikë çaji nxjerrin avull përballë tyre.

- Sëmundja ishte shumë e avancuar dhe shumë shpejt u bë e qartë se vetëm një transplant mund të më shpëtonte. Për fat të keq unë bëj pjesë në grupin e gjakut 0, për të cilin pritja është gjithnjë më e gjatë.

- I njëjti grup gjaku si mamaja ime, - konstaton Evi.

Merediti pohon me kokë para se të vijojë:

- Para dy mujash, pak para darke, dr. Kreg Devisi na telefonoi. Foli me Polin, burrin tim. Ne ishim takuar disa herë me doktorin gjatë vizitave të mia në spital. Atë natë ai i tha burrit tim se ndofta kishte një transplant të gatshëm, por që kishte një problem.

- Një problem?

- Po, problemi ishte nëna jote. Ajo ishte para meje në listën e pritjes...

Evit i shkuan mornica të ftohta nëpër trup, edhe pse diçka në mendjen e saj i bëhet pengesë për të mos parë përballë llahtarin e situatës.

- Kreg Devisi na e tha copë se, nëse do të ishim gati të bënim "një sforco financiare", ai do ta rregullonte punën për ta përjashtuar nënën tënde nga programi i transplantit.

E balsamosur nga sa dëgjoi, Evi më në fund e kupton situatën: u ndryshuan parametrat e analizave të gjakut të Terezës që të besohej se ajo kish vazhduar të pinte alkool.

Në kokën e saj, Evit i duket sikur dëgjon qartë lutjet e së ëmës kur ajo po shpjegohej:

Nuk jam një gënjeshtare!

Të betohem që nuk kam filluar të pi, shpirt.

Jo, nëna e saj nuk kish gënjyer, e megjithatë, Evi nuk deshi ta besonte më...

Tani edhe fytyra e Mereditit fillon të shpërbëhet, por ajo ka vendosur t'i shkojë deri në fund kësaj historie:

- Në fillim unë nuk pranova. Mendova se kjo ishte makabre dhe e llahtarshme. Por kisha pritur aq shumë dhe dihet se transplantet bëhen gjithnjë e më të rrallë... më në fund u

dorëzova dhe pranova. Në gjendjen që isha unë rrija shtrirë e gozhduar nga dhimbjet, më shumë e vdekur se sa e gjallë. Poli, fiton mirë me punën që ka. Pas disa negociatash Poli dhe Devisi ranë dakord për një shumë prej 200.000 dollarë, por duhet thënë se Poli më la të lirë që të isha unë ajo që vendosja. Dhe kjo është një zgjedhje që unë nuk ia uroj asnjë njeriu.

Merediti humbet në pështjellimet e saj sikur të ishte ajo që po i vuante këto momente të dhimbshme.

- Do të doja të të thosha që këtë e bëra për fëmijët e mi, - vazhdon rrëfimin ajo, - por kjo nuk është e vërtetë. E bëra sepse kisha frikë nga vdekja, kjo është e vërteta.

Merediti ishte e sinqertë në atë që thoshte. Ky rrëfim i rëndon në shpirt që ditën që ka vendosur të bëjë transplantin.

- Jeta na vendos ndonjëherë në situata nga të cilat ne nuk dalim dot veçse duke hequr dorë nga vlerat që ne mbrojmë, - konstaton ajo, më tepër sikur po fliste për veten e saj.

Evi mbyll sytë. Një kokërr e madhe loti rrjedh mbi faqen e saj, por as që mundohet ta fshijë.

Merediti rifillon të flasë edhe një herë të fundit për të qenë më e saktë:

- Nëse ti do të shkosh në polici, unë do t'ju them atyre të njëjtën gjë që të thashë ty, pa lëvizur as presjen, dhe jam gati të marr përgjegjësitë e mia. Ti vepro si të duash.

Dhe Merediti ngrihet nga tavolina.

- Bëj atë që të duket e drejtë, - e këshillon edhe një herë ajo duke dalë nga kafja.

* * *

Pontiaku i vjetër i Karminës parkohet para stacionit të autobusëve. Evi përplas derën e makinës dhe merr në bagazh

një valixhe të vogël dhe një çantë shpine. *Greyhoundi*, është autobusi që do të niset pas pak për në Nju Jork. Me shitjen e atyre pak gjërave që kishte e ëma, Evi fitoi gjithë-gjithë nja 200 dollarë, të cilët i shpenzoi thjesht për një vajtje në Manhatan. Kreg Devisi punon aty tani. E kërkoi fillimisht në Las Vegas, por mjeku batakçi ishte larguar me sa duket nga Kalifornia për të shkuar në bregun Lindor, menjëherë pas vdekjes të së ëmës.

- Je e sigurt që do të shkosh? - e pyet Karmina e cila e shoqëron deri te stacioni i autobusit.

- Më se e sigurt.

Gjatë gjithë jetës së saj Karmina i ishte ruajtur ndjenjave. Fëmijët e saj i ka rritur me të keq dhe ka krijuar një stereotip i cili është i padepërtueshëm në çdo rrethanë qoftë.

- Kujdesu për veten, - i thotë Evit, duke i dhënë një të përkëdhelur me dorë në faqe, që për të do të thotë një ndjenjë e pamohueshme dhimbsurie.

- Ok, - përgjigjet Evi duke hipur në autobus.

Të dyja gratë e dinë që ndofta nuk do të shihen më me njëra-tjetrën. Karmina i jep bagazhet dhe i dhuron edhe një përshëndetje të fundit me dorë. Evi do të gjente më vonë në çantë 300 dollarë që Karmina ia kish futur fshehurazi.

* * *

Më në fund autobusi niset.

E ulur në vendin e vet, Evi mbështet kokën pas dritares. Është hera e parë që ajo largohet nga Las Vegasi.

Pas disa orësh ajo do të jetë në Nju Jork.

Dhe ajo do të bëjë atë që asaj i duket e drejtë.

Ajo do ta vrasë Kreg Devisin.

17

Losing my religion

Nganjëherë e ardhmja jeton me ne
pa e ditur edhe ne vetë, dhe fjalët
tona që kujtojnë se po gënjejmë,
pasqyrojnë një realitet të ardhshëm.

- MARCEL PROUST

Sot
Në avion
Ora 14.00

- Po më pas çfarë ndodhi?

Një sinjal zanor dëgjohet dhe lajmëron se avioni e ka kaluar zonën e turbulencës dhe duke e çliruar në të njëjtën kohë edhe Evin nga ky lloj tmerri në të cilin qe zhytur nga tregimi i saj.

- Çfarë ndodhi në Nju Jork? - nguli këmbë Marku. - E gjete vrasësin e nënës tënde?

- Unë...

Evi u ndal për pak kohë. E befasuar edhe vetë që kish

arritur t'i besonte dikujt për ato që ruante brenda vetes, një njeriu krejt të panjohur, ajo sikur po ngurronte të thoshte më shumë. Si kish mundur t'i tregonte sekretet e saj më intime atij, kur ajo nuk i besonte askujt? Gjykuar nga shikimi, prania dhe vëmendja, Marku dukej sikur i vinte keq për të. Duke e ndjerë veten të rrezikuar, ajo gjeti një mënyrë për t'i bërë bisht bisedës.

- Më duhet të shkoj në banjë, - gjeti pretekstin për t'u larguar.

Marku e kuptoi që "ai e kish humbur kontaktin" me Evin. U ngrit për t'i hapur rrugën Evit dhe pa me keqardhje largimin e saj.

Rrëfimi i vajzës e kishte tronditur pa masë, duke i kujtuar papritmas fëmijërinë e tij dhe atë të Konorit.

Hodhi pastaj një vështrim nga e bija. E përkundur nga frymëmarrja e katër motorëve, ajo vazhdonte të flinte me grushtet e mbledhur, me kokën të anuar nga dritarja.

Avioni tani ishte përsëri i qetë. Sinjali jeshil u ndez dhe donte të thoshte që pasagjerët mund të përdornin tashmë celularët e tyre. Një rele GSM e integruar në avion të jepte mundësinë të jepje e të merrje telefonata. Marku u çudit tek pa pothuajse gjysmën e pasagjerëve që nxituan të përdornin celularët. Pastaj psherëtiu thellë. Brenda tre vjetësh, shoqëria e komunikimit me sa duket qenka ngjitur në një stad të ri. Shumë shpejt njerëzit do të vinin në vesh një kufje për të komunikuar edhe në gjumë, në ëndrrat e tyre, dhe në çastet kur do të ishin me këmbë të ngritura përpjetë duke bërë dashuri... Asnjëherë nuk ishte komunikuar aq shumë dhe nuk ishin dëgjuar aq pak. Duke sharë kohën në të cilën jetonte, Marku vuri re që kish marrë me vete celularin e Nikolës. E

mori nga xhepi i xhaketës dhe qenia njerëzore duke qenë se nuk jetonte me një paradoks të vetëm, ai bëri, pikërisht atë gjë për të cilën po qortonte të tjerët, disa sekonda më parë. Nuk kishte mesazhe, por kishte shumë "thirrje të munguara", të cilat vinin nga një numër që ai nuk e njihte. Që nga nisja e tij, qe munduar disa herë të kapte në telefon të shoqen në Nju Jork por pa ia arritur qëllimit. Në të vërtetë, Marku as nuk e kishte idenë se ku mund të ishte Nikola.

Megjithatë u mundua të marrë në telefon numrin që ishte afishuar në celular.

Një zile, dy zile. Pastaj një sekretari telefonike:

Mirëdita, ju jeni te...

Mesazhi u ndërpre pa i lënë kohë Markut të identifikonte zërin e korrespondentit.

- Mark?

Marku njohu menjëherë zërin e së shoqes.

- Nikolë? Unë jam.

- Mirë je?

- Po ti ku je? Jam bërë si i luajtur nga meraku.

- Nuk... nuk do mund... të të flas shumë tani, zemër.

Marku dalloi një tensionim dhe një ankth të madh në zërin e gruas së tij. Edhe pse ishte i zemëruar me qëndrimin e saj, ideja e parë që i erdhi në mëndje ishte të qetësonte të shoqen lidhur me shëndetin e vajzës së tyre.

- Jam me Lajlën. Ajo është shumë mirë! Ajo më foli!

Me të dëgjuar emrin e saj, Lajla u përmend, hapi njërin sy duke fërkuar qepallat e duke hapur gojën.

- A do ta përshëndesësh mamin? - e pyeti Marku të bijën duke i zgjatur telefonin.

- Jo, - iu përgjigj Lajla.

I befasuar nga kjo përgjigje Marku këmbënguli:

- Shpirt, thuaji nja dy fjalë mamit, do t'i bëhet qejfi... e ka marrë malli...

- Jo! - tha ajo në mënyrë kategorike, duke e shtyrë dorën e të atit.

I pataksuar Marku shtangu për disa sekonda duke parë të bijën deri sa Nikola i thotë:

- Dëgjo Mark, do më duhet ta mbyll telefonin.

Por Marku me sa duket nuk ishte i të njëjtit mendim.

- Prit! Përse nuk do të të flasë Lajla ty?

- Unë e di se çfarë i ka ndodhur Lajlës, - pohon Nikola.

Ky pohim oshtiu si një shpërthim.

- Çfarë po thua? - thotë Marku me një zë të mbytur.

Një pështjellim zemërimi dhe dëshpërimi e bëri që të shtrëngojë grushtin.

- Ti e dije që ajo ishte gjallë?

- Më vjen keq, - kërkoi falje ajo.

- Ç'mutin është e gjithë kjo histori? A do më thuash të vërtetën?

- Nuk duhet të më mbash mëri.

- Unë desh vdiqa nga hidhërimi! - nuk përmbahet Marku. - Gjatë gjithë këtyre viteve, ti më pe që po humbisja! Më pe që po shkoja drejt greminës dhe nuk më the asnjëherë që vajza ishte gjallë?

- Nuk është ashtu si mendon ti, Mark. Unë...

"MJAFT TANI"

Në sfond u dëgjua zëri i një burri i cili e ndërpreu gruan e tij.

- Kush është ai tip aty me ty? - pyeti Marku.

- Është histori e koklavitur. Unë...

"MBYLLE TELEFONIN NIKOLË"
URDHËROI ZËRI.

- Kush është me ty? - ulëriti Marku.

- Nuk është ashtu si mendon ti, - përsëriti ajo.

"MBYLLE PËRNDRYSHE
DO PRISHËSH GJITHÇKA!"

- Unë të dua, shtoi ajo.

Kaq dhe asnjë fjalë tjetër.

* * *

I ngrirë, me shikimin të tretur në boshllëk, Marku e kishte të vështirë të vinte në vete. Kishin kaluar kështu dhjetë minuta që nga biseda e tij me Nikolën. Ai e kish ribërë numrin por as sekretaria nuk përgjigjej më tani. Nikola e kish gënjyer në lidhje me të bijën. Një gënjeshtër e tmerrshme, shumë më tepër se një tradhti e shumë më keq se gjithçka. Për herë të parë në trurin e tij zuri vend një krimb dyshimi. A e njihte vërtet gruan me të cilën ishte martuar? Që nga nata e mbrëmshme atij po i grumbulloheshin pyetje që mbeteshin pa përgjigje.

Me radhë, i del para syve, gazetari në aeroport, pastaj thëniet e vajzës së tij, por ai këto nuk i kish marrë në konsideratë.

Nuk dinte se çfarë të bënte. Ndjente në kokë, në zemër, në trup një lloj katrahure afektive dhe fizike njëkohësisht. Dyzet e tetë orë më parë, jetonte akoma nëpër rrugë si një mi nëpër kanalet e nëndheshëm të qytetit duke mbijetuar vetëm duke pirë alkool.

Kënaqësia e gjetjes së Lajlës arriti kulmin kur ai mendoi se ia kishte dalë mbanë fare vetëm. Ai kish arritur për çastin

të merrte kthesën dhe të përmbante efektet e *delirium tremens*, por universi i tij, edhe një herë po shkërmoqej dhe fitorja e tij e brishtë nuk arriti t'i bëjë ballë kësaj goditjeje të re të fatit.

I çorientuar, vuri re se duart kishin filluar t'i dridheshin. Ish mbushur në djersë, po i zihej fryma, duhej të lëvizte.

Meqë u ngrit menjëherë, shikimi iu ndal mbi vajzën që e kish zënë përsëri gjumi. Frymëmarrja e saj ishte e lehtë dhe e qetë, fytyra notonte nën dritën e bardhë të diellit. Kjo i mjaftoi për ta qetësuar. E kuptoi se ajo ishte e vetmja që mund ta shpëtonte. Kish nevojë për të, siç kish edhe ajo nevojë për të atin. Sa të rrinte ai me të, ai do ta mbronte, dhe, në njëfarë mënyre, edhe ajo bënte të njëjtën gjë.

* * *

Evi ish mbështetur në banjë, duke vjellë atë mëngjes të vakët që kish ngrënë disa orë më parë. Që nga mëngjesi një ndjesi të vjelli e kish shoqëruar dhe tani nga udhëtimi i ishte theksuar edhe më shumë. Madje këto kohët e fundit, shqetësimet shëndetësore i ishin shtuar. Marrje mendsh, dhimbje koke, veshët që i buçasin... Pa folur për mbi ndjeshmërinë e saj e cila e bënte akoma më të brishtë.

U ngrit, pastroi gojën dhe i hodhi një grusht ujë fytyrës. Përpara pasqyrës, vetja iu duk llahtar. Një dhimbje e vazhdueshme i përshkonte gjithë ballin dhe ndjente që tëmthat i rrihnin fort. Ambienti rreth e rrotull, mbytës, i krijonte idenë e klaustrofobisë. Duhej të dilte që këtu, përndryshe do t'i binte të fikët. Në kokë i kalonin me shpejtësi dhe mbivendoseshin me dhjetëra imazhe që përplaseshin njëri me tjetrin në të mijtën e sekondës. Kujtime, frikë, disa çaste gëzimi, që shuheshin

menjëherë. Madje iu duk sikur dëgjoi edhe mërmëritje.

Po bëhej gati të dilte kur ndjeu një si kruajtje në sup dhe ajo e kroi që sipër bluzës. Në vend që të qetësohej, asaj i kruhej edhe më shumë vendi, derisa iu kthye në një dhimbje. Pothuajse kundër dëshirës së saj, ajo e kruajti aq shumë, sa filloi të shqetësohej nga kjo ndjesi e panjohur. Kur tërhoqi mëngën, vuri re në trup një shenjë ngjyrë vjollcë në supin e majtë.

Atëherë u kthye për të parë në pasqyrë formën e çuditshme që ishte formuar në lëkurën e saj:



18

Të mbijetosh

Vërtet janë kujtimet, por dikush i ka
elektrifikuar dhe kur bashkohen
me qerpikët tanë, sapo ne i kujtojmë,
e ndjejmë se sytë na djegin.

- MATHIAS MALZIEU

Sot
Në avion
Ora 14:15 minuta.

Në një lartësi mbi më shumë se 12.000 metra, avioni i fluturimit 714 vazhdonte rrugën për në Nju Jork, si një zog gjigant sipër fushave të mëdha.

Evi mbylli derën e tualetit, e tmerruar nga ajo që kish parë në trupin e saj. Bulëza djerse i rridhnin nga balli. Gjoksi i hidhej përpjetë, trupin ia përshkonin mornica. Kush vallë mund t'ia kish bërë këtë tatuazh, pa dijeninë e saj, këtë dreq shenje mbi sup, këtë shenjë që i ngjante çuditërisht vizatimeve që kish

bërë vajza e vogël e ulur pranë saj?

Ajo eci përpara duke u lëkundur sa majtas djathtas, duke kaluar me vështirësi në mes të stjuardesave që po shpërndanin ushqimin dhe pasagjerët që po çmpinin këmbët e tyre për të shmangur një flebi ose një emboli polmonare, "sindromat e reja të klasës ekonomike" për të cilat mediat bënin zhurmë.

Kur erdhi te rreshti i vet, Evi zuri vendin e saj duke bërë kujdes që të mos e zgjonte Lajlën. Falënderoi dhe Markun që i kishte marrë edhe tabakanë e ushqimit.

- Nuk ndihesh mirë? - e pyet Marku tek sheh fytyrën e saj të shpërbërë.

- Jo, është thjesht lodhje, - e qetëson ajo, duke e ditur që gjendja e saj dukej qartë.

- Nëse mund të bëj diçka...

- Po, a mund të më jepni pak çantën time të shpinës?

Marku kapi çantën e cila kishte rrëshqitur poshtë ndenjëses së tij. Meqë zinxhiri nuk ishte mbyllur mirë, kur ai e ngriti çantën, një libër rrëshqiti dhe ra përtokë.

Marku u ul për ta marrë. Ishte një libër i lidhur, me kopertinën pak të vjetruar nga keqpërdorimi dhe me faqet paksa të kthyera anash të cilat me sa duket ishin lexuar e rilexuar. Kurioz, ai nuk mund të mos i hidhte një sy titullit:

Të mbijetosh
nga Konor Mekkoi

Për një çast mbeti i befasuar. Disa vite më parë, Konori e kishte shkruar këtë libër për të nxjerrë jashtë demonët e të kaluarës së tij. Ishte një vepër eklektike, njëkohësisht edhe një ese psikologjie si dhe një libër kujtimesh të fëmijërisë. Duke u

nisur nga eksperienca e tij si dhe nga seancat e terapisë nga më spektakolare që ai kish drejtuar, Konori u jepte lexuesve të tij pistat e ndryshme për t'u çliruar nga frika e tyre, si të kuptonin ankthet e tyre dhe si t'i rezistonin dhimbjes. I botuar fillimisht te një botues i vogël dhe jo në formatet standard, libri nuk kish pasur ndonjë jehonë të madhe dhe as artikuj kritikë në shtyp. Por kështu, gojë më gojë, ai kish mundur të kapte publikun e gjerë dhe sot kishte mjaft lexues të zjarrtë.

Marku e ktheu librin në anën tjetër. Në faqen e katërt, Konori kishte vënë një foto me atë buzëqeshjen e tij melankolike të cilën Marku ia njihte mirë. Kjo përballje e papritur me fotografinë e mikut të tij i shkaktoi Markut një emocion të rrallë. Ata kishin qenë shumë të afërt për njëri-tjetrin. Para se Marku të zbriste në ferr, ata kishin ndarë gjithçka midis tyre. Përse nuk e kish marrë në telefon shokun e tij për t'i dhënë lajmin e gjetjes së Lajlës? Si nuk i kishte shkuar ndërmend?

- Është libri im i preferuar, - shpjegoi Evi. - A e keni lexuar?

- E ka shkruar miku im më i mirë, - pohoi Marku duke ia dhënë librin.

- Miku juaj më i mirë? Ju jeni Marku për të cilin ai flet shpesh?

- Po, jemi rritur bashkë, në të njëjtën lagje, në Çikago.

- E di.

- Po pse thua se është libri yt i preferuar? - donte të dinte më shumë Marku.

- Sepse ai më ka ndihmuar. Është pak si e tepruar, por nganjëherë më duket sikur këtë libër ai e ka shkruar për mua.

- Ky me siguri që është një nga komplimentet më të bukur që mund t'i bëhet autorit, - tha Marku.

- Por unë i kam bërë pyetje vetes... - filloi Evi.

- Çfarë?

- Ato që ai tregon në këtë libër, janë e vërteta?

- Çdo gjë është e vërtetë, - konfirmon Marku.

Pas një heshtjeje të vogël, Marku e plotëson mendimin e tij:

- Por aty nuk është *e gjithë e vërteta.*

Evi ngrysi vetullat:

- Që do të thotë?

- Ka gjëra të rëndësishme që Konori nuk ka mundur t'i thotë.

- Pse?

Marku e shikoi ngultas Evin. Nganjëherë ai ishte në gjendje ta gjykonte tjetrin në fraksionin e një sekonde. Të paktën ai ishte i sigurt nëse mund të kishte ose jo besim tek personi në fjalë.

Ajo është dora jonë, i tha një zë i brendshëm Markut.

- Përse nuk i ka treguar të gjitha? - nguli këmbë Evi.

- Që të mos shkonte në burg, - u përgjigj pa dorashka Marku.

19

Marku & Konori
Flash backu i parë

Nëntor 1982
Periferia e Çikagos
Marku dhe Konori janë 10 vjeç secili

Lagjja e *Greenwoodit* në *South Side* të Çikagos është një përqëndrim dhe një përzierje e varfërisë dhe e dhunës. Një plazh i shkretë shtrihet për kilometra të tëra. Trotuare të deformuar, ndërtesa të braktisura, skelete makinash të karbonizuara, terrene të boshatisur të mbushur me plehra. Dyqanet janë shumë të rrallë. Disa ushqimore të siguruara me grila hekuri, vetëm një supermarket, vetëm një bankë, dhe asnjë spital. Vetëm konsumi i alkoolit ecën mirë.

Është një lloj si Bagdadi i bombarduar mu në zemër të Amerikës.

Pothuajse të gjithë janë zezakë në *Greenwood* dhe pothuajse të gjithë janë të varfër. Që prej shumë kohësh, të

gjithë ata që kishin pasur mundësi të iknin, kishin ikur nga ky vend pa shpresë që duket se po kalbet gjithnjë e më shumë.

Mark Hetëuej i vogël banon me të atin i cili është roje në një shkollë publike të getos. Mamaja e tij qe larguar që kur Marku ishte tre vjeç. Kur ai pyet: "Përse mami na ka braktisur?" babi i përgjigjet gjithmonë: "Sepse ajo nuk ishte e lumtur".

Jo, ajo nuk ishte e lumtur në këtë shkollë që i ngjante një fortese. Ishte e vërtetë që ambienti i ngjante një zone ushtarake. Dritaret janë me hekura, dyert të blinduara dhe hyrjet të pajisura me detektorë metalikë që bëjnë zhurmë çdo mëngjes nga mbajtja e armëve me vete. Dhuna e gangsterëve është e pranishme kudo. Policia e krijuar nga vetë prindërit ose policë në pension, janë aty për të mbajtur rregull, por pa ia arritur dot qëllimit. Shumë fëmijë shkojnë në shkollë me frikë në shpirt. Shumica e tyre janë dëshmitarë të vrasjeve që u ndodhin para syve dhe vuajnë nga shqetësime nervore e post-traumatike.

* * *

Ora është shtatë e mbrëmjes. Shkolla është e boshatisur. Në një nga klasat e katit të fundit, ndizen dritat.

Marku, 10 vjeç, i drejtohet bibliotekës që ndodhet në murin në fund të klasës. Në fakt, fjala "bibliotekë" është një fjalë e madhe për të quajtur etazherin mbi të cilën janë vendosur disa romane me çmim të lirë. Çdo mbrëmje pasi i ati i ka tharë disa kanoçe me birrë, Marku vjen këtu për të bërë detyrat, ku i pëlqen të jetë i qetë. Babi i tij është pijanec, por nuk është i dhunshëm. Pasi ka rrëkëllyer tre ose katër *Budweiser*, ai thjesht ka bërë si zakon të shajë Reganin, Kongresin, bashkinë,

zezakët, aziatikët, latinët, ish-gruan e tij, si edhe mbarë shoqërinë, e cila është përgjegjëse për varfërinë dhe fatkeqësinë e tij.

Marku shoqëron me gisht romanet që ndodhen në etazher deri sa ai gjen atë që po kërkonte: *To kill a Mockingbird*.

Ai i ka lexuar tashmë 200 faqe. Libri i pëlqen aq shumë saqë ai lexon vetëm nga një kapitull çdo darkë në mënyrë që kjo kënaqësi të zgjasë pa mbarim. Ky tregon historinë e mrekullueshme të një avokati i cili i rrit i vetëm dy fëmijët e tij në Alabama, në kohën e depresionit të madh të viteve 1930. Jeta rrjedh e qetë, deri ditën kur atij i kërkohet të mbrojë në gjyq një zezak të akuzuar padrejtësisht se kishte përdhunuar një të bardhë. Pa marrë parasysh intolerancën dhe paragjykimet e bashkëqytetarëve të tij, avokati do të mundohet të nxjerrë në pah të vërtetën.

Marku lëshohet mbi një bankë, nxjerr një sanduiç me gjalpë kikiriku dhe zhytet në lexim. Ky libër duket sikur i vë balsam në zemër dhe i jep shpresë se, nganjëherë, zgjuarsia dhe integriteti mund të triumfojnë mbi dhunën dhe idiotësinë. *Zgjuarsia*... Që prej disa kohësh, ai e kish kuptuar se ishte i zgjuar edhe pse notat e tij në shkollë ishin mesatare. Duhet thënë se në klasën e tij nuk para i kanë shumë qejf ata që marrin nota shumë të mira. Madje kësaj kategorie ua thyejnë turinjtë në pushimin e madh. Në këtë mënyrë ai ka vendosur të fshehë aftësitë e tij, të bëjë sikur edhe ai ndjek turmën dhe mundohet të marrë kulturë vetë, pa rënë në sy dhe pa u ndjerë.

Papritmas dëgjon një zhurmë të shurdhër në klasë që përsëritej. I shqetësuar ai ngre kokën. Të jenë kanalizimet? Të jetë ndonjë mi? Zhurma vjen nga vendi ku profesori stivon materialin e pikturës dhe të vizatimit. I gozhduar në mes frikës

dhe kureshtjes, Marku ngurron disa sekonda para se të tërheqë derën. Aty sheh një djalë të moshës së tij, i rrasur në fund të dollapit e i dërrmuar.

Gjithë frikë, djali del nga vrima ku qe futur dhe nxiton të iki me vrap drejt daljes. Këtu gjithnjë mbretëron frika dhe, para se njerëzit të flasin me njëri-tjetrin, e kanë më të lehtë të të gjuajnë me grusht. Megjithatë, me të mbërritur te dera, ai kthehet për një çast, dhe të dy shohin njëri-tjetrin me habi.

- Çfarë bën aty ti? - e pyet Marku.

Edhe pse nuk i ka folur kurrë më parë, Marku e njeh për fytyrë djalin tjetër. Një djalë i çuditshëm dhe i vetmuar, me pamjen e një jashtëtokësori. Madje, ai sikur i di edhe emrin, ai quhet Konor.

- Po flija, - u përgjigj tjetri.

Ky është një lloj Hakëlberi Fini, versioni i fundshekullit. Flokët i ka të hapërdarë, është i dobët, i veshur me rroba të pista dhe shumë i vogël nga trupi për moshën që ka.

Ndërkohë që Konori po largohej, Marku e pyet sërish:

- A ke uri?

Me intuitë Marku e kupton se çfarë e preokupon tjetrin.

- Pak, - pohon Konori, duke bërë një pushim të vogël. Në fakt ai nuk ka ngrënë gjë që dje në mëngjes. Familja që e strehon ia ka nxirë jetën. Poshtërime, fyerje, dhe mungesa në shumë gjëra, me pretekstin sepse ai "duhet të përgatitet për jetën".

Por ai e njeh shumë mirë jetën. I braktisur nga prindërit që kur lindi, i endur nga një familje në tjetrën, ai i ka provuar dhe përjetuar të gjitha. Por poshtërimet bien mbi të pa e cënuar atë. Për t'u mbrojtur, ishtë mësuar të fshihej në botën e tij, çelësin e së cilës e ka vetëm ai.

- Merre, - i thotë Marku, duke i dhënë gjysmën e sanduiçit.

I befasuar nga ky veprim, Konori ngurron për një çast. Fakti që ka qenë i privuar nga dashuria e nga ngrohtësia e njerëzve, e ka bërë që të jetë mosbesues ndaj gjithçkaje.

Konori e ngul shikimin në atë të Markut dhe diçka ndodh. Një mirënjohje e heshtur, premtimi i një miqësie. Konori merr gjysmën e sanduiçit dhe ulet pranë Markut, me shpinë nga muri.

Dhe për një çast, ata e ndjenin veten fëmijë si gjithë të tjerët.

* * *

1982, 1983, 1984...
Për jetë, a vdekje...

Marku dhe Konori takohen tani çdo mbrëmje në po këtë vend. Jashtë është kaos, drogë, makina që digjen, gangsterët që vrasin njëri-tjetrin dhe armët që kalojnë nga një dorë te tjetra. Dy shokët kanë krijuar një qoshk qetësie dhe nuk jetojnë më me frikë në zemër. Me kalimin e javëve, të muajve, ata e njohin më mirë njëri-tjetrin dhe besimi midis tyre shtohet.

Marku është intuitiv, këmbëngulës dhe energjik, por është gjithashtu më i brishtë dhe më i influencueshëm.

Konori është i qetë dhe racional. Por shumë i ndrojtur dhe që tani është i shqetësuar nga kërkimi drejt absolutes.

Të dy bashkë kanë vendosur të bashkohen pavarësisht karaktereve dhe kundërshtive mes tyre.

Detyrat i bëjnë bashkë, lexojnë libra, dëgjojnë muzikë dhe shpesh qeshin.

Për herë të parë në jetën e tyre, ata zbulojnë se jeta nuk është vetëm vuajtje dhe vetmi.

Për herë të parë në jetën e tyre, ata konstatojnë se marrëdhëniet njerëzore nuk janë thjesht vetëm raporte force.

Secili prej tyre do të gjejë tek tjetri një siguri afektive, besim dhe forcë.

Bindja, se çfarëdo që të ndodhë, ata do kishin gjithmonë mbështetjen e njëri-tjetrit, sa vjen e forcohet tek ata.

Ata tani kanë forcën për të mos e lënë veten e tyre të shkatërrohen.

* * *

Shkurt 1984

Në Çikago ora është 6 e mëngjesit dhe tashmë qielli fillon të marrë ngjyrën blu. Siç ndodh shpesh Konori zgjohet nga të ftohtit. Ai fle në sallën e ngrënies, mbi një dyshek të vendosur në dysheme, pa çarçafë. Ngrihet, shkon në kuzhinë, lan fytyrën shpejt e shpejt në lavapjatë dhe largohet nga apartamenti para se të tjerët të zgjohen. Qyteti është i ftohtë si kristal. Logjika ta thotë që për të shkuar në shkollë ai duhet të merrte metronë pranë shtëpisë së tij, por stacioni është mbyllur me pretekstin për të kufizuar kriminalitetin. Kjo është një nga specifikat e *Greenwoodit*, ku autobusët qarkullojnë vetëm kur kanë policë në ta.

Kështu Konori i përshkon rrugët në këmbë, duke mbledhur rrugës kanoçe alumini të cilat do t'i shesë më vonë për disa *qindarka*. Në mbrëmje, me shokë të tjerë të moshës së tij, i ndodh të shkojë nganjëherë nga benzinatat e *South Side*, që t'iu

shërbejnë klientëve në mbushjen e makinave me karburant, të pastrojnë makinat ose të fshijnë xhamin përpara për të fituar ndonjë dollar.

Me kalimin e kohës, mësoi se si funksiononin gjërat në lagjen e tij, si funksiononte dhuna, padrejtësia si dhe rregullat e fshehta të zbatueshme e të pa shkruara. Por gjërat mund t'i njohësh pa qenë nevoja t'i përdorësh.

Kur Konori mbërrin në rrugën 61, dielli sapo lind dhe lëshon rrezet e tij në *Hyde Park*. Ky është një vend i çuditshëm. Je gjithmonë në geto, por universiteti prestigjioz i Çikagos ndodhet aty, fare pranë, me vitet shkollore me 30.000 dollarë dhe me studentët që rrjedhin prej familjeve të mëdha. Getoja dhe universiteti, bota e tretë dhe "tempulli i dijes", të ndarë vetëm nga disa kabllo...

Sa herë që kalon këtej, Konori shikon drejt Perëndimit, në drejtim të kampusit. Përse jeta është kaq e ndryshme në të dy anët e ndarjes? Një jetë kaq e rregullt për disa dhe kaq e vështirë për disa të tjerë? A ka kuptim e gjithë kjo? A ka ndonjë logjikë të çfarëdoshme apo edhe një Zot që duket sikur do të na vërë në provë?

Konori nuk di asgjë për këtë gjë. Ai di vetëm një gjë se ka forcë në vetvete për të "kaluar në anën tjetër".

Dhe një ditë, bashkë me Markun ata do të largohen nga kjo lagje.

Po ku do të shkojnë?

Çfarë do të bëjnë?

Ideja është akoma e paqartë në kokën e tyre, por ajo po ravijëzohet. Të ndihmojnë njerëzit të cilët janë në të njëjtën gjendje si ata.

* * *

Gusht 1986
Marku dhe Konori janë të dy 14 vjeç

- Njëzet pikë barazi!

Marku dhe Konori janë duke luajtur në një fushë basketbolli nën një vapë përvëluese. Gjymtyrët e tyre shkëlqejnë nga djersa dhe ata po luajnë me pasion. Aty pranë kanë një radiokasetofon me altoparlantë të rrjepur nga ku dëgjohet *Living America*, disku i fundit i Xhejms Braunit.

Konori e ka topin në duar dhe tenton të bëjë një kosh të vështirë. Topi përplaset në rrethin metalik, nguron për një çast por nuk bëhet kosh. Marku e merr topin dhe me një gjuajtje akrobatike e fiton ndeshjen duke kërcyer një *Sioux* për të ngacmuar shokun e tij.

- Të lashë vetë të fitoje! - pretendon Konori.

- Po pra! E pe gjuajtjen e fundit që bëra? Njëlloj si Mexhik Xhonson!

Të lodhur, të dy djemtë ulen pranë njëri-tjetrit me shpinë nga rrjeta e fushës. Një shishe *Coca-Cola* e ngrohur kalon sa nga një dorë te tjetra.

Pasi pushojnë pak në heshtje, biseda kalon te tema e tyre e preferuar. Si t'ia bënin për t'u larguar prej getos?

Që prej disa kohësh, kjo është bërë vërtet një obsesion për të dy. Në *South Side*, nuk ka të ardhme, nuk ka perspektivë. E vetmja ambicie realiste është se si të mbijetosh ose të ikësh.

Marku dhe Konori ëndërrojnë të fitojnë një bursë për t'u futur në kolegjet *e Down Town*-it. Ata kanë nota të mira, por ato janë të pamjaftueshme që të harrohet reputacioni i ulët i shkollës së tyre.

Shumë shpejt ata e kuptuan se zgjidhja duhet të vinte vetëm nga ata vetë dhe se nuk kishin se çfarë të prisnin nga të tjerët, qoftë edhe shkolla. Por për t'u larguar që këtu, duheshin pará, shumë pará. Dhe i vetmi aktivitet për të bërë pará ishte droga.

Në këtë lagje, paraja ishte kudo. Pushteti, biznesi, marrëdhëniet sociale, të gjitha vareshin nga tregtia e drogës. Ajo nuk kursente asnjë njeri. Të gjithë kanë të paktën një njeri në rrethin e tyre familjar, një mik, një bashkëshort, konsumator apo shitës droge. Droga ka gjithmonë të pranishme me vete të katër kavalierët e saj të Apokalipsit: dhunën, frikën, sëmundjen dhe vdekjen. Disa policë madje janë të përfshirë aktivisht në këtë lloj tregtie duke mbajtur për vete një pjesë të dozave të kapura për t'i konsumuar ata vetë ose për t'i rishitur përsëri në treg.

Marku dhe Konori e dinë se një shitës droge i suksesshëm fiton disa dhjetëra mijë dollarë në javë. Duke punuar për ta, disa nga shokët e tyre kanë filluar të mos vijnë më në shkollë, duke preferuar të bëheshin pjesëtarë të një grupi gangsterësh dhe të merrnin pjesë në këtë biznes fitimprurës. Dhe kështu, natyrshëm një ide iu shkrep në kokë:

- Përse të mos bëjmë edhe ne të njëjtën gjë? - tha Marku.

- Të njëjtën gjë, çfarë? - pyet Konori duke fërkuar vetullat me dorë.

- Ti e di shumë mirë se përse e kam fjalën. Ne jemi të zgjuar dhe të shkathët. Mund të përfitojmë edhe ne nga sistemi. Jargo na ka propozuar të punojmë për të. A e di se sa fiton ai në javë?

Konori nervozohet:

- Nuk më pëlqen që të fus hundët në drogë.

- Unë them të shesim, jo të jemi përdorues. Sikur të arrijmë të punojmë mirë për pak kohë, mund të mblidhnin ca pará për të bërë studime. Dhe kjo është për një arsye të drejtë.

- Nuk mendoj se është ide e mirë.

- Nuk jemi as të parët e as të fundit! A e di ti se çfarë bënte baba Kenedi, gjatë *Prohibicionit*? Ai importonte ilegalisht alkool. Kështu u bë i pasur. Në sajë të tij i biri u bë president dhe në sajë të kësaj ne fituam të drejtat civile!

- I bëre lëmsh të gjitha!

Tani është Marku ai që merr flakë:

- Më gjej një mënyrë tjetër që ne të dalim nga kjo gjendje! Çfarë mundësie tjetër kemi ne për të bërë studime? Nëse nuk ikim që këtu për dhjetë vjet do jemi ose në burg ose në varreza!

- Epo unë nuk kam ndonjë zgjidhje magjike, - pranon Konori, - por nëse ne heqim dorë nga...

Zëri i tij menjëherë meket, sepse ai është shumë i ndrojtur. Kapërcen pështymën pastaj e përfundon fjalinë duke e parë shokun e vet drejt e në sy:

- ... nëse heqim dorë nga vlerat tona, ne do të heqim dorë nga gjithçka.

Marku do të thotë diçka, por, në vend që të përgjigjet, shtrëngon grushtet, kthehet nga rrjeta e telit dhe e godet atë me të gjitha forcat.

I mbushur me zemërim dhe me turp, nuk e do veten që e shprehu këtë mendim.

Duke e kuptuar dhimbjen e tij, Konori i vë dorën në sup.

- Mos e vrit mendjen, - e siguron, i bindur në atë që thotë, - do ta shohësh që një ditë, edhe ne do të kapim shansin tonë. Nuk e di se si, por të betohem se do t'ia dalim mbanë.

* * *

13 tetor 1987
Ora 19 e 36 minuta

I ulur këmbëkryq, me një libër sipër gjunjëve, me duart te veshët, Konori po mundohet të harrojë kaosin që e ka mbërthyer. Por është e pamundur. Nuk arrin të përqendrohet! Ka shumë zhurmë. Televizori është ngritur me zë të lartë në sallon ku askush nuk e dëgjon e askush nuk e fik, muzika nëpër dhoma, britmat e kalamajve që zihen e shahen. Nuk ka asnjë vend të qetë. Klasa që ai përdorte më parë me Markun nuk ishte më në dispozicion të tyre dhe nuk mund të shkonin, qëkur një roje nate më i zellshëm se sa duhet, nuk i linte më të hynin.

Duke mos ditur se çfarë të bëjë, Konori del nga apartamenti duke përplasur derën. Ai shkon në kafazin e shkallëve, por nuk qëndron shumë. E di që ky është një vend që frekuentohet shpesh nga shitësit e drogës. Përfundimisht ai dështon në lokalin e kazanëve të plehrave ku janë vendosur rresht disa kontenierë metalikë. Ambienti është i ftohtë dhe i errët. Konori i kontrollon me imtësi të gjithë kontenierët me plehra, dhe më në fund gjen vend në njërin prej tyre, ku nuk mbante dhe aq erë e keqe. Duke psherëtirë, hap librin dhe nxjerr stilolapsin nga xhepi. Është vërtet diçka e rrallë të jesh i detyruar të bësh detyrat në një kazan plehrash, por Konori është betuar të mos dorëzohet dhe të mos heqë dorë nga ideja e kryerjes së studimeve. Kush e di, mbase një ditë fati mund të kthehej në anën e tij...

Konori është mbërthyer i tëri pas një libri që ia ka këshilluar

një profesor: *Një histori popullore e Shteteve të Bashkuara*, e shkruar nga Hauard Zin. Ai është një panoramë e gjallë e historisë së SHBA-së duke marrë për bazë dëshmitë e popullsive të shtypura. Indianë, skllevër, dezertorë të Luftës së Pavarësisë, punëtorë të tekstileve. Një mënyrë për të treguar se historia ashtu siç është jetuar nga një popull ndryshon shumë nga versioni zyrtar i paraqitur në librat shkollorë.

I zhytur në leximin e tij, Konori nuk i ka dëgjuar hapat e atyre që po i afroheshin. Kur ngre kokën, e gjen veten të rrethuar nga dy kriminelë të lagjes që e shohin me përçmim:

- Hë more trim, kështu pra, po ju vjen rrotull plehrave?

Konori ngrihet menjëherë, por tashmë është shumë vonë. Dy rrugaçët e ngrenë peshë dhe e rrasin në kontenier.

- A e di ti se çfarë bëjmë ne me plehrat? - e pyet një zë sipër tij.

Konori mundohet të ngrihet dhe vë dorën në hundë. I ka plasur gjaku.

- Ne i djegim ato! - ulërin shitësi i drogës.

Konori ngre kokën në drejtim të agresorëve të tij dhe vë re që njëri nga ata ka një bidon me benzinë në dorë. S'ka kohë as të thërrasë dhe tashmë është spërkatur i gjithi me benzinë.

- A do zjarr? - i propozon njëri nga vrasësit duke ndezur një fije shkrepëse.

I llahtarisur, Konori beson akoma se ata duan vetëm sa ta trembin, edhe pse e di, se për këta lloj rrugaçësh, jeta e njeriut nuk ka asnjë vlerë.

Në fakt fija e shkrepëses së ndezur i hidhet direkt në trup dhe benzina merr flakë menjëherë. Konori sheh trupin t'i digjet si një fije pishe dhe se kapaku i kontenierit mbyllet mbi të.

Atij i zihet fryma, mundohet të bëjë diçka, të dalë nga ky

kafaz metalik. Më në fund kontejneri përmbyset dhe del jashtë, por trupi i tij është gjithnjë në flakë. I torturuar nga dhimbjet, vrapon në të gjitha drejtimet, mbërrin në oborrin e ndërtesës dhe zhgërryhet përtokë që t'i japë fund kësaj flake.

Pak nga pak pamje i errësohet.

Shansi u kthye për të. Por jo në drejtimin që ai donte.

Në të qindën e sekondës, e kupton që jeta e tij ka ndryshuar përgjithmonë dhe se nuk do të jetë më kurrë si më parë. E më pas bie në gjendje kome.

Ai është 15 vjeç.

Donte thjesht të bënte detyrat.

20

Marku dhe Konori
Flash backu i dytë

13 tetor 1987
Ora 21 e 18 minuta

Ambulanca me borinë e saj drithëruese ndalet në parkingun e urgjencave të *Chicago Presbyterian Hospital*. Pothuajse pa jetë, i shtrirë në një barelë, Konorin e lajnë menjëherë me ujë të vakët për të ftohur zonat e djegura.

Llokma rrobash të kalçifikuara i janë ngjitur në trup dhe duhet bërë një anestezi lokale për t'ia hequr pa dhimbje. Pasi e kanë intubuar, mjekët e urgjencës i bëjnë një perfuzion dhe e drejtojnë për nga shërbimi i djegieve të shkallës së fundit ku ai merret në ngarkim nga dr. Lorena Mekkormik.

Doktoresha bën vlerësimin e parë: është djegur pesëdhjetë për qind e sipërfaqes së trupit: të dy krahët, të dy duart, pjesa para toraksit, kanë plagë të padurueshme. Pjesa e poshtme e qafës dhe dora e djathtë janë prekur gjithashtu. Disa nga këto

djegie janë të thella dhe kërkojnë një pronostikim jetësor. Për fatin e tij të mirë, fytyra i ka shpëtuar.

Lorena dhe ekipi saj mjekësor e vënë atë në asistencë respiratore dhe në koma artificiale para se të fillojë trajtimin lokal me bazë oksigjenimi antiseptik dhe me pomadë antibakteriale. Pastaj djegiet mbështillen me kompresa sterile të cilat do të ndërrohen vazhdimisht gjatë gjithë natës në mënyrë që trupi të ketë një humiditet dhe një dezinfektim maksimal.

* * *

I transformuar në mumie, i mbushur me perfuzione, Konori po çlodh sytë e mbyllur, në kllapi të plotë këtu në spital. Tek koka e tij, Lorena Mekkormik e shikon në heshtje. Këtë moshë do të kishte edhe djali i saj.

Edhe pse e ka mbaruar prej kohësh orarin e punës, ajo nuk është larguar ende. Kjo botë, me këto ritme i duket gjithnjë e më e ashpër e armiqësore, çnjerëzore dhe barbare. Ajo sapo i ka mbushur të dyzetekatërtat dhe e di që ndofta nuk do të jetë kurrë nënë. Për shkak të karrierës së saj, të takimeve dashurore që ajo nuk i bëri dhe për shkak të kësaj frike të cilën ajo nuk mundi ta kapërcejë: ajo që e quante veten të pazonjën për të mbrojtur një fëmijë në një botë të çmendur.

Ajo është zhytur në kujtimet e saj kur kanatet e dyerve hapen dhe shfaqet një adoleshent i ndjekur nga një punonjës i sigurisë.

- Lërmëni ta shoh, është shoku im! - ulërin Marku ndërsa, punonjësi i shërbimit, një zezak trupmadh, tre herë më i madh nga ai, e mbërthen për zverku.

Lorena i ndan dhe e bind rojën ta lëshojë djaloshin.

- Është shoku im, - përsërit Marku duke u afruar te shtrati i Konorit.

- Ku janë prindërit e tij? - pyet Lorena. - A ia njeh?

- Ai nuk ka prindër.

Lorena i afrohet Markut.

- Unë jam dr. Mekkormik, - e sqaron ajo. - Unë jam marrë me mjekimin e tij.

- Do vdesë? - pyet Marku me lot në sy.

Lorena i afrohet edhe më Markut dhe shquan në shikimin e tij një lutje.

- Do të vdesë? - pyet sërish Marku. - Më thoni të vërtetën ju lutem.

- Gjendja e tij është shumë kritike... - pranon Lorena.

Por shumë shpejt ajo shton në një formë tjetër:

- ... por ekziston një mundësi.

Me një gjest të dorës, ajo e fton Markun të ulet në një karrige.

- Do të marrësh vesh të vërtetën? Atëherë më dëgjo: Miku yt ka djegur mbi pesëdhjetë për qind të të gjithë trupit. Për dy ditë ne do ta mbajmë në koma artificiale. Kjo do të thotë që ne e kemi vënë në gjumë dhe ai nuk vuan. Ai është i ri dhe me shëndet të mirë, nuk ka djegie në sistemin e frymëmarrjes dhe nuk ka thithur gazra toksikë. Këto janë si të thuash lajmet e mira.

- Po ato të këqijat?

- Problemi është se këto plagë ka rrezik të infektohen. Kur lëkura është e djegur, ajo nuk na mbron dot më nga bakteret. Në këto kushte, trupi ynë nuk ka më mjete për t'u mbrojtur kundër sulmeve masive të mikrobeve. Kjo ka rrezik t'i ndodhë

edhe shokut tënd: një përkeqësim i plagëve ose një septicemi. Dhe kjo...

-... një infektim gjaku, e di, - e plotëson Marku.

- Pra do të na duhet të jemi të duruar dhe të lutemi shumë që çdo gjë të shkojë mirë.

- Unë nuk besoj te Zoti, - ndërhyn Marku. - Po ju besoni?

Lorena e shikon e shpërqendruar.

-Unë... As vetë nuk e di.

-Dua të besoj te ju, - thotë Marku. Shpëtojeni ju lutem!

* * *

Në kokën e Konorit
Midis jetës...
...dhe vdekjes

Po fluturoj.
Jo, po bie.
Një rënie e lirë drejt qiellit që zgjat pafundësisht.
Jam i lehtë. Ngrihem. Rrëshqas në një tapet prej pambuku.
Po notoj në një lumë drite.
Ndihem mirë.
Shoh gjithçka. Kuptoj gjithçka.
Që gjithçka është e shkruar.
Që gjithçka ka një kuptim: E mira. E keqja. Dhimbja...
Ndihem mirë.
Por e di që kjo nuk do të vazhdojë gjatë.
Dhe e di që do të harroj gjithçka.

* * *

15 tetor 1987

Tashmë që periudha kritike e orëve të para ka kaluar, Lorena Mekkormik mundohet të heqë sa më shpejt të gjitha indet e nekrotizuar. Lëkura e Konorit duket sikur është pastruar. Një shtresë e granuluar dhe me kore i ka zënë vendin zonavę që rridhnin gjak. Është akoma e vështirë të vlerësosh në mënyrë të besueshme thellësinë e këtyre plagëve. Për çastin, gjendja e tij klinike është e qëndrueshme, por rreziqet e infektimit dhe të frymëmarrjes janë akoma të konsiderueshëm.

Me bisturinë e saj, Lorena vazhdon të bëjë çarje të vogla për drenim në toraks dhe në qafën e adoleshentit për të dekomprimuar qarkullimin lokal dhe të evitojë thellimin e djegieve. Pastaj ajo merr ekuivalentin e dy centimetrave katrore të lëkurës në pjesën e poshtme të mollaqeve të Konorit. Ajo do ta dërgojë këtë mostër në laboratorin e Bostonit, i cili, që prej dy vjetësh, ka zbuluar një metodë që të jep mundësi që të kultivohen celula nga një pjesë shumë e vogël e lëkurës. Teknika është akoma eksperimentale, por Lorena do ta provojë. Edhe pse e di se mjekimi do vite të tëra për t'u kryer dhe se pasojat janë të rëndësishme.

Ndërkohë, ajo vendos të pakësojë dozën e sedativëve me qëllim që Konori të jetë dalëngadalë i ndërgjegjshëm.

* * *

Në kokën e Konorit
Midis jetës...
...dhe vdekjes

Vazhdoj të fluturoj, por më ngadalë, më me pak vrull.
Pak nga pak, trupi im bëhet i rëndë si plumb.
Zbres nga lartësitë për të rigjetur ndjesitë e mija njerëzore.
Përsëri kam frikë. Nga vuajtjet. Nga vdekja.
Rreth e rrotull meje, retë e humbasin bardhësinë e tyre,
Për t'u shndërruar në një avull të purpurt, përvëlues
Asfiksues.
Kam dhimbje gjithandej. Po digjem.
Tashmë gjithçka është e kuqe, çdo gjë është llavë, çdo gjë është shkrirje.
Çdo gjë është e trishtueshme.
Fundi i udhëtimit. Unë hap sytë dhe...

* * *

16 tetor 1987

Kur Konori hap sytë, ai është në reanimacionin e madh dhe plot dritë të shërbimit të djegieve të rënda. Një zhurmë e shurdhër dhe e paqartë i vërtitet në kokë. Mundohet të bëjë një lëvizje, por shumë shpejt e kupton se kjo nuk është një ide e mirë. Pastaj ul kokën dhe sheh që gjithë trupin e ka të fashuar. Papritmas i vjen në mendje kujtimi i dramës që i ka ndodhur dhe tmerrohet.

- Përshëndetje plako, - i thotë Marku i mallëngjyer.

- Mirëserdhe Konor, - e përshëndet edhe Lorena. - Si e ndjen veten?

Djaloshi e shikon atë, hap gojën, pa qenë në gjendje të përgjigjet.

- Mos u shqetëso, - e siguron Marku, - po merremi me ty.

* * *

17 tetor 1987

E ndihmuar nga një ndihmësmjeke, Lorena po i heq një nga fashimet që i mbulojnë toraksin pacientit të saj të ri. Është vetë Konori që kërkoi "të shihte" veten e tij. Dhe ajo që sheh e dëshpëron pa masë. Nëse më parë kishte se çfarë të tregonte duke luajtur rolin e mashkullit, tashmë këto janë zhdukur sapo ai vuri re plagët e tij. Ato i japin përshtypjen se është kthyer në një përbindësh, një lloj *Elephant Man* i kalbëzuar. Ka dëshirë të qajë. Nuk sheh asnjë rrugëdalje. Si mund të shërohej nga e gjithë kjo?

- Është normale që ti të trembesh nga kjo që sheh, - i thotë Lorena duke e parë drejt e në sy.

Konori nuk e di se çfarë të mendojë për këtë grua mjeke. Ajo ka një natyrë të drejtëpërdrejtë dhe e ka shumë kollaj t'i thotë gjërat troç. Por Marku duket se ka besim tek ajo. *Është dora jonë,* - i kish thënë Marku për ta qetësuar.

- Të ta shpjegoj, - thotë Lorena, duke u ulur pranë tij. - Kemi bërë transplant të lëkurës me origjinë shtazore në plagët e tua më të thella.

- Lëkurë kafshësh?

- Po. Lëkurë derri, kjo është një praktikë e kohës. Aftësitë e tua imunitare mbrojtëse do ta nxjerrin jashtë, por për njëfarë kohe, kjo lëkurë do të shërbejë si fashim biologjik për të shmangur infeksionin.

- Po pastaj?

- Pastaj do të tentojmë të bëjmë transplant me lëkurë njerëzore.

- E nga do ta gjeni këtë lëkurë?

- Lëkurën tënde. Kjo quhet autotransplant. Me një brisk unë do të marr një pjesë të sipërfaqes së lëkurës tënde në pjesët e tjera të trupit që nuk janë djegur. Pastaj do të bëj transplant te pjesët e djegura.

- Por kjo nuk do të mjaftojë! - lebetitet Konori. - Unë jam djegur gjithandej!

- Duhet të kesh besim te unë, - i thotë Lorena.

- Si të kem besim te ju kur ju nuk më thoni të vërtetën?

- Ke të drejtë, - pranon mjekja, - nuk do të mjaftojë. Për këtë arsye unë kam dërguar një mostër të qelizave të tua në një laborator në Boston i cili do t'i zhvillojë për të pasur sipërfaqe të mjaftueshme nga lëkura jote. E kupton?

- Kuptoj që unë do të vdes.

* * *

Nëntor 1987

Kryhet transplanti i parë.

Dhimbje e paparë që përballohet vetëm me qetësues.

Krahu i djathtë i Konorit është bllokuar në një shpatull, ndërsa qafa i është fiksuar në një minervë.

Marku vjen çdo ditë tek Konori në spital. Ai vjen dhe i lexon *Konti i Monte Kristos* të Aleksandër Dymasë. Hakmarrja e pamëshirshme e një njeriu, viktimë e një padrejtësie dhe i dënuar me 15 vjet burg.

Hakmarrja e pamëshirshme...

* * *

Krishtlindje 1987

Konori është dobësuar aq shumë sa të shtie frikën kur e shikon.

- A mund të humbasë njeriu 15 kilogram në dy muaj?

Lorena i shpjegon se, pavarësisht nga marrja e kalorive të nevojshme, personat me djegie të rënda kanë një katabolizëm intensiv që e stërlodh organizmin dhe e bën më të ndjeshëm ndaj infeksioneve.

Dorën e djathtë e ka plotësisht të fashuar.

Më 25 dhjetor, atij i duhet t'i heqin një falangë.

Gëzuar Krishtlindjet!

* * *

Janar 1988

Që nga aksidenti, policët kanë ardhur vetëm një herë për ta pyetur. U tregoi gjithçka dinte. U dha edhe emrat, edhe adresat e tyre, por asgjë e re.

Marku, ndërkohë e ka bërë hetimin e tij. Dy shitësit e drogës lëvizin lirisht nëpër lagje, pa u fshehur e pa pasur frikë fare.

* * *

Në mendjen e Konorit fillon të kristalizohet një mendim. Ai i një hakmarrjeje të pamëshirshme.

* * *

Shkurt 1988

Ka vende ku transplanti nuk realizohet.
Mishi është akoma i gjallë.
Duhet filluar nga fillimi.

* * *

Duke qenë se krahu i djathtë ishte i pamanovrueshëm, atij i duhet të ushtrohet me dorën e majtë për të shkruar.

Për t'u ushtruar, ai vizaton me orë të tëra skica dhe portrete.

Vizaton gjithmonë të njëjtën fytyrë. Është një fytyrë që e qetëson. Një fytyrë femërore që nuk dihet se nga ka mbirë.

Një grua të cilën ai nuk e njeh akoma...

* * *

Pranverë -Verë 1988

Transplantet ia lënë vendin transplanteve dhe pak nga pak, lëkura rindërtohet për t'ia lënë vendin ndërthurjes së çikatricave të cilat duhen shtrydhur me ndihmën e një indi elastik.

Ka disa kohë që ai ka filluar studimet e tij, një mësim me korrespondencë që jepej për të rinjtë në mjediset spitalore. Nuk ka hequr dorë nga të mësuarit. Kjo është e vetmja gjë që e ngushëllon, përjashto këtu praninë e Markut.

* * *

Vjeshtë 1988

Dhimbjet e këmbëve e detyrojnë akoma të rrijë shtrirë.

Ka më se një vit të tërë që po fermentohet me tërbimin e tij të llahtarshëm.

Nuk kalon as edhe një ditë pa dhimbje.

Nuk ka as edhe një natë pa makthe.

Vetëm një gjë është e sigurt: nga një udhëtim i tillë nuk del dot pa pasoja.

Nuk dilet më i mirë.

Nuk dilet më i fortë.

* * *

Dhjetor 1988

Është mëngjesi i Krishtlindjeve.

Lorena Mekkormik hap derën e dhomës së Konorit. Që prej 14 muajsh, është dita e parë që krevati i tij është bosh. Një natë më parë djaloshi është transferuar në një qendër riedukimi të gjymtyrëve në anën tjetër të qytetit, por nuk është Lorena që e ka firmosur daljen e tij.

Ajo qëndron aty për disa minuta pa lëvizur, nën dritën e

ftohtë në blu që pushton dhomën. Nganjëherë, kur ndonjë prej pacientëve të saj largohet nga pavijoni, ajo ndjen një si boshllëk të madh. Në mënyrë të veçantë, në një rast si sot. Nën jastëk, Konori ka lënë një zarf në adresë të saj. Në zarf ai kishte shkruar fillimisht "Dr. Mekkormik", pastaj e kish fshirë këtë formulë shumë solemne për të shkruar thjesht:

Lorena

Lorena e futi në xhepin e përparëses. Ajo do ta hapë më vonë, kur të shkojë në shtëpi.

Sirtari i komodinës është i mbushur plot me fletë vizatimi. Lorena i shikon me vëmendje. Me dhjetëra vizatime që paraqesin të njëjtën fytyrë, atë të një gruaje të re që ajo nuk e njeh.

Lorena rri për një kohë të gjatë e përhumbur mbi këto vizatime.

Pastaj ajo vendos që t'i vërë bashkë me dosjen mjekësore të Konorit.

Ndoshta, ndonjë ditë do të mund të dijë më shumë.

* * *

Qershor 1989

Konori merr diplomën e përfundimit të shkollës së mesme.

Ai largohet nga qendra e riedukimit dhe shkon në një shtëpi për të rinj.

Për gjashtë muaj, i duhet të kryejë seancat e terapisë kineze dhe të masazhit për të rifituar lëvizshmërinë e gjymtyrëve.

Qafa dhe toraksi janë të kuq dhe blu. Plagët që po përthahen nuk e lejojnë të bëjë shumë lëvizje, por ai është mësuar tashmë të bëjë një numër lëvizjesh të thjeshta: të ecë, të ushqehet, të ulet, të shkruajë...

Por blana të tjera, edhe pse të padukshme e therin në shpirt dhe e bëjnë të vuajë në një mënyrë tjetër.

* * *

Për herë të parë, pas një viti e gjysmë ai del në rrugë dhe ka frikë nga gjithçka: nga makinat, njerëzit, nga jeta... Një zhurmë e vogël e bën të dridhet. Çdo gjë po ndodh shumë shpejt për të. Gjithçka nuk do të thotë agresion.

Për të pushuar dhimbjen bind veten se ka vetëm një mënyrë për ta bërë këtë: I duhet një hakmarrje e pamëshirshme.

* * *

Tetor 1989

Nuk iu desh shumë kohë për t'i gjetur dy shitësit e drogës. Ata janë vendosur në një ndërtesë të braktisur, prapa hekurudhës. Për ditë të tëra me radhë, Konori i ndjek dhe shënon çdo lëvizje të tyre dhe mbledh të dhëna për ta. Në dy vjet, ata kanë fituar mirë. Nuk janë më thjesht dy shitës të një zone të vogël, por janë bërë kaidë të vërtetë që kontrollojnë një pjesë të mirë të shpërndarjes së heroinës në lagjen e jugut. Meqë ata rrallë herë lëvizin vetëm, Konori e ka zgjedhur çastin për të vepruar. Dhe ky çast është pikërisht sonte.

Ai i pa të dy njerëzit që sapo dolën nga bari dhe vuri re që

ishin të dehur. Në parking, ata u futën në makinë, një Mustang i vjetër, ngjyrë ndryshku. I la të ecin përpara dhe preferoi ta bëjë këtë pjesë rruge në këmbë për të ndjerë edhe më shumë dhimbjet që i shkaktonin akoma plagët e pashëruara plotësisht.

Pas pak gjendet para ndërtesës së rrënuar, ora është dy e mëngjesit. Konori futet në hollin e errët ku të gjitha kutitë postare janë shkulur. Po në errësirë ai ngjit shkallët. Nuk ka fare frikë. Tani është para derës që lëkundet nga muzika shumë lart e vendosur aty brenda. Me një shkelm thyen derën, një veprim ky që e ka përsëritur me qindra herë në programin e riedukimit të gjymtyrëve.

Të ulur në një kanape të vjetër, dy tipat shtangen në vend. Ata janë të dehur e të droguar plotësisht. Konori ecën nëpër dhomë. Është një apartament i rrënuar, i zhytur në një ngjyrë si në të verdhë në të gjelbër. Mbi një arkë që shërbente si tavolinë kishte shiringa, një qese me pudër dhe një pistoletë me dorezë argjendi ishte vendosur mbi një valixhe të hapur, plot me dollarë.

Një nga shitësit zgjat dorën për të marrë armën, por është shumë vonë. Konori, me një goditje me shkelm e largon tavolinën tutje. Dhe është Konori që e merr revolverin në dorë.

E drejton armën në drejtim të tyre, gati për të qëlluar.

Dy shitësit shohin njëri-tjetrin dhe tundin kokat.

- Kush mutin je ti? - pyet njëri prej tyre.

- Kush jam unë?...

Konorit i hipin xhindet. Këtë skenë, e ka realizuar me dhjetëra herë në kokën e tij, por asnjëherë nuk i kishte shkuar ndërmend që armiqtë e tij nuk do ta njihnin.

Ai fut dorën në njërin xhep të xhupit dhe nxjerr dy palë pranga që ia kish blerë pesë dollarë një polici.

- Lidhni njëri-tjetrin te radiatori! - i urdhëron Konori.

- Prit, le të merremi ve...

Një e shtënë ia preu fjalën në grykë shitësit që po fliste. Ai e vë dorën te gjuri dhe shikon që aty po rrjedh gjak.

- Lidhuni! - përsërit Konori.

Të dy gangsterët binden duke u lidhur me prangat pranë një radiatori prej gize që nuk punon prej shumë kohësh.

- *Kush jam unë?*

Ai heq xhakoventën dhe zbërthen këmishën.

Tashmë është lakuriq para atyre që e kanë gjymtuar në këtë mënyrë dhe po u tregon djegiet e tij, si në një ritual primitiv.

- Kush jam unë?

Nga sytë e dy gangsterëve kuptohet se ata nuk kanë marrë vesh akoma me kë kanë të bëjnë. Shikimet e tyre të çakërdisura zgurdullohen edhe më nga tmerri dhe habia.

Konori del në korridor, merr bidonin e benzinës që e kish marrë me vete dhe kthehet te ata.

- Kush jam unë?

Tashmë rolet janë ndërruar.

Viktima bëhet xhelat dhe xhelati bëhet viktimë.

E mira bëhet e keqe dhe e keqja bëhet e mirë.

- Kush jam unë? - pyet veten ai duke hedhur benzinën mbi trupat e tyre.

Ata ulërijnë por ai nuk ua vë veshin. Në kokën e tij dëgjohen të tjera britma të cilat ushtojnë si një jehonë:

"Hë, ndyrësisë, po vjen rrotull sipër plehrave? A e di ti se çfarë bëjmë ne me plehrat? Ne i djegim ato!"

- Kush jam unë? - thotë Konori duke ndezur një fije shkrepëse.

Në çastin kur flaka merr, Konori mendon për atë që ai i kish thënë dikur Markut: Nëse ne heqim dorë nga vlerat tona, kemi hequr dorë nga gjithçka.

* * *

E njëjta natë
Ora 5 e mëngjesit

Një Mustang ngjyrë ndryshku u parkua përgjatë trotuarit, pranë një shkolle publike.

Konori zbret nga vetura, merr një grumbull zhavorri dhe i hedh në drejtim të njërës prej dritareve të apartamentit të rojës.

Pas pak sekondash, në dritare, shfaqet koka e Markut.

- Ç' dreqin bën aty në këtë orë? - pyet Marku.

- Vishu Mark. Merr portofolin dhe dokumentet e tua.

- Pse?

- Mos e zgjat.

Pesë minuta më vonë Marku është bashkë me Konorin.

- Më thuaj, çfarë ka bërë vaki? - pyet Marku. - Je prishur në fytyrë.

- Hip në makinë, - e urdhëron Konori duke i treguar Mustangun.

- E kujt është kjo rrangalle?

- Lëri fjalët, nxito. Ta shpjegoj rrugës.

Konori merr timonin dhe niset për në drejtim të *Loop*-it. Pasi kanë kaluar nja 5 minuta, ai kthehet nga Marku dhe e pyet:

- A të kujtohet se çfarë të thosha: se një ditë ti do të kesh

shansin për të ikur që këtu e për të vazhduar studimet?

- Natyrisht që më kujtohet.

- Ja pra, shansi yt, është sonte plako, - i thotë Konori duke i treguar valixhen metalike të cilën ua kishte marrë dy gangsterëve.

Marku hap valixhen dhe lëshon një fërshëllimë habie.

- Nga vijnë gjithë këto pará?!

- Por...

- Dëgjomë, nuk kemi shumë kohë, kështu që mos na i kompliko gjërat.

Konori fut dorën në xhep, nxjerr dhe i jep një biletë treni.

- Po të çoj në *Grand Central*. Ka një tren për në Nju Jork në orën 6 e 15 minuta. Merri paratë me vete dhe mos u kthe më kurrë këtu. Më kuptove?

- Po ti kur do të vish?

- Asnjëherë, - i përgjigjet fare qetë Konori dhe e fut makinën në parkingun nëntokësor të stacionit të trenit.

* * *

Ora 6 e mëngjesit

Të dy djemtë janë ulur pranë njëri-tjetrit në makinën e parkuar. Konori e mbaron tregimin e tij ndërsa Marku është komplet i trullosur e i hutuar.

- Tani duhet të ikësh, - thotë Konori duke kontrolluar orën. - Do të të iki treni.

- Po ti, çfarë do të bësh? - pyet Marku, akoma në gjendje shoku.

- Do shkoj të dorëzohem në polici, - thotë ai, duke dalë nga Mustangu.

Edhe Marku zbret dhe ndjek shokun e tij.

- Nuk iki pa ty!

- Lëri kalamallëqet tani! - nervozohet Konori. - Unë nuk kam se çfarë të bëj më. Për mua çdo gjë ka marrë fund! Kam lënë shenja gjithandej. Policët për dy orë do të më gjejnë.

- Nuk është e thënë, - thotë Marku, - flaka i fshin të gjitha gjurmët. Pastaj kujt i plasi për ata tipa, një përleshje midis bandash rivale, dhe kaq.

Të dy djemtë ndodhen te peroni i trenit. Edhe pse është akoma herët, udhëtarët janë të shumtë.

- Epo, - thotë Konori, paç fat miku im.

- Eja edhe ti! - i thotë Marku duke hipur në vagon. - Gjithmonë kemi thënë se do të iknim bashkë.

Ai do të shtojë diçka por fishkëllima e një bilbili ia mbyti zërin, sinjali që treni po nisej.

Nga peroni, Konori nuk e lë shokun e tij të rimarrë fjalën.

- Dëgjo Mark, duhet të jesh i fortë. Ti mund të fillosh një jetë të re, por jo unë. Është tepër vonë për mua. Nuk kam më nerva e fuqi. Unë tani nuk jam asgjë.

- Çdo gjë do kalojë, do të të ndihmoj unë! Të gjitha i kemi përballuar bashkë. Dhe kështu ia kemi dalë mbanë!

Shefi i stacionit kontrollon mbylljen e dyerve.

Konori bën disa hapa në peron. Papritmas, e gjithë frika e akumuluar u grumbullua tek ai. Filloi të dridhej dhe çdo gjë i ngatërrohej në kokë. Tingujt deformoheshin deri sa bëheshin të padëgjueshëm. Pas pak, pllakosi një heshtje e plotë. Atij i merren mendtë dhe shembet për tokë.

Ndërkohë Marku ka pasur kohë të zbresë nga treni dhe ndodhet tashmë në peron. Ai ulet pranë mikut të tij, e kap që poshtë krahut, dhe me të gjithë forcat e tij, e fut brenda në vagon.

Pas një fërshëllime të fundit, treni fillon të shkundet dhe niset duke kuisur.

* * *

Kur lokomotiva lë pas stacionin, u shfaqën rrezet e para të diellit. Marku pa nga dritarja. Një dritë ngjyrë purpuri dhe portokalli po çante nëpërmjet reve.

Ai do t'i kujtonte gjithë jetën ngjyrat e dritës të këtij mëngjesi.

Të këtij mëngjesi që ata u nisën të dy bashkë.

21

Më tej se retë

Ne jemi si kokrrat e arrës,
duhet që të thyhemi
për të kuptuar se kush jemi.
- KHALIL GIBRAN

Sot
Në avion
Ora 15.00

Diku larg.

Shumë larg, poshtë avionit, një shtresë e trashë resh e fshinte gjithë peizazhin, duke e izoluar edhe më tepër këtë avion Super Xhumbo nga toka e njerëzve.

Ndërsa Marku as vetë nuk e kuptonte se si kish arritur të rrëfehej kaq shumë. Ky udhëtim në fëmijërinë e tij kish bërë që ai të harronte, për çastin, tradhtinë e Nikolës dhe kjo i kish bërë mirë. Si të thuash, fakti që iu rrëfye dikujt sikur e bëri ta ndjente veten disi më të çliruar.

Duke i parë gjërat me qetësi, e vlerësonte më mirë rrugën që kish përshkuar. Në një interval kohor prej 15 vjetësh, dy bomba kishin shpërthyer, fillimisht e para në jetën e shokut të tij dhe e dyta në të tijën. Bomba e parë desh e shkatërroi Konorin përgjithmonë dhe e shndërroi në kriminel. Tjetra, - rrëmbimi i Lajlës, - e kishte zhytur Markun në një proces vetëshkatërrimi, duke e çuar deri në prag të vdekjes. Në të dy rastet, mbijetesa e tyre ka qenë në fije të perit: ka qenë shumë luftë dhe fare pak fat.

Evi e dëgjoi tregimin e Markut e mrekulluar. Vajza e re, gjente në fëmijërinë e Konorit një jehonë të jetës së saj. Kur ishte i ri, Konorit i ishte dashur të përballej me të njëjtat pyetje që Evi i bënte vetes sot: Si të përballosh dhimbjen? A është vallë hakmarrja mënyra më e mirë?

Ajo u përkul për nga dritarja dhe pati një ndjenjë të pafundësisë tek pa oqeanin dhe retë.

Kështu edhe ajo mbylli sytë dhe ra në mendime të thella...

22

Evi
Flash backu i katërt

Nju Jork
Nata e Krishtlindjeve 2006
Ora 2 e 30 e mëngjesit

Ajri ishte i akullt dhe i hidhur.

Me trup të ngrirë nga acari, Evi endej në mes të *Greenwich Village*. Ngaqë nuk kish ngrënë që nga mëngjesi, zorrët i kërcisnin. Muskujt dhe artikulacionet shkaktonin dhimbje dhe frymëmarrja e saj kthehej menjëherë në brymë. Ajo ndodhej që prej tre javësh në Nju Jork. Ato pak pará që kishte kishin shkrirë si dëbora në diell, dhe tani i kish mbetur vetëm një dollar në xhep. Në fillim kish gjetur strehë në një hotel të qelbur të Harlemit pastaj në një qendër në Amsterdam Avenue, ndërsa sonte nuk kishte se ku të flinte. I duhej të rezistonte të paktën për nja dhjetë ditë: kohë e nevojshme për të vrarë Kreg Devisin. Kish shkuar në spital ku punonte aktualisht vrasësi i

nënës së saj, por i kishin thënë që mjeku i kalonte festat e fundvitit me familjen e tij në Evropë. Parashikohej që ai të kthehej javën e parë të janarit. S'ka gjë. Evi do ta priste. *Hakmarrja është një pjatë që shërbehet e ftohtë...*

Në ndërtesat borgjeze që kish përreth, festës po i vinte fundi. Nga dritaret shkëputeshin copëza të ambienteve festive. Muzikë, të qeshura. Në Avenunë e 6-të ajo u gjend përballë një afisheje të ndriçuar ku shkruhej: *Lëreni të fryjë fryma e Krishtlindjeve!* Dhe më tej: *Sonte çdo gjë është e mundur!* Evi ngriti sytë nga qielli. Familja, traditat, ëndrrat, nuk bënin pjesë në jetën e përditshme të saj. Për sa i përket të ashtuquajturës *"frymë e Krishtlindjeve"*, kjo ishte një idiotësi që mund ta ndeshje vetëm në filmat e vjetër megjithëse nuk kish ekzistuar kurrë. Ose më saktë, ajo kish vdekur shumë kohë më parë për t'ia lënë vendin etheve të shfrenuara të konsumit.

Një Aston Martin, ngjyrë argjendi, akull e re e plot shkëlqim kaloi para saj dhe u ndal në semafor, disa metra më larg. Kur Evi ndali në krah të veturës, vuri re një çantë lëkure që ishte hedhur si pa kujdes në vendin e pasagjerit por dhe faktin se personi në timon, nuk i kish mbyllur automatikisht dyert e makinës. Vajza u ndal, pastaj bëri tre hapa mbrapa që të mos dukej. I përkulur në timon, një burrë që me sa duket nuk ishte fort në terezi po fërkonte qepallat. Evi heziton. Ajo s'kishte vjedhur asnjëherë më parë, por tani sepse i dukej e lehtë: të hapte derën, të merrte çantën dhe t'ia mbathte. Një makinë si kjo kushtonte një pasuri të tërë dhe çanta prej lëkure, e qepur me copën e famshme Monogram me inicialet LV (*Louis Witton*), me siguri që nuk mund të ishte një imitacion. Ishte e sigurt të vinte bast se brenda asaj çante duhet të ishin disa qindra dollarë. Pa llogaritur paratë që ajo do të fitonte nga

rishitja e çantës, nëse ia dilte mbanë. Të paktën me ato pará mund të jetonte dy javë, të mjaftueshme për të kryer hakmarrjen e saj.

Tipi në veturë po merrte celularin për t'iu përgjigjur një thirrjeje. Në më pak se një sekondë, Evi hap derën e makinës, merr çantën dhe ia mbath me të katra. Pasi ka bërë 5 metra kthehet duke u ngërdheshur. Kishte menduar se ai do të hiqte dorë shumë shpejt. Por, për fatin e saj të keq, ai ishte i ri dhe vraponte shpejt.

Maskara!

Vazhdonte të binte dëborë e rëndë dhe terreni ishte i rrëshqitshëm. Kur Evi e kuptoi që ai do ta kapte, tentoi gjithçka duke kaluar rrugën në mes të makinave duke rrezikuar që të shtypej prej tyre. Por asgjë nuk e ndali tjetrin, që e ndoqi dhe disa sekonda më vonë iu hodh sipër, duke e përplasur me forcë në tokën e shtruar nga dëbora. Koka e saj u përplas në trotuar, por goditja u zbut nga shtresa e dëborës.

- Ec e ma jep atë, gjënë time! - e urdhëroi burri duke i përdredhur dorën që pas shpine.

* * *

Ora 2 e 37 minuta

- Lëshomë! - ulëriti Evi, duke u munduar t'i shpëtonte nga duart.

Burri kish marrë çantën e vet, por gjithnjë po ia mbante të shtrënguar dorën. Pastaj e tërhoqi deri nën dritën e një llambe, gjë që i dha mundësi Evit ta shikonte më mirë. Ishte një burrë i madh, brun, i veshur klas, me forma elegante por me fytyrë

të lodhur. Sikur të mos ishte shikimi i rreptë dhe vetullat e ngrysura, që shprehnin shqetësimin e tij, shumë mirë nga pamja e jashtme mund të thuhej se sapo e kishin marrë nga katalogu i fundit i *Hugo Boss*-it.

Diku e kish takuar më parë këtë njeri.

Po ku?

- Si quheni?

- Ik pirdhu! - e fyeu ajo.

* * *

Ora 2 e 40 minuta

- Më dëgjo, unë jam mjek, mund të të gjej një vend ku të kalosh natën.

- Kështu pra, dashke të më shpëtosh?

- Dua të të ndihmoj.

- Nuk kam nevojë për ndihmën tënde.

* * *

Ora 2 e 42 minuta

- A do të të paguaj diçka të ngrohtë për të ngrënë?

* * *

Ora 2 e 43 minuta

- Unë po iki, nuk kam nevojë të më japësh diçka për të ngrënë.

* * *

Ora 3 e 01 minuta

E ulur në një stol prej lëkure sintetike, Evi mbaron së ngrëni hamburgerin duke parë nga xhami, burrin që po pi cigare jashtë. Ai pretendon se është mjek, po a është e vërtetë? Ai thotë që do ta ndihmonte, po a ishte i sinqertë? Ish mësuar të mos kishte besim por në fakt gjithçka në qëndrimin e tij e çarmatoste vajzën e re. Asaj do t'i pëlqente t'i besonte, por kish frikë se mos zhgënjehej.

- Hë, si t'u duk hamburgeri? - pyeti ai kur u kthye.

* * *

Ora 3 e 14 minuta

- Prit! - i tha ai që ajo të ndalej. - S'mund të ikësh kështu. Bën ftohtë dhe është e rrezikshme. Do mundohem të të gjej një strehë për sonte.

Ajo po e vështronte tek i afrohej. Mohoi me kokë pa denjuar as t'i përgjigjej.

- Të paktën, merr këtë, - e këshilloi ai, duke i futur në xhep kartëvizitën e tij. - Në qoftë se do të kesh nevojë...

Por Evi e dinte që kjo nuk do të ndodhte.

* * *

Ora 3 e 45 minuta

Ka një gjysmë ore që është larguar prej tij dhe që tani i vjen keq për atë që bëri. Ka aq ftohtë sa kockat e saj përplasen me njëra-tjetrën në trupin e brishtë. Migrena e kokës, armiku

i saj i betuar që në vogëli, po e shqetëson kaq shumë sa asaj i vjen për të vjellë dhe e detyron të ndalojë në mes të trotuarit, sepse nuk kish fuqi për të shkuar më tej.

Ajo i ka studiuar ndërtesat rreth e rrotull. Disa prej tyre kanë roje nate. Të tjerat, si kjo ku ajo gjendet përballë në këtë çast, nuk kanë roje por kanë nga një kod hyrjeje. Në shumë apartamente, shumica e të ftuarve mendojnë të kthehen në shtëpitë e tyre. Si do që të jetë kjo gjë po ndodh tani në 37, *Fenweet Street*, ku tre çifte të rregulluar mirë nga pija largohen nga ansambli *Paradisio Building*.

Evi u mban derën dhe në këtë rrëmujë, ajo arrin t'i bëjë ata të kujtojnë se banon aty. Bën sikur shtyp butonin e ashensorit dhe kur ata janë larguar paksa, mundohet të gjejë një qoshe ku mund të flejë për disa orë. Gjen një hapësirë, paksa e fshehur nga dera e hyrjes nga ku zbritet në bodrum. Nuk bën dhe aq ngrohtë, por është më mirë se asgjë. Mbështetet pas murit, mbështillet në pallton e saj dhe mbyll sytë, duke i lënë mendimet të shkojnë te ky burrë, meqë rruga e saj e çoi drejt tij. Që kur ai i foli, ndjeu një lloj familjariteti, sikur ta kish njohur që prej shumë kohësh. Asnjëherë ai nuk e përmendi emrin e tij, por Evi u kujtua se ai i kishte lënë kartëvizitën. Kontrollon në xhepa dhe e nxjerr. Megjithëse drita është e zbehtë, arrin të lexojë emrin e mjekut dhe papritmas ndihet e befasuar.

Ky burrë ishte Konor Mekkoi!

Evi tashmë ka brofur në këmbë. Ajo ndez dritat e shkallëve dhe nxjerr nga çanta librin që ka marrë një mbrëmje në një dhomë të hotelit *Oasis* në Las Vegas. Që nga ajo kohë, këtë libër e mban gjithnjë me vete, si një hajmali që do ta mbronte nga fati i keq.

Të mbijetosh
Nga Konor Mekkoi

Shikon fotografinë e tij në kopertinën e fundit të librit që i konfirmon identitetin e bashkëbiseduesit të saj të çuditshëm. Dhe tani e kupton përse portreti i tij ishte i njohur për të. Sa idiote! E kish lënë të ikte të vetmin person në botë që ëndërronte të takonte. - Shpejt! - i tha vetes. Mblodhi me shpejtësi gjërat e saj, kësaj here e bindur të shkonte ta takonte.

Ndërsa bëhet gati të dalë nga ndërtesa, vë re një veturë policie, me xhirofar, që ulërinte e shkëlqente nga drita. Makina parkohet pikërisht para kësaj ndërtese ku gjendej Evi. E kupton që policia ka ardhur për të. Banorët e ndërtesës me siguri kanë dëgjuar zhurmë dhe kanë lajmëruar policinë. Nga që është një lagje e privilegjuar policia nuk humbi kohë dhe u dërgoi menjëherë një patrullë.

Ndërkohë dy policë trupmëdhenj dhe të armatosur deri në dhëmbë dalin nga makina sikur do të arrestonin Bin Ladenin.

- Ja ku është! - thotë njëri prej tyre duke drejtuar projektorin në drejtim të saj.

Ata formojnë kodin e hyrjes dhe futen në ndërtesë, me dorën te revolja.

- Zonjushë, ecni drejt nesh, pa fjalë.

23

Fjalëkalimi

Njohja e sekreteve të tjetrit
është një pushtet dehës.
- MICHAEL CONNELLY

Sot
Në avion
Ora 16.00

Një pjesë e mirë e pasagjerëve të fluturimit 714 janë si të përgjumur dhe po tresin rizoton me fruta deti si dhe krepët me reçel molle që ju kanë shërbyer në bord. Me kufjet në kokë, të tjerët janë mbërthyer duke parë ndonjë film ose duke dëgjuar programe muzikore të propozuara nga kompania ajrore.

Me sy të mbyllur, me frymëmarrje të rregullt, Evi i ishte bashkangjitur Lajlës në botën e ëndrrave. Marku që mezi priste që avioni të ulej, lëvizte pa pushim në ndenjëse, duke parë me shqetësim orën. Se ç'kishte një ndjenjë padurimi. Nuk donte

që të priste mbërritjen në Nju Jork që të zbulonte misterin e qëndrimit të pakuptueshëm të Nikolës. Duhej që ai të gjente diçka.

Tani.

U përkul edhe më për të parë në drejtim të rreshtit të mesit të avionit. Dy radhë përpara tij, një nëpunës ndërmarrjeje, i stresuar dhe me kravatë po shikonte i tendosur kurset e Bursës në Internet. Marku pati një frymëzim të menjëhershëm, u ngrit nga vendi i tij dhe iku përpara në korridor, duke mbajtur në dorën e majtë gotën me lëng portokalli që Evi sa e kish vënë në buzë. Kur u ndodh pranë këtij nëpunësi, Marku bëri sikur u pengua dhe i derdhi qëllimisht lëngun e portokallit në këmishë dhe në pantallona.

- A nuk mund te tregoheshit pak më i kujdesshëm! - ndërhyri viktima duke kontrolluar se sa ishte lagur.

- Më vjen vërtet keq, - kërkoi falje Marku me një ton të qetë.

Ai kish nxjerrë një shami letre nga xhepi dhe në vend që ta thithte lëngun, mundohej t'ia shpërndante edhe më shumë nëpër trup, duke e zmadhuar njollën e cila do të bëhej edhe ngjitëse nga sheqeri që kish lëngu i portokallit.

- Lëreni fare këtë punë! - i thotë viktima që donte të shpëtonte sa më parë nga ky guak. - Po shkoj ta shpëlaj me ujë.

Ai u ngrit nga vendi, fshiu me kujdes disa pika që kishin rënë mbi tastierën e laptopit dhe e vendosi në ndarjen e bagazheve sipër kokës. Pastaj duke sharë nëpër dhëmbë i drejtohet tualeteve:

- ... kostum Kenzo 1000 dollarë, mbledhje me japonezët... mundësi për të pasur stoqe opinionesh...

Marku bëri sikur po vazhdonte rrugën për ku gjoja qe nisur dhe kthehet menjëherë. Për t'u mbrojtur më mirë nga rrezet ngjyrë portokalli të diellit, shumica e pasagjerëve kishin vënë grilat, duke e zhytur avionin në një gjysmerrësirë, tamam si për të bërë gjumë ose për të parë ndonjë film.

Marku, duke vepruar fare natyrshëm, hapi bagazhin e merr që aty laptopin e viktimës së tij dhe shkon ulet në vendin e tij. Pastaj hedh edhe një sy nga fundi i avionit ku ndodheshin tualetet. Kishte goxha njerëz që prisnin radhën. Me pak fat, kish në dispozicion nja dhjetë minuta para se viktima të marrë vesh se i ka humbur laptopi.

E nxori laptopin nga këllëfi. Ai kish lexuar në broshurën që i kishin shpërndarë pasagjerëve se në sajë të të rejave më të fundit tashmë mund të hyhej në internet me debit të lartë. Kështu që i dha komandën *logjicielit* të lundrimit.

Faqja *web* u hap te Google. Marku shkroi: "vjetar i përmbysur" dhe u fut në një *websajt* që i propozonte motori i kërkimit. Në formularin shkroi numrin e telefonit me të cilin ai kish mundur të fliste me Nikolën pak më parë. Pas disa sekondash kompjuteri dha këtë rezultat:

Konor Mekkoi Psy.D
Time Warner Center
10, Colombus Circle
New York 100119

Ishte numri i kabinetit të ri të Konorit! Zëri që urdhëronte Nikolën që ta mbyllte telefonin ishte ai i shokut të tij më të ngushtë. Tani çdo gjë ishte e qartë. E përse nuk ia njohu zërin që atë kohë? E çfarë do gruaja ime në shtëpinë e tij?

I zënë ngushtë, nuk dinte se si të orientohej në kërkimet që duhej të bënte. Nëse i kujtohej mirë, Nikola më parë kishte një adresë e-maili në Hotmail ku ajo shikonte e-mailet e saj kur nuk ishte në shtëpi. U fut në këtë *sajt* dhe formoi "Nikolë.Hetëuej".

Kursori po jepte sinjal dhe e ftonte që të jepte edhe fjalëkalimin e së shoqes. Por ai nuk e dinte fjalëkalimin.

Gjatë gjithë këtyre viteve që kish jetuar pranë saj, nuk ish bërë asnjëherë xheloz. Marrëdhënia e tyre ishte ndërtuar mbi besimin reciprok dhe Markut as që i kishte shkuar ndërmend të kontrollonte çantën e së shoqes ose të deshifronte agjendën e takimeve të saj.

Ndofta do kish qenë më mirë që ta bënte një gjë të tillë...

Nuk ishte ndonjë njohës i madh i informatikës, por me siguri që një *logjiciel* "prishës" do t'i kish dhënë mundësi të futej në e-mailin e së shoqes. Por për fat të keq, Marku nuk dispononte një të tillë. Për këtë ai kish vetëm trurin e tij dhe me sa duket ky ishte i pamjaftueshëm për këtë rast. Edhe terapeuti më i shquar nuk do të ishte në gjendje të gjente fjalëkalimin duke u bazuar thjesht në një analizë psikologjike. E aq më pak, vetëm në pesë minuta. Megjithatë Marku nuk donte të dorëzohej pa bërë edhe disa prova të tjera akoma.

Si e zgjedhin njerëzit fjalëkalimin? Me logjikë u mundua t'i përgjigjet kësaj pyetjeje: emri i tyre, mbiemri, ai i bashkëshortit, i fëmijëve, i kafshës që duan më shumë...

Dhe Marku provoi me radhë:

Nikolë

Hetëuej

Lajla

Mark

Peywacket (emri i maces së tyre siameze)

Por pa rezultat.

Pastaj iu kthye shifrave:

06.06.74 (datëlindja e Nikolës)

19.08.72 (datëlindja e tij)

15.05.96 (data e takimit të tyre)

10.09.96 (data e martesës)

11.01.97 (datëlindja e Lajlës)

Ai e riprovoi pa vënë thonjëzat " ". Pastaj duke vënë / në vend të pikave. Për më shumë siguri, futi edhe shifrat e viteve me katër numra.

Por pa sukses.

Po pastaj?

Përsëri futi të dhëna të tjera, siç i vinte për mbarë, numra telefoni, targa makine, numri i sigurimeve shoqërore... Provoi të fusë edhe numrin e veshjes të së shoqes, masën e këmbëve, peshën. Dhe gjithashtu:

Ngjyra e saj e preferuar?

E kuqja e plotë

Romani i saj i preferuar?

Princi i zbaticave

Filmi i saj i preferuar?

Varri i xixëllonjave

Por nuk duhej të ëndërronte.

Për një çast mbylli sytë. Para syve i doli fytyra e Nikolës, plot shkëlqim, në një skenë, duke marrë duartrokitjet pas një koncerti.

violinë

Pastaj përdori emrat e kompozitorëve të preferuar të së shoqes si dhe të atyre që ajo i kish luajtur në koncerte:

Mozart
Bach
Beethoven
Mendelssohn
Chostakovitch
Brahms
Barber
Stravinsky

Jo. Nuk ishte kjo pista e duhur. *Orientohu në drejtime të tjera.* Në këtë çast i dukej sikur mendja e tij funksiononte me 100 kilometra në orë. Duke u nisur nga parimi se një fjalëkalim nxjerr në pah një pjesë të personalitetit intim të krijuesit, Nikola që ai e njihte do të kish zgjedhur një formulë që shprehte një vlerë emocionale: një kod që vlerësonte lidhjet e saj familjare ose historinë e saj të dashurisë me Markun.

Por Nikola ishte gjithashtu shumë e kujdesshme. Para disa vitesh, dikush ishte orvatur të vidhte llogarinë e tyre bankare në internet, fakt që Nikola e kish përjetuar mjaft keq. Për të shtuar sigurinë e fjalëkalimit të saj, me siguri që ajo do të kish sajuar një kombinim gërmash, shifrash e simbolesh. Ndoshta diçka të gjatë, siç ua kishte rekomanduar edhe bankieri atë kohë.

Por fakti ishte se ajo e kontrollonte e-mailin e saj çdo ditë, dhe për këtë duhet që edhe kodi të mos jetë shumë abstrakt.

Ja pra se çfarë duhet të bënte Marku: duhet të kërkonte një fjalëkalim *i vështirë për t'u gjetur* nga të tjerët dhe *shumë i lehtë për t'u mbajtur mend.*

Për të kompozuar një kod të tillë, mënyra më e thjeshtë është që të kesh një fjali kyçe: proverb, fjalët e një poeme ose të një kënge...

Jo, në fakt Marku ishte gati të vinte bast se gruaja e tij do të ketë zgjedhur diçka më personale. Por çfarë? A kishte ndonjë fjalë që të përmblidhte thelbin e dashurisë së tyre?

Ndërkohë Marku u përmend se po e humbiste fillin e arsyetimit logjik. Një dhimbje e padurueshme koke po ia çante têmthat. Çdo gjë u bë mish-mash në kokën e tij: shifra, germa, kode, mesazhe, kujtime... I mbylli sytë për t'u përqendruar. Ndërkohë imazhi i së shoqes hapi rrugën në kokën e tij të trullosur.

Pas kësaj një mori imazhesh i parakalojnë në mendje, sikur një forcë e panjohur kish vendosur të mitralonte trurin e tij me qindra flashe të fuqishëm e të shpeshtë: takimi i parë, puthja e parë, hera e parë që kishin bërë dashuri, grindja e parë, pushimet e para të të dashuruarve...

Paris, Francë
Një natë vere.
Një shesh i vogël në l'île de la Cité.
Një tarracë restoranti.
Një kërkesë për martesë.
Në shesh ka drurë rrapi.
Në një prej tyre, një mbishkrim është gdhendur
me biçak. Pastaj vijon një datë.
Një çift të dashuruarish ka qenë para tyre
para disa vjetësh.
Marku dhe Nikola për një çast qëndrojnë të heshtur
para këtij epigrafi.
Pastaj premtojnë që edhe ata do të gdhendin
të dhënat e tyre në unazat e tyre.

Marku vendosi dorën e tij të djathë në gishtin tregues së dorës së majtë. Unazën e kishte aty në dorë. Ajo i kish rezistuar gjithçkaje: ndarjes, jetës nëpër rrugë... ai e hoqi me vështirësi dhe lexoi atë që ishte gdhendur nga brenda:

Aty ku ka dashuri
Nuk bën asnjëherë natë

Një lot i rrodhi në faqe dhe përfundoi mbi tastierë. Marku e kuptoi që e kish gjetur.

Meqë fjalia ishte shumë e gjatë dhe nuk hynte në hapësirën e rezervuar për fjalëkalimin, ai u mjaftua me futjen e germës së parë të çdo fjale:

loosainfjn

Fjalëkalim i gabuar.

Normal. Duhej shtuar edhe një datë. Ngurroi për një çast, pastaj mendoi se data më e mundshme do ishte ajo e takimit të tyre të parë. Gjithnjë e më i eksituar, ai provoi përsëri:

loosainfjn 150596

Pastaj shtypi butonin "enter".

Këtë radhë kompjuteri e pranoi fjalëkalimin. Faqja e *webit* u ngarkua dhe u hap kutia postare e Nikolë Hetëuejit.

* * *

Kishte një numër jashtëzakonisht të madh mesazhesh. Shumica e tyre i vinin nga Sonja, agjentja e Nikolës që organizonte koncertet e saj. Një e treta e tyre ishin *spams*: "free viagra", "si të zgjatësh penisin ", "jepni pará për cunamin" si dhe mesazhe të tjera koti. Disa mesazhe urimi nga admiruesit

e saj që i bënin komplimente Nikolës pas koncerteve. Disa kritika të rralla: *Ju nuk jeni e nivelit të Anne-Sophie Muther* [1] ose: *Shtëpitë diskografike nuk ju kanë zgjedhur për talentin tuaj, por për bythën që keni* ose akoma: *Sikur të isha në vendin tuaj do me vinte turp të bëja pará me fatkeqësinë e humbjes së vajzës suaj.*

Interesante këto që po lexonte, por asgjë të re për motivin për të cilin po kërkonte Marku. Këto mesazhe Nikola i merrte edhe dy vjet më parë. Marku kërkoi mos kishte korrespondencë me Konorin, por nuk kishte asgjë. Megjithatë një mesazh i tërhoqi vëmendjen, sepse ai përmbante një video në *atachment*. Një dërgues i panjohur ia dërgonte pa tekst. Ishte thjesht një fishë *QuickTime* e cila u hap vetë.

Marku u afrua edhe më nga ekrani i laptopit. Dritarja e vizualizimit ishte e vogël dhe figura ishte bardh e zi me një cilësi të keqe. Shumë shpejt e kuptoi që ishte një filmim i kamerave të survejimit.

Kur fytyra e Lajlës u shfaq në ekran, ai shtangu dhe bota u ndal në vend.

---

[1] Violiniste e famshme gjermane e njohur gjithashtu për interpretimet e Mozartit dhe të Beethovenit.

24

The Good Life

Pjesa më e mirë e jetës kalon
duke thënë: "Është shumë shpejt", pastaj
"Është shumë vonë"
- GUSTAVE FLAUBERT

Sot
Në avion
Ora 16 e 20 minuta

Me sy të zgurdulluar, Marku nuk e shqiste shikimin nga ekrani. Para syve të tij, filmimi dukej sikur jepej me xhirim të ngadalësuar. Doktorit nuk iu desh shumë kohë që të kuptonte se filmimi ishte bërë ditën që Lajla ishte rrëmbyer. Ai dalloi fare qartë xhakoventën e lehtë me kapuç që Lajla kish veshur atë ditë si dhe pelushi i vogël Shrek që ai i kishte blerë një javë para ndodhisë.

Marku po zbriste në tokë sepse policia i kish thënë gjithmonë se nuk kishte pasur asnjë fotografi të së bijës nga

kamerat e survejimit. Ai po ndërgjegjësohej tani se zonat e errëta lidhur me anketimin për gjetjen e së bijës duhet të kishin të tjera të fshehta dhe jo vetëm një rrëmbim fëmije. Dhe kjo video, ishte prova se, me gjithë mohimet e tyre, policët dinin gjëra që atij nuk ia kishin thënë asnjëherë.

Sa më shumë kalonte filmimi, aq më shumë imazhi venitej dhe sfumohej. Marku nuk ishte në gjendje as të identifikonte vendin ku ndodhej Lajla. Me siguri ndodhej jashtë dyqanit, sepse ishte errësirë dhe fytyra e vajzës mezi dallohej.

Pastaj disa sekonda më vonë, frika e bëri të hiqte sytë nga ekrani dhe të kthehej nga e bija e cila vazhdonte të flinte e qetë, fare pranë tij. Madje iu afrua asaj për të parë nëse merrte frymë nga frika se mos e humbiste përsëri.

Pasi u sigurua se Lajla ishte aty me të, u kthye përsëri te "kompjuteri i tij" ku vëren se videoja që ishte parashikuar të zgjaste dy minuta e dhjetë sekonda, ishte ndalur kur kish kaluar vetëm një minutë e gjysmë. Marku kujtoi se mos kish bërë ndonjë veprim gabim. Shtypi disa herë butonin *"play"* për ta parë nga fillimi, por e njëjta gjë përsëritej: filmi ndërpritej dyzetë sekonda përpara. I nxehur dhe i dëshpëruar njëkohësisht, psherëtiu në një dëshpërim të plotë.

Cili ishte ai që luante kështu me nervat e tij? Çfarë mund të ketë ndodhur gjatë këtyre dyzet sekondave?

- Na more! Zotnia e paska në terezi! Po ky është laptopi im!

Marku ngriti kokën sikur të zgjohej nga një makth. Me një lëvizje të shpejtë, Zoti Lëng Portokalli ia rrëmben laptopin nga duart.

- Thjesht ta mora pak, - u mundua të justifikohej Marku.

- Ta merrje pak? Një mut që të hash!

- Doja thjesht të sigurohesha që çdo gjë funksiononte në rregull, - vijoi Marku duke vazhduar të luajë rolin e budallait. - Mendova se mos e kisha dëmtuar nga pakujdesia ime, dhe nëse do të ishte e vërtetë, unë jam gati...

Por biznesmeni nuk ishte aq i metë:

- Do të ngre padi, - tha ai duke u munduar të gjente dëshmitarë të tjerë në avion.

Ndërkohë një stjuardesë kish mbërritur për të qetësuar gjakrat. Marku e kuptoi që ishte në interesin e tij të mos ndihej e të pranonte fajin. Ndërkohë që tjetri që kish marrë kot, vazhdonte sqarimet e tij.

- Dua të vë në dijeni komandantin për këtë incident! përsëriste ai.

- Shumë mirë, zotëri, - mundohej ta qetësonte stjuardesa. - Ju siguroj se do ta vëmë në dijeni.

Pastaj ajo e shoqëron Zotin Lëng i Portokallit në vendin e tij duke i dhënë një buzëqeshje sikur donte t'i thoshte: *Ulu mor trap dhe mjaft u grinde. Incidenti me kaq merr fund.*

* * *

- Babi, po akullorja që më premtove?

Kacafytja e dy burrave ua kish prishur gjumin Evit dhe Lajlës.

Marku kthehet nga ato e pothuajse si me magji i harroi problemet e tij dhe si për të thënë që asgjë nuk kishte ndodhur shton:

- Hajde pra, zonjushe, - thotë duke përplasur duart, - a do hamë apo jo akullore?

- Pooo! - tha Lajla gjithë gëzim.

Marku kapi për dore të bijën dhe i bëri shenjë Evit që të vinte edhe ajo. Kështu ekipi u drejtua për nga pontili i sipërm me shpresë që të gjente një tavolinë të lirë te Floridita. Salloni i mëparshëm ku kish qenë Marku tani më shumë i ngjante një salloni çaji. Për t'i bërë ballë fluksit të madh të klientëve, Isaku, baristi, tani kishte edhe dy ndihmës. Me pamjen e tyre mikpritëse, të tre vepronin shpejt dhe shumë saktë.

Me t'u liruar një tavolinë, Lajla u ul e para. Mori kartën e ëmbëlsirave sikur të bëhej fjalë për Shën Gralin dhe shikoi gjithë neps fotografitë e çokollatave të Liezhit si dhe 'banana splitet' e tjera. Marku dhe Evi u ulën edhe ata duke u ngazëllyer me qëndrimin e saj. Marku i hodhi një vështrim turmës që ndodhej aty me shpresë se mos shihte Elison Harrisonin, por trashëgimtarja e pasur ish larguar nga bari.

Ata porositën një *Frosen Hot Chocolate* që ua u solli vetë Isaku me tre lugë e tre pipa. Tasi i madh i vendosur në mes të tavolinës kishte pothuajse formën e një akuariumi. Aty ishin nja dhjetë kupa me akullore, të gjitha me çokollatë, por secila një varietet më vete, të cilat ishin të zhytura në një lloj kremi kakaoje dhe të mbuluara sipër me krem të rrahur.

- Ha ngadalë, - e këshilloi Marku të bijën, ndërkohë që Lajla sulej me babëzi mbi akullore. - Nuk ta merr njeri!

Me pipën në gojë, me hundën në kremin *Chantilly*, vajza e vogël po thithte me një kënaqësi të dukshme çokollatën e shkrirë. Evi bëri shaka me Lajlën para se të fillonte e të degustonte akulloren. Marku e pa për herë të parë adoleshenten me një buzëqeshje në buzë dhe kjo i dha mjaft kënaqësi. Tregimi që Evi i kish bërë për jetën dhe dëshira e saj për hakmarrje i kishin bërë shumë përshtypje Markut. I vinte keq që ajo s'e kish mbaruar rrëfimin e historisë së saj, por se

ç'kish një parandjenjë se ai do të dinte diçka më shumë para se të arrinin në Nju Jork. Me sa duket ky udhëtim ka qenë i ngjeshur me ngjarje, i pasur me takime dhe plot surpriza. Të mira dhe të këqija...

* * *

Evi, teksa e shijonte akulloren, shikonte gjithashtu me bisht të syrit Markun dhe Lajlën me shumë dashuri. Diçka e prekte në këtë marrëdhënie të mjekut me të bijën. Evi, që nuk e kish njohur asnjëherë familjen e vërtetë, ishte e mallëngjyer tek shihte këtë burrë. Në sytë e saj, ai ishte edhe i fortë edhe i brishtë njëkohësisht.

Në bar, Isaku e ngriti edhe më muzikën. Ambienti ishte shumë i këndshëm. Evi mori edhe një lugë nga lëngu i mrekullueshëm i akullores pastaj mbylli sytë për ta shijuar akoma më mirë. Me sy të mbyllur ajo lëshoi kokën të lëvizë me ritmin e saksofonistit Xhon Koltren, e ndërgjegjshme edhe vetë se po jetonte një çast qetësie që nuk e kish pasur prej shumë kohësh.

Ajo vuri re përsëri se të gjitha mendimet e saj lidheshin me Konorin të cilin Marku me tregimin e historisë së tij, ia kishin bërë më të afërt. Në moshën e saj, Konori kish arritur me kurajë të ecte përpara. Ai e kish marrë në sy të kaluarën e tij, pastaj kish gjetur përsëri forca që të bëhej një nga doktorët më të mirë dhe më novatorë të vendit. Kjo ishte një fitore e bukur mbi jetën.

Po vallë hakmarrja, a e kish qetësuar dhimbjen e tij?

Kur hapi sytë, këtë pyetje ia bëri Markut.

25

Marku dhe Konori
Flash backu i tretë

1989-1995: Vitet e formimit

Marku dhe Konori mbërrijnë në Manhatan një pasdite tetori me shi.

Ata janë vetëm 17 vjeçarë.

Gjithmonë kanë ëndërruar për Nju Jorkun, duke përsëritur nga getoja e tyre, fjalë magjike dhe të famshme si *Central Park, Washington Square, World Trade Center* dhe *Lady Liberty.*

Ajo që ata kanë para syve është krejt ndryshe nga ajo që kanë parë nëpër filma.

Me të zbritur nga treni që të dy u ndeshën me qiellin gri që i jep qytetit një pamje të ftohtë e të trishtë.

Por i ftohti është në zemrën e tyre.

Janë akoma dy fëmijë që janë në ikje, duke mos ditur se çfarë ju rezervon e nesërmja. Mundet që edhe policët të bien në gjurmët e tyre. Ndofta edhe ikja e tyre do të marrë fund

më shpejt se sa e kanë parashikuar ata dhe do të përfundojë me futjen në qelitë e burgut.

Ndërkohë, atyre u duhet të mbijetojnë.

* * *

Tani është Marku që merret me drejtimin e veprimeve. Ka ardhur çasti që të provojë, ashtu siç e kish zakon të mburrej, se ai është inteligjent dhe që di të bubërrojë. I vendosur që të luftojë deri në fund duke pasur parasysh që përballë ka një Konor të dërmuar e gjithnjë e më shumë depresiv, arrin të gjejë një apartament të vogël jo shumë larg kampusit universitar të Nju Jorkut. Shkrin të gjithë talentin dhe energjitë për të kapërcyer vështirësitë administrative lidhur me kërkesën e tyre për t'u regjistruar në fakultet. Për fat të mirë ata nuk kanë vështirësi financiare. Në sajë të parave qiellore që Konori u mori gangsterëve, paratë e drogës, ata paguajnë qiranë e dhomës dhe një pjesë të studimeve. Pas një muaji, arrijnë të marrin gjënë e shumëkërkuar prej tyre, kartën e studentit me emrin e tyre, duke u zhytur njëkohësisht edhe në studime.

Ata e dinë me saktësi se çfarë duan të bëjnë: duan të marrin një doktoratë në psikologji dhe të hapin një ditë kabinetin e tyre.

* * *

Ora është tre e mëngjesit. Konori shtyn derën e banjës dhe ndez dritën. Ai bën kujdes që të mos e zgjojë Markun që fle në dhomën ngjitur. Kërkon diçka në sirtarin e mobilies që

shërben njëkohësisht si dollap farmacie, kap një tub medikamenti, nxjerr prej aty dy kokrra dhe i pi me ujë. Janë kokrrat e pesta dhe të gjashta të ditës së sotme. Letra shoqëruese e medikamentit thotë që të mos kalohen katër kokrra në ditë, por ka shumë dhimbje. Qëndron ashtu pa lëvizur para pasqyrës, sikur të kish përballë një të huaj. Nën dritën e zbehtë, zbërthen pizhamet për të nxjerrë lakuriq trupin e tij të gjymtuar që e shikon me habi dhe me neveri. Ka ca kohë që mendon se trupi i tij do të jetë gjithë jetën kështu. Ndërsa një pjesë e dorës dhe e toraksit e kanë humbur ndjeshmërinë e tyre, këmbët i dhembin gjithmonë dhe e bëjnë të varur ndaj analgjezikëve. Dhimbjes fizike i shtohet edhe pagjumësia që e ndjek gjithmonë. Ai kujtonte se i kishte hequr nga mendja dy shitësit e drogës, por, pothuajse çdo natë, ata kthehen dhe ai është në makth të plotë. Ai mendonte se i kishte dhënë fund dhimbjes por ajo ishte kthyer edhe më therëse për të: ajo jetonte tashmë nën lëkurën e tij prej vrasësi.

Kur po bëhej gati të shtrihej, atë natë, e kuptoi se barra e rëndë e sfilitëse e hakmarrjes do ta shoqërojë për gjithë jetën.

* * *

Një mbrëmje i dëshpëruar, Konori shikon Markun që merr telefonin.

- Alo?

Në anën tjetër të telefonit dëgjohet zëri i Lorena Mekkormikut që Marku ka marrë iniciativën ta marrë në telefon. Doktoresha është e emocionuar që po flet në telefon me Konorin dhe i rekomandon një nga kolegët e saj në Nju Jork që të ketë mundësi të vazhdojë me riaftësimin e gjymtyrëve.

Është e vështirë t'ia dalësh mbanë fare i vetëm...

* * *

Konori e rimerr veten dalëngadalë. Kur ka mundësi nuk i merr medikamentet anti-dhimbje dhe i zëvendëson me banja, me masazhe dhe me aplikacione të ngrohta.

Në sajë të Markut dhe të këshillave të Lorenës, fillon të ketë më shumë besim te vetja, por gjithmonë mendon se si do të reagojnë të tjerët kur ta shohin. Fytyra i ka shpëtuar nga djegiet, gjë që në fakt është një thikë me dy presa, sepse aq sa ai do të shkojë përpara, po aq, trupi i tij e frenon. Këtë problem ka gjithmonë me vajzat, është gjithmonë i njëjti ankth: në fillim ato mrekullohen prej tij por gjithmonë ka përshtypjen se "po i gënjen për mallin që iu ofron". Duke qenë i bindur se ato mund të mos e pranojnë me një trup të dëmtuar kaq shumë nga djegia, nuk shkon më larg me to se sa thjesht një shtrëngim, dhe kur mendohet të shkohet më tej, nxiton "të jetë ai që largohet i pari", se sa të durojë "që të largohen prej tij".

* * *

Vitet kalojnë.

Konori vuan gjithmonë nga pagjumësia, por mundohet ta përballojë. Që t'i shpëtojë hijeve të shitësve të drogës që e shqetësojnë në gjumë, i kalon netët duke studiuar e duke lexuar libra të tërë psikologjie. Këmbëngulja e tij në punë dhe fakti i të mësuarit autodidakt i impresion profesorët e tij. Njëri prej tyre, një As i psikiatrisë, e merr si asistent dhe i jep rastin

që Konori ta shoqërojë kudo. Në disa vjet, Konori do të shkojë të bëjë stazhe nëpër burgje, spitale, shkolla për handikapatë... Kudo që shkon lë përshtypjet më të mira. Agresioni i tij e ka bërë shumë më të ndjeshëm ndaj dhimbjes së të tjerëve, dhe nuk nguron të jetë edhe vetë në një gjendje emotive shumë të brishtë. Ky është mjeti që ka zgjedhur për të ndjerë sa më afër vuajtjen e pacientëve të tij, dhe kështu, t'i kuptojë më mirë që të mund t'i ndihmojë sa më shumë.Është i ndërgjegjshëm për rreziqet që ka një qëndrim i tillë, por ky është një çmim që është gati ta paguajë.

Ai kupton shumë shpejt që sekreti i shpirtit njerëzor gjendet në tru, dhe për këtë i duhet të plotësojë studimet e tij në neurologji. Kështu bën, gjithmonë duke pasur të njëjtën ambicie: të kuptojë se çfarë ndodh në tru, të zhbirilojë edhe skutat më të errëta të mendimit, të udhëtojë në zemër të ëndrrave dhe të inkonshiencës.

* * *

1996-2001 Vitet e arta

Gruaja e jetës sime

15 maj 1996

Një mëngjes pranvere Marku futet në një farmaci pranë *Washington Square*. Thotë për forcë zakoni një "mirëdita" të thatë dhe zë radhë pas klientëve të tjerë. Ka ardhur të blejë ca aspirina me shpresë që të kthjellohet pak nga koka e rënduar nga pija. Një natë më parë, në Nju Jork *Knick*-sat kanë fituar një ndeshja ndaj *Bulls*-ave të Majkëll Xhordanit, duke rihapur edhe njëherë luftën për titull për fundvitin. Edhe

Marku ishte në këtë ndeshje! Një biletë që kishte kushtuar jashtëzakonisht shumë në treg të zi, por ia vlente! Për të festuar fitoren e ekipit të tij, ndenji jashtë gjithë natën. Është 24 vjeç dhe çdo gjë i buzëqesh. Sapo ka marrë diplomën dhe ka gjetur një vend pune si psikolog në një qendër riedukimi. Vitet e vështira të Çikagos kanë marrë fund njëherë e mirë. Atij i pëlqen puna, jeta, Manhatani...

Me sy të përqendruar te *Nju Jork Times*, Marku nuk bën kujdes për gruan që është përpara tij në radhë. Me këllëfin e violinës në dorë, Nikola është e përpirë nga skena që po zhvillohet para syve të saj. Në arkë, arkëtarja po i shërben një gruaje që ka një bebe në duar. Kjo kërkon një kuti qumësht për bebe dhe ca pelena. Tiparet e saj janë të lodhura. Ajo shtrëngon një kartëmonedhë dhjetë dollarësh në dorë.

- 14.95 dollarë, - thotë shitësja.

Gruaja duket sikur është e zënë ngushtë, dhe nguron për një çast. Me sa duket ajo se kish parashikuar të shpenzonte një shumë të tillë. E vënë në siklet, kruan kuletën, duke kërkuar pa e besuar edhe vetë se mund ta plotësojë shumën.

- Nxito pra, - ankohet shitësja duke psherëtirë.

- Ja, ja... - thotë gruaja duke nxjerrë mbi banak monedhat e tjera.

Të gjitha ata që mbajnë radhën e kuptojnë se ajo nuk ka aq pará për të paguar. Disa tregojnë shenja padurimi, ndërsa të tjerë e kuptojnë në heshtje, pa thënë gjë.

Në atë kohë Nikola afrohet.

- Më duket se ju ranë juve këto, - i thotë ajo gruas duke i dhënë një kartëmonedhë 20 dollarëshe.

Tjetra e shikon si e shastisur dhe pas disa sekondash e merr kartëmonedhën, e cila e shpëton nga një siklet i madh.

- Faleminderit, - thotë ajo, duke ulur sytë.

* * *

- Zonjushë!

Marku vrapon në trotuar për të kapur Nikolën.

Ec e mos i beso fatit! Mjaftoi që ai të ngrinte sytë nga gazeta dhe të rrokë shikimin e një të panjohure që t'i krijohet një pështjellim në bark dhe zemra t'i rrihte fort. Një gjë është më se e qartë: nuk duhet ta lërë këtë grua të iki pa i mësuar emrin.

- Zonjushë!

- Po? - pyet Nikola duke u kthyer.

- Mirëdita, - thotë si i zënë ngushtë, duke u munduar të rregullojë frymëmarrjen nga emocioni. Këmbët nuk i ndjen më të tijat. Duart i ka të squllura.

Thuaj diçka Mark. Mos rri aty në mes të rrugës si trap!

- Unë... unë quhem Mark Hetëuej. Isha mbrapa jush në radhë në farmaci. Ju pashë se si e ndihmuat atë gruan...

- Nuk ishte ndonjë gjë kush e di se çfarë, - thotë ajo duke ngritur supet.

- Në këtë lagje banoni?

- E ç'ju intereson juve? - përgjigjet ajo dyshuese.

- Në fakt, do të dëshiroja t'ju ofroja një kafe...

- Në rregull jeni ju? - thotë tjetra duke vazhduar rrugën.

- Ju lutem! - ngul këmbë Marku duke i shkuar nga pas.

- Po unë nuk ju njoh!

- Arsye më tepër për të pranuar: kështu mund të njihemi.

- Po humbisni kohën kot me mua.

- Thjesht një kafe, nuk keni asnjë detyrim pastaj!

- Jo, faleminderit! Mjaft e nervozuar jam edhe pa kafe, kështu që s'kam nevojë për kafeinë.

- Po mund të merrni diçka tjetër, një çokollatë, është afrodiziake.

- Po thoni vërtet idiotësira... - thotë ajo gjithë duf dhe ngre dorën për të kërkuar një taksi.

- Jo, po them të vërtetën. Tek Aztekët, mbreti Moctezuma pinte rreth pesëdhjetë filxhanë në ditë para se të shkonte të nderonte gratë e haremit të tij.

- Dhe ty të duket vetja interesant me këto që thua?

Një taksi ndalon para tyre dhe Nikola hipën në të pa humbur kohë.

- Më jepni të paktën numrin tuaj të telefonit! - i lutet Marku.

- Gjejeni në numërator, - i thotë ajo si për t'u tallur me të.

- Por nuk ua di as emrin.

- Edhe ai është në numërator, - i thotë ajo duke mbyllur derën e makinës.

Taksia niset. Marku vrapon disa metra pas taksisë dhe makinat që janë mbrapa fillojnë t'i bien borive.

I zhgënjyer, qëndron një çast pa lëvizur në trotuar. Për të ka rënë gongu i gjendjes nokaut. Çuditërisht ka përshtypjen se la të ikte gruan e jetës së tij dhe i vinte inat me veten që ishte sjellë njëlloj si një adoleshent pesëmbëdhjetëvjeçar.

Normale që të më shpërfillte: asaj iu duka si një trap mjeran, një adoleshent me shakatë e tij pa kripë...

Ai që beson në shenjat e fatit, ai që beson në shansin e tij, dreq o punë që nuk arriti t'i tregonte se kush ishte në të vërtetë. Më keq akoma. Nuk ishte i zoti as të merrte vesh se si e kishte emrin, duke humbur kështu çdo shpresë se mund ta gjente ndonjë ditë.

Ai nuk ka guxuar t'ia thotë këtë asnjëherë askujt, madje

as Konorit, por që kur ishte i vogël, ai ka besuar se gjithmonë kishte pranë tij një engjëll mbrojtës, i cili e paralajmëronte gjithmonë kur do të ndodhte ndonjë gjë e rëndësishme. Kurse sot, asgjë nuk e ndihmoi që të kapte shansin e tij.

Engjëll mbrojtës koti? shau me vete, *përse më le vetëm*?

- Kujdes! Hapi sytë kur ecën rrugës! - i hakërrehet një djalë me patina që po kalonte aty.

Marku mënjanohet, por është vonë për të evituar përplasjen. Ai shembet përtokë me forcë dhe gjendet i shtrirë në trotuar.

- Mirë je? - e pyet i shqetësuar djali me patina duke u zgjatur dorën që të ngrihej.

Ndërkohë që Marku ngrihet, sytë e tij ndalen në një shtyllë buzë rrugës.

Në shtyllë, një afishe.

Në afishe, një fytyrë.

Poshtë fytyrës, një lajmërim për shfaqjen e ardhshme:

Nikolë Kopland.
Në Galerinë Carnegie
Koncert për Violinë -Prokofiev- Stravinsky
Orkestra Simfonike e Bostonit
E enjte, 13 Maj

Faleminderit engjëlli im mbrojtës...

* * *

- Më thuaj si të duket?

Që nga ballkoni i sipërm i auditoriumit, Marku dhe Konori vështrojnë me vëmendje orkestrën dhe solisten që po ekzekutojnë koncertin e Prokofievit. Salla prestigjioze e koncertit dridhet nën ritmin e ndryshimeve të linjave melodioze të kësaj pjese muzikore e cila është e rezervuar vetëm për virtuozët.

- Hë, pra më thuaj, si të duket? - përsërit Marku.

Një shëëët qortuese u drejtohet dy miqve.

- Nuk ke se ç'thua. Luan shumë mirë, - pëshpërit Konori.

- E çfarë merr vesh ti nga muzika klasike?

- Asgjë, - pranon Konori. - Fakti është që ajo është e bukur.

- A mendon se mund të ketë ndonjë të dashur?

- Një vajzë kaq e bukur, natyrisht që...

- A mendon se unë e kam një mundësi?

- Sinqerisht?

- Po pra, po.

- Do ta kesh shumë të vështirë, shoku! - pohon Konori.

Shëëëëëët!

* * *

Ora 22 e 57 minuta

Nikola (kategorike): Nuk dua të fantazoni shumë, pranova ftesën tuaj sepse kështu evitova të shkoj të ha darkë me kolegët e mi.

Marku (në humor): E mora vesh.

Ulen përballë njëri-tjetrit, në një tavolinë të vogël, nën kubenë vezulluese të barit të Mansfield Hotelit. Ambienti është i veshur me një tapiceri bakëmi dhe shkëlqen nga mijëra

llambushka që ngjajnë me yje dhe që krijojnë një atmosferë intime dhe mikpritëse. Baristi u servir porosinë me një pamje solemne: një koktej ngjyrë vjollcë për Nikolën dhe një *Corona* për Markun.

Nikola (më butë): Pra, domethënë, ju jeni psikolog?

Ora 23 e 08 minuta

Nikola (me shaka): Si psikolog që jeni, flisni si shumë për dashurinë...

Marku (me bindje): Sepse dashuria është e vetmja gjë interesante në jetë.

Nikola (dyshuese): Kjo, është shumë e kundërshtueshme.

Marku: Imagjinojeni jetën pa dashuri, është një gjë e trishtueshme. Të paktën dashuria e bën kohën të eci përpara...

Nikola (e vendosur): Dhe koha e lë dashurinë të shkojë...

Marku e vështron. Fytyra e saj është fine, faqet e rregullta me mollëza. Ka diçka të trishtueshme dhe të parezistueshme në shikimin e saj.

Ora 23 e 12 minuta

Marku (sikur e pyet si rastësisht): Pra, veç këtyre, a ke njeri në jetën tënde?

Nikola: Jo krejt.

Marku (i intriguar): Jo krejt?

Nikola (me një buzëqeshje): Le të themi që për çastin unë fle vetëm me violinën time.

Marku: Shpresoj që instrumenti të jetë afektiv me ju.

Nikola (duke trazuar koktejin e saj): Violina është një Guarneri[1].

Marku: Një italian...

Nikola: Është pak qejfli, por shumë i lidhur me mua. Unë gjithmonë i bëj korte dhe kjo është reciproke.

Edhe ajo e sheh, buzëqesh dhe largon me dorë një balluke flokësh mbi fytyrën e saj. Ajo nuk e di akoma, por e ndjen se është duke rënë në dashuri me të.

Ora 23 e 24 minuta

Marku (i këndshëm): A do shihemi prapë?

Nikola (papritmas më e shpërndarë): Mendoj se jo.

Marku i ngul sytë. Një hije sikur kalon në fytyrën e gruas së re. Goja e saj sapo tha "Nuk mendoj", sytë e saj sikur thonë "shpresoj".

Marku: Ka ndonjë gjë që ju shqetëson?

Nikola (hezituese): Qëparë kur më pyetët nëse kisha dikë në jetën time... Në fakt nuk ju thashë të vërtetën.

Marku: Pra keni dikë?

Nikola: Po.

Marku: Natyrisht, normale që një femër si ju....

Heshtje.

Nikola: (duke kërkuar diçka në çantën e saj): Është ky.

Marku kujton se ajo do t'i tregojë fotografinë e ndonjë

---

[1] Emri i një familje të famshme instrumentesh në Kremona, që në shekujt e XVII dhe të XVIII, prodhonte violina me famë, të krahasueshme me ato të Stradivarit.

burri. Por në vend të saj, ajo i zgjat një test shtatzënie, në një kapsulë plastike. Ai e ndjen që mund ta shohë rezultatin. Ajo është shtatzënë.

Marku (me një buzëqeshje të ëmbël dhe i qetë): Ai apo ajo?

Heshtje.

Nikola: Jeni akoma i një mendjeje që doni të dilni me mua?

Marku: Më shumë se kurrë.

* * *

Është vajzë!

Lajla

erdhi më 11 janar 1997
në orën 15.
Peshon 2.990 kg dhe është e gjatë 48.5 cm



Lumturia jonë është e pafund!

Mark dhe Nikolë Hetëuej
10, Greene Street
Brooklyn, NY, 11238- 6050

* * *

The family Man

10 shtator 2001

Marku dhe Nikola festojnë 5 vjetorin e martesës së tyre. Me këtë rast ata kanë ftuar disa miq dhe ndodhen në kopshtin e shtëpisë së tyre rreth e rrotull një barbekjuje. Është një mbrëmje e këndshme fundvere, që shtrihet në një ambient shumë *american life*, duke pasur si sfond muzikor Marvin Gaje, Leonard Kohen dhe Xhoni Kesh.

Me pirun në dorë, pranë prushit, Marku i mëson Lajlës shkencën dhe rreziqet e pjekjes në skarë.

- Kjo është për ty! - thotë Marku duke vendosur një kofshë pule në një pjatë kartoni dhe ia jep vajzës së tij.

- Do t'i hedh *ketçap*! - thotë vajza e vogël duke vrapuar nëpër bar.

Ndërkohë që darka është në kulmin e saj, Marku shikon se Konori rri pak i tërhequr, me shikimin askund, i zhytur në mendime. Marku i afrohet mikut të tij.

- Provoje pak këtë mrekulli, - i thotë duke i zgjatur një gotë verë.

- Çfarë lloji është?

- *Château cheval-blanc 1995*, një *Saint-Émilion grand cru.*

Ka disa kohë që Marku është apasionuar pas verërave dhe mrekullohet:

- Shikoje, këtë fustan me reflekse rubini. Dhe taninet, të butë dhe elegantë. Po aromat, a i ndjen aromat?

- Më lër ta provoj! - thotë Konori dhe të dy ia plasin të qeshurit me të madhe dhe duket sikur tallen ngaqë Marku po hiqet si njohës i madh verërash.

- Për shëndetin tënd, plako!

- Unë e pi për ty, - përgjigjet Marku duke tringëllirë gotat.

Para dy vjetësh ata krijuan kabinetin e tyre dhe puna u ecën shumë mirë. Konori është një mjek i shkëlqyer por edhe një kërkues novator, kurdoherë në kërkim të trajtimeve të reja mjekësore. Metoda e tij për të lënë duhanin me anë të hipnozës ecën jashtëzakonisht mirë në Manhatan dhe i siguron kabinetit të tyre të ardhura të majme. Pasi ka arritur këtë sukses, Konori po punon që të shërojë të tjera shqetësime: vartësinë alkoolike, depresionet nervore, ankthin kronik si dhe fobitë e ndryshme. Ndryshe nga ai, Marku merret më shumë me aspektin e "marrëdhënieve me publikun". Mediat e kanë vënë re këtë psikolog të ri me pamje elegante dhe me fjalë bindëse.

- Të kujtohet kur ishim fëmijë, me ato shishet e *Coca-Colës* që i hidhnim ujë që të na shtohej sasia?

- Po, po thotë Marku, ishte e llahtarshme.

- Jo më shumë se kjo vera jote shato bla- bla- bla.

- E realizon dot rrugën që kemi përshkuar? Megjithatë ia dolëm mbanë.

- Nuk jam edhe aq i sigurt, - thotë Konori mendueshëm.

- Ç'domethënë kjo? Nuk jam i sigurt?

- Nganjëherë më duket sikur nuk jemi larguar asnjëherë nga Çikago.

- Për shkak të maktheve të tua?

- Jo, është diçka më e thellë se kaq. Sikur ta dije se sa jam penduar që i vrava ata të dy.

- Ata ishin kriminelë, fëlliqësira, gjëja më e shpifur...

- Ndofta ke të drejtë, por unë jam bërë si ata. Dhe ajo që është më e tmerrshme, është se unë përfitova nga paratë e

tyre. Jam i sigurt se do t'ia kishim dalë mbanë edhe në mënyra të tjera.

- Jo, - ia pret shkurt Marku. - Ti e di shumë mirë se pa ato pará, ne me siguri do të ishim akoma atje. Ishte një çmim që duhej paguar, edhe pse më vjen keq, që je ti ai, që mban peshën e rëndë të kësaj që ndodhi. Dëgjo Konor, e gjithë kjo është histori e kaluar. Shiko në drejtim të së ardhmes...

- Për mua është njëlloj sikur të ishte dje.

- Më të vështirën e kaluam. Asgjë nuk mund të na ndodhë më.

Lajla e ndërpret bisedën e tyre duke iu hedhur në krahë të atit.

- Babi, të solla një ëmbëlsirë. Eja e ma bëj një herë lojën e aeroplanit?

Marku e shtrëngon të bijën në kraharor, por sytë nuk ia shqit Konorit.

- Asgjë tjetër nuk mund të na ndodhë, - përsëriti ai si për t'i mbushur mendjen edhe vetes së tij.

- *Gjithçka* mund të na ndodhë, - e korrigjon Konori.

- Jo, sot ne jemi më të fortë, më të fortë se asnjëherë.

- Është krejt e kundërta. Ne mund të humbasim gjithçka.

Marku ndalet pak, pastaj vazhdon:

- Duhet të bësh edhe ti si unë, duhet të martohesh, të bësh fëmijë...

- Nuk besoj. Kur dashuron, bëhesh më i brishtë.

- Jo, - kërkon ta sigurojë Marku, - bëhemi më të fortë.

Por Konori nuk është i bindur:

- Kur ti ke frikë se mos humbasësh ata që do, ti bëhesh më i brishtë. Ti je i thyeshëm: mund të të lëndojnë më lehtë,

vetëm duke u marrë me të afërmit e tu. Dhe unë nuk mund t'i lejoj vetes të jem i brishtë.

- Pse?

- Sepse në këtë rast e kaluara do të më kapë, - thotë ai duke rrëkëllyer gotën me verë.

Marku do të thotë diçka, por Lajla e tërheq dhe i kërkon të luajë me të:

- Hë pra babi, do ta bëjmë lojën e aeroplanit?

* * *

2001- 2006: Vitet e errëta

Ku ishit ju në mëngjesin e asaj dite?

Të nesërmen, 11 shtator 2001

- Lajla, merre shpejt çantën, do bëhemi vonë, ti për në shkollë e unë për në punë.

- Kam akoma gjumë!

- Zemra ime, duhej të flije më herët mbrëmë, siç të tha babi.

- Po unë doja të festoja bashkë me ju...

- E di, dakord, tani vish xhakoventën dhe shko përshëndete mamin.

Gjatë kohës që vajza ngjitet për të shkuar tek e ëma, Marku mbyll laptopin dhe e vendos në çantë, duke kthyer gotën me lëng portokalli.

- Mirupafshim, zemër, - i drejtohet Nikolës që poshtë.

- Mirëardhsh, - përgjigjet zëri i Nikolës ndërsa Lajla zbret shkallët rrëmbimthi.

Dhe ja ku nisen të dy babë e bijë, në këtë mëngjes me diell mbi Bruklin.

- Ku është vetura? - pyet Lajla kur ata janë duke ecur në trotuar.

- Pak më larg zogu im. Eja, të të mbaj hopa.

- Tani jam shumë e rëndë! - thotë ajo duke qeshur.

- Pa ta shohim sa e rëndë je!

Marku e ngre të bijën me një dorë dhe në tjetrën mban çantën.

- Ti nuk e di që unë kam qenë Musklor, apo jo?

- Çfarë është Musklori?

- Njeriu më i fuqishëm i Universit.

- Dhe ky je ti?

- Po pra! Unë i luftoj forcat e së keqes në sajë të formulës sime magjike: "Në bazë të fuqisë së kafkës së stërlashtë, unë disponoj forcën e gjithëfuqishme..."

- Vërtet? - pyet ajo mosbesuese.

- Pothuajse e dashur, pothuajse.

Tek vrapon nëpër trotuar, Marku mendon për bisedën e mbrëmshme me Konorin. Shoku i tij nuk është fort mirë këto kohë. Ndryshe nga Marku, suksesi që ai ka në punë, nuk i sjell asnjë lloj qetësie në shpirt. Konori është gjithmonë i mbërthyer nga e kaluara, i brejtur nga ndërgjegjja dhe i bindur se një ditë e keqja do të dalë në shesh.

- Ja ku është vetura, - thotë Lajla. - A mund ta hap me pult?

Ndërsa vajza po hap makinën, Marku pyet veten se nga ku mund t'ju kanoset rreziku.

Ajri është i ngrohtë dhe qielli asnjëherë nuk i është dukur më blu se sot.

Para se të ulet në timon, shikon orën e tij: ora është 8 e 46 minuta.

Në më pak se një minutë avioni i parë do të përplaset në kullën veriore.

Në më pak se një minutë, Nju Jorku do të humbasë pikat e referimit dhe të gjithë sigurinë.

* * *

26 mars 2002

Informacion flash - CNN/US

"Pas tre orë kërkimesh, nuk kemi akoma asnjë lajm nga vogëlushja Lajla Hetëuej, pesë vjeçe, e cila është zhdukur të mërkurën në një qendër tregtare të Orange County.

Lajla është vajza e violinistes Nikolë Kopland dhe e psikologut nga Nju Jorku, Mark Hetëuej. Është pikërisht ky i fundit, që në kundërshtim me rekomandimet e FBI-së, foli para kamerave për t'iu drejtuar rrëmbyesve të mundshëm të vajzës së tij".

Në ekran Marku ngjan i shpëlarë, pa jetë, me sytë të veshur me rreth të zi, me një fytyrë të shpërbërë.

"Do të doja t'ju thosha atyre që kanë rrëmbyer vajzën time, që të mos i bëjnë keq... më kërkoni çfardo shume që doni, unë do t'ju paguaj. Më kërkoni çdo gjë, dhe unë do ta bëj. Por ju lutem mos i bëni keq vajzës sime. Ju përgjërohem...".

* * *

Ka një kohë për gjithçka dhe një kohë për
Çdo gjë poshtë qiellit

Një kohë për të qenë fëmijë e një kohë për të vdekur
(...)
Një kohë për të vrarë, dhe një kohë për të shëruar
Një kohë për të shkatërruar, e një kohë për të ndërtuar
Një kohë për të qarë, e një kohë për të qeshur
(...)
Një kohë për të shqepur, e një kohë për të qepur
Një kohë për të heshtur, e një kohë për të folur
Një kohë për të dashur, e një kohë për të urryer.
(...)
Ekleziasti, kap. 3.

* * *

10 janar 2005

- Konor, unë po iki.

Marku u fut në zyrën e mikut të tij.

Ka disa muaj që zyrat e tyre janë shpërngulur në godinën e re llamburitëse të *Time Warner Center*. Një zhvendosje e parashikuar kohë më parë, por për të cilën Marku nuk ka kontribuar. Që prej tre vjetësh që Lajla është zhdukur, nuk ka ardhur më të punojë, duke ia kushtuar gjithë kohën e tij kërkimeve për gjetjen e saj.

- Ku do shkosh?

- Nuk e di. Ti mund ta heqësh emrin tim nga pllaka e kabinetit. Nëse do të blesh pjesën time, merru vesh me Nikolën, ajo nuk do të të bëjë fjalë.

- Mblidhe veten, o burrë! - i përgjigjet Konori duke e shtrënguar fort Markun. - Ajo që po përjeton ti është e

tmerrshme, por nuk je i vetmi. Ke një grua që të do, më ke edhe mua gjithashtu. Sot, më shumë se kurrë kemi nevojë të jemi bashkë.

- E di, - i përgjigjet Marku duke u shkëputur nga shoku i tij, - por nuk mund të bëj gjithmonë sikur e kam kaluar këtë. Kjo është më e fortë se unë.

Konori nuk dorëzohet.

- Të gjitha bashkë i kemi kaluar, ti dhe unë! Të kujtohet? Për jetë a për vdekje! Më lër mua të të ndihmoj tani, siç më ndihmove ti.

Por Marku është i shurdhër ndaj këtyre fjalëve të shokut të tij. Atëherë Konori shpërthen sikur do të bindë edhe veten e tij:

- Njeriu arrin të mbijetojë, asnjëherë nuk harron, dhimbja është gjithmonë e ngulitur në thellësi të zemrës sonë, por prapë se prapë, njeriu arrin të mbijetojë. Këtë kam bërë gjatë gjithë kësaj kohe dhe të njëjtën gjë mund të ta mësoj edhe ty.

Por Marku nuk dëgjon më. I dëshpëruar Konori tenton t'i thotë edhe një herë të fundit:

- Mos bëj budallallëqe. Në qoftë se do zhytesh shumë, nuk do të dish të kthehesh më.

Marku ngriti supet dhe drejtohet për nga dera. Tashmë ai nuk është më aty.

- Nëse nuk kthehem bashkë me vajzën time, më mirë të mos kthehem fare.

26

Hakmarrja jonë do të jetë falja[1]

Jetoni mirë. Kjo është hakmarrja
më e mirë.
- TALMUDI

Sot
Në avion
Ora është 17 e 10 minuta

- Nuk ha dot më! - thotë Lajla duke lënë lugën mbi tavolinë.

Marku, Evi dhe Lajla ishin ende të ulur në tavolinë te bar Floridita. Me barkun të mbushur plot, vajza e vogël shikonte me keqardhje akulloren e madhe që kish mbetur akoma e që s'kish mundur ta mbaronte. I ati i përkëdheli me ëmbëlsi flokët

[1] Tomas Borge

dhe pastaj u mbështet pas dritares. Sipër tij shtrihej një tapet resh që zgjatej pafundësisht. Intimiteti që sapo i kishte bërë Evit e kishte zhytur Markun në rrënjët e së kaluarës, duke i ngjallur kujtime të thella nga të cilat ai donte të mbante mend vetëm një gjë:

- Ti nuk duhet të bësh të njëjtën gjë, që bëri Konori, - i thotë Marku Evit. - Ti nuk duhet ta shkatërrosh jetën tënde thjesht për një hakmarrje.

Adoleshentja e shikon me skepticizëm.

- Më duket se ju nuk mund ta kuptoni...

- Pikërisht, sepse e kuptoj shumë mirë po jua them sepse dhimbja jote i ngjan simes! Ti ke dhimbje dhe kjo është e pashmangshme. Ajo që i ka ndodhur nënës tënde është kriminale dhe është më se normale që ti të jesh plot zemërim...

- ...Dhe urrejtje, - plotëson Evi, me sy të përshkënditur.

Marku ia vendos lehtë dorën mbi sup.

- Zemërimi mund të jetë një arsye e fortë, me kusht që të transformohet në forcë pozitive.

- Këto janë trapllëqe psikologu, - i hakërrehet adoleshentja.

Marku analizon atë që i thotë ajo dhe pas pak e rimerr fjalën:

- Hakmarrja nuk do ta shuajë dhimbjen tënde, për këtë duhet të më besosh, dhe dije që nuk është psikologu që po të flet.

- Sikur Konori të ishte këtu...

- Sikur Konori të ishte këtu, do të të thoshte që dhimbja që ke pësuar nuk riparohet kurrë në këtë mënyrë. Ai e ka provuar vetë një gjë të tillë.

- Por... këtij burrit, - belbëzoi Evi me një zë ku ndihej

dhimbja, - këtij Kreg Devisit do të doja t'ia ktheja dhjetë fish, njëqind fish dhimbjen që më ka shkaktuar.

- Nëse ti e vret, kjo nuk do të ta kthejë në jetë mamanë tënde dhe kjo vrasje do të të ndjekë si hije gjithë jetën. Dhe asgjë nuk do të jetë për ty siç ishte më parë...

Marku i serviri një gotë ujë Evit. Ajo njomi buzët në të e më pas fillon t'i rrëfehet Markut me një zë të mallëngjyer:

- Për aq sa mund të mbaj mend unë, nëna ime dhe unë kemi qenë gjithnjë të përbuzura nga tipa si ai...

- E besoj, - u përgjigj mjeku.

- Nuk do të lejoj më që të më shkelin me këmbë.

- Ke plotësisht të drejtë, - i thotë Marku, - por duhet të dish që ka edhe mjete të tjera veç hakmarrjes për t'ia arritur qëllimit.

Evi ngre sytë mosbesuese në drejtim të tij.

- E çfarë duhet të bëj sipas jush?

Marku nguron, duke qenë i bindur se reagimi i saj do të jetë i ashpër:

- Të falësh.

- Jo! Nuk dua të fal, - u revoltua adoleshentja. - Nuk dua të harroj!

- Të falësh nuk do të thotë të harrosh, - filloi të shpjegojë qetësisht Marku, - as të gjesh arsye dhe as ta abstragosh problemin. Ndryshe nga hakmarrja që ushqen urrejtjen, falja na shpëton prej urrejtjes.

Tani është Evi që nguron një çast para se të pyesë me një zë të dridhur:

- Po sikur t'ua kishin vrarë vajzën tuaj, a do të falnit ju?

- Nuk e di nëse do të mundja ta bëja një gjë të tillë, - i flet Marku, pa mundur t'i bënte bisht pyetjes, - por jam i sigurt që do të përpiqesha.

Marku vështroi Lajlën. Ajo po zbavitej me çadrat e vogla prej letre që ishin vendosur mbi akullore.

- Mendoj se të falësh është gjëja më e vështirë në botë, - vijoi Marku, - është pikërisht ajo që kërkon më shumë forcë.

Dhe vijoi me një zë të qetë:

- Në radhë të parë duhet të falësh për veten tënde, Evi. Që të çlirohesh nga e kaluara dhe të kesh më në fund mundësi të bësh një jetë normale.

Evi ngriti supet.

- Për mua gjithçka ka marrë fund tashmë. Nuk më ka mbetur asgjë: as familje, as pará, asnjë perspektivë...

- O Zot i madh! - klithi Marku, - ti ke gjithë jetën tënde përpara! Mos kërko të gjesh arsye të gabuara për të penguar jetën tënde.

- Ai njeri është një vrasës, - lëshohet Evi që i duket sikur po i zihet fryma në kraharor.

Tani Marku e solli bisedën aty ku donte ai për t'i thënë Evit atë që kish në mëndje që në fillim:

- Që ta dish, Evi, unë mendoj se pas këtij Kreg Devisit, personi që në të vërtetë ti kërkon të dënosh...

Adoleshentja priti që ai të mbaronte fjalën. Marku vazhdoi:

- ... në fakt personi që ti do të vrasësh, është vetja jote.

- Jo, - u zemërua Evi, tashmë e mbytur në lot.

Pa i lënë kohë që ta merrte veten nga kjo goditje, Marku vijoi më tej:

- Sigurisht që po! Ti nuk ia fal akoma vetes që vure në dyshim fjalën e nënës tënde. Në njëfarë mënyre, ti ndihesh përgjegjëse për atë që i ndodhi mamasë, dhe këtë nuk e duron dot.

- Nuk është e vërtetë! - po mbrohej Evi, por lotët që i rridhnin rrëke mbi faqe vlenin më shumë se çdo lloj pohimi.

- As mos mendo që gjërat do të kishin marrë tjetër rrokullimë, - u mundua Marku ta bënte të arsyetonte. - Asgjë nuk është për fajin tënd Evi, asgjë.

Tashmë adoleshentja po qante me dënesë, me gulçima.

- Përse e bëra këtë? Përse nuk i besova mamasë?

- Mjaft tani, mjaft, - i thotë Marku duke e rrokur në krahët e tij.

- Ajo gjithnjë më kishte gënjyer, por jo këtë herë, jo këtë herë.

- Mjaft, qetësohu tani.

Pa u përmbajtur, Evi e lëshoi veten me kokën të mbështetur në supin e Markut. Pa e pritur as ajo vetë një gjë të tillë, Marku e kish çliruar nga diçka që ishte rrënjosur shumë thellë tek ajo.

Për më se një minutë, askush prej tyre nuk foli, deri sa Lajla të pyeste me zë të ulët:

- Babi, pse po qan Evi?

- Sepse ajo ka një brengë shumë të madhe.

- Për shkak të mamasë së saj?

Marku ia pohoi me një lëvizje të kokës, dhe Lajla e shtrëngon Evin pas vetes.

- Mos u ligështo, - i thotë Lajla, duke përkëdhelur flokët e Evit.

Disi më e qetë, Evi ngriti sytë në drejtim të Markut. Ky i zgjati një shami letre dhe pas pak, një lloj flladi mirënjohje u shpërnda midis tyre.

- Babi, më bëhet çiçi, - lajmëroi Lajla papritmas me një zë bebeje.

- Eja se po të shoqëroj unë, - i tha Evi.

Marku iu dha miratimin me shikimin e tij dhe ranë dakord që pastaj të shiheshin në vendet e tyre. Ndërsa Marku bënte pagesën, ai pa me mall Evin dhe Lajlën të largoheshin të dyja. Ato ishin zënë për dore, si dy motra ku njëra kujdesej për tjetrën.

* * *

Marku, pasi pagoi e i la një bakshish të mirë Isakut, ishte duke u larguar nga *Floridita.*

Pikërisht në atë kohë ai e pa.

E ulur në pjesën e prapme të sallës, e vetme, Elison Harrisoni po mbaronte kupën e dytë me shampanjë *dom perinjon.*

- *Pink Champagne...* konstatoi Marku duke iu afruar tavolinës ku ndodhej trashëgimtarja Elison.

Elisoni hoqi syzat e saj të diellit dhe ngriti sytë për të parë.

- Mos do të më thoni prapë se kjo ishte pija e preferuar e Heminguejit? Unë më shumë do thosha uiski...

- Po mund të themi se ishte pija e preferuar e Keri Grentit dhe e Deborah Kerrit [1].

Me një lëvizje të dorës ajo e ftoi të ulej. Që nga biseda intensive e mëparshme, ajo shpresonte se ai do të vinte përsëri. Ky burrë, portreti i të cilit nuk ishte i panjohur për të, kishte një tërheqje magnetike të çuditshme, që nuk kishte aspak të bënte me sharmin e tij ose me kortet që i bëhen një femre. Por

---

[1] Këtu bëhet aluzion për një skenë të famshme të filmit Ajo & Ai i regjizorit Leo McCarey.

në fakt kur iu hap atij pak më parë, asaj iu duk sikur u çlirua nga ndjenja e terrorit që, prej kohësh, kish zënë vend brenda saj.

- Përse kam përshtypjen sikur ju njoh? - pyeti ajo.

- A janë akoma të modës këto shprehje kur kërkon t'ia luash dikujt? - u çudit edhe vetë Marku me këtë lloj shakaje që bëri me të.

- Jo, e kam seriozisht.

Marku foli hapur fare:

- Le të themi që kisha edhe unë një çerek ore lavdi mediatike, para disa vjetësh.

- Në çfarë fushe?

- Në psikologji. Në atë kohë kam dalë shpesh në CNN dhe MSNBC. Isha psikologu në shërbim të qytetarëve, ai që mundohet të qetësojë qytetarët pas ndonjë ngjarje tragjike: vrasjet në liceun 'Columbine', atentatet e 11 shtatorit, sulmet me antraks...

- Po tani nuk e ushtroni më?

- Jo, i kam dhënë fund.

- Pse?

- Një ngjarje tjetër tragjike më detyroi ta bëj një gjë të tillë. Veçse këtë radhë e kisha unë mbi kurriz. Në të tilla raste e kupton se të gjitha këshillat që u jep të tjerëve nuk munden, në fakt, të bëjnë asgjë të madhe kur gjendesh para dhimbjes tënde.

Një hije e rëndë mbuloi tërë fytyrën e mjekut. Elisonin mezi e mbante vendi për të ditur më tepër, por pllakosi një heshtje dhe Elisoni filloi të mendojë për andrallat e ankthet e veta. Alkooli që kish gëlltitur gjatë gjithë udhëtimit, i shkaktonte tashti dhimbje koke. Pavarësisht nga kjo, kishte edhe një kupë

shampanjë që e rrëkëlleu menjëherë. Donte të vazhdonte të pinte, por Marku vendosi dorën e tij mbi të sajën që ajo të hiqte dorë.

- Nëse do jenë të detyruar t'ju mbajnë në krahë kur të zbrisni nga avioni, kam përshtypjen se do t'u jepni shumë punë paparacëve. Mos ua u jepni këtë kënaqësi.

Ajo ngriti supet.

- Se mos është hera e parë që duan të më poshtërojnë.

- E përse keni gjithë këtë duf kundër vetes suaj?

- Sepse kjo është e vetmja liri që më ka mbetur, - thotë ajo me sytë shpuzë. - Sepse jeta ime nuk ka më asnjë vlerë.

- E di që burrat përgjithësisht nuk e bëjnë këtë pyetje, por më thuaj çfarë moshe keni Elison? 24? 25?

- 26.

- E si mund të thuhet që jeta nuk ka asnjë vlerë kur je vetëm 26 vjeçe?

- Aty qëndron edhe problem im.

Marku e provokoi qëllimisht:

- Hiqe nga mendja se unë mund të ulem aty e të qaj hallin ty. Ju i keni të gjitha ato që një njeri dëshiron t'i ketë: pará, rini, pa dyshim shëndet... Ju pretendoni se jeta juaj nuk ka më vlerë, atëherë ndryshojeni atë. Bëni diçka tjetër, me njerëz të tjerë. Ju mund t'ia rifilloni madje edhe nga zeroja. T'i bëni vetes një fytyrë tjetër, një identitet tjetër me emër tjetër, një jetë të re.

- Asnjëherë nuk mund ta fillosh jetën nga e para, atë vetëm e vazhdon. Të gjithë e dinë këtë, zoti psikolog.

- Sot në mëngjes, unë ju bëra një pyetje, por ju nuk m'u përgjigjët.

- Nuk më kujtohet, - thotë ajo, disi e zënë ngushtë.

- Ju pyeta përse donit ta dënonit veten.

Elisoni nuk përgjigjet menjëherë. Pastaj një ndjenjë e pa përballueshme e pushton që t'ia thotë gjithçka këtij të panjohuri, të cilin e njihte vetëm prej disa orësh. Ngutja për t'u çliruar nga sekreti i saj, që po e bënte të plaste. Ishte shumë i fuqishëm. Natyrisht që pasojat ishin të tmerrshme: burgim... turpërim... Por po ta mendoje mirë, jeta e saj kishte vite që ishte kthyer në një burg. Ndërsa për sa i përket turpit...

Kur ndeshi shikimin e gruas, Marku e kuptoi se ishte hera e fundit që ai ia bënte këtë pyetje:

- Përse doni ta dënoni veten tuaj?

- Sepse kam vrarë një djalë të vogël, - përgjigjet Elisoni.

27

Elisoni
Flash backu i tretë

Beverly Hills, Kaliforni
Pranverë 2002

Ora është dy e pasdites.

Në dhomën e një vile luksoze të Mesdheut, Elisoni hap njërin sy që sakaq e mbyll menjëherë.

- *Olele, koka!*

Dje në mbrëmje, ajo ka organizuar një mbrëmje të madhe për të festuar ditëlindjen e të dashurit të saj të çastit. Ishte një grumbullim i rinisë në modë të Beverly Hillsit, i cili vazhdoi deri natën vonë. Elisoni ra për të fjetur vetëm në orët e para të mëngjesit, gati për të vjellë ngaqë kishte pirë më shumë se ç'duhej e ishte rregulluar mirë.

Kur më në fund sheh se sa është ora, shan me vete dhe ngrihet menjëherë nga shtrati.

Dreq o punë!

Ajo ka premtuar se do të merrte pjesë në inaugurimin e një salle të re sportesh për VIP-at në *Huntington Beach*, dhe është shumë me vonesë. Bën disa hapa në drejtim të tualetit, por e ka të vështirë të zgjohet vërtetë nga gjumi. Një gjë si darë e fortë ia shtrëngon tëmthat, ka djegie në stomak, gojën e ka të thatë dhe qepallat të ngjitura. Tani i vjen vërtet keq për gjithë ato gota vodkë të pira, për tekilat që i rrëkëllente duke buzëqeshur. U bënë disa vjet që ajo ngrihet nga gjumi me një kokë të rënduar. Dhe çdo herë pasi ngrihet në këtë gjendje betohet se nuk do të pijë më, por vendimet e saj nuk mbahen asnjëherë.

Pasi i hodhi një grusht ujë fytyrës, çapitet deri në kuzhinë ku Graciela, guvernantja e vjetër portorikane, po mundohet që nga mëngjesi të vërë rregull pas zallamahisë së një dite më parë.

- Përse nuk më zgjove? - e qorton Elisoni.

- Ti nuk më the gjë.

- Pse çfarë prisje ti? Ora është 2 e pasdites!

Punëtorja portorikane nxjerr një pjatë nga furra e sobës dhe e vendos mbi tavolinë.

- Eja, të kam përgatitur këto ëmbëlsirat ashtu siç të pëlqejnë ty.

Por Elisoni e shtyn pjatën gjithë mllef.

- Gjëra me yndyrë dhe me sheqer! Mos je gjë e çmendur? Nuk dua të bëhem një trashaluqe si puna jote!

Graciela e dëgjon pa u ndjerë. Ka mbi njëzet vjet që punon për Riçard Harrisonin dhe Elisonin e njeh qëkurse ka lindur.

Më përpara merreshin vesh shumë mirë njëra me tjetrën. Elisoni i tregonte se si e kalonte ditën, preokupimet dhe sekretet e saj. Por ka disa kohë që marrëdhëniet e tyre po bëhen më të ftohta.

Elisoni, mahmur siç është, mbush tasin me drithëra duke u hedhur sipër ca lëng portokalli.

- Më dhëmb barku, - ankohet ajo duke hapur dritaren.

Kuzhina ka pamje të mrekullueshme me një pishinë më formë kitare. Elisoni ulet një moment në një karrige por detyrohet të ngrihet nga pikat e shiut që fillojnë të bien.

- *Edhe kohën paskemi mangët sot*! - shfryn gjithë inat.

Futet në kuzhinë dhe kërkon aspirina *efervesheute*, dy prej të cilave i fut në një gjysmë gote ujë.

- Do ishte më mirë të merrje paracetamol, - i thotë Graciela. - Aspirina mund të t'i shtojë djegiet e stomakut.

- E ku merr vesh ti nga kjo punë? - acarohet Elisoni. - Ti nuk je mjeke, je punëtore shërbimi!

Pastaj shkon në banjë dhe bën një dush të ftohtë, që nuk e qetëson aspak. Shkon në dhomën e saj, vesh shpejt një xhins Blue Cult, sandale romane Ferragamo, pastaj, ashtu si e tërbuar, kthen përmbys të gjithë dollapët duke kërkuar se çfarë të veshë nga sipër.

- Ku e ke vënë? - ulërin Elisoni duke u shfaqur gjithë nerva në kuzhinë.

- Çfarë? - pyet Graciela.

- Këmishën time!

- Ti ke me qindra.

- Këmishën time ngjyrë rozë *Stella McCartney*!

- Nëse nuk e gjen, duhet të jetë në pastrim kimik.

- Po unë të thashë ta lash me dorë!

- Nuk më ke thënë absolutisht asgjë. Dhe mjaft me kapriçot e tua, Eli. Je 22 vjeçe e jo 12.

- Kush të lejon ty të më flasësh në këtë mënyrë, - hakërrehet Elisoni.

- Po të flas njëlloj sikur të të fliste mamaja jote po të ishte gjallë.

- Ti nuk je mamaja ime, ti je e punësuara ime.

- Unë vërtet jam e punësuara jote, por do të ta them të vërtetën troç: po bëhesh e padurueshme Elison. Po sillesh si një fëmijë i llastuar, e cekët dhe egoiste. Nuk ke më as shpirt e as njerëzillëk. E ke lënë veten të zhytesh në të gjitha veset e këqija që ka paraja: përbuzja dhe humbja e vlerave. Ti akoma nuk e ke kuptuar që pasuria të jep të drejta, por edhe detyrime. Por, në fakt ti, as që do t'ia dish për detyrimet! Nuk ke asnjë projekt për jetën tënde. Është e vërtetë që jam e punësuara jote, vogëlushe, por më lejo të të them, që ka disa kohë që më vjen turp për ato që bën ti...

E ofenduar nga e vërteta e ashpër që i përplas në fytyrë Graciela, Elisoni merr tasin me drithëra dhe pa e kontrolluar fare veten, e vërvit në drejtim të Gracielës.

Graciela është një grua e vjetër, por ka reflekse që i japin mundësi të shmangë objektin që i erdhi përballë, i cili përplaset dhe thyhet në mur.

Për ca çaste të dyja gratë rrinë si të shtangura, njëra përballë tjetrës, të paralizuara nga dhuna dhe shpejtësia e përballjes së tyre.

Elisoni largohet e para duke ja mbathur nga shtëpia dhe futet në makinën e saj, një fuoristradë e kuqe. Duke u dridhur me sy të hapërdarë, ndez makinën dhe ikën me vrull.

* * *

Përse e bëra këtë?

Një shi i furishëm, i shoqëruar me vetëtima e bubullima po bie tani mbi shtëpitë e ndërtuara rresht njëra pas tjetrës dhe në lulishtet e tyre të mbajtura shumë bukur. *Jeep*-i *Wrangler* po ecën me shpejtësi të madhe në rrugën e qarkuar nga palma dhe pemë të tjera dekorative.

Përse u tregova kaq e shpifur? pyet veten Elisoni, me sytë plot lot.

Të gjitha ato që i tha Graciela janë të vërteta. Ka disa kohë që po sillet si një hajvane. Abuzimi me alkoolin dhe me drogën e pengojnë që të zotërojë veten dhe impulsiviteti e çon shpesh deri në buzë të greminës.

Ndërsa shiu vazhdon të bjerë më me furi, Elisoni ka lënë mbrapa kodrat e zbukuruara të Beverly Hillsit për t'u futur në zonën e *raiwways*-it kalifornian. Pa e pasur mëndjen drejtohet për nga *Huntington Beach*, por ajo e di që nuk do të shkojë në inaugurim.

E dërrmuar nga turpi që ndjen, mundohet të qetësohet e të vendosë rregull në kokën e saj. Duhet të ndryshojë patjetër mënyrën e saj të jetesës. Kjo është urgjente. Përndryshe do të rrëshqasë dhe më e pandreqshmja mund të ndodhë.

Elisoni e ul shpejtësinë dhe fshin lotët. Shiu i furishëm vazhdon të bjerë aq sa fshirëset e xhamave e kanë të vështirë të pastrojnë xhamat nga uji.

Elisoni mundohet të mbledhë veten. Është e re, ka humbur vetëm disa vite. Ajo ka akoma kohë për të ndryshuar jetën e saj, të rifillojë studimet, të mos takohet me miqtë që në fakt

nuk janë miq dhe të mos dalë më me ata pasanikët pordhacë që nuk kanë dy gram tru.

Një erë e furishme e shkund edhe *jeep*-in e saj. Në autostradë, tabelat rrugore njoftojnë për kujdes.

Elisoni pothuajse e ka rimarrë veten. Ja, tani do të kthehet në shtëpi, t'i kërkojë falje Gracielës dhe ta falënderojë që po i hapte sytë. Do ta kalojë pasditen me të, do ta vërë në dijeni për vendimet e mira që ka marrë dhe ashtu siç bënte kur ishte e vogël, do ta ndihmonte që të përgatisnin për të ngrënë. Këtë lajm të mirë do t'ia thotë edhe të atit në mbrëmje. Dhe kombinohej mirë sepse këtë javë Riçardi do të ishte në Los Anxhelos. Ai kish pasur gjithnjë projekte të mëdha për të bijën, por ajo ishte larguar nga ai për ta sfiduar, thjesht nga idiotësia e saj. S'kishte rëndësi, ai do të ishte përsëri krenar për të!

Ngaqë kishte ngut ta vinte planin e saj në zbatim, Elisoni futet në mes të makinave për të kapur daljen më të parë nga autostrada. Autostrada shtrihet në një nga këto zonat tipike të Los Anxhelosit ku parkingjet janë rresht njëri pas tjetrit bashkë me zonat tregtare. Elisoni përqendrohet me sy për të parë tabelat ngaqë shikimi ishte mjaft i kufizuar. Duhet thënë se sensi i orientimit nuk është një nga pikat e forta të saj. E humbet daljen që i duhej dhe gjendet në rrugën që të çon në një parking sipërfaqësor. Shiu i dendur, i kombinuar me erën e fortë, është vërtet impresionues. Elisoni mendon për filmin *Magnolia*, i cili përfundon me një shi të mistershëm e të llahtarshëm. Shumë vetura janë ndalur në anë të rrugës në pritje që stuhia të qetësohet, ndërsa Elisoni vazhdon rrugën.

Papritmas bie zilja e telefonit. Celularin e ka brenda në çantë, në ndenjësen tjetër.

Të gjithë e dimë që nuk duhet të përgjigjemi kur jemi duke

ngarë makinën, por megjithatë nuk e respektojmë...

Elisoni ulet për të kapur celularin. Thotë me vete, thjesht sa të shoh se kush më ka marrë. Do ta marrë më vonë në telefon...

Goditja është e fortë dhe e papritur.

Elisoni ngrihet e trembur. Ajo është përplasur me diçka. Mos është ndonjë qosh trotuari? Ndonjë kafshë? Shtyp pedalin e frenit me forcë dhe hap derën. Brenda tre sekondash pulsi i saj kardiak është dyfishuar. Sa zbret nga makina, ajo që kishte frikë se mos ndodhte, kishte ndodhur: nuk ishte diçka që ajo kishte përplasur...

Ishte dikush.

Një fëmijë.

* * *

- Mirë je? Të dhemb gjë?

Elisoni nxiton në drejtim të djalit të vogël dhe ndjen llahtar e tmerr nga pamja e këtij trupi pa jetë. Trupi i tij është i vogël, i njomë. Nuk ka njolla as në rrobat e fëmijës e as në tokë, por ka shumë mundësi që koka t'i jetë përplasur me një nga kolonat e betonit të trotuarit.

Tërësisht e çorientuar, Elisoni kthen kokën gjithandej, duke kërkuar një mbështetje.

- Ndihmë, ndihmë!

Por vendi rreth e rrotull është i shkretë. Shiu, bubullimat dhe vetëtimat nuk kanë të pushuar dhe për pasojë nuk ka këmbë njeriu në rrugë.

Mos u alarmo! Mos u alarmo!

Elisoni kthehet te makina, merr celularin dhe bëhet gati

të marrë numrin 911, por numri i urgjencave del i zënë, ndoshta për shkak të motit të keq.

Provon të marrë në telefon një herë të dytë, një herë të tretë, por pa rezultat.

Ashtu e bërë qullë nga shiu, ajo vendos ta çojë vetë në spital.

Duke bërë kujdesin më të madh, ajo e merr në duar fëmijën deri te *Jeep*-i.

- Eja, do të shpëtosh. Mos u dorëzo!

Niset, dhe ndonëse në panik të plotë, arrin të marrë autostradën. *General Hospital*-i në lindje të qytetit nuk është shumë larg.

- Mos vdis!

Elisoni kullon nga shiu e nga lotët. Ajo nuk beson te Zoti, por megjithatë i lutet atij:

Ju lutem, shpëtojeni! Shpëtojeni ju lutem!

Jashtë, çdo gjë është e errët dhe e tjetërsuar nga stuhia. Ora është 3 e pasdites, por të krijohej përshtypja sikur ishte natë.

Mos më dënoni me vdekjen e tij.

Elisoni tani ndodhet në parkingun e urgjencave por hyrja kryesore është bllokuar nga dy kamionë zjarrfikësish që po bëjnë manovrime. Në vend që të presë që ata të hapin rrugën, Elisoni preferon të ndjekë shigjetat e ndritshme që të drejtojnë në parking. Pasi e parkon *Jeep*-in, Elisoni del nga makina, vjen rrotull dhe e merr fëmijën në duar. Por kur e merr para duarve, vë re se djali i vogël ka vdekur.

Lëshon një klithmë, pastaj në një gjendje krejt tjetër e shtrëngon fort pas vetes.

Ka kaluar njëfarë kohe kur kujtohet të mbyllë dyert e

makinës. E trembur në palcë, pa ditur se çfarë duhet të bëjë, zhytet në një dëshpërim. Dhe më në fund, kujtohet dhe merr në telefon të atin.

* * *

Një gjysmë ore më vonë

Shiu ka pushuar dhe një mjegull e lagësht ka mbuluar parkingun.

Një *Hummer* i madh me xhama të errët futet në zonën e *General Hospital*. Riçard Harrisoni zbret i pari, i shoqëruar nga një zezak i fuqishëm me një trup impresionues. Kurtisi është truproja i Riçardit dhe njëkohësisht njeriu që bën gjithçka dhe i mbulon pisllëqet atij. Gjatë gjithë karrierës së tij, biznesmeni Harrison është treguar i kujdesshëm që të grumbullojë rreth vetes një numër të vogël njerëzish të cilët i detyrohen për gjithçka dhe që janë gati të japin edhe jetën e tyre për të. Kurtisi është njëri prej tyre.

Ata e dallojnë menjëherë Elisonin, ulur në një bordurë, me kokën të rrasur në krahët e kryqëzuar. Rrobat i janë bërë qullë. Pa jetë, ajo dridhet, kërcet dhëmbët dhe duket sikur ka kaluar në fazë. Në një nga duart e saj të shtrënguara fort mban byzylykun prej argjendi të fëmijës, i cili i kishte rënë në makinë. Riçardi përkulet pranë vajzës së tij, i vë dorën në fytyrë dhe vë re që ajo digjet nga temperatura.

- Çoje në shtëpi, - i thotë ai Kurtisit. - Do merret Graciela me të. Telefonoji doktor Jenkinsit nëse gjërat përkeqësohen dhe avioni të jetë gati.

Ndërsa Kurtisi e mbështjell Elisonin me një batanije dhe pastaj e çon tek *Hummer*-i, Riçardi hap derën e *Jeep*-it, dhe sheh aty kufomën e një fëmije dhe e mbyll menjëherë.

- Po "pjesa tjetër" - pyet Kurtisi me një zë pa jetë.

- Merrem unë me pjesën tjetër, - përgjigjet Riçardi.

* * *

Shkretëtira e Mojavës
Në Lindje të Kalifornisë

Riçardi po e ngiste që prej tri orësh *jeep*-in e së bijës. Ishte larguar nga megapoli plot tentakula për t'u zhytur në shkretëtirë. Një udhëtim në fund të tmerrit, duke pasur në ndenjësen e pasagjerit një batanije skoceze ku ishte mbështjellë, si në një qefin, kufoma e një fëmije. Edhe në makthet e tij më të llahtarshme Riçardi s'e kish parë veten se një ditë do t'i duhej të kalonte nëpër një kalvar të tillë. Megjithatë në jetën e tij ai kish kaluar lloj-lloj dallgësh: Vietnamin e 1965-ës, kur ai ishte oficer i ri, kancerin e së shoqes të cilën e kish shoqëruar në të gjitha fazat e sëmundjes, luftën ekonomike që ai jetonte çdo ditë në botën e biznesit... Kur ishte adoleshent, për të mposhtur frikën, u dilte gjithnjë përpara ngjarjeve, duke parashikuar me mend, ngjarjet më të këqija që mund të ndodhnin, me shpresë që t'i zbuste e t'i bënte si të pavlefshme. Me moshë, u bë më i fortë, por këtë zakon për t'iu dalë gjërave përpara e kish ruajtur. Kështu, këto vitet e fundit ish përgatitur për sëmundjen që kishte edhe për vdekjen, dhe e ndjente veten të zotin t'i përballonte me trimëri. Por asnjëherë nuk i kish

ndodhur që të mendonte për *këtë rast:* të varroste me duart e tij një fëmijë që e kish vrarë e bija. Dhe pyeste veten nëse do të ish në gjendje ta çonte deri në fund këtë veprim. Që kur ish nisur nga Spitali, ish ndalur shpesh rrugës për të vjellë dhe tani e ngiste makinën me xhama të hapur se i dukej sikur ajri në makinë i zinte frymën. Pavarësisht nga kjo, ai vuante shumë e i dukej se do të kishte një krizë vaskulare. Por nuk mund ta braktiste të bijën. Para disa kohësh ajo ishte dënuar me tre muaj heqje të patentës në gjendje të dehur. Dhe nëse e ndalonin tani që kishte shtypur një fëmijë pa pasur patentë, do të dënohej me disa vjet burg, dhe në këtë rast, pavarësisht marrëdhënieve të tij, ai nuk do të mund të bënte gjë për ta shpëtuar.

U mundua të bindë veten se mund ta shpëtonte të bijën nga burgu. Pak para se të mbërrinte në Palm Spring, ai kish ndaluar në një dyqan veglash dhe kish blerë një kazmë dhe një lopatë. Kish paguar me pará në dorë, dhe e kish kthyer kokën anash që të mos ia fiksonin kamerat e survejimit dhe ishte pothuajse i sigurt se askush nuk e kishte njohur. Ai ishte njëri nga njerëzit më të pasur të vendit, ku përveç shtypit ekonomik, ai nuk kish një mbështetje mediatike si Bill Gates ose *Warren Buffet*. Kështu që ishte i bindur që personi që i kish shërbyer në arkë lexonte më shumë *TV Guide* se sa *Bussines Week*.

Ndërsa Elisoni, ishte tjetër gjë. Me bëmat e saj, e bija kish fituar një famë të madhe tek lexuesit e shtypit, ose thënë ndryshe, te të gjithë në Los Anxhelos. Nga ana tjetër, përveç atyre që i kish thënë e bija në telefon, Riçardi e kish të vështirë të besonte se nuk kishte pasur asnjë dëshmitar në aksidentin e sapo ndodhur dhe kish frikë se policia do ta gjente menjëherë. Prandaj atij i duhej të vepronte shpejt. Shumë shpejt.

* * *

Akoma edhe për një orë tjetër *Jeep*-it iu desh të përshkonte masivin malor dhe fushat shkëmbore ku rriteshin vetëm kaktuse. Ndërsa po bëhej natë, Riçardi mbërriti në një sipërfaqe të shkretë, jo shumë larg kufirit të Nevadës. Doli nga rruga kryesore dhe u fut në një zonë me gurë, pluhur dhe shkëmbinj të zhveshur. Në mes të kësaj toke të thatë, gjeti një copë vend disi të mënjanuar, me tokë të shkrifët, por disi e mbrojtur nga një pemë Joshua.

Ky vend iu duk i përshtatshëm dhe e ndaloi veturën duke i lënë dritat ndezur.

Ora ishte shtatë e mbrëmjes kur ai dha goditjen e parë të kazmës.

Ora ishte dhjetë kur ai e futi trupin në varr.

Ora ishte dymbëdhjetë e natës kur i hodhi lopatën e fundit me dhé.

Në orën 1 të natës Riçardi bëri lutjen e fundit dhe mori makinën për t'u kthyer.

Në ora tre të mëngjesit, Kurtisi e priste në mes të askundit për t'i vënë flakën makinës.

Në orën gjashtë të mëngjesit Riçardi u kthye në Beverli Hills dhe e shoqëroi të bijën në aeroport.

Dy orë më vonë, avioni privat i miliarderit po fluturonte në drejtim të Zvicrës, me Elisonin në bord.

* * *

Riçardi qëndroi në Shtetet e Bashkuara duke pritur se çfarë do të ndodhte më tej.

Asgjë nuk ndodhi ditën e parë. As të dytën, as të tretën e të katërtën.

Një javë më vonë, Riçardi ishte i mendimit se tani askush nuk do të vinte t'i shqetësonte, as të bijën e as atë vetë.

Por, a mund të fshihet nga kujtesa një veprim i tillë dhe të bësh sikur asgjë s'ka ndodhur?

28

Jetën e ke përpara

E ardhmja është një dhuratë
që na bën e kaluara.
- ANDRÉ MALRAUX

Sot
Në avion
Ora është 18.00

Zonja, *Zotërinj, pas pak avioni ynë do të fillojë uljen e tij drejt Nju Jorkut. Ju lutemi kthehuni në vendet tuaja, drejtoni mbështetësen e kolltukut dhe sigurohuni që e keni vënë mirë rripin e sigurimit.*

Njoftimi i shefit të ekuipazhit e ndërpreu papritmas rrëfimin e Elisonit. Sikur të dilte nga një ëndërr e keqe, ajo ngriti sytë dhe pa rreth e rrotull saj. Floridita kish filluar të boshatisej dhe dy stjuardesa i ftonin pasagjerët të shkonin në vendet e tyre.

- Ajo që kam bërë është e pafalshme, - thotë Elisoni, duke fshirë sipër qepallave njollat e rimelit. - Dhe më e keqja është se e lashë babanë tim të merret me të gjitha këto. Pas kësaj drame, qëndrova për disa muaj në Zvicër, duke shkuar në një qendër kurash dezintoksikimi dhe depresioni. Kur u ktheva, me babanë, bëmë sikur nuk kish ndodhur asgjë!

I tronditur dhe i llahtarisur nga tregimi i Elisonit, Marku megjithatë, u mundua të gjente fjalët e duhura:

- Asgjë nuk është e pafalshme, por në jetë ka gjëra që mund t'i ndryshojmë. Ju mund t'i shkaktoni vetes të gjitha vuajtjes e botës, por fakti është se ky fëmijë nuk do të kthehet më në jetë.

- Ky nuk është ngushëllim.

- Dakord, dhe unë nuk dua aspak t'ju ngushëlloj. Ju duhet të merrni përgjegjësitë tuaja dhe të merrni rrezikun në sy që të keni më shumë dhimbje. Por jeta juaj nuk ka përfunduar. Ka shumë gjëra për të cilat ju mund të angazhoheni Ju mund t'i vini në ndihmë fëmijëve të tjerë në nevojë, të investoni në aksione sociale ose humanitare. Dhe jo vetëm me paratë tuaja. Këtë e keni ju në dorë, por mos u bëni skllave e të kaluarës. Dhe për më tepër, ne mbase nuk i kuptojmë të gjitha...

Marku e la fjalinë e tij pezull. Ai mendonte për të bijën që mrekullia kish dashur që ta gjente dhe për dhimbjen e tij. Shikimi që i hodhi Elisoni ishte ftesë që të vazhdonin bisedën.

- Ndoshta edhe vuajtja nuk është e panevojshme, sepse mbase ajo i hap udhë diçkaje tjetër, - sugjeroi Marku.

- Ndoshta ne nuk e kapim kuptimin e të gjitha këtyre.

Trashëgimtarja uli sytë dhe pyeti:

- Çfarë kuptimi mund të ketë në vdekjen e një fëmije?

I zënë ngushtë, Marku hapi gojën, por nuk gjeti asnjë fjalë për t'ju përgjigjur.

* * *

- Duhet patjetër të shkoni në vendin tuaj zotëri, - i tha një nga stjuardesat duke e detyruar të ngrihej nga tavolina.

Me shikimin të tretur tek ai i Elisonit, Marku u ngrit mekanikisht. Do të kish dashur t'i fliste më shumë, ta bindte që të mos mbetej skllave e kësaj drame, por ta nxiste e ta inkurajonte që të ndërtonte një të ardhme, pa fshirë të shkuarën e saj.

Tani avioni filloi të ulej përmes reve. Kësaj here stjuardesa u bë më këmbëngulëse dhe e shoqëroi mjekun deri te pontili kryesor.

Nga nxitimi Marku harroi portofolin mbi tavolinën e Floriditas. Kur Elisoni e pa portofolin e tij, Marku nuk ishte më aty. E mori dhe po e shikonte. Vuri re se lëkura ishte e ngrënë, por megjithëse kishte dëshirë, nuk e hapi. E futi në xhep dhe vendosi t'ia japë më vonë.

Sikur të ishte një premtim për ta takuar prapë.

* * *

Në të njëjtën kohë Konori në Manhatan, i hodhi një sy orës ultramoderne që zbukuronte murin e zyrës që kishte në klinikën Mozart. Në këtë klinikë ai trajtonte rastet më të rënda që nuk i trajtonte dot në kabinet. Në më pak se një orë do të takohej me Markun, dhe këtë çast e priste edhe me padurim edhe me një lloj shqetësimi.

Disa metra larg tij, e ulur në një kanape me linja të rregullta, Nikola kish hequr këpucët dhe kish mbledhur këmbët nën vete. Konori vuri re se ajo po dridhej dhe i solli një mbulesë të cilën e hodhi sipër gjunjëve para se ta falënderonte me shikim. I vuri dorën mbi sup, dhe për një çast, secili qëndroi i heshtur. Dielli që po perëndonte në drejtim të Battery Park, shpërndante nëpër dhomë një dritë të ngrohtë, ngjyrë çaji, që kontrastonte me ngjyrat blu dhe të ftohta të klinikës.

- Si mendon ti se do të reagojë kur të marrë vesh të vërtetën? - pyeti Nikola.

Këtë pyetje i bënte vetes edhe Konori. Miqësia që kish për Markun, a do t'i rezistonte dot asaj që do të ndodhte? Për t'u bindur edhe vetë, atij iu kujtua nata e tmerrshme e Krishtlindjeve ku, tre qenie në pikë të hallit ishin përqendruar tek ai...

29

Nata ku filloi gjithçka (vazhdim)

Nëse nuk e di se ku po shkon,
kujtohu nga po vjen.
- PROVERBË AFRIKANE

Nata e Krishtlindjeve, në zemër të Manhatanit...

Ora 3 e 30 minuta - Konori & Elisoni

Dëbora shkëlqen nën llambadarët e Sohos.

Pasi e ka parkuar veturën Aston Martin, Konori kthehet në apartamentin e tij, një ambient i ftohtë dhe pa stil, që ai e përdor vetëm për të fjetur. Kur ndez çelësin e dritave, ndizet vetëm një llambushkë e vogël në tavan, sikur apartamenti të ishte një kantier ndërtimi. Me mendjen gjetiu, Konori përshkon sallonin me parket të bardhë, ku akoma gjenden ca kuti kartoni të cilat nuk ka pasur kohë t'i hapë akoma. Edhe kuzhina është

po aq e zhveshur sa edhe salloni. Raftet janë bosh dhe pllakat e sobës me xham qeramike shkëlqejnë ngaqë janë akoma të papërdorura. Në frigoriferin e kromuar, Konori merr një shishe verë *Chardonnay* dhe e kthen një gotë para se të kthehet në sallon. Ngaqë ambienti është akull i ftohtë, ngre termostatin e ngrohjes, por aparatura nxjerr vetëm ajër të ftohtë. Për t'u ngrohur pak, rrëkëllen një gotë të dytë me verë e pastaj një të tretë. Ndoshta do kish bërë më mirë të mos e kish marrë shishen nga frigoriferi. Siç i ndodh shpesh, kur është jashtë pune, ndjen një boshllëk brenda vetes. Një boshllëk që asgjë dhe askush nuk mund t'ia plotësojë: asnjë njeri, asnjë pasuri, asnjë lloj droge. Kështu është pra, jeta e tij private është një pasqyrim i apartamentit të tij: dëshpërimisht bosh.

Duke liruar kravatën, drejtohet nga xhamlleku i sallonit. Atje poshtë, në trotuar vëren, se, edhe plaku prej dëbore të cilit i vari shallin e tij, është po aq i vetmuar sa ai vetë. Konori e ngre gotën si për t'i thënë gëzuar shokut të tij të pafat në trotuar pastaj lëshohet në kanape dhe ndez fare pa e pasur mendjen, ekranin e madh e të sheshtë që është i varur në mur. Ia ul zërin dhe mjaftohet duke e shtypur nga një kanal në tjetrin. Në një kanal kinemaje jepen fragmente nga filma të vjetër ku fundi i tyre zgjidhet në natën e Krishtlindjeve: *Është një jetë e mrekullueshme, Mrekulli në rrugën nr. 34...*

Në besimin popullor, kjo natë duhet të jetë e veçantë. Nata ku çdo gjë mund të ndodhë...

Idiotësira!

Konori mbyll sytë. Imazhi i Evit, kjo vajzë e çuditshme dhe e trishtuar, e cila deshi t'i vidhte çantën, vazhdon të endet në mendjen e tij. Ai e di që ajo do ta kalojë natën në frikë e në të ftohtë. Ai e ndjeu që ajo ishte në buzë të greminës, e

konsumuar nga pesha e urrejtjes, dhe nuk mundi ta ndihmojë.

Këtë gjë nuk po ia falte vetes, ndërsa dëgjohet zilja e telefonit. Vrenjtet. Me siguri do të jetë Nikola që ai kish harruar ta merrte në telefon. Ai sheh numrin e afishuar ku lexohet: "Thirrje private".

- Alo?

- Ju jeni... ju jeni Konor Mekkoi?

- Po.

- E di që është vonë dhe që po ju shqetësoj, por...

Është një zë gruaje, shumë e re në moshë, e cila duket sikur ka ankth:

- ... Babai më tha t'ju takoj... Ai më tha se ju jeni i vetmi që mund të më ndihmojë...

Të gjitha fjalët e saj ndërpriteshin nga lemza.

- Çfarë problemi keni? - e pyet mjeku.

- Kam vrarë dikë.

Për një çast Konori e humbi pusullën. Në anën tjetër të telefonit, ka vetëm ngashërime, gulçima dhe psherëtima.

- Duhet të qetësoheni zonjushë, - e këshillon Konori. - Më thoni ju lutem kush jeni ju?

- Unë quhem Elison Harrison.

Konori bën disa hapa deri te dritarja. Që aty, poshtë në rrugë, ai shquan një grua të re, mbështetur te makina.

- Po ku ndodheni ju Elison tani?

E përhumbur në mes të flokëve të dëborës, gruaja e re ngre sytë nga dritarja e katit të fundit. Shikimi i saj ngjitet në drejtim të Konorit dhe ndeshet me të tijin pikërisht në çastin kur ajo thotë:

- Jam poshtë shtëpisë suaj.

* * *

Një orë më vonë

Dhoma është e zhytur në gjysmerrësirë. Elisonin e ka zënë gjumi në kanapenë e sallonit. Prishja e sistemit të ngrohjes e ka detyruar Konorin të gjallërojë zjarrin e oxhakut dhe një zjarr bubulak kërcet në sallon. Në këmbë pranë dritares, psikologu shikon mendueshëm "pacienten" e tij të re.

E di se kush është ajo. Ai i ka parë fotografitë e saj nëpër gazeta e revista. Ka dëgjuar të flitet për bëmat e saj dhe di gjithashtu se emri i saj shpesh është sinonim i skandaleve të shtypit *people*. Por gruaja me të cilin foli nuk tregoi asnjë shenjë arrogance apo të sillej si një fëmijë i llastuar. E dëshpëruar, e mbërthyer nga një e kaluar që e shtyn gjithnjë e më shumë në buzë të greminës, vajza ka ardhur thjesht për t'i kërkuar ndihmë.

Për më shumë se një orë Elisoni i tregoi historinë e saj të llahtarshme: aksidentin me makinë që i kushtoi jetën një fëmije, kufoma që babai i saj e zhduku, pastaj ndrydhja në vetvete dhe më pas pamundësia për "të jetuar me këtë fakt", spiralja e vetëshkatërrimit si dhe tentativat për vetëvrasje. Në një mënyrë apo në një tjetër ajo kërkon që ky makth të marrë fund, edhe pse e di se nuk ka asnjë shpëtim nga ky ferr në të cilin ajo ndodhet. Sonte ajo ishte e gatshme të shkonte t'ia tregonte të gjitha policisë, por i mungoi kuraja. Si shpëtim të vetëm zgjodhi Konorin, duke përmbushur kështu një këshillë të kahershme të të atit, duke qenë e vendosur që ta linte fatin e saj në duart e mjekut.

Konori shton edhe një trung në oxhak dhe e rrëmon

zjarrin. Atij i kujtohet tani, se disa muaj pas botimit të librit të tij, ai kish marrë një letër nga Riçard Harrisoni. Miliarderi ishte impresionuar nga libri dhe shprehte dëshirën për ta takuar. Konori nuk i ish përgjigjur, dhe ishte penduar për këtë veprim, kur disa muaj më vonë, Harrisoni e kish bërë publike sëmundjen e tij.

"Ky fëmijë që unë kam vrarë, - ishte rrëfyer Elisoni, në fund të tregimit të saj, - më del çdo natë dhe më shfaqet në ëndrrat e mija". Kur dëgjoi këto fjalë Konori u drodh, sepse duke dëgjuar këtë grua të re, atij i dukej sikur dëgjonte vetveten dhe dhimbja e saj dukej sikur ishte e tija. Në këtë çast ai i kish premtuar se do ta ndihmonte.

Konori i dha një anksiotilik dhe i propozoi që ajo të flinte aty atë natë. Të nesërmen ai do t'i përcaktonte një terapi të re, por ndërkohë, ajo duhej të çlodhej. Elisoni, e qetësuar nga fjalët e mjekut, u shtri pranë zjarrit dhe e kish zënë gjumi, e mbështjellë me një batanije.

* * *

Ora 4 e 45 minuta - Konori & Evi

Konori, i zhytur në mendime, po bëhej gati të ndizte një cigare, kur telefoni ra përsëri. I befasuar nga kjo telefonatë e dytë nate, e ngre menjëherë receptorin që të mos zgjohej Elisoni.

- Doktori Konor Mekkoi?
- Po, unë jam.
- Jemi policia...

Ju akuzoj për vrasjen e dy burrave, në Çikago, në vitin 1989...

- ... Unë jam Leitnanti Dave Donavan, i distriktit të 14-të...

Ju akuzoj se po strehoni një vrasëse në shtëpinë tuaj.

- ... Ju kërkoj ndjesë për shqetësimin në këtë orë të vonë të natës, doktor.

- Çfarë mund të bëj për ju leitnant?

- Dy nga njerëzit tanë kanë ndaluar një vajzë të re, jo madhore e cila ishte futur në hollin e një ndërtese në *Village*. Ajo na thotë se e ëma ka vdekur dhe se nuk ka asnjë të afërm në Nju Jork.

- Evi Harper?

- Po me këtë emër na është prezantuar. Ajo pretendon se është pacientja juaj.

- Po... Po, kjo është e saktë, - gënjen Konori. - A është mirë?

- Ishte me hipotermi, por tani është më mirë. Teorikisht unë duhet të kontaktoja shërbimet sociale, por mendova t'ju njoftoj juve më parë.

- Po vij menjëherë, - i premton Konori dhe mbyll telefonin.

I çliruar, mjeku ndjen një si lloj euforie duke menduar se do të takonte Evin. Po sikur kjo natë të ishte ajo ku çdo gjë mund të ndodhë?

- Kujdes Xheremi, kujdes!

Me një lëvizje të shpejtë Konori hedh sytë nga kanapeja. Në kllapitë e saj, Elisoni po lufton kundër një armiku të padukshëm.

Konori ulet pranë saj dhe me kujdes e zgjon nga gjumi.

- Më duhet të largohem për pak kohë, - i thotë Elisonit.

- Do ktheheni? - thotë gruaja që i ka dalë gjumi.

- Sa më shpejt që të jetë e mundur, - e siguron Konori.

Pastaj ai shkon në kuzhinë për t'i bërë një kamomil.

- Xheremi quhej djali që ju keni shtypur?

- Nuk di asgjë më tepër se kaq për të, - pohon Elisoni. - Kështu ishte shkruar në byzylykun e tij.

- Në byzylykun e tij?

- Ai kishte një byzylyk të vogël në dorë, i cili u thye. I kishte rënë në veturën time.

Duke e shoqëruar gjestin me fjalë, Elisoni kontrollon në çantë, për të nxjerrë që aty byzylykun të cilin e vendos mbi tavolinë.

Konori rikthehet në sallon dhe i jep Elisonit çajnikun me kamomil që nxjerr avull. Kur merr në dorë byzylykun, Konori është i tronditur jashtë mase dhe i duhet të bëjë një sforco mbinjerëzore për t'i fshehur shqetësimin e tij Elisonit. Vesh pallton, thotë si nëpër dhëmbë "mirupafshim" dhe del nga apartamenti. Kur ndodhet në ashensor, vetëm atëherë çlirohet nga dhimbja që ndjeu.

Sepse ai e di se kush është Xheremi.

* * *

Komisariati i policisë i distriktit të 14-të.

- Ja, ajo që më kërkuat, - i thotë Konori oficerit duke dorëzuar një formular për marrjen në ngarkim mjekësor, të cilin e mbushi në sy të tij.

Ndërsa polici shikon me zell dokumentin që i dorëzoi mjeku, Konori shkon e vjen nëpër sallë. Në këtë natë Krishtlindjesh ka një gjallëri të pazakontë në komisariat. Nga të gjitha anët vijnë policë që sjellin hajdutë, pijanecë, të

aksidentuar në rrugë etj. Konori e urren këtë vend, siç urren, qoftë nga afër apo nga larg, çdo gjë që ka të bëjë me policinë. Qëkur ai ka parë *Të Mjerët* në Broduej, e quan veten një Zhan Valzhan, që ka gjithmonë frikë se mos vjen Zhaveri. Thellë në qenien e tij, është i bindur që vrasja e drogaxhinjve do të dalë në shesh një ditë dhe se ai do të përfundojë brenda katër mureve të burgut.

- Në rregull, - thotë më në fund oficeri duke e vendosur formularin në vendin e vet.

Pastaj ngre receptorin, mërmërit disa fjalë e i drejtohet Konorit.

- Tani do ta sjellin vajzën, - thotë ai me përkujdesjet e një pronari bordelloje.

- Shumë i sjellshëm.

Megjithatë Konori duhet të presë edhe dhjetë minuta të tjera para se të sjellin Evin.

- Përshëndetje, - thotë ai kur shikon Evin.

- Përshëndetje, - thotë ajo duke bërë disa hapa në drejtim të tij.

Ajo është pis, e dobët dhe me zor i mban sytë hapur. Të ftohtit, mungesa e gjumit si dhe futja në burg e kanë bërë punën e tyre.

- Ikim? - i propozon Konori duke marrë çantën e shpinës së Evit.

* * *

Të dy janë tani të rehatuar në makinën luksoze të Konorit, ndërkohë që para tyre parakalon qyteti i bardhë dhe metalik.

Ato pak flokë dëbore që vazhdojnë të bien largohen menjëherë nga fshirëset e xhamave të makinës.

- Faleminderit që erdhët, - psherëtin Evi, me një zë të stërlodhur. - Më vjen keq që të zgjova në mes të natës.

- Bëre shumë mirë, - i përgjigjet menjëherë Konori, - isha në merak për ty...

Edhe pse rrugët janë të boshatisura, dëbora që ka rënë të detyron që të ecësh me kujdes. Mjeku ngadalëson shpejtësinë në *Houston Street* dhe merr drejtimin për në Jug.

- ...e sidoqoftë, unë nuk para fle shumë, - përcakton Konori.

- E di, - konfirmon Evi.

Në *Lafayette Street*, ndërsa kanë kaluar *Lolita*-n dhe *Little Italy*, Konori ngrys vetullat.

- Ç'domethënë kjo? "E di".

- Sepse është e shkruar në libër.

- Në cilin libër?

- Në librin *tuaj*, - thotë Evi duke nxjerrë nga çanta librin "Të mbijetosh".

I çarmatosur, Konori lëviz kokën, dhe për herë të parë shquan një grimë buzëqeshje në fytyrën e Evit. Nuk është një qeshje e vërtetë, por të paktën i ngjan asaj.

Evi përkul kokën nga xhami i makinës. Akoma nuk ka zbardhur, por ndihet që natës i ka ardhur fundi.

Makina lëviz tashmë në rrugët e ngushta të *Lower Manhattan*. E zënë si në grackë, makina lëviz në mes të kanionit prej xhami e çeliku, duke u drejtuar drejt *Church Street* e deri në zonën *Ground Zero*.

- Ku po shkojmë?

- Në klinikën Mozart. Unë punoj aty kur nuk jam në kabinetin tim.

- Nuk dua të shkoj në spital, - e paralajmëron adoleshentja.

U deshën vetëm fare pak sekonda që dyshimi dhe mosbesimi të mbizotërojnë tek ajo, dhe gjithmonë frika se nuk do të kishte mundësi të realizonte planin e hakmarrjes, që e shoqëron në çdo hap të saj.

- Duhet të çlodhesh dhe të mjekohesh, - i përgjigjet Konori me një ton që nuk lejon kundërshtim.

Por Evi as që do t'ia dijë:

- Dua të zbres! - thërret ajo duke kapur dorezën e makinës.

- Do kisha bërë më mirë të të lija në burg, - psherëtin Konori, por pa e ndalur makinën.

Papritmas, ndërsa makina po lëviz me shpejtësi, adoleshentja hap menjëherë derën dhe heq rripin e sigurimit.

Konori frenon shpejt para *Trinity Church*. I nervozuar, zbret nga makina, del nga ana tjetër dhe e kap vajzën e re nga qafa.

- Do të vrasësh veten? - shpërthen duke e nxjerrë jashtë veturës.

E befasuar nga zemërimi i mjekut, Evi mbyll sytë dhe kthen kokën anash, sikur të kish frikë se mos ky e qëllonte.

- Shikoje veten, o Zot i madh! - ulërin Konori. - Ti je bërë për të ardhur keq! Je e dërmuar, e lodhur, plakur para kohe!

Adoleshentja shikon portretin e saj në xhamin e makinës, por shumë shpejt i ul sytë, se ajo që sheh përballë i shkakton dhimbje në shpirt.

Konori i ndërsyer vazhdon:

- Nëse do të ngordhësh, vazhdo kështu si e ke nisur, në rregull je! Ti as që e njeh Nju Jorkun. Nëse unë të braktis dhe

të lë këtu në trotuar, ti edhe një javë jetë ke! Por ndërkohë do të kesh vdekur, ose do të bëhesh prostitutë me 15 dollarë klienti! Kështu do të përfundosh?

Konori i tërbuar, goditi fort me grusht kapakun e makinës, ndërsa Evi e shastisur shkrehet në lot që i rrjedhin përgjatë faqeve.

* * *

Ja, i thanë të gjitha. Tani janë ballë për ballë njëri-tjetrit duke u parë në këtë mëngjes të akullt, nën hijen e kullave të vdekura. Të dy janë të dërmuar, pa fuqi dhe të çliruar nga çdo emocion.

Pastaj Konori largohet me hap të ngadalshëm dhe hipën në makinë, e ndez atë, dhe rri aty. Evi, si një fantazmë, rri jashtë, në trotuar.

- As edhe një javë, - përsërit Konori sikur të fliste me vete.

* * *

Aston Martini lë pas rrugët e errëta të *Wall Street*-it dhe po lëviz tani përgjatë brigjeve të Hudsonit. Konori ul shpejtësinë dhe futet në *Battery Park City*. Kompleksi luksoz, i ndërtuar buzë oqeanit shtrihet mbi hedhurinat e tokës së mbledhur gjatë ndërtimit të *World Trade Center*.

Mjeku fut kartën manjetike për të zhbllokuar hyrjen në parking dhe e parkon makinën në katin e poshtëm. Largohet nga vetura dhe ecën në parking pa i folur Evit e cila e ndjek disa metra pas tij. Të mbështjellë me këtë heshtje, ata ndodhen para ashensorit, që i çon në hollin e klinikës Mozart, një

ambient ultramodern me dy kate të *Financial Center*.

Në recepsion, Konori flet me përgjegjësin e turnit dhe mbush vetë formularin e pranimit të Evit, ndërsa një ndihmësmjeke e çon atë në dhomën që i është caktuar.

* * *

20 minuta më vonë

Konori hap lehtë derën e dhomës. Edhe pse asnjë llambë nuk është ndezur, një dritë e zbehtë blu nate po feks në qytet. E veshur me pizhamet e klinikës, Evi është e shtrirë në shtrat dhe ka një perfuzion në dorë. Shikimi i saj është i shpërqendruar.

- Mirë je? - e pyet mjeku.

Heshtje.

Duke u munduar të vendosë dialogun, ai i thotë ngadalë të gjitha fjalët që ka në shpirt:

- E imagjinoj që asnjëherë nuk ke dëgjuar fjalë që të të mbështesnin e as të të kuptonin, dhe se, për t'u mbrojtur, ti ke ngritur një kështjellë të fortë dhe mosbesuese ndaj të tjerëve...

Evi nuk bën asnjë lëvizje, por Konori i ndjen frymëmarrjen.

- Ke të drejtë. Vetëm kështu mund t'i bësh ballë ashpërsisë së jetës, dhe për një kohë të gjatë edhe unë kam qenë si ty Evi, nuk kam besim te askush.

Duke e ndjerë shikimin e tij të ngulur tek ajo, vajza e re mbyll sytë.

- Por të vazhdosh të rrish e izoluar dhe në vetmi nuk është kjo zgjidhja e problemeve të tua.

Konori bën disa hapa në drejtim të dritares. Ndërsa vazhdon të flasë, shikimi i tij tretet në drejtim të marinës së North Cove, e cila, e vendosur në breg të ujit, shpalos një pamje madhështore me nja pesëdhjetë anije, dritat e të cilave shkëlqejnë akoma në këtë natë.

- Në zanatin tim, nuk para bëj premtime, - vijon më tej Konori, me një gjuhë të sinqertë. - Nuk ka siguri kur ke të bësh me emocione dhe me llahtari të brendshme të botës së njeriut. Unë nuk i jap asnjëherë garanci pacientëve se pasi më takojnë mua çdo gjë do të shkojë më mirë për ta.

Ndërkohë papritmas dera e dhomës hapet dhe një ndihmësmjeke i drejtohet Konorit:

- Një telefonatë për ju, doktor Mekkoi. Me sa duket është diçka urgjente.

Konori kthehet në drejtim të adoleshentes. Me sytë akoma të mbyllur, ajo ka tani një frymëmarrje normale dhe duket sikur po fle. E megjithatë, Konori e përfundon rrëfimin e tij:

- Por ajo që unë mund të të premtoj është se do të bëj gjithçka që është në dorën time për të të ndihmuar. Por nëse ti do që të kemi edhe një shans për realizimin e këtij pikësynimi, duhet që të kesh besim te unë...

Ai i afrohet edhe më krevatit të saj dhe në shenjë lamtumire i thotë:

- Pa besimin tënd nuk mund të bëj asgjë.

* * *

Ora 7. Konori & Marku

Konori merr receptorin e telefonit që i jep recepsionisti. Në anën tjetër i flet një zë i njohur për të:

- Jam Nikola.

- Doja të të merrja, - fillon të thotë Konori.

Por Nikola i mbulon shpjegimet e tij me zërin e saj:

- Duhet të më ndihmosh, bëhet fjalë për Markun.

- U kthye?

- *Po, por...*

Zëri i Nikolës shkërmoqet.

- E ke parasysh?... Ai jetonte rrugëve. Gjatë gjithë kësaj kohe, ai jetonte me lypësit! Duhet bërë diçka, ai nuk është aspak mirë. Është i stërlodhur dhe mezi mbushet me frymë.

- Qetësohu, - i thotë Konori, - dhe m'i thuaj gjërat me radhë.

Me zërin me shkëputje nga dënesat, Nikola fillon t'i tregojë, se si Marku, pasi e kish shpëtuar nga një agresion në rrugë, e kish kaluar natën në shtëpinë e saj. Edhe pse i plagosur, ai u largua pa aguar mirë me qenin e tij. Nikola, e pafuqishme për të bërë diçka, e kish parë tek ikte në të ftohtë, e tmerruar tek shihte që po humbiste për herë të dytë burrin që ajo dashuronte. Ajo kish qëndruar palëvizur për një kohë të gjatë në trotuar, deri sa ajo pa qenin të kthehej drejt saj duke lehur. Ajo i shkoi pas qenit që e çoi dy rrugë më poshtë.

Marku nuk kishte mundur të ikte shumë larg. Ai ishte i shtrirë përtokë me duart e kryqëzuara, pa ndjenja dhe nuk reagonte ndaj të lehurave të qenit.

- Nëse nuk bëjmë gjë për të, ai do të vdesë, - përfundon Nikola.

- Rri aty me të, - i thotë Konori. - Po ju dërgoj një ambulancë sa më shpejt që të jetë e mundur.

* * *

Natës së Krishtlindjeve po i vjen fundi.

Pavarësisht nga i ftohti, Konori del para hyrjes së klinikës për të pritur kthimin e ambulancës. Që pas tij, lartësohen kullat prej xhami e graniti të *Financial Center*. Për t'u ngrohur nga të ftohtit therës të mëngjesit, mjeku bën disa hapa gjatë shëtitores në breg të lumit.

Ai ka kaluar një natë jo të zakontë gjatë së cilës tre njerëz të lënduar në shpirt kanë ardhur drejt tij.

Elisoni

Evi

dhe Marku

Këta ishin tre njerëz që kishin shkuar deri në buzë të greminës, por që ishin akoma gjallë.

Këtë mëngjes, Konori ndihet i dërmuar nga një përgjegjësi e rëndë.

A do të jetë në gjendje t'i ndihmojë ata?

Dhe si?

Mendueshëm, ai ndez një cigare dhe shikon skafet e policisë që patrullojnë në port. Era fryn edhe më fort tani, duke i larguar retë në drejtim të perëndimit. Do të jetë një ditë e bukur. Konori ngre kokën, shumë lart, duke kërkuar një të çarë në qiell. Ai dallon një avion i cili lë pas një njollë të zgjatur të bardhë.

Në këtë çast i lind një mendim.

30

Hap sytë

Living is easy with eyes closed...

- JOHN LENNON

Gjithmonë frika mbetet. Një njeri
mund të shkatërrojë gjithçka në vetvete:
dashurinë, besimin, urrejtjen e madje edhe
dyshimin. Por për aq kohë sa ai e do jetën,
ai nuk mund të zhdukë frikën.

- JOSEPH CONRAD

Sot
Në avion
Ora 18 e 30 minuta

Avioni po vazhdonte të ulej përmes reve, duke projektuar hijen e tij të stërmadhe mbi shtresën me pambuk të cirrostratusit.

Marku shkoi në vendin e tij pranë Lajlës dhe Evit që dukej sikur po flinte në qoshen e saj.

- E vure rripin e sigurimit?

Vajza ngriti kokën.

- Edhe pak edhe mbërritëm, - i thotë i ati duke i përkëdhelur lehtë faqet me dorë. - Je e gëzuar që po kthehemi në shtëpi?

Lajla e pa me ngrohtësi, por nuk iu përgjigj pyetjes.

Edhe Marku nuk nguli këmbë më dhe filloi të shohë në drejtim të dritares. Re të dendura mbulonin tashmë avionin si të ishte një arkivol i lagësht e i errët. Njëlloj si një insekt që ka rënë në grackë, Airbus-i dukej sikur po luftonte me rrjetat e merimangave qiellore.

Më në fund Lajla e theu heshtjen me një frazë lakonike:

- Të pashë kur ti ishe në errësirë...

- Në errësirë?

- Po, në tunel, në errësirë, në metro...

Markut iu desh njëfarë kohe që të kuptonte se Lajla i referohej kohës që ai kishte kaluar nëpër rrugët dhe kanalizimet e nëndheshëm të Manhatanit. Ato ishin dy vite skëterre në botën e pamëshirshme të të pastrehëve, dy vite në zorrët e qytetit, duke u lemerisur nga zgavrat e metrosë dhe tunelet e linjave hekurudhore. Kishte dy vjet që ishte varrosur i gjallë, duke u bashkuar me faunën e të margjinalizuarve dhe e të droguarve, dy vite që kish kaluar duke u munduar të mbyste dëshpërimin e tij në alkool...

Menjëherë e kapi një panik i madh. Si mund të ishte Lajla në dijeni të një episodi të tillë? Kush i kishte folur kësaj për zbritjen e tij në ferr? Nikola? Rrëmbyesi i saj?

- Unë mërzitem shumë kur ti shkon në tunel, - vijoi Lajla. - Mos u kthe më atje babi!

- Po... - belbëzoi Marku, - si e di ti që unë...

- Sepse të kam parë, - përsëriti Lajla.

- Më ke parë? Pse ku ishe ti?

- Atje lart, - tha vajza me gishtin tregues drejt tavanit të avionit.

Komplet i çorientuar, Marku ngriti kokën në kërkim të "atje lart", të cilin ai nuk mund ta shihte.

- Nuk duhet të pish më, - iu lut Lajla. - S'duhet të largohesh më. Kthehu dhe jeto me mamin.

I tronditur Marku u mundua të justifikonte qëndrimin e tij:

- U largova sepse nuk arrija të përballoja situatën e krijuar. Kisha... kisha kaq shumë frikë për ty... pa ty, jeta ime nuk kishte më kuptim...

Brenda pak sekondash, Marku e kish humbur qetësinë dhe sigurinë dhe tashmë notonte nëpër mjegull. Vështroi Lajlën. E mbledhur kruspull në ndenjësen e saj, ajo dukej edhe më e vogël. Marku ishte i ndërgjegjshëm që i mungonte një e dhënë kryesore: një element i qartë, i dukshëm, të cilin e kish parasysh që nga fillimi i udhëtimit.

- Duhet të më shpjegosh diçka zemra ime, - i thotë së bijës duke iu afruar.

- Çfarë?

- Përse nuk do t'i flasësh mamit?

Vajza bën një pauzë sikur donte të mendohej. Pastaj, duke menduar se ishte çasti i duhur, ajo i tha me ëmbëlsi:

- Sepse ajo e di tashmë.

- Çfarë di ajo?

- Që unë kam vdekur, - u përgjigj Lajla.

* * *

Në të njëjtën kohë, në pjesën e sipërme të avionit, Elison Harrisoni po shikonte nga dritarja. Pak nga pak retë po shpërndaheshin dhe që lart dukeshin disa njolla të kaltërta.

Me fytyrë të ngrysur, shtrëngonte në duar portofolin që Marku kish harruar te Floridita. Përse kishte ajo këtë dëshirë të papërmbajtshme për të marrë vesh se çfarë kishte brenda ai portofol? Ishte diçka tjetër dhe jo thjesht kurioziteti. Një nevojë jetësore, një nevojë e thellë, sikur një zë po i pëshpëriste në vesh se nga ky portofol varej jeta e saj.

Nuk kishte ndonjë gjë të madhe në këtë portofol: dy karta krediti, disa dollarë, një patentë makine, një kartë profesionale si dhe një fotografi të Markut me të shoqen. Elisoni po e vështronte Nikolën me admirim dhe i dukej se ajo ishte e bukur dhe me klas. Ajo kishte një lloj elegance që Elisoni e ëndërronte për vete, por që s'do ta kishte kurrë. Po bëhej gati ta mbyllte portofolin, ku pa një tjetër fotografi, e ngjitur pas asaj të çiftit. Ishte portreti i një vajze të vogël, rreth pesë vjeçe, me një hundë të bukur dhe me sy të qeshur. Veshja sportive, flokët e shkurtër dhe kasketa e beizbollit të jepnin përshtypjen sikur të ishte një djalë. Duart i kish vendosur te mjekra dhe te kyçi i dorës së saj të majtë, shquhej qartë një byzylyk argjendi e gdhendur me emrin Xheremi.

Një vetëtimë përshkoi dhimbshëm trurin e Elisonit. Tashmë çdo gjë ishte e qartë për të. Fëmija që ajo kish shtypur me makinë ishte vajza e Markut! Nën efektin e panikut, të frikës dhe të humbjes së toruas, të shiut që vazhdonte të binte, si dhe për shkak të veshjes me rroba beizbolli, ajo e kish marrë për një djalë të vogël dhe përshtypja e saj e parë ishte

konfirmuar nga emri i gdhendur në byzylyk. Më pas ajo do të mësonte se byzylyku i përkiste një kushëririt të Lajlës, i cili ia kish bërë dhuratë pasi kyçi i tij ishte shumë i madh tani dhe nuk i bënte më.

Elisoni e tmerruar, u ngrit papritmas dhe, me gjithë kundërshtimet e stjuardesave, u nis në drejtim të pontilit kryesor.

* * *

- Përse... përse thua që ti ke vdekur? - vazhdoi Marku, i çatrafiluar nga përgjigja e së bijës.

- Sepse kjo është e vërtetë, - i thotë Lajla pothuajse me keqardhje.

- Por kjo është e pamundur, sepse ti je këtu, me mua tani.

Ajo ngriti supet me mirësjellje, si për të thënë që gjërat nuk janë kaq të thjeshta.

- Që kur paske vdekur? - mezi i nxori fjalët Marku.

- Që nga fillimi, - pohoi qetësisht Lajla. - Qëkur më përplasi vetura.

- Vetura ?

- Po *Jeep*-i, - saktësoi ajo.

- Ty,... ty nuk të kanë rrëmbyer asnjëherë?

- Jo, ishte thjesht një aksident. Unë dola nga dyqani për të luajtur jashtë dhe pastaj për shkak të stuhisë humba rrugën.

Tërësisht i çorientuar nga këto që po dëgjonte, Marku pati një reagim fare të papritur:

- Përse dole nga dyqani? - e qortoi ai. - Ta kishim thënë me mijëra herë të mos largoheshe asnjëherë kur ishim në dyqane. Binte shi, ishte e rrezikshme...

- Po kur je fëmijë, është e lezetshme të ecësh nëpër shi, - u përgjigj Lajla me një ton që të çarmatoste.

Marku ndjeu që sytë po i digjnin. Sado jorealiste të ishte kjo bisedë, thellë-thellë brenda vetes e ndjente që Lajla thoshte të vërtetën, edhe pse nuk ishte gati për ta pranuar një fakt të tillë.

- Unë kam vdekur por ti nuk duhet të jesh i trishtuar, - i thotë vajza e vogël duke e kapur për dore.

- E si mund të mos jem i trishtuar? - pyeti Marku me një ton lutës.

- Nganjëherë gjërat ndodhin sepse duhet të ndodhin, - shpjegon Lajla me një ton fatalist.

Marku e kuptonte tani që koha e tij ishte e kufizuar, dhe se, çfarëdo që të bënte situata do t'i rrëshqiste nga duart. E merr të bijën dhe e shtrëngon fort pas vetes, sikur ky shtrëngim do ta shpëtonte nga kthetrat e vdekjes.

- Nganjëherë gjërat ndodhin sepse u ka ardhur ora, - tha Lajla me një zë të mekur, pjesërisht e mbytur edhe nga zhurma e motorëve.

- Jo! - klithi Marku në një përpjekje të fundit.

Thirrja e tij u përzie me zëra që vinin nga pjesa e prapme e avionit. Mjeku u kthye dhe pa Elisonin që po vraponte drejt tij. Kur ajo ishte një metër përballë tij, u ndal.

- Fëmija që kam vrarë... filloi të thotë ajo me një zë të mekur...

Fotografia që mbante në duar i ra në tokë. Fotografia filloi të rrotullohet në ajër dhe ra para këmbëve të mjekut.

- ... unë kujtova se ishte një djalë i vogël, - mezi shtoi Elisoni. - Por ishte... vajza juaj.

Në të njëjtin çast të dy panë në drejtim të ndenjëses ku ishte ulur Lajla.

Por ajo nuk ishte më aty.

Por ka edhe më shumë se kaq.

Stjuardesat, të gjashtëqind pasagjerët: të gjithë kishin avulluar si me magji! Avioni i stërmadh A380 ishte bosh. Në mes të qiellit, në këtë avion prej më shumë se 500 tonësh, kishte vetëm tre persona:

Marku,

Elisoni,

Evi.

31

Si më parë

Kur merr tabletën blu, historia
ndalet në vend, ti zgjohesh në shtratin
tënd, dhe ti beson çfarë të duash ti.
Kur ti merr tabletën e kuqe, ti
ndodhesh në Botën e Mrekullive dhe
unë të tregoj deri ku janë kufijtë e strofkës.
- Dialog nga filmi *MATRIX*

Sot
Në avion

- Çfarë...

Elisoni deshi të ulërijë, por klithma i mbeti në grykë.

Evi zgurdulloi sytë, e mbërthyer nga një tmerr i pakontrollueshëm.

Është e pamundur...

Marku, komplet i hutuar nga situata e krijuar po shikonte

me bisht të syrit qindra ndenjëse të boshatisura në mënyrë të mistershme.

Nuk kish mbetur këmbë njeriu. Brenda sekondës, pasagjerët dhe ekuipazhi ishin zhdukur.

Konori eci në korridorin kryesor i ndjekur nga të dy gratë. Të gjitha vendet ishin bosh. Në ndenjëse nuk kishte as rroba, as çanta, as libra, as gazeta. Në ecje e sipër Elisoni kontrolloi vendet e bagazheve sipër kokës: bosh, bosh, bosh.

- Lajla! - rënkoi Marku. - Lajla!

Thirrja e tij e pashpresë mbeti pa përgjigje.

Elisoni dhe Evi panë njëra-tjetrën, secila duke kërkuar pak mbështetje tek tjetra. *Ky nuk është realiteti,* mendoi Evi, për të qetësuar veten, por makthi dukej kaq i vërtetë saqë ajo u shkreh në vaj nga një frikë e tmerrshme dhe e pakontrollueshme.

- Pilotët! - pyeti Marku. - Ku janë pilotët?

Në pamje të parë, avioni dukej stabël dhe vazhdonte pa problem uljen në drejtim të Nju Jorkut, po a kishte njëri aty që ta drejtonte?

Gjithmonë i shoqëruar nga Elisoni dhe Evi, mjeku po i drejtohej shkallës që të çonte në katin e sipërm. Edhe klasi i parë e biznes klasi ishin bosh si të tjerët. Marku u sul i pari në zonën e shërbimit, një sallë funksionale e cila kishte hyrje në kabinën e pilotimit, që ndodhej midis të dy kateve. Meqë dera e hyrjes në kabinë ishte e hapur, Marku hyri brenda pa problem.

Në pjesën përballë të kabinës, kishte 8 ekrane kontrolli, por vendet e pilotit dhe të kopilotëve ishin të braktisura.

Elisoni dhe Evi iu bashkuan Markut në kabinë. Të tmerruar deri në palcë, që të tre i afrohen hapësirës me xham. Avioni po fluturonte ulët. Ai kish dalë nga retë dhe po i afrohej

Manhatanit. Dita ishte në të ngrysur dhe pavarësisht nga situata e llahtarshme në të cilën ndodheshin, pasagjerët e fundit të fluturimit 714 nuk mund të mos hipnotizoheshin nga spektakli që ndodhte para syve të tyre. Ndriçimi i jepte qiellit reflekse ngjyrë bakri, duke ravijëzuar linjën e qiellgërvishtësit më të famshëm në botë me një sfond shkëlqimi të praruar.

Por ajo që të hutonte më tepër, në peizazhin që shfaqej para syve të tyre, ishte prania e dy kullave të *World Trade Center* që dukej sikur do të çanin qiellin.

Si më parë...

Para se Marku të humbiste të bijën,

Para se Elisoni të shtypte Lajlën,

Para se Evi të humbiste të ëmën.

Ishte e çuditshme të ktheje kohën mbrapsht dhe të shikoje përsëri Nju Jorkun "e vjetër".

I drejtuar nga një forcë e padukshme, avioni kish filluar të ulte shpejtësinë. Me lehtësinë e një avioni të vogël, ai kaloi sipër kullave binjake, shkëlqimi i bardhë i të cilave reflektohej në xhamat e argjendtë të avionit.

Marku, Elisoni dhe Evi ishin afruar. Krahët, duart e tyre, supet i kishin pranë njëri-tjetrit. Ata kishin frikë dhe nuk donin ta përballonin të vetëm këtë tmerr.

Çfarë po ndodhte? Secili tru më vete u mundua të japë një zgjidhje racionale për atë që po përjetonin. Ëndrra? Efekte haluçinante si rezultat i një mbidoze kokaine apo alkooli? Jo. Ky udhëtim i çuditshëm i kishte çuar deri në dhimbjet e tyre më intime. Ata u përballën me demonët e tyre, duke jetuar me mend çaste kryesore të ekzistencës së tyre, duke u munduar gjithsecili të distancohet nga rruga e përshkuar si dhe të

vendosnin pak rregull në jetën e tyre, sikur të përgatiteshin për... të vdekur.

- Vdekja...

A ishte vërtet destinacioni i këtij udhëtimi? A mund të ishte ky fluturim një lloj purgatori? Përshkimi i një tuneli të gjatë dhe të shndritshëm, i ngjashëm me atë që marrin ata që kanë përjetuar një eksperiencë të një vdekjeje të menjëhershme?

Mundet...

Sipër *East River*, avioni kreu një gjysmë turi ajror dhe u gjend përsëri nga jugu i ishullit. Tashmë, ai fluturonte shumë, shumë ulët, vetëm disa dhjetëra metra nga toka dhe uji. Qyteti dukej shkretë dhe i palëvizshëm. Avioni fluturoi mbi *Battery Park* dhe mbi gjirin e Nju Jorkut deri në Ishullin Elis dhe mbi statujën e Lirisë.

* * *

Disa sekonda para se avioni të përplaset, Elisoni kapi krahun e Markut dhe i mërmëriti:

- Më vjen keq.

Mjeku pranoi me kokë. Në shikimin e tij të turbulluar keqardhja ishte më e fortë se urrejtja.

Veprimi i tij i fundit ishte të kthehej nga Evi. Meqë shihte llahtar në sytë e adoleshentes, ai e kapi për dore dhe e qetësoi:

- Mos ki frikë.

* * *

Avioni u përplas me forcë në sipërfaqen e ujit.

U dëgjua një britmë e shkurtër.
Pastaj një ngjyrë blu.
Pastaj e zezë.
Dhe pastaj?
Dhe pastaj...

32

E vërteta

Për të gjetur lumturinë, duhet të njohësh fatkeqësinë. Nëse doni të jeni të lumtur, nuk duhet patjetër t'i fshiheni fatkeqësisë me çdo çmim. Madje duhet të kërkoni se si dhe në sajë të kujt do të mund ta kapërcejmë atë.

- BORIS CYRULNIK

Sot
Klinika Mozart
Ora 19

Tre trupa.
Marku,
Elisoni,
Evi.

Tre trupa janë shtrirë pranë njëri-tjetrit në një sallë spitali.

Tre trupa janë vendosur secili në një ndarje të programuar kundër zhurmave në formën e një balloni.

Tre koka janë mbështjellë me nga një kaskë të pajisura me elektroda të cilat janë të lidhura me një kompjuter.

Konori dhe Nikola qëndrojnë në këmbë që prapa xhamave, duke pritur me ankth që të tre pacientët të dalin nga gjendja e tyre hipnotike ku janë vendosur që prej disa orësh.

Nuk ka pasur asnjë lloj avioni.

Nuk ka pasur kurrë fluturim nr. 714.

Nuk ka pasur asnjë rrëzim avioni.

Takimi gjatë një udhëtimi me avion, i Markut, Evit dhe i Elisonit nuk është gjë tjetër veçse skenari i një terapie kolektive e mbështetur tek hipnoza. Kjo është një lloj loje terapeutike e imagjinuar nga Konori për të shoqëruar të tre personat, të cilët, në këtë natë të famshme të Krishtlindjeve, i kishin kërkuar ndihmë.

As ai e as Nikola nuk e kishin parë të arsyeshme që t'i thoshin Markut se Lajla kishte vdekur. Ai ishte në një gjendje kaq të dobët dhe çorganizimi mendor sa në qoftë se do ta kish marrë vesh këtë fakt, ai mund të kish rrëshqitur drejt vetëvrasjes ose drejt çmendurisë. Për t'i bërë të ditur këtë lajm të tmerrshëm, Konori pati idenë e ndërtimit të këtij skenari i cili duhej që t'i mbushte mendjen edhe Evit të hiqte dorë nga hakmarrja e saj dhe Elisoni të pranonte fajësinë që kishte vrarë Lajlën.

Nikola po e shihte të shoqin me shqetësim. Ndërsa disa minuta më parë dukej sikur flinte qetësisht, tani trupi i lëvizte pa pushim që tregonte se së shpejti do të dilte nga gjendja hipnotike. Pothuajse në të njëjtën kohë, Evi lëvizi kokën dhe Elisoni shtriu krahun.

I sigurt se tashmë dalja nga "koma" ishte e shpejtë, Konori

po kontrollonte ekranet e kompjuterit që ishin rreshtuar në gjysmë harku përballë tij. Spitali ishte i pajisur me fjalën e fundit të teknologjisë në fushën e IRM-së, gjë që i jepte mundësi neurologut të ndiqte në kohë reale aktivitetin e trurit të pacientëve të tij. Konori nuk i kish shqitur sytë nga ekranet gjatë gjithë kohës së eksperimentit. Gjatë një seance hipnoze, aktiviteti cerebral ishte përgjithësisht shumë intensiv, ku lëshimi i mekanizmave të inhibicionit favorizon prodhimin e imazheve të trurit dhe e bën më vulnerabël ndaj emocioneve.

Në kabinën e kontrollit, Konori vuri re një rritje të aktivitetit në lobin qendror ku ndodhej kontrolli i funksioneve ekzekutive, që tregonte se pacientët po merrnin tashmë kontrollin e trupave të tyre. Dalëngadalë, të tre pacientët po dilnin nga gjendja e tyre letargjike.

- Kam nevojë për ju, - njoftoi Konori duke shtypur butonin e interfonit.

Dy ndihmësmjeke u gjendën sakaq për të qenë të pranishme në zgjimin e pacientëve dhe t'i ndihmonin që të liroheshin nga solucioni pikë-pikë që prej disa orësh injektonte në organizmin e tyre një solucion medikamentoz me bazë DMT, një psikotrop i fuqishëm halucinogjen.

Marku i hapi sytë i pari dhe hoqi kaskën nga koka. U mundua të ngrihej në këmbë, iu morën këmbët dhe u detyrua të ulej. Në kokë i kalojnë me mijëra imazhe e ndijime me një shpejtësi marramendëse të cilat shiheshin si me teleskop: emocioni gjatë rigjetjes së vajzës së tij, kënaqësia e pafund kur merr vesh se është gjallë, frika e madhe para nisjes së avionit, haluçinacionet që e kishin llahtarisur, mungesa e alkoolit të cilën ai kujtonte se nuk do ta kalonte kurrë, takimi i tij i çuditshëm me Elisonin si dhe rrëfimet e Evit e kishin emocionuar jashtë mase.

- Si e ndjen veten? - e pyeti Konori.

Marku desh të përgjigjej, por duke qenë akoma në gjendje shoku, vuri dorën në kokë. Imazhet kalonin pa fund në trurin e tij, si vetëtima të dhimbshme: copëza jete nga fëmijëria e tij me Konorin, fragmente nga historia e dashurisë me Nikolën, fytyra e qeshur e Lajlës para akullores së madhe, pastaj fytyra e saj e brishtë kur ajo i tha se kishte vdekur...

Konori u afrua dhe i vuri dorën në sup shokut të tij:

- Do jesh më mirë miku im, do kalojë.

E ndihmuar nga Nikola dhe nga një ndihmësmjeke, Elisoni me zor qëndroi në këmbë. Hoqi kaskën dhe duart i vuri mbi gjunjë që të mos shembej përdhe. Koka i vinte vërdallë, mezi mbushej me frymë. Hipnoza kish qenë e thellë dhe iu desh një kohë e gjatë për të vendosur kontaktet me realitetin.

Ndërsa Evi, shtriqi këmbët, krahët dhe pastaj lëvizi kokën. Kur po i hiqnin perfuzionin, ajo ndjeu një rëndesë të madhe, e shoqëruar me një ndjesi të shkurtër paralize. Hapi e mbylli sytë disa herë, pasi e kish të vështirë të shquante figurat që kish përballë. Refleksi i parë qe që të shihte krahun e saj: tatuazhi i saj si edhe ai i Elisonit ishin zhdukur.

Konori u fut në kabinën e tij për të rritur pak nga pak intensitetin e dritës në sallë që deri në atë kohë ishte pothuajse në errësirë të plotë. Në bluzën e tij të bardhë të mjekut dallohej qartë simboli i klinikës:



KLINIKA MOZART

* * *

A kish arritur Konori të realizonte atë që donte? Ishte akoma shumë shpejt për ta thënë. Megjithatë duhet thënë se ai shkoi deri në fund të njohurive të tij, duke integruar në këtë eksperiment të gjitha dijet e karrierës.

Hipnoza gjithmonë e kishte mrekulluar Konorin. Këtë teknikë ai e përdorte prej vitesh për të shëruar varësinë ndaj duhanit dhe alkoolit, depresionet, migrenën, pagjumësinë, bulimin dhe anoreksinë. Hipnoza i lejonte të shkëpuste bllokimet dhe të bënte një lidhje të shkurtër të proceseve mendore mbrojtëse. Sidomos në gjendje pauze hipnotike, mjeku dhe pacienti i tij kishin akses në kasafortën e inkonshiencës ku janë magazinuar me mijëra të dhëna që qeverisin jetën e çdo qenieje njerëzore. Në këtë gjendje të veçantë, pacienti kishte mundësi të futej deri te kujtimet e harruara dhe të jetonte ëndrrat e zgjuara sikur ato të ishin të vërteta.

Për të drejtuar Markun, Elisonin dhe Evin në rrugën drejt shërimit, Konori kish ndërtuar një skenar si një lojë rolesh. Trupi "i shkëputur" dhe mendja e lidhur me një lloj realiteti virtual, ata u përballën me demonët dhe me frikërat e tyre më të thella. Për disa orë rresht, Konori i kishte drejtuar, duke shqiptuar me një zë të ngadalshëm sugjerime për t'i orientuar më mirë drejt rrugës së zisë, të pranimit dhe të faljes. Hipnoza pra, kishte luajtur kështu rolin e një katalizatori terapeutik, duke iu dhënë mundësi mendjeve të tyre që të realizojnë për disa orë evoluime, të cilat do të kishin dashur disa vjet me psikoterapi klasike.

Për të theksuar këtë periudhë të thellë, Konori kishte

konceptuar një kaskë manjetike, që duke vendosur kontekstin kohor në një fushë manjetike intensive, do të arrinte të shpërbënte ndërgjegjen e pacientëve. E kombinuar me DMT, ai kish shkaktuar halucinacione të fuqishme si dhe daljen në pah të kujtimeve intensive të marra që nga fëmijëria e tyre ose nga periudhat traumatike të jetës.

Tashmë që janë zgjuar plotësisht, Marku, Elisoni dhe Evi shikojnë njëri-tjetrin me mëdyshje. Që nga nata e Krishtlindjeve, Konori zhvillonte me ta biseda psikologjike individuale dhe bëri kujdes që ata të mos takoheshin me njëri-tjetrin. Pra, ishte hera e parë "në jetën e tyre të vërtetë" që ata shihnin njëri-tjetrin dhe, edhe nëse askush nuk guxoi t'u flasë të tjerëve, ata e dinin që tashmë ishin të lidhur nga një fije e padukshme. Fizikisht, ata ndiheshin pak të lodhur, pa fuqi, sikur të kishin vrapuar me orë të tëra pa marrë frymë. Por evoluimi më i qartë për ta ishte në trurin e tyre. Në sajë të *hard diskut* të kompjuterit, truri u jepte përshtypjen sikur ata ishin të programuar, të copëzuar, të pastruar nga këto viruse dhe nga *failat* e infektuara. Por a ishin çliruar ata nga pesha e hidhërimit dhe e fajësisë që i stërmundonte që prej kaq shumë kohësh?

* * *

Pasi u larguan nga klinika, ata u gjenden të gjithë bashkë në shëtitoren e *Battery Park City*-t.

Shëtitorja e rrahur nga një erë e fortë, ndiqte rrjedhën e lumit. Sot ajo ishte e mbushur plot me vrapues, me shitës ambulantë, me patinatorë, etj. Dielli po perëndonte tashmë, por qielli kishte akoma këtë shkëlqim elektrik që nxirrte në

pah ngjyrën pranverore të lulishteve ku fëmijët luanin frizbi me top.

Disi më i tërhequr, Konori vërente tre pacientët duke pyetur veten se vallë çfarë u rezervonte e ardhmja atyre. Pasi dalin nga gjendja e tyre hipnotike, pacientët ndihen më të çliruar dhe më të lehtësuar, por rezultatet për një kohë më të gjatë nuk janë të garantuar. Konori kish pasur të sëmurë të cilët kish menduar se ishin shëruar por që kishin vrarë veten në mënyrë të pa shpjegueshme. Të tjerë që konsideroheshin "raste pa shpresë", jetonin edhe sot duke pasur një jetë normale dhe të lumtur.

A mund të ishte ky rasti i Elisonit? Trashëgimtarja mori një taksi. Nga xhami i makinës, e pa tek po i tregonte shoferit se ç'drejtim të merrte, duke folur me të për disa çaste. Më në fund, taksia u nis dhe para se ajo të zhdukej në lumin e makinave të tjera, neurologu dhe gruaja e re shkëmbyen një shikim të shkurtër por të thellë. Imazhi i fundit që Konorit i mbeti nga Elisoni ishte dora e saj ishte mbështetur në xham, si për t'i thënë lamtumirë.

Ndërsa Nikola po largohej edhe ajo në drejtim të makinës së saj, Marku dhe Konori pranë njëri-tjetrit heshtnin me sy të papërqendruar.

- As mund ta besosh sa të vërteta të dukeshin gjërat atje..., - i thotë Marku, duke thyer heshtjen.

Konori e shikoi me dashamirësi.

- Lajla... - vijoi Marku, me një zë që po i dridhej, - ishte kaq reale..., kaq e vërtetë...

- Ishte e vetmja mundësi që kisha për të të ndihmuar, - u shpjegua Konori. - Kur ti erdhe për Krishtlindje, nuk ishe në

gjendje të përballoje lajmin e vdekjes së vajzës tënde. Do të kishe vdekur edhe ti vetë.

- Kjo është e vërtetë, - pranoi Marku.

Shikimi i tij u përhumb në drejtim të oqeanit, nga ana e statujës së Lirisë dhe Ishullit Elis. - Faleminderit që më dhe mundësinë t'i flas edhe një herë të fundit, - tha Marku. - Kjo ishte shumë e rëndësishme për mua...

Konori pa shokun e tij. Lot të qetë po i rridhnin mbi pulovër e në tokë. Ndërsa të dy burrat mbërthehen në krahët e njëritjetrit, Marku shtoi:

- Sa mirë që ishte ajo, që ta dish. Dukej sikur ishte e lumtur atje lart...

Atje lart...

Kjo fjalë ushtoi çuditshëm në mendjen e tyre dhe përsëri, secili u mbyll në heshtjen e tij, duke medituar për kuptimin që duhet t'i jepnin fjalës *atje lart:* produkt i pastër i një truri nën hipnozë apo një *më tej* i vërtetë?

Berlina e Nikolës u ndal para tyre, duke u ndërprerë kështu meditimin. Violinistja hapi xhamin elektrik dhe me një ton të shkëputur që nuk e fshihte mirë një lloj ankthi, pyeti të shoqin:

- Ku do të shkosh?

Pa nguruar Marku u ul pranë saj dhe u përgjigj:

- Në shtëpinë tonë.

* * *

Dielli tashmë ishte zhdukur. Edhe dhjetë minuta dhe ngjyra rozë e kullave të *Battery Park*-ut do të bëhej një ngjyrë kafe në gri. Konori shkoi në drejtin të Evit pranë kolonave të

marinës që rrethonin serën e *Winter garden*-it. Edhe pse vendi është i dëmtuar nga atentatet, nuk dukej më asnjë shenjë nga 11 shtatori. Megjithatë, *Ground Zero* ishte shumë afër dhe ai valëvitej akoma në ajrin me pak si shumë vdekje, erë, jetë...

E ulur në një stol përballë lumit, vajza e re vështronte pa shikuar anijet e bukura me vela të rreshtuara në *North Cove*.

- Si e ndjen veten? - pyeti Konori duke u mbështetur në murin mbajtës.

- Mirë, - u përgjigj Evi me një ton asnjanës.

Pa ia ndarë sytë adoleshentes, Konori ndezi një cigare dhe e thithi disi me nervozizëm. Ai do të kish dashur që terapia e tij të triumfonte dhe që Evi të hiqte plotësisht dorë nga hakmarrja për vrasësin e së ëmës.

- Do t'ju vrasë, - konstatoi ajo pas një heshtje të vogël.

- Kush?

- Cigarja.

Konori ngriti supet.

- Ka shumë gjëra që të vrasin...

- Domethënë nuk trembeni se mund të vdisni?

Konori u mendua për një çast, duke nxjerrë shtëllunga tymi nga goja.

- Të jetoj, më tmerron më shumë, - pohoi ai me një sinqeritet nga i cili u befasua edhe vetë.

Megjithatë, e hodhi cigaren në lumë dhe i rezistoi tundimit për të ndezur një cigare tjetër.

Këto javët e fundit nuk kish fjetur shumë. Gjatë gjithë kësaj kohe, çdo ditë e çdo natë ai kish punuar me këmbëngulje dhe si perfeksionist për të përpunuar të gjitha etapat e kësaj terapie kolektive. Dhe tani, e gjithë lodhja e mbledhur po shpërthente papritur, duke ia thyer trupin e duke ia bërë të turbullta

mendimet. Megjithatë, akoma nuk e kish përfunduar plotësisht "misionin" e tij. Duhej të sigurohej që Evi nuk do të hakmerrej dhe të vriste doktorin Kreg Devis. Për të qenë i sigurt, ai kishte vetëm një mundësi. Një mjet i dhunshëm dhe i pazakontë i cili nuk mësohej në shkollat e mjekësisë. Por ai nuk ishte një mjek si gjithë të tjerët... Suksesi i tij, paratë, vetura luksoze, apartamenti që kushtonte dy milionë dollarë: të gjitha këto ishin vetëm pluhur e erë dhe ai e dinte këtë. Ai asnjëherë nuk kish qenë pjesë e këtij rrethi të ngushtë e këtyre psikologëve njujorkezë. Ajo botë nuk ishte e tij. Bota e tij, ishte ajo e lagjeve të varfra të Çikagos, bota e fëmijërisë së gjymtuar, e dhunës dhe e frikës.

Pas një ngurrimi tjetër, ai iu afrua Evit, u ul pranë saj dhe nxori nga xhepi i palltos një pistoletë me dorezë argjendi.

* * *

Kjo është arma që u ka marrë jetën 20 vjet më parë dy shitësve të drogës. Një provë shkatërruese nga e cila ai nuk ka mundur të shkëputet, sikur një shqisë e gjashtë t'i kish thënë se ndoshta një ditë ai do të kish përsëri nevojë për të.

Evi, kur pa armën qëndroi stoike. Si Konori edhe ajo vjen nga bota e poshtme: bota e zhurmave, goditjeve, nga bota ku e keqja ndodh shumë më shpesh se e mira.

- E gjeta, - shpjegon Konori.

- Kë? - e pyet ajo duke ngulur shikimin e saj në të tijin.

- Kreg Devisin, vrasësin e mamasë tënde.

Fytyrat e tyre tashmë ishin larg njëra-tjetrës vetëm disa centimetra. Konori e pa Evin të dridhej lehtë dhe një flakë sikur i shndriste në sy.

- Ai banon në një ndërtesë të vogël, mbrapa katedrales *St. John the Divine*. Që prej një jave, unë shkoj atje çdo natë. E di numrin e tij të apartamentit, kodin e portës së hyrjes, oraret e lëvizjeve të tij, si dhe vendin ku ai bën blerjet.

Instinktivisht Evi e ndjeu që Konori po i thoshte të vërtetën, por ajo nuk dyshoi për asnjë çast për propozimin që do t'i bënte:

- Po të më thuash ti, unë jam gati të shkoj ta vras, - tha duke treguar me sy pistoletën.

Evi u turbullua nga oferta që po i bënte Konori.

- Nëse ti do vërtet të hakmerresh, - vijoi neurologu, - kjo punë mund të mbyllet që sonte. Mjafton të thuash një fjalë dhe për një orë Kreg Devisi nuk do të jetë më në këtë botë.

Evi e humbi edhe më keq pusullën tani që ishte e bindur që ato që po i thoshte Konori nuk ishin fjalë të lëshuara kot në erë.

- Tani, je ti ajo që vendos, - tha Konori duke u ngritur, i ndërgjegjshëm që e kish lënë fatin e jetës së tij në duart e adoleshentes.

* * *

Kaloi më shumë se një minutë para se Evi t'i afrohet përsëri Konorit pranë parmakut. Pa asnjë fjalë, me delikatesë, ajo ia merr nga duart pistoletën, dëshmia e vetme e një ngjarje të dhimbshme që kish lënë shenja në jetën e doktorit.

Me një ndjenjë të pasigurt ku ngërtheheshin neveria, admirimi, ajo e pa armën disa sekonda para se ta hidhte me të gjithë forcën e saj në ujërat e ftohta të Hudsonit.

* * *

Dielli tashmë ishte zhdukur. Përballë shfaqjes së qiellgërvishtësve, çdo gjë ishte e shkretë. Konori dhe Evi kishin qëndruar shumë kohë pa folur, pa lëvizur, së bashku dhe vetëm. Pastaj kish filluar të frynte erë dhe Evi zuri të dridhej.

Ndërsa ktheheshin nga klinika, Konori i hodhi mbi supe Evit pallton e tij.

I hodhën njëri-tjetrit një vështrim të qetë, dhe Konori e kuptoi se e kishte shpëtuar Evin.

Dhe se edhe Evi e kish shpëtuar atë gjithashtu.

EPILOGU NR. 1

Jeta më pas...
Marku & Elisoni

Marku nuk filloi më punë në kabinetin e Konorit.

Dy muaj pas terapisë, ai gjeti një vend pune si "psikiatër i rrugës" në kuadrin e një shoqate në ndihmë të endacakëve. Gjatë gjithë ditës, ai endej nëpër qytet, kontrollonte rreth 100 persona pa vendbanim të përcaktuar të cilët mundohej t'i shpëtonte nga alkooli, nga rruga dhe që të mund të kishin një jetë normale. Ai u përkushtua plotësisht në këtë përpjekje të re dhe pati arritje të mira. Zbritja e tij në skëterrë e kish transformuar atë: psikologu i ri, ambicioz dhe i sigurt në vetvete, ia kishte lënë vendin një njeriu më të brishtë, por më njerëzor.

* * *

Shpesh i ndodhte të shihte Lajlën në një qoshe rruge, e ulur në shkallët e një peroni ose të një shilarësi të ndonjë kopshti. Ajo kish gjithmonë të njëjtën fytyrë të bukur, të qetë,

si në avion. Ajo nuk fliste por i bënte shenjë me dorë dhe ai bënte të njëjtën gjë në mënyrë të fshehtë. Sikur qetësohej që ajo ishte diku aty, në hije dhe të kujdesej për të sikur të ishte engjëlli mbrojtës i saj i fëmijërisë. Për këtë ai nuk foli as me Konorin e as me Nikolën, sepse e dinte se këto imazhe të së bijës shfaqeshin vetëm në kokën e tij. Por ç'rëndësi kishte: ky aspekt imagjinar bënte pjesë në ekuilibrin që ai kish krijuar për të rimarrë veten.

Dhe për Markun kjo ishte shumë e rëndësishme.

* * *

Një ditë të bukur shtatori, duke ndezur radion, Marku mori vesh vdekjen e Elison Harrisonit në një aksident helikopteri në Amazonë. Duke drejtuar një nga fondacionet që kish krijuar i ati, trashëgimtarja e re, që prej disa muajsh i ishte përkushtuar luftës ekologjike kundër shkatërrimit të pyjeve të mëdha tropikale.

* * *

U deshën shume javë që të lokalizoheshin mbetjet e helikopterit, por asnjëherë nuk u gjend as trupi i pilotit brazilian dhe as ai i trashëgimtares së pasur.

* * *

Në nëntor, Marku mori një kartolinë e ardhur nga *Lhassa*. Kjo fotografi tregonte një skulpturë të rrotës së jetës para hyrjes së një manastiri tibetian.

Letra nuk ishte firmosur, por ai e kuptoi menjëherë që këtë kartolinë ia dërgonte Elisoni.

Në kartolinë ishin shkruar këto fjalë:

Mendoj shpesh për ju.

Ndoshta kishit të drejtë: ndoshta mund të rifillosh nga e para jetën tënde dhe të mos mjaftohesh vetëm duke e vazhduar atë. Të paktën kjo është shpresa tek e cila jam varur tashmë.

Duke pritur, do të doja t'ju dërgoja diçka. Këto shënime i kam gjetur në një nga blloqet e tim ati. Më pëlqen të besoj se ai i ka shkruar me shpresë se do t'ua jepte një ditë...

Pas këtyre fjalëve, kishte tre fjalë të tjera: *Gjatësi, gjerësi, lartësi...*

Të shoqëruara me një numër shifrash, të cilat e futën Markun në mendime deri sa ai të arrinte të kuptonte domethënien e tyre.

Këto ishin koordinatat GPS të vendit ku ishte varrosur Lajla.

* * *

Një të shtunë dhjetori, Marku dhe Nikola përshkuan me makinë masivet malore dhe fushat shkëmbore të shkretëtirës Mojave. Në një fillim pasditeje pa diell, ata u gjendën në një

vend të sheshtë, jo shumë larg nga kufiri i Nevadës. Siç ua u tregonte dhe GPS, ata dolën nga rruga kryesore për të marrë një rrugë pa rrugë, me gurë e pluhur dhe me shkëmbinj të zhveshur. Në mes të kësaj toke djerrë, ata vunë re një parcelë disi të veçuar, me tokë disi më të ngritur, ku ndodhej një pemë Joshua. Ata e kuptuan tashmë se ishin *aty*. Zbritën nga makina dhe të kapur për dore, u afruan pranë vendit ku ishte varrosur vajza e tyre e vogël.

Gjashtë vjet pas vdekjes së saj, ata mundën më në fund t'i thonë asaj lamtumirë.

* * *

Pastaj jeta i arriti...

Një ditë Marku u befasua edhe vetë tek buzëqeshi dhe foli përsëri për të ardhmen.

Me kalimin e kohës, shfaqjet e Lajlës filluan të rrallohen. Jo se ai nuk mendonte për të bijën, por ai mendonte për të në një mënyrë të ndryshme.

Tani ai e kujtonte të bijën pa vuajtur në mënyrë të llahtarshme.

Një mbrëmje Nikola i tha se ishte shtatzënë dhe Marku e priti gjithë gëzim këtë lajm.

Ata u bënë me një djalë, pastaj me një të dytë pas tre vjetësh.

* * *

Dhe vitet kalonin...

Në fund të një pasditeje të korrikut, dhjetë vjet pas fillimit

të kësaj historie, ndodhi një takim i çuditshëm në aeroportin e *Heathrow*-t.

Atë verë, Marku dhe Nikola kishin marrë pushime të gjata për t'i treguar djemve të tyre, Teos, tetë vjeç dhe Semit, pesë vjeç, mrekullitë e kontinentit të vjetër. Pasi kishin vizituar Athinën, Firencen, Parisin dhe Londrën, familja Hetëuej përgatitej të fluturonte në drejtim të Lisbonës.

- Eja, eja Semi! - e mori Marku të birin për ta vendosur mbi supet e tij, ndërsa Nikola mbante për dore Teon. Kështu, të katër bashkë po ngjisnin shkallët vetëlëvizëse që të çonin në zonën e imbarkimit të pasagjerëve.

Një çift po zbriste nga shkallët përballë. Burri, një tip amerikano-jugor, po shqyente me sy gruan dhe vajzën e tij, një metise e bukur me ngjyrë çokollatë.

Kur të dy familjet u ndodhën në të njëjtën lartësi, shikimi i Markut kryqëzoi shikimin e gruas që po kalonte nga ana tjetër. Ai ishte i sigurt se ajo ishte Elison Harrisoni. Nga ana fizike ajo kish pësuar një metamorfozë: biondja me forma te bollshme dhe me pamje të sofistikuar, tani ishte një grua e lulëzuar, brune, me disa forma të rrumbullakëta që i jepnin asaj një pamje të qetë. Vetëm sytë e saj nuk kishin ndryshuar.

Shpesh Marku e kish pyetur veten se ku bëhej vallë Elisoni. Disa muaj pas vdekjes së ashtuquajtur, ai kish lexuar në gazeta se vejusha e Riçard Harrisonit kish marrë në dorë frenat e perandorisë *Green Cross* pas humbjes tragjike të Elisonit.

Dhe vetëm kaq.

Me këtë informacion të fundit, Elisoni i ndërpreu marrëdhëniet me shtypin, ajo, që për vite të tëra, kish qenë një tabelë qitjeje për gjithë botën.

Kur Marku pyeste veten për ndjenjat e tij për Elisonin, ai

nuk ndjente asnjë ligështim apo hidhërim dhe madje shpresonte që ajo të kish gjetur paqe e qetësi.

Kur ai e pa në shkallën lëvizëse, Marku e vuri re se ish trashëgimtarja e kish rifilluar jetën me një identitet tjetër se bashku me pilotin e helikopterit, i cili e kish ndihmuar të simulonte një vdekje dhe se më në fund ajo ishte e lumtur.

Edhe Elisoni e njohu Markun. Ata shkëmbyen vetëm një shikim, por secili prej tyre pa në shikimin e tjetrit pasqyrimin e të gjithë asaj që ata ndjenin.

EPILOGU NR. 2

Historia e tyre...
Evi & Konori

Çikago

Evi doli duke vrapuar nga spitali dhe hipi në një taksi që po e priste që prej 20 minutash. Ajo i dha shoferit adresën e një restoranti në *Magnificient Mile*, pastaj, akoma me bluzë të bardhë, filloi të ndërrohej brenda në makinë.

Kishin kaluar dhjetë vjet që nga takimi i tyre i parë me Konorin. Adoleshentja e dobët dhe e rreckosur, ishte bërë një grua e re e bukur 25 vjeçare. Para dy muajsh ajo ishte diplomuar në mjekësi dhe këtë javë fillonte vitin e parë si mjeke e brendshme në shërbimin e të djegurve rëndë në *Chicago Presbiterian Hospital*. Pikërisht në këtë spital, vite më parë ishte kuruar Konori pas agresionit që iu bë. Një koincidencë që në fakt nuk ishte vërtet e tillë...

Evi kish bërë çfarë qe e mundur për të marrë këtë post. Ajo kish dëshiruar të vinte në qytetin ku Konori kish lindur dhe ku kish kaluar fëmijërinë e tij. Ajo donte të ecte në gjurmët

e tij, të shihte ato që kish parë ai, të vuante ato që kish vuajtur ai, deri sa ajo të bëhej njësh me të.

Për të festuar diplomën e saj, ajo e kish ftuar Konorin në restorant. Kjo ishte një lloj mënyre për ta falënderuar për të gjitha ato që ai kish bërë për të që prej dhjetë vjetësh: ai që kish qenë gjithmonë pranë saj, që i kish paguar studimet dhe që e kish pranuar në gjirin e familjes që formohej edhe nga Marku me Nikolën.

Pastaj ajo donte t'i thoshte diçka gjithashtu.

Diçka që i peshonte në zemër që prej shumë kohësh...

* * *

Para dy ditësh, gjatë një vizite të përgatitur për personelin e ri, Evi ishte takuar me dekanen e spitalit, Lorena Mekkormikun, e cila më parë drejtonte pavijonin e djegieve të rënda. Pa e parë kurrë më parë, Evi e dinte kush ishte ajo. Konori i kish folur për të dhe për përkushtimin e saj gjatë mjekimit të Konorit.

- Në saj të saj, unë jam akoma në këtë botë, - i kish thënë Konori Evit, në çastet e tij të sinqeritetit.

Pra Evi ishte kureshtare të njihte doktoreshën. Ajo që e befasoi, në fakt, ishte se dekania e pa me shumë vëmendje doktoreshën e re, ndërkohë që ajo nuk kishte se si ta dinte se kush ishte kjo.

Doktoresha e re u zu edhe më ngushtë akoma të nesërmen kur ajo kish marrë një *e-mail* nga dekania, i cili kufizohej thjesht në një numër dosjeje të një pacienti misterioz. Evi u interesua të informohej, por dosja ishte shumë e vjetër dhe nuk mund të shihej *online*. Në mes të natës kur kishte mbaruar turnin e

saj, ajo shkoi në arshivë, në katin e tretë të spitalit. Ajo kish kërkuar me orë të tëra nëpër korridoret e raftet e shumtë të arshivave deri sa gjeti numrin e dosjes që i kishte dhënë dekania.

Ishte dosja e Konorit.

* * *

Ajo e hapi, me duart që i dridheshin. Në mes të radiografive dhe raporteve të ndryshëm mjekësorë të ndërhyrjeve të shumta, Evi vuri re me dhjetëra vizatime të kryera nga Konori kur ishte i shtruar në këtë spital. Me grykën që i shtrëngonte, ajo pa me vëmendje vizatimet e para, pastaj të tjerat. Gjithmonë ishte e njëjta figurë gruaje, e vizatuar me shumë ëmbëlsi.

Dhe çuditërisht kjo ishte fytyra e saj.

* * *

Ajo vendosi ta interpretojë këtë episod si një shenjë të fatit. Një shenjë që i jepte kurajë t'i shprehte dashurinë e saj Konorit.

Rrënjët e ndjenjës së saj ishin të thella. Pas seancës së hipnozës, Konori e ndjeu veten përgjegjës për këtë vajzë të re që i kujtonte shumë adoleshencën e tij.

"Ajo është dora jonë", - kishte thënë Marku gjatë terapisë, dhe është e vërtetë që ata kishin kaluar të njëjtat vështirësi dhe kishin ndjerë të njëjtat poshtërime.

Që në fillim, ata u bënë të afërt për njëri-tjetrin dhe afeksioni i Konorit për Evin vetëm shtohej me kalimin e viteve.

Nga ana e saj, Evi vetëm atë kish në këtë botë. Duke i

pranuar ndihmën, ajo e kish lënë jetën e saj në duart e tij dhe ai ishte gjithçka për të. Shpesh ajo kujtonte listën e gjatë që kish bërë në fund të ditarit të saj, kur jetonte në Las Vegas. Ajo asnjëherë nuk kishte shkuar me pushime me të ëmën. Kjo e fundit kish vdekur pa mundur të bënte transplantin e veshkës. Por Evi kish arritur të shkonte në Nju Jork dhe më në fund kish gjetur dikë që ta kuptonte.

Për sa i përket dëshirës së saj - "që një ditë, dikush të bjerë në dashuri me mua" - ajo dëshironte vetëm një gjë: që ky të ishte Konori.

* * *

Konori mbërriti i pari në restorant. Ai ia la parkuesit të makinave të merrej me BMW-në *coupe* që e kish marrë me qira në aeroport dhe mori ashensorin që të çonte në tarracën panoramike nga ku dukej gjithë pamja e Çikago Riverit. E vendosën në një tavolinë me diell të bollshëm nga ku mund të admironte pyllin e madhërishëm të qiellgërvishtësve që shtriheshin përballë tij. Ishte hera e parë që ai kthehej në qytetin ku kish lindur dhe nga i cili ish larguar 30 vjet më parë në rrethana krejt tragjike. Ai iku si i nëmur dhe po kthehej si fitimtar.

Këto dhjetë vitet e fundit kishin qenë plot shkëlqim. Eksperimentimet e tij në fushën e terapisë me hipnozë tashmë ishin të njohura dhe të pranuara dhe jepeshin si lëndë në shkollat e mjekësisë. Në sajë të kësaj metode, ai kish kuruar me qindra pacientë dhe kish marrë për dy vjet rresht titullin *Best Doctor in America.*

Në aspektin familjar, ai ishte nuni i dy djemve të Markut,

me të cilin takohej pothuajse çdo ditë. Edhe pse nuk punonin më bashkë, dy shokët ishin shumë të afërt me njëri-tjetrin. Madje Marku ishte i vetmi të cilit i kishte besuar sekretin e tij që e torturonte prej më se dy vjetësh dhe kundër të cilit ai mundohej të luftonte...

* * *

Në taksi, Evi hoqi atletet dhe në vend të tyre veshi një palë këpucë elegante. Nxori nga çanta qesen e tualetit. Ja pra, pak të kuq e krem dhe çdo gjë në rregull. Ajo donte të dukej e bukur, si në vizatimet e Konorit.

Si do të reagonte vallë ai kur kjo do t'i deklaronte dashurinë e saj? Ajo as që dinte absolutisht asgjë. Por kurrsesi nuk mund ta mbante fshehur akoma dashurinë e saj, sepse duke u rritur, kjo dashuri po i zinte frymën dhe po e shkatërronte.

Çdo gjë e bukur dhe e mirë që i kishte ndodhur në jetë kishte vetëm një emër: Konor. Shpesh ajo pyeste veten se çfarë mund të kishte qenë jeta e saj nëse ajo nuk do të kish takuar në rrugën e saj neurologun e famshëm, në atë natë të magjishme të Krishtlindjeve ku ajo ish orvatur t'i vidhte çantën. Ku mund të ishte ajo tani? Në burg? Do të kish vdekur? Pastruese në një motel në zonën e tretë? Shpesh fati në jetë qëndron në fare pak gjë: një takim, një vendim, një fat, një fije...

Gjatë gjithë këtyre viteve, ishte munduar t'i tërhiqte vëmendjen, duke i kërkuar gjithnjë miratimin e tij. Çdo gjë të re që ndërmerrte, ajo e bënte vetëm për Konorin. Sepse vetëm me të e ndjente veten vetvetja. Konori ishte pjesa që asaj i

mungonte. Ai dinte gjithçka për të. Ajo filloi të ndjente frikë, dyshim, pasiguri.

Sidomos kjo i ndodhte kur mendonte për të ardhmen e saj. Gjithmonë pranë saj shihte vetëm atë dhe nuk imagjinonte asnjeri tjetër që të ishte babai i fëmijëve të saj.

* * *

Konori pa orën dhe piu një gllënjkë ujë mineral. Përse e kishte pranuar ftesën? Përse të vazhdonte ta vuante këtë vuajtje?

Për një kohë të gjatë Evi dhe ai merreshin vesh shumë mirë. Pastaj, këto kohët e fundit, Konori ishte larguar, duke shumëfishuar konferencat jashtë shtetit dhe duke i rralluar edhe telefonatat. Pse? Sepse e kish kuptuar se kish rënë në dashuri me Evin dhe se nuk ishte më i zoti ta fshihte dashurinë e tij e të dukej sikur të ishte thjesht një ndjenjë miqësore. Ai donte çdo gjë tek ajo: zërin e saj, veprimet që ajo bënte, buzëqeshjen e saj, ngjyrën e lëkurës. Dhe ajo dinte gjithashtu gjithçka për të. Kur ishte me të, Konorit i dukej sikur i zgjohej diçka që e kish ndrydhur thellë brenda vetes: shpresën, dëshirën për t'u hapur me të tjerët dhe besimin në të ardhmen. Si neurolog, e dinte shumë mirë se procesi i dashurisë nuk ishte tjetër veçse një çështje biologjie, hormonesh dhe neurotransmetuesish. Por kjo nuk e ndihmonte në zgjidhjen e problemit të tij: duhej që ai të shkëputej nga kjo dashuri.

Edhe sikur të fitonte zemrën e Evit, perspektiva se mund ta humbiste një ditë, mjaftonte që ai të hiqte dorë nga kjo dashuri. Ai ishte 45 vjeç. Ishte në majë të famës dhe të karrierës së tij. Për çastin ishte akoma i lezetshëm dhe joshës. Po nesër?

Dhjetë, pesëmbëdhjetë, apo njëzet vjet më vonë?

Papritmas duke mos u përmbajtur dot, u ngrit në këmbë. Çfarë dreqin bënte në këtë restorant turistësh, duke pritur një grua që nuk mund ta dashuronte kurrë?

La një kartëmonedhë mbi tavolinë dhe u drejtua për nga dalja dhe kërkoi ashensorin.

* * *

Taksia e la Evin përpara restorantit.

Ajo kaloi hollin dhe kërkoi ashensorin për t'u ngjitur në tarracën e restorantit.

Të dy kabinat u kryqëzuan dhe asnjeri prej tyre nuk dinte asgjë.

E çfarë duhet që dy të dashuruar të mos takohen? Një grusht sekondash, një ngurrim, një shans, një fije...

* * *

Gjatë tridhjetë vjetëve pak gjëra kishin ndryshuar në *Greenwood*. Procesi i borgjezimit që kish prekur pjesën e *South Side*-it nuk kish prekur akoma kullat e rrjepura e të dalë boje të qytetit të fëmijërisë së tij. Konori e ndaloi makinën e tij të re akull në mes të parkimit. Në kohën e tij, një veturë e tillë në këtë vend do ishte djegur menjëherë në më pak se një çerek ore. A do të duhej më shumë kohë sot? Sigurisht që jo, po të vështroje me kujdes shikimet që po i hidhnin atij një grup nga kjo zonë. Konori kaloi para tyre pa devijuar nga rruga. Një top basketbolli i erdhi deri te këmbët. Ai u ul, e mori topin dhe

e dërgoi në drejtim të dy fëmijëve që po luanin "njëri kundër tjetrit" në fushën ku Marku dhe Konori kishin luajtur e ku kishin prishur këpucët e tyre. Me njëfarë druajtjeje, Konori u fut në hollin e ndërtesës së tij të vjetër ku kishte jetuar kohë më parë. Vetëm një pjesë e kutive postare ishin shkulur. Në ato që kishin mbetur, dalloi disa emra që më parë i kish njohur, por jo atë të familjes që e kishte strehuar. Në sheshpushimin e katit, një fëmijë po bënte detyrat në heshtje.

Gjithmonë ka një, mendoi Konori duke e përshëndetur me kokë.

Pastaj Konori mori shkallët që të çonin te lokali i kazanëve të plehrave. Me hap të pasigurt, zbriti ngadalë duke u mbajtur te parmaku prej betoni. Përse po e bënte këtë? Çfarë do të gjente në këtë ambient të ftohtë e të errët ku ai kish humbur fëmijërinë e tij? *"Hë mor trap, a e di se çfarë bëjmë ne me plehrat?"*

Ai u kthye i tromaksur, por nuk kishte njeri. Ishte thjesht imagjinata e tij që nuk ishte në rregull. Tridhjetë vjet kishin kaluar që nga ajo natë tragjike, por, në kokën e tij, edhe tani plaga ishte po aq e gjallë.

Kur mbërriti te pragu i kësaj kthine plehrash, ndezi çelësin e dritave. Kthina vazhdonte të ishte në errësirë, sikur llamba e thyer nuk ishte zëvendësuar që nga ajo kohë. Ngurroi të hyjë. Çfarë donte të provonte? Që nuk kishte më frikë? Që mund të përballej me demonët e tij?

Gjithnjë me druajtje, u fut në këtë dhomë dhe e mbylli derën metalike duke e shtyrë nga brenda.

"Trapat, ne i djegim", - u dëgjua një zë në kokën e tij.

Tashmë ishte i vetëm në terr, i rrethuar nga errësira. Ai e ndjente që trupi i dridhej i tëri dhe bulëza të mëdha djersësh të ftohta i rrëshqisnin në kurriz. U dëgjua një zhurmë tjetër,

dhe me gjithë errësirën iu duk se shqoi siluetën fantazmë të një fëmije 15 vjeçar. Zemra filloi t'i rrahë më fort. Bëri disa hapa në drejtim të hijes dhe e pa veten ashtu siç ishte dikur me zbehtësinë e tij, dobësinë dhe rrobat shumë të ngushta për moshën që kishte. Fëmija që ai kish qenë dikur e shihte si një vizitor i shumëpritur prej kohësh. Konori filloi të ndjejë se brenda tij po zgjohej një frikë e stërmotshme e cila nuk i ish shqitur kurrë dhe që shpesh i kish prishur jetën.

- Ti nuk duhet të kesh më frikë, - i pëshpëriti adoleshenti i ri.

Konori iu përgjigj trishtueshëm:

- Në fakt unë kam frikë për ty.

Tjetri i hodhi një vështrim që sikur donte të sigurohej edhe vetë:

- Tani, unë jam më mirë.

Konori vuri dorën mbi supin e djaloshit që ai kish qenë, dhe pastaj mbylli sytë dhe e la frikën të lëvizte ngadalë.

Dhe pastaj të zhdukej.

* * *

Kur Konori doli nga ndërtesa, Evi e priste te makina. Asaj nuk iu desh shumë kohë që ta gjente se ku ishte. Thellë-thellë brenda vetes, e dinte që çdo gjë do t'i sillte këtu, në këto kulla të fëmijërisë, të cilat në fakt nuk i braktisim kurrë.

Me besim në vetvete, ajo ecën në drejtim të tij.

Ajo e dinte që tani çdo gjë do të shkonte mirë.

Sepse aty ku ka dashuri, nuk bën natë kurrë.

Fjalitë misterioze që shfaqen në faqet 100-101, njëra është e Marie Kyri ("Asgjë nuk të tremb, çdo gjë duhet kuptuar") dhe tjetra është e Ernest Heminguejit ("Një njeri mund të shkatërrohet, por jo të mundet").

"Në hijen e kullave të vdekura", shprehja e përdorur në kapitullin 29, është titulli i një albumi të ilustruar të Art Spiedelman, shkruar pas tragjedisë së 11 Shtatorit.

